



**RAPORT**

**(Auditim Financiar dhe i Përputhshmërisë)**

**BASHKIA KAVAJË**

**Tiranë 2024**

## PËRMBAJTJA

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>4-8</b>
1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit .....	
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve .....	
3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit .....	
<b>II. HYRJA .....</b>	<b>8-13</b>
2. Identifikimi i çështjes. ....	
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	
4. Përgjegjësitë e audituesve. ....	
5. Kriteret e vlerësimit.....	
6. Standardet e auditimit.....	
7. Metodologjia e auditimit. ....	
8. Dokumentimi i auditimit. ....	
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT .....</b>	<b>13-</b>
1. Informacion i përgjithshëm .....	13-14
2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit.....	14-168
2.1. Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik. ....	14-25
2.1.2. Mbi veprimtarinë e njësisë së AB.....	25-28
2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit. ....	28-36
2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave.....	36-74
2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar për vitin 2023.....	74-80
2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.....	80-117
2.4.1 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike. ....	117-129
2.5 Mbi organizimin, funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.....	129-150
2.6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtës së Territorit.....	150-162
2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm. ....	162-168
<b>IV. GJETJE DHE REKOMANDIME .....</b>	<b>168-196</b>
<b>VI. ANEKSET.....</b>	<b>196-245</b>

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

### 1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit.

Bashkia e **Kavajës** është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe ish-komunave në afërsitë të tij, pra në total ka 5 njësi administrative si vijon: Njësia Administrative Kavajë (qyteti), Njësitë Administrative Golem, Helmas, Synej, Luz i Vogël. Kavaja kufizohet në veri nga Bashkia Durrës, në lindje nga Bashkia Tiranë, në jug nga Bashkia Kavajë dhe në perëndim nga deti Adriatik. Bashkia e Kavajës shtrihet në një zonë kodrash të buta dhe fushash pjellore përreth Qytetit të Kavajës deri në detin Adriatik, ku gjenden plazhe pjesërisht ranore dhe pjesërisht shkëmbore. Qyteti i Kavajës është një qendër historike zejtare i cili e mori statutin e Kasabasë (ekuivalentin e titullit qytet) në vitin 1867.

**Misioni** i Bashkisë Kavajë është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

**Synimi kryesor** është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

**Buxheti i Bashkisë** Kavajë si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavaruar, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

**b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.** Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. *Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisë të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm.* 2. *Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë*”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Kavajë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

**c. Qëllimi i auditimit.** Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Kavajë. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve
- mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
- mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit, Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).
- mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

**Shënim:** Çështja; “Mbi vlerësimin e raportimit financiar për vitin 2023” nuk është shqyrtuar nga Grupi i KLSH për arsye se, auditimi në terren u krye në kohën apo gjatë afatit ligjor deri

31 mars 2024 të hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2023 dhe nuk u bë mundur auditimi i saktësisë dhe plotësisë së informacionit kontabël në lidhje me transaksionet financiare dhe mbylljen e llogarive financiarë të kësaj njësie shpenzuese.

#### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.**

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 20 gjetje dhe ka dhënë 21 rekomandime, nga e cila: masa organizative me 20 gjetje dhe 21 rekomandime, 4 gjetje-rekomandime shpërblim dëmi në vlerën totale 43,468 mijë lekë, 10 gjetje dhe 14 rekomandime në fushën e të ardhurave, si dhe një gjetje dhe rekomandim në 3-E.

#### **2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.**

a. **Paraqitja e gjetjeve kryesore.** Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

- ***Procedurat e zbatimit të kontratave të punimeve të ndërtimit***
  - Në **4 raste** janë konstatuar punime të pakryera me një **dëm ekonomik në vlerën 43,468,061 lekë.**
- ***Procedurat e prokurimit publik*** për punë publike, mallra dhe shërbime:
  - Në **7 raste** u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar.
  - Në **7 raste** kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së të gjitha kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DT.
- ***Procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit.***
  - **2 praktika** në lidhje me përlllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është përlllogaritur në mënyrën e duhur, duke evidentuar të ardhura të munguara në vlerën **15,237,176 lekë.**
  - Në **4 praktika** pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosrespektimin e kriterëve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe ato të përcaktuara në Planin e Detajuar Vendor, të tilla si koeficienti i shfrytëzimit të territorit, intensiteti i ndërtimit, lartësia e ndërtimit, distancat dhe tipologjia e lejuar sipas njësisë strukturore përkatëse, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.
  - Në **2 praktika** pasqyrohej e njëjta situatë në lidhje me pavlefshmërinë e dokumentacionit të pronësisë dhe kufizime të pronësisë në kartelën e pasurisë së paluajtshme, përpara miratimi të lejes të ndërtimit.
  - Në **3 praktika** pasqyrohej situata në lidhje me mungesën e marrjes së miratimeve dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, të paraqitura e ngarkuara në sistemin e-leje gjatë aplikimit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi.
  - Në **1 (një) praktikë** pasqyrohet situata në lidhje me mosrealizimin e marrëveshjes për 3% të sipërfaqes funksionale për kontributin e sektorit privat në favor të krijimit të fondit publik të banesave sociale, pasi nuk është përcaktuar në mënyrën e duhur tipologjia e ndërtimit.
  - Në **1 (një) praktikë** tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me miratimin e certifikatës së përdorimit pa pasur dokumentacionin e nevojshëm të ngarkuar në sistemin e-Leje dhe realizimi i objektit në terren në mospërputhje me lejen e ndërtimit të miratuar.

▪ **Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave**

- Janë evidentuar të ardhura të munguara më vlerën **142,546,882 lekë**, nga mos saktësimi dhe arkëtimi i detyrimeve nga taksat e tarifave vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjarë, nga e cila:

- Për kategorinë familjare në shumën 72,856,135 lekë, kjo për 19,771 familje;

- Për vlerën 6,088,673 lekë nga mos taksimi i 20 subjekteve për sipërfaqe ndërtesë (tendë), sipërfaqe reklame dhe mos pagesë taksave vendore nga 4 subjekte.

- Për vlerën 200,000 lekë për 20 subjekte si rezultat i mos aplikimit të tarifës “Leje aktiviteti 24 orësh” për vitin 2023;

- Për 15 subjekte në vlerën totale prej 15,716,667 lekë, nga taksa e autorizimit të lejeve për tregtim karburanti

- Për shumën 7,205,204 lekë, subjekte ndërtuese të pajisura me leje ndërtimi, që kanë ushtruar veprimtari ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Kavajë dhe nuk janë pajisur me certifikatë regjistrimi për adresë dytësore për çdo kantier ndërtimi për vitin 2023 sipas përcaktimeve në paketë fiskale;

- Për shumën 4,020,853 lekë detyrim për taksë pasurie e paluajtshme (ndërtesë dhe truall), pas pajisjes me Certifikatë Përdorimi për vitin 2023 për 22 subjektet sipas përcaktimeve në paketë fiskale;

- Për shumën 6,198,107 lekë për familjet të cilat janë trajtuar me tokë bujqësore;

- Për shumën 1,589,287 lekë të kategorisë biznes për 7 subjekte si rezultat i mosrespektimit të Aktmarrëveshjeve për shlyerjet e vlerave debitorë;

- Për shumën 243,689 lekë e cila u përket 5 subjekteve që kanë rezultuar me diferencë midis akt verifikimit dhe planifikimit;

- për shumën 16,326,291 lekë si pasojë e keq administrimit të aseteve;

- Për shumën 401,976 lekë nga 13 subjekte të cilët janë çregjistruar duke qenë debitorë për taksa dhe tarifa vendore;

- Për mos arkëtim nga 29 kundërvajtës i vlerës prej 11,700,000 lekë të gjobave të vëna nga IMT.

▪ **Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve**

Nga auditimi rezultoi se, janë transferuar në total **3176 pasuri** si ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat **2645 pasuri në pronësi** dhe **531 pasuri në përdorim** të Bashkisë Kavajë me VKM. Në total në pronësi të Bashkisë Kavajë janë **2645 pasuri**, nga të cilat **201 pasuri** janë të pajisura me certifikatë dhe **2444 pasuri** nuk janë të pajisura me titull pronësie. Nga Bashkia Kavajë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura.

**b. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:** Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

▪ Bashkia Kavajë në lidhje me **zbatimin e kontratave të punimeve të ndërtimit** të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, nga sipërmarrësit e punimeve arkëtimin e vlerës prej **43,468,061 lekë** të faturuara dhe të paguara nga AK, të konstatuar dëm ekonomik nga mos kryerja e punimeve.

▪ Bashkia Kavajë **në lidhje me të ardhurat** të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për:

-Arkëtimin e detyrimeve për 20 subjekte në vlerën prej **6,088,673 lekë** për vitin 2023 për një diferencë prej 3976 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtesë (tendë) dhe 347 m<sup>2</sup> sipërfaqe reklamë pa regjistruar në regjistrin elektronik të DTTVAB dhe si rezultat i mos pagesës së detyrimeve për taksa tarifa vendore për 4 subjekte që ushtrojnë aktivitet në këtë bashki.

-Arkëtimin e detyrimeve si rezultat i mosaplikimit të tarifës “Leje aktiviteti 24 orësh” për vitin 2023, në vlerën **200,000 lekë** për 20 subjekte.

- Arkëtimin e vlerës **7,205,204** lekë për subjektet ndërtuese të pajisura me leje ndërtimi, që kanë ushtruar veprimtari ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Kavajë dhe nuk janë pajisur me certifikatë regjistrimi për adresë dytësore për çdo kantier ndërtimi për vitin 2023 sipas përcaktimeve në paketë fiskale.
- Arkëtimin e vlerës **4,020,853 lekë** detyrim për taksë pasurie e paluajtshme (ndërtesë dhe truall), pas pajisjes me Certifikatë Përdorimi për vitin 2023 për 22 subjektet sipas përcaktimeve në paketë fiskale.
- Arkëtimin e detyrimeve për subjektet fizik/juridik në shumën **236,970,755 lekë**.
- Arkëtimin e detyrimeve për 20 subjekte në vlerën prej 6,088,673 lekë për vitin 2023.
- Arkëtimin arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara, *konkretisht* për 10 subjekte që nuk janë pajisur me licencë 5 vjeçare por me autorizim 1 vjeçar në vlerën 8,000,000 lekë, për 3 subjekte që ushtrojnë aktivitetin pa licencë pas përfundimit të vlefshmërisë në vlerën 2,100,000 lekë, për 5 subjekte debitor për vlerën 2,800,000 lekë, si rrjedhojë e mos likuidimit të tarifës së licencimit të tregëtimit të karburantit.
- Arkëtimin e vlerë 2,816,667 lekë e cila i përket 2 subjekteve që zhvillojnë aktivitet pa u identifikuar dhe regjistruar në regjistrin e të dhënave që administrojnë drejtoria e konsumatorit (nuk janë pajisur me licenca apo autorizime).
- Arkëtimin e detyrimeve si rezultat i mosaplikimit të tarifës “Leje aktiviteti 24 orësh” për vitin 2023, në vlerën **200,000 lekë** për 20 subjekte.
- Arkëtimin e vlerës **7,205,204** lekë për subjektet ndërtuese të pajisura me leje ndërtimi, që kanë ushtruar veprimtari ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Kavajë dhe nuk janë pajisur me certifikatë regjistrimi për adresë dytësore për çdo kantier ndërtimi për vitin 2023 sipas përcaktimeve në paketë fiskale.
- Arkëtimin e vlerës **4,020,853 lekë** detyrim për taksë pasurie e paluajtshme (ndërtesë dhe truall), pas pajisjes me Certifikatë Përdorimi për vitin 2023 për **22** subjektet sipas përcaktimeve në paketë fiskale.
- Arkëtimin e vlerës **6,198,107** lekë për familjet të cilat janë trajtuar me tokë bujqësore.
- Arkëtimin e vlerës **1,589,287** lekë të kategorisë biznes për 7 subjekte.
- Arkëtimin e vlerës **243,689** lekë e cila u përket 5 subjekteve që kanë rezultuar me diferencë midis akt verifikimit dhe planifikimit.
- Arkëtimin e vlerës **16,326,291** lekë, nga 4 subjekte në shumën **99,360 lekë** nga dhënia me qira e dyqaneve, nga dhënia me qira e banesave sociale për 21 familjet për shumën prej **4,845,417 lekë**, nga dhënia me qira e tokës bujqësore për 5 subjektet në shumën **8,707,016 lekë**, nga dhënia me qira e hapësirave stacione plazhi për 4 subjektet në shumën **1,964,100 lekë**, nga dhënia me qira e hapësirave publike për 3 subjekte në shumën totale prej **710,400 lekë**.
- Arkëtimin e vlerës **401,976 lekë** e nga 13 subjekte të cilët janë çregjistruar duke qenë debitorë për taksa dhe tarifa vendore.
- Arkëtimin e vlerës prej **11,700,000** lekë të gjobave të vëna nga IMT për kundërvajtje nga personat fizik/juridik.
- Arkëtimin e vlerës 15,237,176 lekë në **2 praktikat** në lidhje me përllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është përllogaritur në mënyrën e duhur.
  - Bashkia Kavajë në lidhje *me procedurat e prokurimeve publike* të marrë masat e nevojshme, që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.
  - Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, *në lidhje me lejet ndërtimit*, të marrë të gjitha masat për të respektuar kondicionet urbane, ku në çdo rast të ruhen distancat nga kufiri i pronës sipas përllogaritjes së parashikuar në rregullore. Të kërkojë çdo subjekti që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqëruar të tij,

sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi dhe të ngarkuar në sistemin elektronik. Në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, të merret mendimi i autoriteteve, të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Të marrë të gjitha masat për të përlloritur në mënyrë të saktë sipërfaqen ndërtimore me funksion banim e pjesë takuese të sipërfaqeve të përbashkëta për çdo aplikim për pajisje me leje ndërtimi.

▪ Në lidhje me **inventarizimin, përditësimin dhe regjistrimin e asetëve në ASHK** Bashkia Kavajë nëpërmjet strukturave drejtuese dhe përgjegjëse të kryejë procedurat e plota për miratimin e listave përfundimtare të pronave, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave paraprake të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve. Gjithashtu për pjesën tjetër të pronave të kaluara Bashkisë me VKM në pronësi/përdorim të pa hipotekuar të përgatisë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të ndjekë deri në fund regjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Rajonale Kavajë.

### 3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.

#### I. Opinioni mbi përputhshmërinë

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Kavajë për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik; c) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, d) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike.

#### Opinionin:

*Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit Bashkia Kavajë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionin të modifikuar/kualifikuar, e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

#### Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar në vlerën **33,306 mijë lekë**. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e opinionit të modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë.

Nga evidencat e marra për veprimtarinë e Bashkisë Kavajë, rezultuan:

- Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët në mënyrë progresive më datën 31.12.2023, në kenë vlerën **236,970 mijë lekë**;
- Në **7 raste** nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023, u konstatua se në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar plotësisht vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike, si dhe se OE janë shpallur fitues në kushtet e mos përmbushjes së kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DT;
- Në **3 raste**, janë konstatuar mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi;

- Në **4 raste**, janë konstatuar punime të porealizuara sipas kushteve të preventivit në zbatimin e kontratave të punëve publike me vlerë **43,468 mijë lekë, dëm ekonomik**;
- Në mos arkëtimin e gjobave nga IMTV me vlerë **20,300 mijë lekë**, me efekt mungesë ët ardhurash;
- Në mos arkëtimin e kontratave të qirave për vlerën **16,326 mijë lekë**;
- Në mos arkëtimin e detyrimeve për taksën e tokës bujqësore për vlerën **6,198 mijë lekë**;
- Në mos taksimin e subjekteve për taksa e tarifa vendore të ndryshme me vlerë **17,233 mijë lekë**;
- Në mos arkëtimin e taksës së subjekteve që tregtojnë karburante me vlerë **13,116 mijë lekë**;
- Në mos llogaritjen e saktë të TNI me vlerë **15,237 mijë lekë**, me efekt mungesë të ardhurash.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit të auditimit nr. 34/1 prot., datë 10.01.2024 (i ndryshuar), miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 15.02.2024, deri më 23.02.2024, në institucionin Bashkia Kavajë u krye auditimi “Financiar dhe i Përputhshmërisë”. Auditimi mbuloi periudhën prej datës 01.01.2023 deri me datën 31.12.2023.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. G.K (Përgjegjës grupi)
2. J.G anëtar
3. A.Ç anëtare
4. O.F anëtare

## OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

**Objekti dhe qëllimi i auditimit:** Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Kavajë.

**Identifikimi i çështjes:** Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 “Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjisllacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi”, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe



përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Kavajë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Kavajë.

**Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.** Kryetari i Bashkisë Kavajë (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Kavajë, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësive së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.<sup>1</sup>

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

**Përgjegjësitë e audituesve.** Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Kavajë dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësi të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë

---

<sup>1</sup> Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 15

të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kutueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Kavajë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, paragrafi 44-51.

**Kriteret e vlerësimit.** Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik“.

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Ligji nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e

buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021”, pikat 88-125; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2022”, pikat 95-122; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” .

- Në fushën e prokurimeve publike: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”; Ligji Nr. 107-2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuar”; VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për

pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

**Standardet e auditimit.** ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

**Metodat e auditimit.** Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin<sup>2</sup>. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- Kontrolli aritmetik. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen

---

<sup>2</sup> ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- Konfirmim nga të tretët. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- Verifikimi i transaksioneve - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- Intervistimi - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- Raporte dhe informacione - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

**Dokumentimi i auditimit.** Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticismit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të akt-konstatimeve, u përgatit Projektraporti i Auditimit i cili u dërgua në subjekt me shkresën nr. 973/5, datë 08.03.2024. Nga ana e Bashkisë **Kavajë** me shkresën nr. 973/6, datë 09.04.2024 është dërguar konfirmimi i marrjes së projektraportit dhe observacionet përkatëse. Në përfundim nga audituesit u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimit.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### 1. Informacion i përgjithshëm

Bashkia e **Kavajës** është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe ish-komunave në afërsitë të tij, pra në total ka 5 njësi administrative si vijon: Njësia Administrative Kavajë (qyteti), Njësitë Administrative Golem,

Helmas, Synej, Luz i Vogël. Kavaja kufizohet në veri nga Bashkia Durrës, në lindje nga Bashkia Tiranë, në jug nga Bashkia Kavajë dhe në perëndim nga deti Adriatik. Bashkia e Kavajës shtrihet në një zonë kodrash të buta dhe fushash pjellore përreth Qytetit të Kavajës deri në detin Adriatik, ku gjenden plazhe pjesërisht ranore dhe pjesërisht shkëmbore.

Qyteti i Kavajës është një qendër historike zejtare i cili e mori statutin e Kasabasë (ekuivalentin e titullit qytet) në vitin 1867.

## 2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

### Pika 2.1 e programit: Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

#### 1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një koncept i rëndësishëm, i cili bazohet në krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, për të ndihmuar menaxherët në arritjen e objektivave, marrjen e vendimeve të përshtatshme dhe përcaktimin e përgjegjësive për zbatimin e tyre.

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësive publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga stafi i Bashkisë Kavajë, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

#### **I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”**

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësive publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

#### **Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike.**

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se bashkia vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar me Vendimin nr. 3223 prot., datë 02.12.2016 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Kavajë”. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore rezultoi se në rregulloren e brendshme përfshihen vetëm **46** pozicione pune të strukturës aktuale përkatësisht:

*5 pozicione pune me statusin funksionar politik;*

*1 pozicion pune me statusin i zgjedhur;*

*25 pozicione pune me status të nëpunësit civil;*

*15 pozicione pune me kontratë.*

Konstatohet se, Bashkia Kavajë nuk ka rishikuar rregulloren e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore, si dhe nuk ka Kod Etike. Për zbatimin e tij bashkia mbështetet në ligjin

nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar si dhe ligje apo rregulloret specifike që janë krijuar në bazë të një ligji specifik.

- Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se nuk ka asnjë procedurë për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave si rrjedhojë e kësaj. Mungojnë programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës.

- Është hartuar rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e kofidencialitetit në Bashkinë Kavajë në përputhje me ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit” e cila është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 3726 prot., datë 02.12.2021.

- Është hartuar rregullore për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Kavajë e cila është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 3727 prot., datë 02.12.2021.

- Për rastet e raportimit lidhur me ankesat për korrupsion, funksionon sektori i çështjeve të antikorrupsionit, ngritur pranë bashkisë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

- Njësia përgjegjëse e menaxhimit të burimeve njerëzore nuk bashkëpunon me zyrtarët raportues dhe zyrtarin autorizues në lidhje me performancën dhe sjelljen profesionale të nëpunësve civil.

**Parimi 2** - *Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.*

- Për vitin 2023, situata paraqitet **jo efektive**, vlen të theksohet është mungesa e raportimeve të rregullta periodike nga drejtoritë e bashkisë, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion.

- Titullari i bashkisë nuk mbikëqyr projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

- Nuk rezulton të ketë urdhër për miratimin e planit të veprimit për kontrollin e brendshëm dhe për rrjedhojë as raporte periodike të monitorimit të këtij plani;

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe nga Njësia e AB nëpërmjet veprimtarisë audituese.

- Titullari i bashkisë nuk ka miratuar plan për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm e të lartë.

**Parimi 3** - *Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.*

- Bashkia nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.

- Me Vendimin nr. 1, datë 04.01.2023 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kavajë” për vitin 2023, titullari ka miratuar strukturën e përbërë nga **630** punonjës, pozicione pune që përfshijnë edhe funksionet e deleguara e të transferuara si dhe **29** (njëzet e nëntë) vende pune të përkohshme për pozicionet “Mjeshtër Uji” dhe “Polic Bashkiak Sezonal Bregdeti” për periudhën 14 maj-14 shtator 2023.

Kjo strukturë ka ndryshuar me vendimin nr. 01/3, datë 22.08.2023, e përbërë nga **630** punonjës.

-Përgjatë vitit 2023 janë rekrutuar **304** punonjës të rinj dhe janë larguar **296** punonjës.

### Struktura e Bashkisë Kavajë për vitin 2023

Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	630	Nëpunës Civilë	121
		Nëpunës me kontratë	485
		Të zgjedhur	2
		Funksionar Politik	22

*Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore Kavajë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Nga auditimi konstatohet se nuk është rishikuar rregullorja e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore e për rrjedhojë nuk ka çdo drejtori, sektor apo njësi, përgjegjësi dhe detyra të mire përcaktuara.

- Rezulton se delegohen përgjegjësitë brenda bashkisë nga ana e menaxherëve nëpërmjet urdhrave të delegimit por nuk analizohen risqet që lidhen me funksionet dhe kompetencat e deleguara.

- Evidenca të analizës së riskut ka vetëm nga Njësia e Auditit të Brendshëm.

#### **Parimi 4** - *Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave*

- Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale e cila ka mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, librezat e punës, rekrutimin, trajnimet, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.

Përshkrimet e punës nuk janë rishikuar periodikisht edhe pse bashkia ka ndryshuar strukturën e saj. Nuk janë kryer vlerësimet periodike të punonjësve nga menaxherët në lidhje me arritjen e objektivave dhe respektimin e Kodit të Etikës.

- Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore mbi rekrutimet dhe largimet, rezultoi se përgjatë vitit 2023 janë rekrutuar **304** punonjës të rinj dhe janë larguar **296** punonjës.

- Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, bashkia nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

**Për vitin 2023** janë kryer **15** trajnime ku kanë marrë pjesë **27** nëpunës të institucionit.

- Bashkia Kavajë nuk disponon një regjistër të detajuar për regjistrimin e trajnimeve të kryera nga nëpunësit e institucionit si dhe nuk parashikohen fonde në buxhet për trajnime në fusha të ndryshme.

- Institucioni ka miratuar Vendimin nr. 120, datë 27.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetin e Bashkisë Kavajë për vitin 2023”.

- Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12, 13 të ligjit 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit”.

#### **Parimi 5** - *Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.*

Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi, rezulton se bashkia nuk i ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale për hartimin dhe monitorimin e objektivave strategjike në dokumentin e rregullores së brendshme. Gjithashtu, evidentohet se njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë.

Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në GMS, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

**Për vitin 2023**, është ngritur Urdhri nr. 857, datë 23.10.2023 për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) për programin buxhetor afatmesëm 2024-2026.

Për vitin 2023, nuk është përcjellë në MFE “Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive Bashkia Kavajë dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”.



### **Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me:**

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 20;
- VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, Kreu II. “Dosja e Personelit”;
- “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me UMF nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.1, Kapitulli IV “Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit”, Kapitulli V, Anekset.

## **II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”.**

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

### **Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva.**

Titullarët/NA/Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitetet, raportimet dhe pajtueshmërinë.

- Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2023-2025 është miratuar me VKB nr. 26, datë 23.03.2022.

- Dokumenti përfundimtar i PBA 2023-2025 është miratuar me VKB nr. 120, datë 27.12.2022. Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion shkresa përcjellëse e PBA në MFE.

Është e rëndësishme që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike. Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.

Nga auditimi i dokumentacionit, konstatohet se, bashkia nuk ka plan veprime vjetore operacionale të miratuara për arritjen e qëllimeve dhe politikave afatmesme dhe objektivave vjetore që të përmbajnë veprime, afate dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.

### **Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e këtij parimi, konstatohet se, bashkia nuk ka përcaktuar mekanizma të organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut.

Nuk është hartuar strategjia dhe regjistri i risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Kavajë si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre.

Titullari i bashkisë nuk ka ngritur urdhër për përcaktimin e grupit koordinues teknik për procesin e menaxhimit dhe raportimit mbi risqet e për rrjedhojë nuk ka as raportime tek menaxherët e risqeve. Konstatohet se, nuk ka plan-veprime për menaxhimin e riskut.

### **Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve.**

Nga auditimi i dokumentacionit, konstatohet se, Bashkia Kavajë nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

**Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme.**

Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi, rezulton se, efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel të ulët. Konstatohet se, Bashkia Kavajë nuk ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni për rrjedhojë këto ndryshime strukturore apo menaxheriale nuk janë ndjekur nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualët e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

**Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me:**

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a,b,c,ç,d,dh,e,ë, Kreu III, neni 21, pika 2;

- Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3 “Përgjegjësitë dhe detyrat e KR”, pika 3.2.1 “Titullari i njësisë publike” pika 4 “Hapat për ngritjen e sistemit të MR”

-“Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me UMF nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.2, Kapitulli V, Aneksët.

**III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”.**

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

**Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.**

- Në vijim të auditimit të kryer, mund të themi se ka problematika për t’u adresuar, të cilat lidhen kryesisht me mungesën e hartave apo manualeve të proceseve të punës dhe sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësiave.

Përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij. Nga të dhënat e vëna në dispozicion, rezulton se asnjë prej drejtorive nuk ka hartë dhe manual të proceseve të punës.

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Nga komunikimi me punonjësit e Drejtorisë së Burimeve, rezulton se, ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person. Detyrat janë të ndara. Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimit të tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga nëpunësi zbatues, regjistrohet nga specialisti i buxhetit dhe miratohet nga nëpunësi zbatues. Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga specialisti për kontabilitetin dhe autorizimi i pagesës kryhet nga nëpunësi autorizues.

- Në zbatim të Udhëzimit nr. 01, datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të PP dhe krijimi i tyre në sistemin e PP” është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve.

- Bashkia Kavajë ka krijuar një regjistër aktivesh i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet.

- Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Nuk ka asnjë procedurë të miratuar nga titullari dhe gjurmë auditimi për inventarizimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktivëve afatgjata materiale. Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë

përdorimit bëhen duke u bazuar në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike” i ndryshuar.

**Gjurma e auditimit.** Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Qëllimi i përgjithshëm i gjurmës së auditimit është të ndihmojë menaxhimin të vlerësojë përshtatshmërinë e sistemeve të MFK-së në kuadër të një procesi të caktuar si dhe të identifikojë boshllëqet, mbivendosjet, ose dublimet ndërmjet strukturave të ndryshme të njësisë.

Nga auditimi i kryer, konstatohet se, bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës.

Gjurma e auditimit duhet të ndërtohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

**Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë**

Bashkia Kavajë nuk ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra përveç sistemeve qeveritare si APP, SIFQ, PBA, HRMIS).

Nga auditimi rezulton se bashkia nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up-it.

Bashkia nuk ka vendosur procedura për të siguruar vazhdimësinë e veprimeve kundrejt risqeve kryesore që mund të pengojnë këtë veprimtari. Pra, nuk ka plane të riskut për sigurinë e aktiveve nga zjarri/përmbytjet dhe rimëkëmbjet nga fatkeqësitë.

**Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.**

Nga auditimi i kryer, konstatohet se, bashkia nuk i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj dhe nuk ka procedura të shkruara operative për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.

**Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me:**

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1;

- Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.7 “Monitorimi dhe Raportimi”;

- “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me UMF nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

**IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”.**

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

**Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.**

- Në vijim të auditimit, rezulton se bashkia nuk i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit. Bashkia ka një sistem komunikimi si brenda dhe jashtë institucionit por ky sistem nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.
- Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.
- Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.
- Institucioni operon me program të vetin të kontabilitetit, në përputhje me udhëzimet dhe ligjin e kontabilitetit të pasqyrave financiare.

**Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm.**

- Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se të gjitha vendimet, projektet, proces verbalet e mbledhjeve komunikohen punonjësve në rrugë zyrtare. Faqja zyrtare e institucionit nuk përditësohet rregullisht dhe punonjësit nuk kanë e-mail zyrtar. Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave sa herë që ka alokime fondesh.

**Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm.**

- Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.
- Për vitin 2023 janë zhvilluar 5 dëgjesa publike në Bashkinë Kavajë. Dëgjesat Publike janë zhvilluar në lidhje me Paketën Fiskale dhe Projekt Buxhetin për vitin 2024.

**Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me:**

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 23, “Informacioni dhe Komunikimi” pika 2;
- “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me UMF nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Aneksat.

**V. Komponenti: “Monitorimi”.**

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

**Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm.**

- Nga auditimi i kryer, konstatohet se, institucion nuk ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ende nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

Bashkia Kavajë monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili nuk është dërguar në Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MFE.

Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet edhe nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm, performuar nga NJAB. NJAB ka kryer auditim mbi MFK i cili është formal dhe pa u thelluar analitikisht për çdo subjekt të audituar. Bashkia nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

NJAB ka hartuar planin strategjik të auditit të brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2022.

### **Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë.**

Në bazë të auditimit të kryer, konstatohet se, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH nuk ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe nuk ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

#### **Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me:**

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 24, “Monitorimi” pika 1;
- “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me UMF nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.5, Kapitulli V, Aneksset.

#### **Sa më sipër arrihet në konkluzion se:**

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për MFK e brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK, nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk funksionojnë, për gjatë gjithë strukturave të njësisë. Funksionimi i sistemit të MFK ka shfaqur mangësi, duke sjellë fenomenin që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht. Për ta përmirësuar atë në të ardhmen kërkohet një vëmendje e shtuar për implementimin dhe respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Bashkia nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nuk janë hartuar rregulla për mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave elektronike (sistem rezervë back-up), si dhe ruajtjen e aktiveve. Nuk është hartuar një regjistër i risku, dokumenti i listës (hartës) së proceseve të punës, dhe dokumenti i gjurmës së auditimit.

#### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

**Z. R.K** , në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kavajë (për periudhën 01.01.2023-15.06.2023), **z. F.Q** , në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kavajë (për periudhën 15.06.2023-31.12.2023), **z. D.H** , në cilësinë e Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse (për periudhën 01.01.2023-28.07.2023), **z. K.M** , në cilësinë e Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse (për periudhën 07.08.2023-31.12.2023), **z. A.M** , në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Ligjore, **z. A.T** , në cilësinë e Drejtorit të Burimeve Ekonomike (për periudhën 01.01.2023-23.06.2023), **zj. F.GJ** , në cilësinë e Drejtorit të Burimeve Ekonomike (për periudhën 23.06.2023-31.12.2023), **zj. Z.Z** , në cilësinë e Përgjegjëses së Njësisë së Auditit të Brendshëm.

- *Mbi rregullimin e marrëdhënieve të punës me stafin e punësuar si dhe procedurat e krijimit dhe administrimit të dosjeve të personelit.*

Në zbatim të këtij drejtimi u auditua dokumentacioni përbërës, pjesë e dosjeve të personelit, në lidhje me stafin e punësuar për gjithsej **28 punonjës** të punësuar me kontratë, në bazë të Kodit të Punës dhe **22 punonjës** të punësuar si nëpunës civil.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjeve fizike, u konstatuan disa parregullsi, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht si vijon:

#### **Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:**

- a- *Mbi Procedurën e Krijimit dhe Administrimit e Dosjeve të Personelit.***

Nga dokumentacioni pjesë e dosjeve të personelit, konstatohet se, në të gjitha dosjet personelit **mungon “Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit”**, në kundërshtim me lidhjen nr. 2 të VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

**Dosjet e personelit janë të paplota**, në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020, e cila në lidhjen 1 të saj cilëson dokumentacionin që duhet të përmbajë dosja e personelit me qëllim vërtetimin e pohimit të bërë në fletën prezantuese.

*Në formë tabele paraqiten mangësitë e evidentuara mbi dokumentacionin përbërës të 50 dosjeve të personelit për vitin 2023 (pasqyruar në Aneksin L4).*

**Konkluzion:** Mangësitë si dhe keqadministrimi i dosjeve të personelit, duke mos kryer përmirësimin dhe përditësimin e të gjitha elementeve përbërëse të tyre, ndikon negativisht në raportimin, zhvillimin dhe menaxhimin e proceseve të burimeve njerëzore.

Për sa më sipër, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Kavajë ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, veprime për të cilat ngarkohen me përgjegjësi **z. D.H**, në cilësinë e ish Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe **z. K.M**, në cilësinë e Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse si dhe **titullari i institucionit**. Përgjegjësitë në rastin konkret rrjedhin nga pika II/3 e VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

**VKM nr. 833, datë 28.10.2020, pika II/3** “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

**VKM nr. 833, datë 28.10.2020, pika II/1.**

**b- Në lidhje me vlerësimin periodik të performancës së punonjësve.**

Në lidhje me mënyrën e vlerësimit periodik të performancës së punonjësve, Vendimi nr. 109, datë 26.2.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë” i ndryshuar, ndër të tjera, në kreun II, parashikon sistemin e vlerësimit të rezultateve në punë, si procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive apo i dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, **që realizohet çdo 6 muaj të vitit kalendarik**. Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese kryhet bashkërisht nga zyrtari raportues, zyrtari kundër firmues dhe zyrtari autorizues.

Së pari, nga verifikimi i dokumentacionit pjesë e dosjeve të personelit, për nëpunësit civil, konstatohet se vlerësimet e performancës, nuk janë pjesë e tyre, në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020, pika II/1.

Së dyti, nga verifikimi i dokumentacionit pjesë e dosjeve të personelit, për punonjësit me kontratë pune, konstatohet se nuk ka vlerësime të performancës.

**Si konkluzion**, mungesa e formularëve të vlerësimit të performancës si dhe mungesa e njoftimit të tyre, ndikon negativisht në menaxhimin e marrëdhënies së punës midis palëve si dhe përbën një risk eventual të shtuar për institucionin e Bashkisë Kavajë.

Për sa më sipër, Bashkia Kavajë ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi **z. D.H**, në cilësinë e ish drejtorit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse dhe **z. K.M** me drejtor i burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse si dhe **Titullari i Institucionit**.

**VKM nr. 833, datë 28.10.2020, pika II/1** “Dosja e personelit është individuale dhe përmban të dhëna të karakterit të përgjithshëm, profesional, akademik, masa disiplinore, të dhëna për vlerësimin e rezultateve në punë, si dhe të dhëna të tjera...”;

**VKM nr. 109, datë 26.2.2014, kreu II**, “Sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë, si procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive apo i dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, **që realizohet çdo 6 muaj të vitit kalendarik ...**”;

**c- Në lidhje me rekrutimin (punësimin) e punonjësve pranë Bashkisë Kavajë.**

Bashkia Kavajë funksionon sipas strukturës të miratuar me Vendimin nr. 01, datë 04.01.2023 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kavajë”, e ndryshuar me Vendimin nr. 01/2 dhe përbëhet nga:

Pozicione pune gjithsej, sipas strukturës (pozicione të shërbimit civil, pozicione politike, punonjës me kontratë pune) rezultojnë **630** pozicione;

Punonjës të shërbimit civil janë **121**.

Punonjës me kontratë pune janë **509**, ndër të cilët **22** funksionar politik.

Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të bashkisë rregullohen sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Përveç sa më sipër, pjesë e stafit të Bashkisë Kavajë janë edhe punonjësit me kontratë pune, për të cilët marrëdhëniet e punës rregullohen me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se përgjatë periudhës objekt auditimi janë rekrutuar **304** punonjës (nëpunës civil dhe punonjës me kontratë), pranë Bashkisë Kavajë.

Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në nenin 5 përcakton se: “Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mos diskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil”.

Ndër të tjera, në nenin 20 të ligjit 152/2013 i ndryshuar, përcaktohet se: “Procesi përzgjedhës bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve nëpërmjet një konkurrimi kombëtar, që përfshin një testim të shkruar, një testim me gojë dhe çdo formë tjetër të përshtatshme të verifikimit të aftësive, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatit”. Në nenet 22, 23, 24 dhe 25 të këtij ligji parashikohen procedurat administrative për rekrutimin në shërbimin civil.

**Në zbatim të këtij ligji, ka dalë VKM nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar.**

Ndër të tjera, në VKM e sipërcituar, janë të përcaktuara edhe procedurat e shpalljes ku njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të bazohen për rekrutimin e nëpunësve, si vijon:

Institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore **bëjnë shpalljen e procedurës së pranimit për secilin grup në portalin “Shërbimi kombëtar i punësimit”, në stendat e informimit të publikut, si dhe në faqen e tyre të internetit në rast se kanë.**

Procedurat e konkurrimit për plotësimin e pozicioneve të kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, përcaktohen në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe VKM nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, grupi i auditimit ka verifikuar respektimin e kuadrit ligjor nga ana Bashkisë Kavajë për rekrutimin (punësimin) e **40** nëpunësve civilë gjatë kësaj periudhe kohore, sipas aneksit 2.2 bashkëlidhur RPA.

**Konkluzion:** Punësimi pranë Bashkisë Kavajë i nëpunësve për të cilët nuk është zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi e hapur, përveçse bie ndesh me interesin publik, parimin e konkurrencës së lirë dhe barazisë përpara ligjit, ndër të tjera, përbën një risk të shtuar duke ndikuar negativisht në mbarëvajtjen e punës në Bashkinë Kavajë.

Për sa më sipër, Bashkia Kavajë ka vepruar në kundërshtim me Kushtetutën e R.Sh., Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, nenet 5, 20, 22, 23, 24, 25, 26, VKM nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, VKM nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe **titullari i institucionit (sipas periudhës përkatëse).**

***Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 107, pika 2, Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, nenet 5, 20, 22, 23, 24, 25, 26; VKM nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar ku janë të përcaktuara edhe procedurat e shpalljes ku njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të bazohen për rekrutimin e nëpunësve, si vijon: Institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore **bëjnë shpalljen e procedurës së pranimit për secilin grup në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në stendat e informimit të publikut, si dhe në faqen e tyre të internetit në rast se kanë.*****

**Për vitin 2023**, referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga drejtoria e burimeve ekonomike, rezulton se, **36** punonjës nuk plotësojnë nivelin i arsimit në lidhje me pozicionin e punës, sipas Aneksit 1.1 bashkëlidhur Raport Auditimit.

**Konkluzion:** Punësimi pranë Bashkisë Kavajë i nëpunësve për të cilët nuk plotësojnë kriteret arsimore, mbart riskun e pamjaftueshmërisë së burimeve për arritjen e objektivave në sasi por mund të çënojë dhe cilësinë e punës, në kundërshtim me Vendimin nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Pavarura” i ndryshuar, ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe **titullari i institucionit (sipas periudhës përkatëse).**

**ç- Në lidhje me largimin e punonjësve, Bashkia Kavajë.**

Nga auditimi i kryer, konstatohet se, përgjatë periudhës objekt auditimi janë larguar **293** punonjës (nëpunës civil dhe punonjës me kontratë), nga Bashkia Kavajë.

- **213** punonjës janë larguar me Urdhër Largimi;
- **50** punonjës janë larguar me dorëheqje;
- **24** punonjës janë larguar me motivacionin (mbushje e moshës së pensionit);
- **5** punonjës janë larguar me motivacionin (përfundimi i lejes së lindjes);
- **1** punonjës është larguar me transferim.

**Konkluzion:**

**1.** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, mbi largimin nga puna të punonjësve me kontratë pune, për të cilët marrëdhëniet e punës rregullohen me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konstatohet se procedura e ndjekur nuk është në përputhje me nenet 143 dhe 144.

**2.** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi largimin nga puna të nëpunësve civil, për të cilët marrëdhëniet e punës rregullohen me Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, konstatohet se procedura e ndjekur nuk është në përputhje me nenet 58, 59 dhe 60.

Për sa më sipër, Bashkia Kavajë ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, nenet 58, 59, 60, dhe ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 143 dhe 144, **ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe titullari i institucionit (sipas periudhës përkatëse).**

Nga ana e sektorit juridik, disponohen aktet zyrtare të ardhura nga gjykata dhe rezulton se për 6- mujorin e dytë të vitit 2023, i janë drejtuar gjykatës **64** punonjës të larguar nga puna, të pasqyruara në ameksin 2.4 bashkëlidhur RPA.:

**Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi: Z. R.K , në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kavajë (për periudhën 01.01.2023-15.06.2023); Z. F.Q , në**



cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kavajë (për periudhën 15.06.2023-31.12.2023); **Z. K.M** , në cilësinë e Drejtorit të Burimeve Njerëzore, (periudha 07.08.2023-31.12.2023); **Z. D.A** , në cilësinë e ish Drejtorit të Burimeve Njerëzore, (periudha 01.01.2023-28.07.2023).

### **Pika 2.1.2. Mbi vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.**

NJAB, përgjatë periudhës objekt auditimi, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Vendimit nr. 01 datë 04.01.2023, duke pasur në strukturën e saj 1 (një) Përgjegjës i Auditit të Brendshëm zj. Z.Z dhe 2 (dy) specialiste auditimi, zj. F.T dhe zj. E.T të certifikuar si auditues të brendshme.

Njësia e Auditit të Brendshëm në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së saj, ka miratuar rregulloren e brendshme me nr. 3725 prot., datë 02.12.2021, e cila përcakton mënyrën e organizimit, kuadrin ligjor, detyrat e përgjegjësit të NJAB dhe audituesve të brendshëm etj.,

#### *Struktura e njësisë AB për vitin 2023*

Nr	Periudha	Funksioni	Arsimi bazë	Niveli i diplomës	Vjetërsi i ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
	<b>Për vitin 2023</b>							
1	Z.Z	Përgjegjës	Ekonomiste	Master Shkencor	34	30	2010	Po
2	F.T	Audituese	Ekonomiste	Master Shkencor	38	18	2010	Po
3	E.T	Audituese	Inxhinierë	Master Profesional	7	4	2021	Po

Burimi: NJAB Kavajë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

#### **Trajnimet e NJAB dhe certifikimet**

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se i është kushtuar rëndësi trajnimeve të audituesve të NJAB sipas planit të trajnimeve, përpiluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.

Për vitin 2023 trajnimet e audituesve të NJAB për Bashkinë Kavajë pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

#### *Trajnimet e njësisë AB për vitin 2023*

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni i Punës /Drejtoria	Tema e trajnimit të ndjekur	Institucioni Trajnues	Data e trajnimit dhe mënyra e ndjekjes së trajnimit (online/Fizik)
1.	Z.Z	Përgjegjëse	Menaxhimi i të ardhurave vendore	Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm	9-13 Tetor (40 orë) Trajnim Fizik
2.	F.T	Audituese	Menaxhimi i të ardhurave vendore	Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm	9-13 Tetor (40 orë) Trajnim Fizik
3.	E.T	Audituese	-Menaxhimi i të ardhurave vendore -Trajnim për biznesin e vogël dhe Oj f	Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm	9-13 Tetor (40 orë) Trajnim Fizik

Burimi: NJAB Kavajë përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

#### **Komiteti i Auditit të Brendshëm**

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, nuk ka Urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 12, pika b.

#### **Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik**

NJAB në mbështetje të UMF nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik” ka hartuar “Kartën e auditimit të brendshëm në sektorin

publik” në Bashkinë Kavajë e cila është miratuar nga titullari me shkresën nr. 855. prot., datë 11.03.2021 dhe rezulton se është në përputhje me formatin e paraqitur në Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”.

- **Planifikimi/ndryshimet dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve.**

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar dhe miratuar Plani Strategjik 2023-2025 i cili është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 3585 prot., datë 14.10.2022. Plani vjetor i auditimeve për vitin 2023 është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 3606 prot., datë 18.10.2022.

Plani Strategjik dhe Plani Vjetor janë përcjellë zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë MFE, me shkresën nr. 3259/1 prot., datë 18.10.2022, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe UMF nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

- **Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2023**

Në planin vjetor të auditimit për vitin 2023, miratuar me shkresën nr. 3606 prot., datë 18.10.2022, janë programuar për auditim drejtori brenda strukturës së Bashkisë dhe institucione në varësi të saj.

**Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023**, Njësia e Auditimit të Brendshëm janë planifikuar për t’u kryer **8** auditime kundrejt **8** auditimeve të programuara, pra plani vjetor është realizuar 100%, nga të cilat **7** auditime paraqiten në statusin “*Angazhime të përfunduara*” dhe **1** auditim në statusin “*Auditim në proces*”, pasqyruar si më poshtë:

N r	Planifikuar	N r	Subjekte të audituara nga NJAB	N r	Realizimi i angazhimeve të auditimit					Të përfunduar	Në proces
					Përputhsh	Perform	Financ	IT	Kombin		
1	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore	1	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore	1	1					1	
2	Drejtoria e Shërbimeve Publike Sektori i Menaxhimit të Transportit	1	Drejtoria e Shërbimeve Publike Sektori i Menaxhimit të Transportit	1	1					1	
3	Drejtoria e Shërbimeve Publike Sektori i Gjellbërimit dhe Varrezave	1	Drejtoria e Shërbimeve Publike Sektori i Gjellbërimit dhe Varrezave	1	1					1	
4	Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor	1	Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor	1	1					1	
5	Njësia Administrative Helmas	1	Njësia Administrative Helmas	1					1	1	
6	Njësia Administrative Synej	1	Njësia Administrative Synej	1					1	1	
7	Drejtoria e Shërbimit Social	1	Drejtoria e Shërbimit Social	1	1					1	
8	Drejtoria e Burimeve Ekonomike	1	Drejtoria e Burimeve Ekonomike	1					1		1
		<b>8</b>	<b>Totali</b>	<b>8</b>	<b>5</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	<b>7</b>	<b>1</b>

Burimi: NJAB Kavajë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, për aktivitetin e vitit 2023 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 824/1 prot., datë 13.02.2023.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2023, u konstatua se janë dhënë 37 rekomandime gjithsej, të cilat janë të karakterit organizativ dhe janë pranuar nga subjektet objekt auditimi.

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Pranuar	Zbatuar	Ne proces	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	2023	37	37	-	37				
<b>TOTALI</b>		<b>37</b>	<b>37</b>	<b>-</b>	<b>37</b>				

Burimi: NJAB Kavajë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

**Konstatim:** Për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Kavajë, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, NjA Golem, Drejtoria Ligjore, Drejtoria e Burimeve Ekonomike (sistemi i prokurimeve), në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit pika 3.1.3.

- **Auditimi i dosjeve të auditimit kryer nga DAB**

Grupi auditimit duke patur në fokus gjetjet e konstatuara në subjektet e audituara në vitin 2023, zgjodhi të auditojë dosjet të cilat janë vlerësuar nga DAB me nivel të mesëm dhe të lartë risku siç janë:

- *Dosja e auditimit të kryer në Njësinë Administrative Helmas;*
- *Dosja e auditimit të kryer në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore”;*
- *Dosja e auditimit të kryer në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit Vendor;*
- *Dosja e auditimit të kryer në Drejtorinë e Shërbimeve (Sektori i Transportit).*

**Konstatim:** - Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;

- NJAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara;
- Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshtkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12.

- **Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm**

NjAB në Bashkinë Kavajë ka hartuar “Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm” i cili rezulton të jetë i miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 3887/1 prot., datë 15.12.2021. Është hartuar rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e kofidencialitetit në Bashkinë Kavajë në përputhje me ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit” e cila është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 3726 prot., datë 02.12.2021.

Është hartuar rregullore për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Kavajë e cila është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 3727 prot., datë 02.12.2021.

### - **Dosja e përhershme**

Nga kontrolli i dokumentacionit u konstatua se, audituesit e brendshëm nuk kanë krijuar dosjet e përhershme të auditimit në mos përputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm ku përcaktohet se: *NjAB mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet.* Dosja e përhershme duhet të përditësohet pas plotësimit të çdo angazhim auditimi me qëllim që të sigurohen ndryshimet e ndodhura në përmbajtjen e saj. Dosja e përhershme mbahet në format elektronik ose të printuar, kjo në funksion të mundësive të NjAB.

**Konstatim:** NjAB në Bashkinë Kavajë nuk ka dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, pika 6.3 “*Dosja e Përhershme*” .

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenet 12, 13 të Ligjit nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar;

- Për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Kavajë, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, NjA Golem, Drejtoria Ligjore, Drejtoria e Burimeve Ekonomike (sistemi i prokurimeve), në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit;

- Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;

- NJAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara;

- Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12;

- NJAB nuk ka kryer auditim tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH.

### **Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi:**

**Z. R.K** , në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kavajë (për periudhën 01.01.2023-15.06.2023);

**z. F.Q** , në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kavajë (për periudhën 15.06.2023-31.12.2023);

**zj. Z.SH** , në cilësinë e Përgjegjëses të NJAB Kavajë;

**zj. F.T** , në cilësinë e auditueses në NJAB;

**zj. E.T** , në cilësinë e auditueses në NJAB.

### **Pika 2.2 e programit: Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

#### **Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2023 - 2025**

PBA 2023 - 2025 është përgatitur nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike. Në fazën përfundimtare (*Referuar realizimeve të viteve paraardhëse, duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes*), janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzime korrente, investime dhe të ardhurat. *Theksojmë se investimet nuk janë paraqitur në mënyrë të detajuar në nivel projekti referuar dhe burimeve të financimit, duke llogaritur kostot.* PBA 2023 është miratuar me VKB nr. 120, datë 27.12.2022.

Kërkesat buxhetore për PBA janë dërguar në MFE me shkresat përkatëse. Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor.

Faza e parë e PBA 2023-2025 dhe programi i buxhetit vjetor 2023, është miratuar me VKB nr. 26, datë 23.03.2022.

Faza e dytë e PBA 2023-2025 dhe programi i buxhetit vjetor 2023, është miratuar me VKB nr. 58, datë 23.06.2022. Faza e dytë nuk ka ndryshime (të njëjtat parashikime si faza e parë).

Sipas Urdhërit nr. 64, datë 09.02.2022, Struktura e ngarkuar për përgatitjen e PBA-së është Grupi i Manaxhimit Strategjik dhe Ekipet e Manaxhimit të Programeve.

Sektori buxhetit mbledh gjithë kërkesat për nevojat reale dhe bazuar në vendimet e GMS (struktura përgjegjëse për manaxhimin e garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të planifikimit të buxhetit brenda njësisë së qeverisjes vendore).

Kryetari i Bashkisë ka përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor brenda datës 31 dhjetor, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33/1.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore apo nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”, pasi mungojnë dokumentet e evidentimit të kryerjes së këtyre konsultimeve (proces - verbalet përkatëse).

- Hartimi dhe programimi i “Buxhetit Vjetor” për vitin 2023

Buxheti vjetor për vitin 2023 është miratuar me VKB nr. 120, datë 27.12.2022 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 2388/1, datë 04.01.2023, konkretisht sipas pasqyrës së mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani 2023	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëg. nga viti paraardhës (pa destinacion)	30,000	
2	Transferta pakush. trashëg. Viti paraardhës	-	
3	Trashëguar nga Transferta specifike	2,048	
4	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	626,407	
5	Transferta e pakushtëzuar	271,647	
6	Transferta specifike	218,717	
7	Paga (600)		406,507
8	Sigurime shoqërore (601)		69,451
9	Shpenzime operative (602)		578,218
10	Fondi rezervë		16,437
11	Fondi I kontigjencës		
12	Investimet (230 +231) nga Të ardhurat e Tr. Pakush.		64,844
13	Transferta buxhetore familjare llog.604		13,362
14	Emergjencia Civile		
<b>Totali i Buxhetit</b>		<b>1,148,819</b>	<b>1,148,819</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

Sipas tabelës së mësipërme “Buxheti i Vitit 2023” është miratuar *i balancuar dhe pa defiçite*, ku të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **1,148,819** mijë lekë.

Buxheti duhet të ndërtohet mbi bazën e kërkesave shkresore nga NjA, sektorët e bashkisë dhe njësitë vartëse etj. për nevojat reale.

- Krahasimi i planeve buxhetore me PBA respektive:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plan fillestar viti 2023	Sipas PBA 2023-2025	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga të ardhura, grant i pakush. e spec.)	434,770	475,957	41,187
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtëz e specifik)	438,095	605,518	167,423
3	Investime Bashkia (nga të ardhura dhe grant i pakushtëzuar)	21,316	64,844	43,528
4	Investime nga FZhSh			
<b>Total i planit fillestar</b>		<b>894,181</b>	<b>1,146,319</b>	<b>252,138</b>
	Shtesat nga Pushteti Qendror			
1	Investime grant i kushtëzuar			
2	Shpenzime për pagat (600+601)			
3	Shpenzime (602.604.609)			
4	Grant i kushtëzuar (230-231)			
	<b>Gjithsej</b>			

**Burimi i të dhënave:** Bashkia Kavajë.

Referuar tabelës së mësipërme, nga krahasimi i “Planit fillestar të Buxhetit për vitin 2023” me vitin e parë të “Planit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, rezulton se:

- Ka diferencë prej **252,138 mijë** lekë mbi tavanin e përcaktuar në PBA.
- Ka diferencë prej **2,500 mijë lekë** mbi tavanin e përcaktuar në PBA (Konkretisht 2,500 mijë lekë janë planifikuar për tu paguar për këstin e radhës së “Kredisë CEB” por nuk janë likuiduar).

Nga të dhënat PBA-të përfundimtare dhe “Projekt Buxheti i vitit 2023” konstatohen ndryshime në krahasim me Fazën e parë dhe Fazën e dytë, konkretisht:

-Niveli i pagave dhe sigurime shoqërore ka pësuar rritje në krahasim me PBA fillestare, si pasojë e ndryshimit të nivelit të pagave me vendim VKM nr. 604, datë 14.09.2022 për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi, si dhe VKM nr. 627, datë 28.09.2022, për disa ndryshime në Vendimin nr.234, datë 20.04.2022 për “Pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”.

-Zëri mallra e shërbime 602, 606 dhe shpenzime kapitale, si pasojë e rritjes së nivelit të planifikimit të të ardhurave nga **505.034** mijë lekë në **626.407** mijë lekë.

Me VKB nr. 16, datë 20.02.2023 është marrë vendim nga “Këshilli Bashkiak Kavajë” për miratimin e “Buxhetit shtesë” për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2022 në vlerën **630.530.197** lekë.

Me VKB nr.53, datë 17.07.2023 konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut me shkresën nr.1034/1 datë 26.07.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave e të shpërblimeve të funksionareve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile të institucioneve në varësi dhe të njëjve administrative dhe punonjësve mbështetës” në Bashkinë Kavajë sipas

-VKM nr. 328, datë 31.05.2023 për rritje të pagave në vlerën **18,037,152** lekë.

-VKM nr. 681,687 datë 06.12.2023 Fond rindërtimi **882,110.517** lekë.

-Shkresa nr. 182 prot., datë 10.01.2024 **32,925,612** lekë.

-Shkresa nr. 20901/1 datë 04.12.2023 **908,000** lekë.

Buxheti i rishikuar paraqitet si më poshtë në tabelë:

Në 000/lekë

Nr.	Emertimi	Plani 2023	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëg. nga viti paraardhës (pa destinacion)	30,000	
2	Transferta pakush. trashëg. viti paraardhës	468,560	
3	Trashëguar nga Transferta specifike	65,109	
4	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	725,315	

Nr.	Emertimi	Plani 2023	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
5	Transferta e pakushtëzuar	1,205,629	
6	Transferta specifike	218,717	
7	Paga (600)		445,307
8	Sigurime shoqërore (601)		78,226
9	Shpenzime operative (602)		741,568
10	Fondi rezervë		16,437
11	Fondi I kontigjencës		
12	Investimet (230 +231) nga Të ardhurat e Tr. Pakush.		1,286,460
13	Transferta buxhetore familjare llog.604		145,332
14	Emergjencia Civile		
<b>Totali i buxhetit</b>		<b>2,713,330</b>	<b>2,713,330</b>

**Burimi i të dhënave:** Bashkia Kavajë.

- Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Buxheti fillestar me shtesat e trashëguar për vitin 2023 është **2,713,330** mijë lekë.

Ndarja e “Plan buxhetit” dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Kavajë dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Buxheti vjetor ka pësuar ndryshime gjatë vitit, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjera, sipas nevojave të Bashkisë Kavajë. Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në vlerë totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, investime për rindërtimin nga pasojat e tërmetit etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo në ligjin e buxhetit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me VKB.

Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion të grupit të auditimit për periudhën 2023-2025”, rezulton se për vitin 2023 kanë ndodhur 5 ndryshime të shoqëruara me shkresat përkatëse për cdo shtesë dhe pakësim sipas artikujve që preken. Këto ndryshime paraqiten të detajuara në aneks.

- Auditim mbi saktësinë e realizimit të Treguesve Buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Kavajë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Kavajë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendim të KB, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara. Për sa më sipër u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Niveli i realizimit të treguesve të buxhetit

Në 000/lekë

nr.	Emërtimi i llogarive ekonomike	Plani	Fakti	Diferenca	Realizimi ne %
1	Paga 600	445,307	417,434	-27,873	94
2	Sigurime shoqërore 601	78,226	69,874	-8,352	89
3	Shp. Oper. 602+F. Rezervë	741,568	476,070	-265,498	64
4	Kredia+Interesi 166-651 (CEB)	0	0	0	0
5	K. Q Emergj Civile 604	908	908	0	100
6	Nd/Ekonom invalid 606+te tjera	0	0	0	0
	a. Nd/Ekonom invalid 606+të tjera	161,769	37,018	-124,751	23
	b. Bonus qeraje+bursa+ndihmë financiare+bonuse nga rindërtimi	0	0	0	0
7	Investime 230-231	1,285,552	1,054,607	-230,945	82
	<b>Totali</b>	<b>2,713,330</b>	<b>2,055,911</b>	<b>657,419</b>	<b>76</b>

**Burimi:** Nga të dhënat e buxheteve të hartuara nga Bashkia Kavajë.

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme, më poshtë po analizojmë në trajtë narrative nivelin e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2023 në Bashkinë Kavajë, konkretisht:

- Për **vitin 2023** fondet buxhetore janë realizuar 2,055,911 lekë nga 2,713,330 lekë të planifikuara, ose në masën 76%. Në këtë masë realizimi ka ndikuar realizimi në masë të ulët në zërit të buxhetit llog.231 “Shpenzimet për investime” në masën 82%, kjo pasi fondet e alokuara nga Ministria e Rindërtimit janë çelur vetëm 63% e vlerës të investimit.

Peshën specifike më të madhe në buxhet ndaj totalit e zënë shpenzimet për investime, ndjekur nga shpenzimet operative dhe shpenzimet për paga, tregues të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	EMËRTIMI	Përqindja e shpenzimeve ndaj totalit viti 2023 Bashkia
1	Shpenzimet operative	25
2	Investime	51
3	Shpenzime për paga	24

**Burimi:** Nga të dhënat e buxheteve të hartuara nga Bashkia Kavajë.

- Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës

Me miratimin e buxhetit për vitin 2023 është parashikuar dhe miratuar (por nuk është përdorur) fondi rezervë/dhe kontigjencës, në vlerën **16,437** mijë lekë.

- Miratimi i realizimit faktik i buxhetit

Në fund të periudhës ushtrimore nga Bashkia Kavajë **nuk është hartuar** raporti për buxhetin faktik të vitit 2023 i shoqëruar me një analizë faktoriale për realizimin e fondeve dhe rekomandimet për përmirësimin e situatës.

- Raportet e Monitorimit.

Për vitin 2023, është përgatitur raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të buxhetit në mënyrë periodike për çdo 4-mujor, në përputhje me ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor”, me ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 65.

- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e buxhetit vjetor si prioritet ka caktuar detyrimet e papaguara të vitit paraardhës (kreditor). Gjatë zbatimit të Buxhetit ky prioritet nuk është mbajtur në konsideratë në raport me fondet e mbetura. Nga ky institucion nuk është



realizuar ndjekja e procedurave të domosdoshme për vitin pasardhës për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

- Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likuidimi i faturave të pa likuiduara.

Detyrimet e raportuara në MFE në fillim të periudhës ushtrimore 2023 dhe lëvizjet dhe të mbetura në fund të vitit 2023 paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:  
*Raportimi në MFE i detyrimeve të prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2023:*

Në Lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31/12/2022/lekë	Shlyerja e detyrimeve gjate vitit 2023 per detyrime e prapambetur/lekë	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023 (lekë)	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2023 lekë
1	2	3	4	5=2+4-3
Vendime gjyqesore	46,009,272	22,891,801	20,455,028	43,572,499
Sherbime	189,292,816	25,473,095	17,874,468	181,694,189
Mallra	1,687,040	829,800	32,375,255	33,232,495
Investime	83,243,425	69,165,131	3,686,152	17,764,446
Energji Elektrike	482,050,135	0	0-	482,050,135
<b>Kredia CEB</b>	<b>27,957,696</b>	<b>0</b>	<b>7,670,516</b>	<b>35,628,212</b>
<b>Totali</b>	<b>830,240,384</b>	<b>118,359,827</b>	<b>82,061,419</b>	<b>793,941,976</b>
Detyrime te prapambetura FZHR (ministrite e linjes			346,121	346,121
<b>Detyrime Total</b>				<b>794,288,097</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë

Vlera e detyrimeve të raportuara në MFE prej **758,659,885** lekë, nuk rakordon me gjendjen e llog. të klasës 4 të detyrimeve në pasiv të bilancit konkretisht:

- Detyrimet e krijuara ndaj të tretëve për fatura të palikujduara për investime (llog.231).

Në fund të vitit 2023 kanë mbetur pa u likujduar **41 fatura në vlerën totale 34,173,066 lekë nga të cilat 36 fatura në vlerën 17,764,446 lekë janë të raportuara dhe rakordojnë me gjendjen e llog. të klasës 4 të detyrimeve në pasiv të bilancit ndërsa 5 fatura në vlerën 16,408,620 lekë nuk është raportuar në MFE për vitin 2023.**

Nga analiza e faturave të palikujduara për investime rezultojnë fatura, të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, ose janë kryer pagesa pjesore të tyre, kjo për efekt të mungesës së fondeve nga mosrealizimi i të ardhurave vendore.

Detyrimet e krijuara ndaj të tretëve për fatura të palikujduara për investime (llog.231) në mënyrë analitike pasqyruar në Aneksin nr.3.1 Buxheti “Detyrimet e krijuara ndaj të tretëve për fatura të palikujduara për investime (llog.231)” bashkëlidhur RPA.

- Detyrimet e krijuara ndaj të tretëve për fatura të palikujduara për mallra e shërbime (llog.602):

Detyrimet e krijuara ndaj të tretëve për fatura të palikujduara për mallra (**Nga të ardhurat e veta**)

Nga analiza e faturave të pa likuiduara për mallra rezulton se, në fund të vitit 2023 kanë mbetur pa u **likujduar 18 fatura në vlerën 34,247,593 lekë** nga të cilat 11 fatura në vlerën 33,232,495 lekë janë të raportuara dhe rakordojnë me gjendjen e llog. të klasës 4 të detyrimeve në pasiv të bilancit. Total detyrim i pa raportuar në MFE si detyrim për vitin 2023 për mallra (Nga të ardhurat e veta) janë, 7 fatura në vlerën 1,015,098 lekë.

Detyrimet e krijuara ndaj të tretëve për fatura të palikujduara për investime (llog. 231) në mënyrë analitike pasqyruar në Aneksin nr. 3.2 Buxheti “Detyrimet e krijuara ndaj të tretëve për fatura të palikujduara për mallra (**Nga të ardhurat e veta**)” bashkëlidhur RPA.

- Detyrimet e krijuara ndaj të tretëve për fatura të palikujduara për shërbime.

Nga analiza e faturave të pa likuiduara për shërbime (nga të ardhurat e veta) rezulton se, në fund të vitit 2023 kanë mbetur pa u likuiduar 21 fatura në vlerën **1,296,781,069** lekë nga të cilat 7 fatura në vlerën 181,694.189 lekë janë të raportuara dhe rakordojnë me gjendjen e llog. të klasës 4 të detyrimeve në pasiv të bilancit.

Total detyrim i pa raportuar në MFE si detyrim për vitin 2023 për Shërbime janë **14 fatura në vlerë 1,115,086,880** nga të cilat 13 fatura për shërbime të ndryshme në vlerë 19,129,469 dhe detyrimet për energjinë elektrike (të prapambetura) në vlerën totale 1,095,957,411 lekë.

Total detyrim i pa raportuar për Shërbime për 14 fatura në vlerë 1,115,086,880 lekë, paraqitur në mënyrë analitike pasqyruar në Aneksin nr.3 Buxheti “Detyrimet e krijuara ndaj të tretëve për fatura të palikuiduara për Shërbime” bashkëlidhur raportit.

(Peshën më të madhe në këto fatura e zënë detyrimet ndaj “F” Sha, për shpenzime për enrgji elektrike. Faturat e palikuiduara për shërbime (furnizim me energji elektrike) paraqiten në vlerën **1,095,957,411** lekë për 231 kontrata që bashkia Kavajë ka ndaj “F” Sha për periudhën janar 2015- korrik 2022 (sipas akt rakordim nr. 2811/4 prot., datë 14.09.2022 midis Bashkisë Kavajë dhe “F” Sha). Bashkia Kavajë në pagesat e faturave mujore të vitit 2023 paguan shtesë 500,000 lekë bazuar në një akt marrëveshje midis “F” Sha dhe këtij institucioni. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të grupit të auditimit nuk rezulton dokumentacion fizik apo i skanuar për këtë akt marrëveshje. Detyrimi për vitin 2023 (dhjetor -2022- dhjetor 2023) total 13 fatura në vlerë 69,679,085 lekë nga të cilat janë likuiduar 10 fatura (periudha dhjetor 2022-shtator 2023 përfshirë) në vlerën 50,647,912 lekë. të palikuiduara për vitin 2023 janë 3 fatura në vlerë 19,031,173 lekë të paraportuara në MFE. Për periudhën qershor -nëntor 2022, 5 muaj nuk rezultojnë fatura të regjistruara për shërbimin furnizim me energji elektrike).

- Detyrimet e krijuara ndaj të tretëve për fatura të palikuiduara për mallra-shërbime nga Granti

Nga analiza e faturave të palikuiduara për shërbime (Nga granti) rezulton se, në fund të vitit 2023 kanë mbetur pa u likuiduar 5 fatura në vlerën 5,698,190 lekë nga të cilat 4 fatura në vlerën 5,447,160 lekë janë të raportuara dhe rakordojnë me gjendjen e llog. të klasës 4 të detyrimeve në pasiv të bilancit **ndërsa 1 faturë në vlerën 251,030 lekë nuk është raportuar në MFE si detyrim për vitin 2023.**

Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023 për mallrat dhe shërbimet (Nga granti)

Nr .	Emërtimi i i Objektit	Emërtimi i i Subjektit	Gjendja e faturave	Numri dhe data e faturës	Vlera e detyrimit me 31.12.2023
1	Sherbimi i mirembajtjes dhe gjelberimit	G Shpk	4 fatura raportuar si detyrim	nr 11 date 31.07.2023	5,447,160
2	Sherbimi i mirembajtjes dhe gjelberimit	G Shpk	1faturë e pa raportuar si detyrim	nr 23 date 29.12.2023	251,030
	<b>Total</b>				<b>5,698,190</b>

- Detyrimet e krijuara ndaj të tretëve për Vendimet Gjyqësore të formës së prerë

Pjesë e detyrimeve janë dhe 44 Vendimet Gjyqësore të formës së prerë që nga viti 2016 deri në vitin 2023 për konflikte të krijuara ndër vite me objekt mosmarrëveshje kontraktuale, dëmshpërblime për largime nga puna në mënyrë të paligjshme etj.

Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me likuidimin e Vendimeve Gjyqësore nga Bashkia Kavajë vërehet se në çelje të vitit 2023 vlera e detyrimeve gjyqësore është në numër 32 vendime me vlerë 46,009,272 lekë. Gjatë vitit 2023 shtesat janë 21 vendime me vlerë 20,455,028 lekë dhe vlera e likuiduar është 38 vendime në vlerën 22,891,801 lekë, nga të cilat janë 4 vendime janë shlyerje pjesore në vlerë 2,050,000 lekë dhe 34 vendime në vlerën 20,841,801 lekë.

Në fund të vitit 2023 ka mbetur pa u likuiduar **20 vendime vlera prej 43,572,499 lekë.**

**Theksojmë se në pagesat e bëra në 2023, 21 vendime janë shtuar për 2023 dhe paguar po në 2023 pa marrë parasysh detyrimet e mbartura në këte zë dhe shlyrjen bazuar në kohën e lindjes së detyrimit.**

Detyrimet nga Vendimet e Gjykatës në mënyrë *analitike pasqyruar në Aneksin nr. 3.4 Buxheti “Detyrimet e krijuara ndaj të tretëve për Vendimet Gjyqësore të formës së prerë” bashkëlidhur raportit.*

- *Detyrimet e krijuara ndaj të tretëve për pjesën e vlerës së kredisë të pashlyer për ndihmesën e qytetarëve të pastrehë me kredi të buta në bazë të programit të strehimit të akorduar nga CEB.*

Pjesë e borxhit të Bashkisë Kavajë është edhe vlera e kredisë të pashlyer për ndihmesën e qytetarëve të pastrehë me kredi të buta në bazë të programit të strehimit të akorduar nga CEB. Kjo kredi është akorduar në vitin 2014 në vlerë totale prej **662,000 euro** principal dhe 28,73% interes, nga shqyrtimi i të dhënave për transhet, e detyrimet e lindura principal dhe interesa si dhe pagesat e kryera të shpërndara në vite rezultojnë se, nuk është paguar principal dhe interes sipas transheve të planifikuara. Ka mbetur pa u paguar detyrimi i kredisë për strehimt për vitet 2021 dhe 2022 në **vlerën 35,628,212 lekë**, vlerë e cila rakordon me raportimin e detyrimeve në MFE në zërin “Hua afatgjatë”.

- *Detyrimet e krijuara ndaj të tretëve për detyrimet si rezultat i shpronësimeve për interesa publike për ndërtimin e Unazës Lindore.*

Pjesë e detyrimeve janë dhe detyrimet si rezultat i shpronësimeve për interesa publike për ndërtimin e Unazës Lindore vlera totale e detyrimit për këtë zë paraqitet 15,134,369 lekë, për 14 individë. Gjendja më 31.12.2022 në numër 13 në vlerën 12,243,728 lekë, gjatë 2023 janë likuiduar 9 individë në vlerë 9,791,662 lekë. Gjendja më 31.12.2023 në numër 4 në vlerën 2,452,066 lekë e cila nuk është përfshirë në detyrimet e raportuara në MFE.

Likuidimet gjatë vitit 2023, sipas objekteve dhe individëve privat në mënyrë *analitike pasqyruar në Aneksin nr.3.5 Buxheti “Detyrimet e krijuara ndaj të tretëve për detyrimet si rezultat i shpronësimeve për interesa publike për ndërtimin e Unazës Lindore” bashkëlidhur RPA.*

Gjatë vitit 2023, për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në Buxhetin e Bashkisë janë bërë shtesë fondesh në vlerën 32,925,000 lekë nga Pushteti Qëndror me shkresën MFE nr. 182 prot., datë 10.01.2024 në bazë të Aktit Normativ nr. 06, datë 14.12.2023 me anë të akordimit të fondeve në vlerën 32,925.000 lekë.

**Vështirësia Financiare:** Nga auditimi është konstatuar se **detyrimet e papaguara (të akumuluar)** në fund të vitit 2023 paraqiten në vlerën **1,452,552,695 lekë** dhe **fondet e miratuara** për shpenzime të këtij viti janë në vlerën **2,055,911,469 lekë**. Pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj ndaj palëve të treta është 70.6 % kundrejt shpenzimeve faktike. Kjo situatë tregon se, Bashkia Kavajë mund të konsiderohet në vështirësi financiare në fund të vitit ushtrimor 2023, pasi raporti i detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është mbi nivelin prej 25 %, sipas nenit 56 “Vështirësia financiare” të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Bashkia Kavajë ka vite, që është në vështirësi financiare, pasi nuk është bërë një punë e mjaftueshme për daljen nga situata e vështirësisë financiare.

- *Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.*

Me miratimin e buxheteve vjetore janë miratuar dhe projektet për investime. Këto projekte për investime janë programuar që në PBA përkatëse. Fondet për investime janë realizuar 1,317,067 mijë lekë nga 1,548,021 mijë lekë të planifikara ose në masën 85%. Investimet kryesisht janë

me burim financimi nga transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta, Ministria e Rindërtimit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), kështu:

- Për **vitin 2023** janë planifikuar dhe realizuar fonde për investime:

**a. Me burim financimi të ardhurat e veta (ardhurat e veta + transfertat e pakushtëzuar+transferta specifike)** janë planifikuar 18 projekte investimesh (përfshihen 16 projekte investimesh me vlerë kontrate 148,685,374 lekë nga këto janë realizuar për vitin 2023 projekte investimesh me vlerë kontrate **21,844,800** lekë dhe ka mbetur pa u likuiduar në datë 31.12.2023 vlera prej 21,041,045 lekë. Për këto 2 investime janë lidhur kontratat në vitin 2023 dhe për 16 investime janë lidhur kontrata para vitit 2023, por që ka vazhduar realizimi dhe financimi dhe në vitin 2023, në mënyrë të detajuar paraqiten në aneksin 3.6 bashkëlidhur RPA.

- Për **AKUM** janë planifikuar dhe realizuar fonde për 9 projekte investimesh të ndara në rikonstruksione, mbikqyrje dhe kolaudime për të cilat cila është deleguar vlera prej 262,459,093 lekë. Për këto investime janë lidhur kontratat nga viti 2019 deri në vitin 2022 dhe pagesat janë të ndara sipas viteve në vitin 2020 në vlerë 313,420,404 lekë; në vitin 2021 në vlerën 291,834,364 lekë; në vitin 2022 në vlerën 95,373,168 lekë dhe në vitin 2023 në vlerën 262,459,093 leke. Nga totali i vlerave të kontratave ka mbetur 231,691,721 lekë që pritet të paguhet pasi të transferohen fondet nga ministria e linjës, sipas Aneksi 3.7 bashkëlidhur RPA.

- Investime të kryera nga FZSHH, për të cilën Bashkia Kavajë nuk është pjesëmarrës si në financim me buxhet dhe zbatimin e procedurave:

Për **FZSHH (Ministria e Rindërtimit)** janë planifikuar dhe realizuar fonde për 23 projekte investimesh të ndara në rikonstruksione, mbikqyrje dhe kolaudime për të cilat është deleguar vlera prej **2,888,137,807** lekë. Për këto investime janë lidhur kontratat nga viti 2021 deri në vitin 2023 (në vitin 2023 janë lidhur kontrata mbikqyrje dhe kolaudimi), pagesat janë të ndara sipas viteve konkretisht në vitin 2021 në vlerën **703,541,867** lekë; në vitin 2022 në vlerën **293,323,030** lekë dhe në vitin 2023 në vlerën **990,528,790** lekë. Nga totali i vlerave të kontratave ka mbetur **911,913,871** lekë që pritet të paguhet pasi të transferohen fondet nga Ministria e linjës, paraqitur në mënyrë të detajuar në Aneksin nr. 6 Buxheti, bashkëlidhur raportit.

**Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. R.K** (Kryetar i Bashkisë) **Kryetar**, **z. E.L** (Sekretar i Përgjithshëm) **Kordinator**, **znj. A.K** (Drejtor Burimeve Ekonomike) **Sekretare**, dhe Anëtare **z. SH.B** , **z. A.M** (Drejtor Drejtoria Juridike), **z. R. I** (Drejtor i DTTVAB), **z. D.H** (Drejtor i Burimeve Njerëzore,) **znj. D.Q** (Drejtor Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit), **z. Y.N** , (Kryeinspektor IMTV), **z. L.H** (Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Vendore), **z. G.K** (Nënkryetar i Bashkisë), **znj. M.P** (Drejtoresha Kujdesit Social), **znj. Z.SH** (Përgjegjëse Auditit të Brendshëm), **z. F.H** (Drejtor PMNZSH), **z. J.D** (Drejtor i Arsimit parashkollor dhe të mesëm), **z. E.B** (Drejtor i Rrugëve Rurale), **znj. P.M** Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Kontabilitetit.

## **2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i tyre.**

Nga verifikimi i të dhënave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Kavajë, konstatohet se Bashkia Kavajë ka një numër popullsie prej **84 815** banorë. Nën administrimin e saj janë 5 (pesë) Njësi Administrative (Kavajë, Golem, Synej, Luz i Vogël dhe Helmas).

### **1. Burimi i krijimit të të ardhurave.**

Për vitin 2023 burimet e financimit të Bashkisë Kavajë, ndahen në 3 kategori (Të ardhurat nga burimet e veta, transferta nga buxheti qëndror, trashëgimi nga viti i shkuar), trajtuar si më poshtë vijon:

**A. Të ardhura nga burimet e veta** (zënë 24% të të ardhurave të përgjithshme).

Sipas informacionit në evidencën e të ardhurave (rakorduar me thesarin) marrë nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike rezulton se:

Planifikimi për vitin 2023 është **627,789,780** lekë, nga e cila realizuar në fakt vlera **766,627,200** lekë.

**Realizimi faktik i vitit 2023 krahasuar me vitin 2022 në përqindje është + 36 %, në vlerë absolute është 202,413,170 lekë më shumë.**

**B. Transferta nga buxheti qëndror**

**C. Huamarrja**

Bashkia Kavajë ka marrë hua për ndërtimin e banesave sociale me afat 20 vjeçar (aktualisht viti i 11- të) bazuar në marveshjen date 13.02.2008 midis **(CEB) dhe Bashkisë Kavajë për kredinë** e marrë nga Banka Qendrore Europiane (CEB) me ndërmjetësimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në rolin e institucionit garant. Bazuar në kushtet e kësaj marrveshjeje bashkia ka marrë përsipër pagesën e kësaj të kredisë me specifikimin se “*në rast të mosrespektimit të pagesave ministria e financës do ta mbajë këtë detyrim nga transfertat e buxhetit qendror*”. Nga auditimi u konstatua se për vitet 2022 – 2023 nuk ka kryer pagesën e planifikuar për këstet vjetore në vlerën **7,670,516** lekë. Në pasqyrat financiare të Bashkisë Kavajë kjo hua duhet të pasqyrohet si shpenzim konkretisht:

*Në kredi te Pasivet Afat Gjata/klasa 4 llogari të pagueshme, hua afat gjatë;*

*Në debi tek të tjera aktive afatshkurtra, llog 481, shpenzime për tu shpërndarë në disa ushtrime.*

Nga Auditimi u konstatua se për vitet 2022 – 2023 nuk ka informacion sa i përket kredisë së marrë nga Banka Qendrore Europiane (CEB) me ndërmjetësimin e MFE në rolin e institucionit garant të kësaj detyrimi. Në kontabilitetin e bashkisë kjo kredi është pasqyruar si huamarrje por nuk ka të dhëna kontabël ku të tregohet historiku i transferimit të gjendjeve të llogarive të kësaj veprimtarie. Për këtë huamarje Bashkia Kavajë nuk rezulton të ketë kryer pagesa për vitet 2022-2023 për këstet vjetore në vlerë **7,670,516** lekë.

Bazuar në legjislacionin për kontabilitetin paraqitja e huasë në bilanc duhet:

*Në kredi te Pasivet Afat Gjata/klasa 4 llogari të pagueshme, hua afat gjatë;*

*Në debi tek të tjera aktive afatshkurtra, llog 481, shpenzime për tu shpërndarë në disa ushtrime;*

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; nenet 10-11, të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 3 pikat 4, 6., nenet 57-60, nenet 62, 63, 64, 67; Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me UMF nr. 5, datë 21.02.2022, Aneksi 1, “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, si dhe në Udhëzimin e MFE nr. 34, datë 14.12.2022, “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022”.

**Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** Drejtori i Drejtorisë Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë **z. A.T** për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, znj. **F.GJ** për periudhën 23.06.2023-31.12.2023 dhe Përgjegjësi i Sektorit të Buxhetit dhe Kontabilitetit pranë kësaj Drejtorie **znj. P.M** për periudhën 01.01.2023-08.09.2023, znj. **XH.K** për periudhën 15.09.2023- në vazhdim.

#### **D. Trashëgimi nga viti i shkuar**

Për vitin 2023 Bashkia Kavajë një pjesë të nevojave për financim e ka mbuluar nga të ardhurat e trashëguara. Në kontabilitetin e bashkisë nuk ka një listë analitike për evidentimin e këtij lloji të ardhurash (të ardhurat e trashëguara nga burimet e veta) por është vetëm vlera totale në kontabilitet. Kjo e bën të pamundur verifikimin e burimit nga është krijuar kjo e ardhur (e ardhura e trashëguar) e si pasojë nuk jep mundësinë për të kontrolluar mënyrën e përdorimit të tyre.

Për vitin 2023, nuk ka evidenca të sakta për llojin e të ardhurave (të trashëguara “Të ardhura nga burimet e veta”) të cilat do të shërbejnë si bazë për destinimin e tyre në shpenzime (procesin e buxhetimit).

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 neni 35, neni 41; Ligji nr. 68/2017, datë 18.05.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pikat 2, 3, 10, 11, neni 5 gërma “e”, neni 12 pika 4, neni 13 pikat 1, 8, nenet 14-20, nenet 33-36; Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 11, neni 63 pika ç; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 22/5, pika 3; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.

**Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë z. **A.T**, Përgjegjësi i Sektorit të Buxhetit dhe Kontabilitetit pranë kësaj Drejtorie znj. **P.M**. Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit të Ardhurave Mbledhjes së Borxhit Rakordimit të Taksave dhe Apelit znj. **M.Ç** për periudhën 01.01.2023-06.07.2023, znj. **XH.U** për periudhën 11.07.2023-15.10.2023, znj. **D.M** për periudhën 16.10.2023- në vazhdim.

#### **2. Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.**

Nga auditimi i dokumentacionit të përmendur më sipër dhe kontrolli në ndërfaqen zyrtare të Bashkisë Kavajë u rezulton se gjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023, për planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është hartuar dhe zbatuar 1 paketë fiskale, miratuar me VKB nr. 107, datë 22.11.2022 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023”, konfirmuar ligjshmëria nga Prefektura e Qarkut Tiranë, me shkresën nr. 2187/1 prot., datë 05.12.2022, protokolluar në Bashkinë Kavajë sipas shkresës nr. 4056/1 prot., datë 05.12.2022. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së paketës fiskale për vitin 2023, kryesisht në ndarjen e detyrave, mbi strukturën që bën përlllogaritjen e taksës dhe tarifës dhe strukturën që ngarkohet për vjeljen e saj, konstatohet se:

- Struktura e DTTVAB Bashkia Kavajë nuk është plotësisht në funksion të planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. DTTV Bashkia Kavajë organizohet në nivel drejtorie por nuk kanë një rregullore të brendshme për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së drejtorisë sipas pozicioneve të miratuara në strukturën organizative.

Përcaktimet e Rregullores së Brendshme të miratuar më vitin 2016 me Vendimin nr. 01, datë 02.12.2016, protokolluar me shkresë nr. 3223 prot., datë 02.12.2016, rregullojnë organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së DTTVAB sipas strukturës së miratuar për vitin 2016 ku kjo drejtori ka në përbërje të saj 2 sektorë: Sektorin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat si dhe Sektorin e Task Forcë dhe verifikimit në terren. Struktura organizative DTTVAB e miratuar me VKB nr. 01, datë 04.01.2023 “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe strukturën organizative sipas drejtorive/sectorëve për vitin 2023” ka në përbërje të saj 4 sektorë (Sektorin e Planifikimit të Ardhurave, Mbledhjes së

Borxhit, Rakordimit të Taksave dhe Apelimit; Sektori i Verifikimit në Terren; Sektorin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore; Sektori i të Ardhurave nga Taksat e Turizmit në NjA Golem).

- Bashkia Kavajë nuk ka një sektor për regjistrimin të përgjithshëm të të ardhurave për të gjithë taksat/tarifave vendore sipas strukturës së miratuar në paketën fiskale dhe për të gjithë territorin që ka në administrim, por organizimin e veprimtarisë së saj sa i përket menaxhimit të të dhënave (Planifikim, Njoftim detyrimi, rregjistrim/crregjistrim, arkëtim) e bën vetëm nëpërmjet regjistrin elektronik në format “Excel” në vijim “Regjistri Elektronik” (*veçmas për çdo njësi administrative dhe vetëm për taksat/tarifave për të cilat DTTVAB ngarkohet për vjeljen sipas paketës fiskale pra jo për të gjitha taksat/tarifave vendore sipas strukturës së miratuar në paketë fiskale për vjeljen e të cilave ngarkohen drejtori të tjera*).

- Bashkia Kavajë nuk ka krijuar strukturën vendore të apelimit tatimor (*komisioni i apelimit tatimor dhe rregullorja për funksionimin e tij*) e cila shërben për apelim të akteve vendore që lidhen me taksat dhe tarifave vendore.

- DTTVAB përlllogaritjen e njoftim detyrimeve e bën brenda afateve të përcaktuara në paketë fiskale, por nuk realizohet në kohë njoftimi i të gjitha subjekteve subjekteve në lidhje me detyrimet tatimore pasi mungon një adresar i plotë dhe i qartë për kategoritë Familjarë dhe Biznes (*nuk përdoren metoda alternative “e-mail” për njoftimin e tatimpaguesve*).

- Në Bashkinë Kavajë nuk bëhet publikimi i VKB në platformën online “Vendime.al” (*Në kuadër të Reformës Territoriale dhe Administrative është miratuar platforma online Vendime.al, e cila shërben për publikim të VKB-ve*).

- Për disa lloje taksash dhe tarifash nuk është përcaktuar qartë struktura e ngarkuar për të bërë përlllogaritjen dhe struktura që do të ndjekë vjeljen e taksës ose tarifës përkatëse. Gjithashtu konstatohet se në disa raste për vjeljen e taksave dhe tarifave të ndryshme ngarkohen njëkohësisht më shumë se dy struktura.

- Procesi për planifikimin, përlllogaritjen e detyrimeve tatimore, ndjekjen e subjekteve debitore për taksa tarifa vendore nuk është i saktë pasi:

- Planifikimi për taksa dhe tarifa vendore nuk është kryer bazuar në rakordimin midis DTTVAB, DRT dhe QKB për numrin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin që administron Bashkia Kavajë, analizën e rezultatit historik, pritshmërive të vitit korrent dhe kordinimit midis drejtorive që mbulojnë realizimin e tyre.

- Burimi i të dhënave sa i përket kategorisë biznes për llojin e aktivitetit, sipërfaqes së ambienteve ku biznesi ushtron aktivitet, xhiros vjetore etj në regjistrin elektronik të DTTVAB-së nuk është i plotë dhe i shoqëruar me dokumentacion shoqërues.

Kjo ndikon në cilësinë e të dhënave që popullojnë bazën e regjistrin elektronik të DTTVAB-së, planifikim dhe në përgatitjen e evidencave të qarta sa i përket identifikimit të subjektit dhe përcaktimit të njoftim detyrimit për tu paguar lidhur me taksat dhe tarifave vendore”.

- Në paketën fiskale nuk identifikohen taksa dhe tarifa vendore për të gjitha kategoritë e bizneseve që zhvillojnë aktivitet në Bashkinë Kavajë si, ATM pajisje elektronike, makineta, lojra për fëmijë, ekranet dixhital të reklamimit, karikues për mjetet lëvizëse (që janë të vendosura në hapsira publike, biznes privat, apo pranë institucioneve të ndryshme etj), tenda, konstruksione metalike. Mos përfshirja në strukturën e paketës fiskale e të gjitha kategorive të bizneseve që zhvillojnë aktivitet në Bashkinë Kavajë çon në mosplanifikim të disa kategorie biznesesh.

- Evidenca e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për vitin 2023 nuk jep informacion të plotë mbi të gjitha taksat/tarifave vendore dhe gjobat e aplikuara për kundravajtjet administrative pasi:

Drejtoritë që administrojnë (sipas strukturës së paketës fiskale) taksa/tarifa vendore nuk mbajnë regjistër për manaxhimin e të dhënave. (*Vetëm DTTVAB administron regjistër për manaxhimin e të dhënave mbi taksat dhe tarifa vendore*).

Evidenca e realizimit të të ardhurave për vitin 2023 nuk jep informacion për 77% të taksave/tarifave **apo** kundravajtje administrative vendore të miratuara në paketën fiskale për vitin 2023, në vlerë absolute 76 taksa /tarifa dhe kundravajtje administrative.

Në DTTVAB nuk përcillet informacion lidhur me “Planifikimin” mbi realizimin e pritshëm për taksa/tarifa vendore dhe “Listat e debitorëve” nga gjithë struktura e ngarkuar për administrimin e të ardhurave por vetëm nga DTTV për taksa/tarifa që administron.

Sa më sipër “Evidenca e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për vitin 2023” dhe “Vlerësimi i gjendjes së debitorëve të krijuar për gjithë taksat/tarifat vendore” sipas strukturës së Paketës Fiskale të miratuar: nuk janë të plota. Mungon gjurma e auditimit mbi vlerësimin e gjendjes së debitorëve të krijuar për gjithë taksat/tarifat vendore.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, **nenet 5- 11**, shkronjën “b” në pikën 3 në **nenin 22**; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar neni 4, pika 7, nenet 20-25 në Kreun IV; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 1, **neni 2** gërmat a, ç, **neni 5** gërmat a, d, dh, f, g, gj, h, i, **neni 6** pikat 1, 2, 3, neni 12 **gërmat** a, b, dh..., **neni 13** gërma b, neni 15, **neni 23** pika 1, 4, neni 26, neni 27, neni 28 pika 1, **neni 29**, neni 31, neni 40, neni 41, neni 42, **neni 43 pika 1, 2, 3, neni 44, neni 45**, neni 47, **neni 48** pika 1, **neni 57** pikat 4, 5, **nenet 60, 61, 62**, neni 65 pika 5, nenet 68, 69, **neni 70 pika 2, neni 71/1** pika 5 **nenet 88 – 104**; **Neni 3** në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore; Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, Neni 2 pika 13, pika 16 nenet 28-40, **neni 42, neni 43** gërma d, **neni 59**; Ligji nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 12; në nenin 7 Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportele”, Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”; Manuali i Manaxhimit Financiar dhe kontrollit kapitulli III, Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me Urdhërin e MFE nr. 108, datë 17.11.2016; Udhëzimi nr. 26, datë 16.12. 2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë; Udhëzimi nr. 655/1, datë 06.02.2007, “Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore neni 12; pika 3.1, pika 3.2, pika 3.3, pika 4.; VKB nr. 107 datë 22.11.2022, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë;

**Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** Drejtor i Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit z. **R. I** për periudhën 01.01.2023 deri me 11.08.2023, z. **D.H** (ish Drejtor i Burimeve Njerëzore), z. **K.M** (Drejtor i Burimeve Njerëzore), z. **A.M** (Drejtor Drejtoria Juridike), z. **A.Ç** për periudhën 14.08.2023 në vazhdim; Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë z. **A.T**, znj. **D.Q** (Drejtor Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, z. **L.H** (Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Vendore), Z. **J.K** Drejtor i DKMU, z. **S.M** (Drejtor i Drejtorisë së konsumatorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit). Përgjegjës i sektorit të turizmit z. **G.T** për periudhën 01.01.2023 deri më 27.06.2023, z. **B.R** për periudhën 11.07.2023 në vazhdim; Përgjegjëse e Sektorit të të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore Znj. **M.H** për periudhën 01.01.2023 deri më 15.08.2023; Znj. **S.M** për periudhën 16.08.2023 në vazhdim.

- DTTVAB çdo fillim viti krijon një regjistër të ri elektronik në format excel për administrimin e të dhënave për çdo njësi administrative. Bazuar në regjistrin elektronik që këto njësi administrojnë (veçmas për çdo njësi administrative) Sektori i të ardhurave në NjA Kavajë dhe Zyrat e Taksave pranë NjA bëjnë menaxhimin e të dhënave sa i përket regjistrimit/çregjistrimit, planifikimit, njoftim detyrimin dhe regjistrimin e arkëtimeve për abonentët familjarë dhe personat fizikë e juridikë të cilët kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifat vendore, sipas kategorisë së detyrimeve tatimore, përfshirë përjashtimet apo lehtësimet fiskale për kategori të caktuara taksapaguesish.



DTTVAB për periudhën në auditim nuk ka një dokumentim, protokollim të momentit të mbylljes së regjistrin elektronik vjetor ekzistues dhe krijimit të regjistrin elektronik të ri vjetor. Të dhënat që administrohen nga regjistrin elektronik (informacioni mbi subjektet tatimpagues që popullon regjistrin elektronik), shërbejnë për përgatitjen e evidencave të cilat përdoren për raportim (*evidenca mbi planifikimin e pritshëm dhe realizimin faktik mbi të ardhurat për taksa/tarifa vendore, evidenca mbi ndjekjen e subjekteve debitore, listat për njoftim bllokimi për rsubjektet debitore në bankat enivelit të dytë apo QKB*) realizimi në drejtimin e Bashkisë Kavajë dhe përgatitjen e pasyrave financiare. Mungon rakordimi analitik dhe i dokumentuar midis sektorëve dhe kontabilitetit. Kontabiliteti përdor për veprimtarinë e tij evidencën e vënë në dispozicion nga DTTVAB e cila krijohet nga procesi i përpunimit në formatin excel i informacionit të grumbulluar në rregjistrin elektronik vjetor (në të cilin nuk ka të dhëna mbi informacionin historik mbi subjektin) si dhe nga informacioni që paraqesin drejt saj drejtoritë të cilat administrojnë taksa dhe tarifa vendore bazuar në paketën fiskale. Procesi i përpunimit bëhet manualisht duke ulur eficientësinë, nivelin e cilësisë dhe sigurinë e informacionit të përpunuar.

Auditimi i “Regjistrin Elektronik” për kategorinë “Biznes” dhe “Familjar”, është vlerësuar i rëndësishëm, për shkak të rëndësisë së veçantë të shërbimit që ofron. Ky “Regjistër Elektronik” administron të dhëna për kategorinë “Biznes” dhe “Familjar”, në nivel lokal.

Siguria e informacionit është bërë gjithnjë më e rëndësishme për institucionet e administratës shtetërore që administrojnë të dhëna, si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit.

Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Bazuar në sa më sipër, **çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit bazuar në elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria”.**

Për të minimizuar rrezikun e gabimeve, parregullsive, shkeljeve dhe moszbulimin e tyre, titullarët duhet të vendosin rregulla që e shpërndajnë tek punonjës të ndryshëm përgjegjësinë e zbatimit të dy, ose më shumë fazave kyçe të një operacioni, procesi, apo aktiviteti. Përgjegjësitë duhet të ndahen në mënyrë të tillë, që përjashton mundësinë që një punonjës i vetëm të jetë njëherësh përgjegjës për miratimin (marrjen e vendimit), zbatimin, dhe kontrollin, për të garantuar kryerjen e kontrolleve efektive, si dhe për të ruajtur ekuilibrin në zbatimin e një operacioni/transaksioni.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe aktet ligjore e nënligjore në zbatim të këtij ligji përcaktojnë kuadrin rregullator që shërben për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet e njësive publike janë të përshtatshme dhe efektive për të ofruar shërbime publike dhe për të adresuar risqet me efikasitet dhe efektshmëri.

Objektivat e auditimit janë të sigurohet se njësia publike:

- Pajtohet me legjislacionin, aktet e brendshme dhe kontratat,
- Siguron informacione operative dhe financiare të besueshme dhe të plota,
- Mbron informacionin dhe aktivitetet e saj.

Nga informacioni i marrë në intervistat me punonjësit e DTTVAB, pyetësorët e drejtuar institucionit dhe evidencat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se: Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore” nenin 3, Ligji nr. 2/2017, datë 26.01.2017, “Për sigurinë kibernetike” neni 4; Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” Kreun II “Rregullat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave; Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të ndryshuar” nenet 2, 3, 5, 6, 20, 27, 28.; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar nenet 25, 27, 28, 31; VKM nr. 945, datë 02.11.2012, “Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore” i ndryshuar; Vendimin nr. 710, datë 21.08.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, (ndryshuar me VKM nr. 755, datë 26.10.2016); Kreun II, pikën k, të Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit”, (ndryshuar me VKM nr. 36, datë 24.01.2018; nr. 88, datë 14.02.2018; nr. 448, datë 26.7.2018; nr. 872, datë 24.12.2019); pikën 4, “Kërkesat e sigurisë” shkronja b, të “Rregullores për administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019; pikën 4, gërma “a”, të “Rregullores për menaxhimin e log-eve digitale në administratën publike”, miratuar me Urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT); Manualin e Auditit të Brendshëm të miratuara me Urdhërin nr. 4, datë 10.01.2020, pika 2.4.4.

- DTTVAB nuk ka një rregullore të brendshme të miratuar apo përshkrim të proceseve të punës së personelit që operon në “Regjistrin elektronik”, ku të përcaktohen detyrat, përgjegjësitë sipas funksioneve të përcaktuara në strukturën organizative të miratuar.

Bashkia Kavajë organizimin e veprimtarisë së DTTVAB e bën duke u mbështetur vetëm në “Regjistrin Elektronik” (veçmas për çdo njësi administrative). Për çdo njësi administrative ky regjistër bën menaxhimin e të dhënave sa i përket regjistrimit/çregjistrimit, planifikimin, njoftim detyrimin dhe regjistrimin e arkëtive dhe administrimin e debitoreve për abonentët familjarë, personat fizikë e juridikë të cilët kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifat vendore, sipas kategorisë së detyrimeve tatimore, përfshirë përjashtimet apo lehtësimet fiskale për kategori të caktuara taksapaguesish.

Struktura e kategorizimit të regjistrit për bizneset dhe popullatën është e ndërtuar bazuar në paketën fiskale të miratuar. DTTVAB çdo fillim viti krijon një regjistër të ri për administrimin e të dhënave për çdo njësi administrative. Procesi i popullimit të Regjistri Elektronik në DTTVAB dhe procesi i përpunimit dhe përgatitjes së evidencave kryhet nga të njëjtit përdorues. Për periudhën në auditim nuk ka një dokumentim, protokollim të momentit mbylljes së regjistrit vjetor ekzistues dhe krijimit të regjistrit të ri vjetor. Raportet të cilat prodhohen nga informacioni që popullon regjistrin elektronik (*evidenca mbi planifikimin e pritshëm dhe realizimin faktik mbi të ardhurat për taksat/tarifa vendore, evidenca mbi ndjekjen e subjekteve debitore, listat për njoftim bllokimi për subjektet debitore në bankat eniveli të dytë apo QKB etj.*) shërbejnë për përgatitjen e evidencave të cilat përdoren për raportim në drejtimin e Bashkisë Kavajë dhe përgatitjen e pasyrave financiare. Mungon rakordimi analitik dhe i dokumentuar midis sektorëve dhe kontabilitetit. Kontabiliteti përdor për veprimtarinë e tij evidencën e vënë në dispozicion nga DTTVAB e cila krijohet nga procesi i përpunimit në formatin excel i informacionit të grumbulluar në regjistrin elektronik vjetor (në të cilin mungon informacioni historik mbi subjektin) si dhe nga informacioni që paraqesin praj saj drejtoritë të cilat administrojnë taksat/tarifa vendore bazuar në paketën fiskale për vitin 2023. Procesi i përpunimit bëhet manualisht duke ulur eficientësinë, nivelin e cilësisë dhe sigurinë e informacionit të përpunuar. Kjo drejtori për vitin 2023:

- Nuk ka një rregullore të brendshme të miratuar ku të përcaktohen detyrat, përgjegjësitë sipas funksioneve të përcaktuara në strukturën organizative të miratuar me VKB nr. 01, datë

04.01.2023 “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve, nivelin e pagave dhe strukturën organizative të Bashkisë Kavajë”

- Nuk administrojnë një regjistër për të gjitha taksat/tarifat vendore sipas strukturës së paketës fiskale (në total 77 taksa/tarifa vendore) dhe për gjithë territorin që ka nën administrim qoftë dhe në formatin Excel për të parandaluar për shembull, regjistrimin e dyfishtë të taksapaguesve, modifikime të paautorizuara të të dhënave. Nuk ka monitorim dhe dokumentim për ndryshimet që kanë ndodhur në lidhje me ngarkesat dhe pagesat për detyrimet mbi taksat dhe tarifat vendore (lista e veprimeve të ndryshimeve sipas natyrës së veprimit), Nuk administrohen në dosjet e subjekteve procesv-verbale sa i përket ndryshimeve që kanë ndodhur në lidhje me ngarkesat/pagesat e detyrimeve mbi taksat dhe tarifat vendore (Credit Note).

- Nuk ka bashkëveprim me burimet njerëzore për procedurën që ndiqet për përdorues të cilët janë punësuar rishtaz, larguar nga detyra apo kanë ndryshuar pozicion në strukturën organizative lidhur me ruajtjen e të dhënave personale për regjistrin elektronik që ata kanë marrë në administrim.

- Nuk ka një rregullore të brendshme apo përshkrim të proceseve të punës për personelin që operon me këtë regjistër elektronik. Nuk ka monitorim dhe dokumentim të rakordimeve midis raporteve të gjeneruara nga regjistri elektronik me formatet e përpunuara nga përdoruesit. Nuk ka evidenca të cilat vërtetojnë monitorimin e procesit të popullimit të regjistrit elektronik, përpunimin e informacioneve të raporteve të gjeneruara nga ky regjistër në evidencat format excel dhe më pas shkresore për njoftim detyrime drejt tatimpaguesve, raportime midis drejtorive apo drejt titullarit.

- Drejtoritë të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për subjekte tatimpagues apo individë nuk administrojnë regjistër për manaxhimin e të dhënave mbi taksat dhe tarifat që administrojnë (Sipas strukturës së Paketës Fiskale). Këto drejtorë nuk rakordojnë me DTTVAB lidhur me realizimet e të ardhurave që kanë përgjegjësi të manaxhojnë sipas përcaktimeve në paketën fiskale të miratuar me VKB nr.107, datë 22.11.2022 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Kavajës” dhe kërkesat të cilat i drejtohen Bashkisë Kavajë për informacion sa i përket gjendjes debitore (detyrimeve ndaj bashkisë lidhur me taksa dhe tarifa vendore) të subjekteve. “A janë të regjistruar këto subjekte në sistemin e DTTVAB” dhe “A kanë detyrime të pashlyera?”.

**Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me përcaktimet në Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 4 pika 26, neni 5, neni 11; Udhëzimi e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar; ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, neni 35, neni 41.; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika ç; ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë i ndryshuar”, VKM nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, i ndryshuar, Manuali për MFK i miratuar me urdhër të Ministrisë të Financave nr. 108 datë 17.11.2016, kapitulli III.**

**Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi personat si më poshtë:** Kryetari i Bashkisë **z. R.K** për periudhën 01.01.2023 deri më 15.05.2023, Kryetari i Bashkisë **z. F.Q** për periudhën 15.05.2023 në vazhdim, Drejtor i Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit **z. R. I** për periudhën 01.01.2023 deri me 11.08.2023, **z. A.Ç** për periudhën 14.08.2023 në vazhdim; Drejtori i Drejtorisë Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë **z. A.T** për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, znj. **F.GJ** për periudhën 23.06.2023 në vazhdim.

#### **4.Mbi kontrollin e cilësisë së të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve.**

Veprimtaria e DTTV bazohet në proceset që manaxhojnë:

- Kërkesa për regjistrim të subjekteve të reja
- Ndryshime në të dhënave rreth adresës primare, shtimin apo mbylljen e adresave dytësore dhe të dhënave mbi të cilat përlogariten tarifat dhe taksat vendore për subjektet egzistuese
- Kërkesat për çregjistrim, pezullim të subjekteve egzistuese

Të dhënat e administruara në regjistrin elektronik të DTTVAB janë në funksion të identifikimit të subjektit tatimpagues dhe përcaktimit të detyrimit për tu paguar lidhur me taksat dhe tarifat vendore.

Bashkia Kavajë nuk ka element kontrolli mbi vërtetësinë e të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve, pasi ky kontroll nuk është pjesë vetëm e aktivitetit të këtij institucioni por një ndërthurje midis Degës Rajonale të Tatimeve në vijim (DRT), Qendrës Kombëtare të Biznesit në vijim (QKB) dhe sektorit të kontrollit në terren pranë DTTV. Kjo drejtori nuk ka një korendiment të plotë me QKB dhe DRT. *Për vitin 2023 nuk ka asnjë komunikim me QKB dhe DRT lidhur me rakordimin mujor apo vjetor për numrin e subjekteve të reja, subjekteve të cilat kanë ndryshuar të dhënat rreth adresë primare ose sekondare, subjekteve të çregjistruara.* **Sektori i terrenit është hallka e vetme për të përcaktuar përputhjen midis të dhënave të deklaruara vullnetarisht nga subjekti në QKB, të dhënat faktike në terren dhe të dhënave që administron DTTV në dosjen e subjektit.**

Mungon Gjurma e auditimit dhe nuk ka element kontrolli mbi vërtetësinë e të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve.

Popullimi i regjistrimit elektronik të subjekteve me kërkesa për reregjistrim të subjekteve të reja, ndryshimet në të dhënat rreth adresës primare, shtimin apo mbylljen e adresave dytësore dhe të dhënave mbi të cilat përlogariten tarifat dhe taksat vendore për subjektet egzistuese **nuk realizohet bazuar në përcaktimet e cituara në manualin e manaxhimit financiar dhe kontrollit dhe duke rakorduar informacionin e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB me sektorin e verifikimeve në terren dhe DRT.**

**Kërkesat për regjistrim të subjekteve të reja, kërkesat për ndryshime të dhënash, kërkesat për ndryshimin e statusit të aktivitetit (çregjistrim, pasiv apo pezullim të subjekteve egzistuese) nga subjektet tatim pagues.**

Akt konstatimet nga sektori i terrenit nuk janë të rifreskuara periodikisht (çdo vit) dhe nuk shprehin qartë objektin për të cilin është kërkuar mbajtja e këtij akt konstatimi konkretisht:

*- Akt konstatimet e mbajtura mbi kërkesat për regjistrimet e reja.*

Sipas përcaktimeve të kuadrit rregullator, DTTVAB për çdo aplikim për regjistrim të subjekteve të reja duhet ti kërkojë sektorit të verifikimit në terren verifikimin për konfirmimin e të dhënave të deklaruara vullnetarisht në QKB apo në sportele.

Akt konstatimet e mbajtura nuk japin informacion të plotë sa i përket të dhënave të nevojshme për: Përcaktimin e bazës së taksës dhe nuk shoqërohen me dokumentacion justifikues të njehsuar me origjinalin. Përputhjen midis llojit të aktivitetit të deklaruar dhe dokumentacionit të administruar në praktikën për aplikim të subjektit, adresën e plotë ku ushtrohet ky aktivitet, sipërfaqen që administron, gjëndjen debitore që shfaqin aktivitete të mëparshme të administruara prej tij në regjistrin elektronik të DTTVAB dhe paqartësinë me masat e marra për rastet debitore.

Rregjistrimi i subjekteve të reja në regjistër elektronik duhet të kryhet bazuar në akt konstatimet nga sektori i verifikimit në terren të taksave dhe tarifave. Nëpërmjet akt konstatimeve në terren ky sektor konfirmon saktësinë e të dhënave për të procesuar më tej me regjistrimin e subjekteve në sistemin e DTTVAB. *Në dosjet që ju përkasin regjistrimeve të reja për 2023 DTTVAB nuk administron asnjë Akt konstatim ku të përcaktohet përputhja midis informacionit të deklaruar vullnetarisht nga subjekti në QKB me informacionin faktik në terren. Kjo ndikon në cilësinë e të dhënave që popullojnë bazën e regjistrimit elektronik të DTTVAB-së, planifikim dhe në përgatitjen e evidencave të qarta sa i përket identifikimit të*

subjektit dhe përcaktimit të njoftim detyrimit për tu paguar lidhur me taksat dhe tarifave vendore” ndërkohë që të dhënat për këto subjekte janë lehtësisht të verifikueshme në terren apo nga drejtoritë që administrojnë informacion për kryqëzimin e këtij informacioni.

- Akt konstatimet e mbajtura nga sektori i terrenit mbi kërkesat për ndryshime të dhënash nga subjektet tatim pagues.

Sipas përcaktimeve të kuadrit rregullator DTTVAB për çdo aplikim nga subjektet ekzistuese lidhur me ndryshimin e të dhënave duhet të kërkojë nga sektori i verifikimit në terren të kryej verifikimin për konfirmimin e të dhënave që të deklaruara vullnetarisht në QKB apo në sportele.

Nga ky sektor nuk mbahen akt konstatime ku të përcaktohet përputhja midis llojit të të dhënave që kërkohet të ndryshohen dhe të dhënave që administrohen në sistem apo në dosjen e subjektit pranë DTTVAB. Në regjistrin elektronik konstatohen raste ku subjektet kanë gjendje debitore në kodin seli apo në kodet që i përkasin adresave dytësore. Në DTTVAB nuk konstatohen evidenca të ndjekjes së procedurës ligjore për mbledhjen e debisë së tyre, por procesohet me hapjen apo mbylljen e adresave dytësore të tjera. Për të gjitha subjektet të cilat kanë adresë dytësore është i pa përcaktuar në fushën adresë dytësore numri serial që lëshohet nga DRT për adresat dytësore sipas ligjit në fuqi.

- Akt konstatimet e mbajtura mbi kërkesat për ndryshimin e statusit të aktivitetit (çregjistrim, pasiv apo pezullim të subjekteve ekzistuese).

Sipas përcaktimeve të kuadrit rregullator DTTVAB për çdo aplikim nga subjektet ekzistuese lidhur **ndryshimin e statusit të aktivitetit (çregjistrim, pasiv apo pezullim)** duhet të kërkojë nga sektori verifikimit në terren informacion lidhur me kërkesën e paraqitur nga QKB. (nëse subjekti i cili ka paraqitur kërkesën për ndryshim statusi ushtron aktivitet ose jo.)

Ky akt konstatim është shumë i rëndësishëm, ai duhet të realizohet konform kuadrit rregullator ligjor brenda afateve të përcaktuara në ligj sepse: **Në rast të mos respektimit të afateve të përcaktuara në kuadrin ligjor, QKB proceson automatikisht me ndryshimin e statusit. DTTVAB Kavajë për të gjitha rastet kur statusi ka ndryshuar ndërpret faturimin e mëtejshëm të subjektit edhe pse ky çregjistrim ka ardhur si pasojë e mos përgjigjes në kohë ndaj kërkesës për evidentimin e gjendjes debitore nga QKB.**

Në regjistër janë konstatuar raste ku subjekti edhe pse ka gjendje debitore, rezulton me statusin çregjistruar, pasiv apo pezulluar.

Në regjistër elektronik janë konstatuar raste ku subjekti, ka gjendje debitore, rezulton me statusin aktiv në QKB por në regjistër pasqyrohet me statusin mbyllur pasiv apo pezulluar. Ky status në regjistër elektronik ndërpret njoftim detyrimit. Termi i përdorur më shpesh në akt konstatime është “Nuk u gjet në aktivitet” ose “Nuk u gjet”, pa përcaktuar numrin e procesverbaleve të mbajtura për të vërtetuar shpeshësinë e kontrolleve apo faktin nëse ky subjekt nuk ushtron aktivitet.

Nga evidencat e trajtuar në DTTVAB nuk u konstatua asnjë dokument i cili tregon rakordimin me Degët Rajonale të Tatimeve lidhur me klasifikimin e biznesit dhe llojin e aktivitetit që kryen.

Rastet *analitike pasqyruar në Aneksin nr.1, “2.2.6 Të ardhurat” “Rakordimi lidhur me regjistrimet dhe çregjistrimet e subjekteve për 25 raste” bashkëlidhur raportit.*

Nga auditimi lidhur me të dhënat në regjistrin elektronik të subjekteve, mënyrën e përlllogaritjes së detyrimeve dhe përgatitjen e evidencave mbi raportet e përfituara nga sistemi i manaxhimit të të dhënave është konstatuar se:

Veprime në kundërshtim me ligjin Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 5, neni 11.; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e

taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 1, **neni 2** gërmat a, ç, **neni 5** gërmat a, d, dh, f, g, gj, h, i, **neni 6** pikat 1, 2, 3, neni 12 **gërmat** a, b, dh..., **neni 13** gërma b, neni 15, **neni 23** pika 1, 4, neni 26, neni 27, neni 28 pika 1, **neni 29**, neni 31, neni 40, neni 41, neni 42, **neni 43 pika 1, 2, 3**, **neni 44**, **neni 45**, neni 47, **neni 48** pika 1, **neni 57** pikat 4, 5, **nenet 60, 61, 62**, neni 65 pika 5, nenet 68, 69, **neni 70 pika 2**, **neni 71/1** pika 5; Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, nenet 28-40, **neni 42**, **neni 43** gërma d, **neni 59**; Manuali i Manaxhimit Financiar dhe kontrollit kapitulli III, Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me Urdhërin e MFE nr. 108, datë 17.11.2016; Udhëzimi nr. 26, datë 16.12. 2014; Udhëzimi nr. 655/1, datë 06.02.2007, “Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore; VKB nr. 107, datë 22.11.2022, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë.

**Ndikimi/Efekti:** Mos regjistrim në DTTVAB dhe mos faturim i subjekteve tatimpagues, çregjistruar nga QKB subjekte debitore, mbyllur në regjistrin elektronik të DTTVAB subjekte aktive në QKB.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi

**Rëndësia:** E lartë

**Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi z.R. I**, Drejtor i DAV Bashkia Kavajë, për periudhën 01.10.2023-11.08.2023; Për periudhën 11.08.2023 - 31.12.2023 z. **A.Ç** (Sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr.420, datë 11.08.2023, “Për administrimin sa më efikas të DTTV), Përgjegjës i Sektorit të Turizmit z. **G.T** për periudhën 01.01.2023 deri më 27.06.2023, z. **B.R** për periudhën 11.07.2023 në vazhdim; Përgjegjëse e Sektorit të të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifave Vendore **znj.M.H** për periudhën 01.01.2023 deri më 15.08.2023; **znj. S.M** për periudhën 16.08.2023 në vazhdim.

- Taksa dhe tarifa lokale (familjarët).

Me VKB Kavajë nr. 107, datë 22.11.2022 “Për sistemin taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Kavajë”, për vitin 2023 për kategorinë e taksapaguesve “Familjare” është miratuar: *Taksë ndërtese* për familjaret 1785 lekë në vit për çdo familje, *Taksë trualli* 200 lekë, Tarifë pastrimi 1000 lekë, arsimit 500 lekë, gjelbërimi ndriçimi 200 lekë për çdo familje (vlera totale 3685 lekë).

Janë përcaktuar lehtësira dhe përjashtime sipas paketës fiskale 2023 Kreu IV gërma (a, b, c, d), e të VKB-së nr. 107 datë 22.11.2022 për 2605 familje sipas kategorizimit dhe te detajuara si më poshtë në formë tabelle:

Nr.	Kategori	Niveli i pagesës tarifave	Familje të përjashtuara në nr sipas DTTVAB	Shënime
1	Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike	0 Lekë	251	Përjashtohen nga taksat
2	(PAK)	0 lekë	573	Përjashtohen nga taksat
3	Të verbër	0 Lekë	169	Përjashtohen nga taksat
4	Para plegjikë tertra plegjikë	0 lekë	57	Përjashtohen nga taksat
5	Kryefamiljarët pensionist	0 Lekë	102	Përjashtohen nga taksat
6	Invalid pune	0 Lekë	1400	Përjashtohen nga taksat
7	Familjet që jetojnë në emigracion	0 Lekë	Ska info	Përjashtohen nga taksat
7	Gra të divorcuara ose të veja	0 Lekë	53	Përjashtohen nga taksat
	<b>Total</b>		<b>2605</b>	

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

**Sipas të dhënave nga DTTVAB**, planifikimi vjetor i taksave dhe tarifave lokale për vitin 2023 për kategorinë familjar, është **13,266,000** lekë.

Bashkia Kavajë, planifikon për taksat/tarifa vendore për 3600 familje. Realizimi faktik për vitin 2023 (arkëtime nëpërmjet sistemit bankar dhe arka në njësitë administrative) janë në vlerën **76,167,604** lekë nga të cilat **1,083,757** lekë nëpërmjet bankave (faturimi i taksës

familjare tek subjektet biznes) dhe **75,083,847** lekë nëpërmjet arkave në njësi (ku përfshihen edhe pagesat për taksat në fshatrat turistike dhe taksën e tokës bujqësore). *Nuk mund të ndahet vlera e realizuar për llogari të taksës për kategorinë familjare e likuiduar për vitin 2023 pasi pagesat kryhen nisur nga gjendja e akumuluar për vitet e mëparshme (pra subjekti paguan detyrimet e mëparshme dhe jo vitin korent).*

Sipas sistemit të gjendjes civile numri i familjeve rezidente në territorin e Bashkisë Kavajë për vitin 2022 është 23,371 familje.

**Krahasuar me numrin e familjeve sipas informacionit nga gjendja civile janë planifikuar 19 771 familje më pak x 3685 lekë/familje = 72,856,135 lekë më pak, të cilat janë të ardhura të munguara si pasojë e mosplanifikimit korrekt të taksave për Kategorinë e taksapaguesve “Familjarë”. Krahasuar me të dhënat e evidencës për planifikim dhe realizim për vitin 2022 u konstatua se janë planifikuar **5799 familje më pak** x 3685 lekë/familje = **21,369,315** lekë më pak se planifikimi për vitin 2022.**

Përsa i takon taksimit të kategorisë “Familjar”, për Qytetin e Kavajës, DTTVAB Bashkia Kavajë planifikon për arkëtim vetëm ato familje të cilat kanë një aktivitet ekonomik, pasi vetëm tek kjo kategori e ka të mundur identifikimin dhe ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore.

DTTVAB Bashkia Kavajë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM nr. 132, datë 7.3.2018, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”.

Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” u konstatua se:

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Kavajë dhe NJA janë planifikuar dhe taksohen gjithësej 3600 familje për vitin 2023. Krahasuar me të dhënat e evidencës për planifikim dhe realizim për vitin 2022 u konstatua se janë planifikuar **5799 familje më pak** x 3685 lekë/familje = **21,369,315** lekë më pak se planifikimi për vitin 2022.

Të dhënat për numrin e familjeve që planifikohen për çdo NJA, të krahasuara me të dhënat nga gjendja civile dhe evidencat për planifikim dhe realizim për vitin 2022 pasqyrohen si më poshtë në formë tabelore:

	Njësi Administrative	Familje gjithësej të planifikuarra dhe tarifuara për vitin 2022	Vlera në planifikim për vitin 2022	Familje gjithësej të planifikuarra dhe tarifuara për vitin 2023	Diferenca në nr krahasuar me Planifikimin për vitin 2022	Vlera në planifikim për vitin 2022	Diferenca në vlerë per planifikimin 2023 krahasuar me planifikimin 2022	Familje sipas Gj.Civile	Diferenca krahasuar me gj civile	Diferenca krahasuar me gj civile në vlerë
1	Luz i Vogël	1939	7,145,215	500	1439	1,842,500	-5,302,715	2690	-2190	-8,070,150
2	Helmas	1763	6,496,655	200	1563	737,000	-5,759,655	1293	-1093	-4,027,705
3	Golem	2601	9,584,685	1,090	1511	4,016,650	-5,568,035	3543	-2453	-9,039,305
4	Kavajë	1372	5,055,820	1,260	112	4,643,100	-412,720	13047	-11787	-43,435,095
5	Synej	1724	6,352,940	550	1174	2,026,750	-4,326,190	2798	-2248	-8,283,880
	<b>TOTAL</b>	<b>9399</b>	<b>34,635,315</b>	<b>3,600</b>	<b>5799</b>	<b>13,266,000</b>	<b>-21,369,315</b>	<b>23371</b>	<b>-19771</b>	<b>-72,856,135</b>

**Burimi:** DAV Bashkia Kavajë dhe Zyra e Gjendjes Civile Kavajë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Rakordimi mbi numrin real të Familjeve për taksapaguesit në kategorinë “Familjar” nuk është i saktë.

Për vitin 2023 nuk është hartuar një plan apo strategji, vjetore apo afatgjatë (më shumë se një vit), për të evidentuar familjet e pa rregjistruara, (jo vetëm ato familje të cilat kanë një aktivitet ekonomik) në mënyrë që të ndiqet arkëtimi i tyre nga administrata e taksave dhe tarifave vendore.

DTTV nuk ka hartuar regjistër të taksapaguesve familjar. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka lënë jashtë mbikëqyrjes së saj këtë kontingjent taksapaguesish familjar (Nuk ka të dhëna për familjarët të cilët nuk kanë një aktivitet ekonomik). Për këta taksapagues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, duhet të ndiqeshin procedurat ligjore për njoftimin dhe arkëtimin e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore në përputhje me paketën fiskale.

**Sipas të dhënave nga DTTVAB**, planifikimi vjetor i taksave dhe tarifave lokale për vitin 2023 për kategorinë “Familjar”, është **13,266,000** lekë.

Bashkia Kavajë, planifikon për taksat/tarifa vendore për 3600 familje. Realizimi faktik për vitin 2023 (arkëtime nëpërmjet sistemit bankar dhe arka në njësitë administrative) janë në vlerën **76,167,604** lekë nga të cilat **1,083,757** lekë nëpërmjet bankave (faturimi i taksës familjare tek subjektet biznes) dhe **75,083,847** lekë nëpërmjet arkave në njësi (ku përfshihen edhe pagesat për taksat në fshatrat turistike dhe taksën e tokës bujqësore).

Sipas sistemit të gjendjes civile numri i familjeve rezidente në territorin e bashkisë për vitin 2022 është 23,371 familje.

**Krahasuar me numrin e familjeve sipas informacionit nga gjendja civile konstatohet se nga Bashkia Kavajë janë planifikuar 19,771 familje më pak x 3685 lekë/familje = 72,856,135 lekë më pak të cilat janë të ardhura të munguara si pasojë e mosplanifikimit korrekt të taksës familjare.**

DTTVAB Bashkia Kavajë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM nr. 132, datë 7.3.2018, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”.

Theksojmë se në këtë përlllogaritje nuk janë marrë parasysh fshatrat turistike si dhe pasuritë e paluajtshme të dyta në NjA Golem.

Situata e mësipërme, është krijuar për arsye se në vitin 2020 është ndërprerë marrëveshja e bashkëpunimit me UK ShA Kavajë ku ky i fundit ka pasur rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Praktikisht sa i takon taksimit të kategorisë “Familjar”, për Qytetin e Kavajës, DAV Bashkia Kavajë takson vetëm ato familje të cilat kanë një aktivitet ekonomik, pasi vetëm tek kjo kategori e ka të mundur identifikimin dhe ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore.

Grupi i auditimit nuk mund të japë një opinion të saktë dhe të qenësishëm për situatën e menaxhimit, identifikimit, rregjistrimit dhe vjeljes së të ardhurave për debiti tatalë për taksat familjare pasi ka pasaktësi në përcaktimet e numrit të familjeve që shërbejnë si bazë për përlllogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifën, për të cilat DTTVAB nuk ka marrë asnjë masë për ndjekjen e etapave që parashikon legjislacioni në fuqi për vjeljen e tyre.

**Sa i përket auditimit mbi vlerësimin e gjendjes debitore të taksapaguesve familjar referuar pyetësoreve (shkresa nr. 692/2 prot., datë 23.02.2024) të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së nga Bashkia Kavajë nuk na u vendos në dispozicion informacion mbi “Gjendjen debitore të taksapaguesve familjarë, pasi janë në proces pune deri në rakordimin e plotë të ditareve deri tek nxjerrja përfundimtare e situatës debitore e cila do të raportohet me qëllim përpilimin e Pasqyrave Financiare.**

### **Taksa dhe tarifa Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjedisit**

EMERTIMI	VITI 2022			VITI 2023		
	Plan	Fakt	% realizim	Plan	Fakt	% realizim
<b>Autorizim per tregti karburanti</b> (pajisja me Autorizim tregti me pakice per pikat e karburantit dhe pikat e gazit)	3,000,000	7,100,000	237	7,575,000	2,000,000	26,4
<b>Te tjera tarifa administrative</b> (Tarifa bagëti e therur)	0	1,391,810		0	1,200	



EMERTIMI	VITI 2022			VITI 2023		
	Plan	Fakt	% realizim	Plan	Fakt	% realizim
<b>TOTALI</b>	<b>3,000,000</b>	<b>8,491,810</b>	<b>283</b>	<b>7,575,000</b>	<b>2,001,200</b>	<b>26.4</b>

Burimi i të dhënave Bashkia Kavajë

Sipas strukturës së Paketës Fiskale kjo drejtori është e ngarkuar për administrimin dhe vjeljen e 8 tarifave. Aktualisht në evidencën e të ardhurave raportohet vetëm për 2 tarifa konkretisht:

- Tarifa për dhënie licence për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj;
- Tarifa për dhënie leje ushtrim veprimtarie;
- Gjoha për kundravajtje.

Drejtorja e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjedisit nuk evidenton(raporton) ndarjen sipas tarifave të tjera për të cilat aplikohen, planifikim dhe realizim. Struktura e raportimit nuk jep informacion të plotë mbi të gjitha taksat dhe tarifatat vendore që kjo drejtori administron si rjedhje mungon gjurma e auditimit mbi vlerësimin e gjendjes së debitorëve. Nuk është rakorduar midis dy drejtorive për kontabilizimin e saktë të arkëtimeve dhe detyrimeve të krijuar për taksat dhe tarifatat vendore që administron kjo drejtori.

Drejtorja e Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nuk administron një regjistër të saktë dhe të azhurnuar për evidentimin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, i cili duhet të ketë minimalisht emrin e subjektit, vendndodhja, NIPT, datën e pagesës, afatin e vlefshmërisë së licencës, datën kur duhet rinovuar licenca etj.me pasojë mos ndjekjen e afateve të subjekteve për përsëritjen e licencës dhe arkëtimin e tarifës për këto licenca.

Nga të dhënat e marra nga Drejtorja e Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit rezulton se nuk është paraqitur një pasqyrë reale mbi aktivitetin e subjekteve që tregtojnë karburant me adresa aktiviteti në territorin e Bashkisë Kavajë.

Nuk ka dokumentacion tjetër nga Bashkia Kavajë që të vërtetojë se janë marrë masat e nevojshme për bllokimin e aktivitetit tregtar (as vetë, as nëpërmjet bashkëpunimit duke informuar dhe kërkuar nga institucionet e tjera që përcakton kuadri rregullator në fuqi), deri në ri paraqitjen e dokumentacionit të plotë nga ana e subjekteve përkatëse.

Nga Bashkia Kavajë nuk konstatohet asnjë shkresë ku të njoftohet me listë subjektesh, vendndodhje, etj., Inspektorati Shtetëror Përgjegjës (Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë), për bllokimin e përkohshëm të veprimtarisë së këtyre subjekteve të pa licencuar, apo për propozimin pranë ministrise përgjegjëse të hidrokarbureve, për fillimin e procedurave të heqjes së licencës së tregtimit me pakicë në stacionet e karburanteve apo njësitë e tregtimit të lëndëve djegëse.

Në pikën nr. 6 të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e. licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” përcaktohet se autoriteti licencues, bashkia, në përputhje me parashikimet ligjore, ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për bllokimin e aktivitetit tregtar, deri në ri paraqitjen e dokumentacionit të plotë për subjektet e pa licencuar të cilët zhvillojnë aktivitet.

Për shkak të mos ushtrimit të kompetencave ligjore nga Bashkia Kavajë, subjektet nuk kanë paguar tarifën e licencimit, nuk janë pezulluar (pezullimi jo nga bashkia, por nëpërmjet kërkesës së bashkisë organeve të caktuara për këtë qëllim), e për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e njësisë vendore të trajtuara hollësisht më poshtë.

*- Mbi tarifën e lëshimit të licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë.*

Drejtorja e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit për vitin 2023, ka planifikuar taksa e tarifa për 20 subjekte të karburanteve dhe gazit të lëngshëm, nga të cilat:

- 19 stacione tregti karburanti;
- 1 stacion tregti gaz i lëngshëm;

- Aplikimi i tarifës për lejet dhe autorizimet për subjektet që tregtojnë hidrokarbure.

Drejtoria e mbrojtjes së konsumatorit dhe mjedisit pranë Bashkisë Kavajë është autoriteti përgjegjës për dhënien e lejeve për subjektet që tregtojnë karburant dhe GLN, e cila përgjigjet dhe për mbledhjen e tarifave që aplikohen.

Bazuar në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, neni 4, ushtrimi i veprimtarive në këtë fushë kryhet **vetëm nga persona juridik pasi të jenë pajisur me licencat dhe autorizimet përkatëse.**

Këto licenca jepen nga organet vendore sipas juridiksionit përkatës, me afat 5 vjeçare, me të drejtë përsëritje, për subjektet që zhvillojnë veprimtarinë e tregtimit të nënprodukteve të naftës në territorin e tyre.

Duke u bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga drejtoria e mbrojtjes së konsumatorit dhe mjedisit (dosjet, nuk disponon regjistër), lejeve e licencave konstatohet se aktualisht janë 18 subjekte që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Kavajë dhe Njësive Administrative.

Subjektet të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënproduktet e tyre *analitike pasqyruar në Aneksin nr.2, “2.2.6 Të ardhurat”* “Subjekte që tregtojnë karburant dhe gaz në territorin e Bashkisë Kavajë” *bashkëlidhur raportit:*

Grupi i auditimit mori në shqyrtim 20 dosjet e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse, karburantit dhe GLN. Lidhur me përputhshmërinë e vetdeklarimit të subjekteve dhe gjendjes në fakt për taksë ndërtese (tendë) dhe taksë tabele për qëllime reklamimi, grupi i auditimit ka kërkuar nga sektori i verifikimit në terren të kryhen akt verifikime. Referuar të dhënave dhe verifikimit të detyrimeve dhe pagesave rezultojnë se të gjitha subjektet (**20 subjekte**) nuk tarifohen për taksë ndërtese dhe taksë tabele për qëllime reklamimi.

**Vlera e munguar në të ardhurat e Bashkisë Kavajë për vitin 2023** si rezultat i mos tarifimit korrekt për taksë dhe tarifa vendore është **6,088,673 lekë**. (*Analitike pasqyruar në Aneksin nr.3 “2.2.6 Të ardhurat”* “Permbledhese për të ardhura të munguara si rezultat i mostarifimit për taksë ndërtese dhe tabele për qëllime reklamimi 20 subjekte dhe detyrime të palikujduara për taksat dhe tarifave vendore” bashkëlidhur raportit)

Referuar listës *analitike pasqyruar në Aneksin nr.3* dhe verifikimit të dhënave në planin e drejtorisë së DTTVAB dhe pagesa të gjeneruara në ditarin e të ardhurave rezulton se për vitin 2023, si rezultat i mos zbatimit të dispozitave ligjore është krijuar një e ardhur e munguar në vlerën 6,088,673 lekë për 20 subjekte konkretisht këto diferenca vijnë si pasojë e:

- Mosllogaritjes së saktë të detyrimeve për taksat vendore në vlerën 5,653,785 lekë, konkretisht për taksën e pasurisë “Tendë” dhe për taksën e reklamës vlera të cilat u përllogaritën nga DTTVAB, pas mbajtjes së akt verifikimeve nga sektori i verifikimit në terren (të kërkuara nga grupi i auditimit), (*Analitike pasqyruar në Aneksin nr.4 “2.2.6 Të ardhurat”* “E ardhur e munguar si rezultat i mostarifimit për taksë ndërtese dhe tabele për qëllime reklamimi 20 subjekte”):

-Detyrime të palikujduara për taksat dhe tarifave vendore **4 subjekte**, për vitin 2023, në vlerën **434,888 lekë** për 4 subjekte (*Analitike pasqyruar në Aneksin nr.5 “2.2.6 Të ardhurat”* “Detyrime të palikujduara për taksat dhe tarifave vendore **4 subjekte”**)

DTTVAB nuk ka marrë masat administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve.

Nga sa më sipër konstatohet një debi e akumuluar për këto subjekt në vlerën prej 6,088,673 lekë detyrim i akumuluar për vitin 2023 i cili vjen si rezultat i mos pagesës së detyrimeve të disa nga subjekteve që ushtrojnë aktivitet në këtë bashki. Gjithashtu për këto subjekte ka një

diferencë prej 3976 **m<sup>2</sup>** sipërfaqe ndërtesë(tendë) dhe 347 **m<sup>2</sup>** sipërfaqe reklamë pa regjistruar në regjistrin elektronik të DTTVAB.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar”; neni 5, 8., neni 23 pika 4, nenet 29,36,69, 75, 89, 90; Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar” neni 20, neni 22/5.; Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”; VKM nr. 132, datë 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesa”, e Bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”; Udhëzim i përbashkët nr. 17, datë 20.6.2022, i Ministrit të Financave dhe Ministrit të Brendshëm “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”; UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar; VKB nr. 107, datë 22.11.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë”.

**Për veprimet më sipër mbajnë përgjegjësi:** Drejtor i Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit z. **R. I** për periudhën 01.01.2023 deri me 11.08.2023, z. **A.Ç** për periudhën 14.08.2023 në vazhdim; Përgjegjës i sektorit të turizmit z. **G.T** për periudhën 01.01.2023 deri më 27.06.2023, z. **B.R** për periudhën 11.07.2023 në vazhdim; Sektori i Verifikimit në Terren, znj. **S.M** për periudhën 01.01.2023 deri më 15.08.2023 dhe z. **I.GJ** për periudhën 16.08.2023 në vazhdim.

*- Pajisja me licencë e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre.*

Nga auditimi i dokumentacionit dhe bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Konsumatorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit konstatohet se për vitin 2023, ushtrojnë aktivitet 20 subjekte (sipas të dhënave në regjistrin elektronik të DTTVAB). Grupi i auditimit mori në shqyrtim 18 dosjet e subjekteve (2 dosje mungojnë) që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse, karburantit dhe GLN konkretisht si më poshtë:

*Të ardhura të munguara për mospajisje me licencë e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, janë 15 subjekte në vlerën totale prej **15,716,667 lekë**, nga ku 10 subjekte nuk janë pajisur me licencë 5 vjeçare por me autorizim 1 vjeçar në vlerën 8,000,000 lekë; 2 subjekte të paregjistruar në regjistrin e DKMM në vlerën 2,816,667 lekë dhe 3 subjekte që ushtrojnë aktivitetin pa licencë pas përfundimit të vlefshmërisë në vlerën 2,100,000 lekë dhe 5 subjekte debitor fund të vitit 2022 për vlerën 2,800,000 lekë .*

10 subjekte janë pajisur në vitin 2023 me autorizime 1 vjeçare.

**Karburantet me autorizime 1 vjeçare**

Nr.	Subjekti	Adresa	Aktiviteti	Marre licencen	Vlefshmeria e licences	PAGUA R	DIFERENC A PER PAGESE
1	K Sh.P.K	Ura Leshniqes, Kavaje	Karburant	21.12.2023	21.12.2024	200,000	800,000
2	G	Stacioni Trenit, Kavaje	Karburant	14.09.2023	14.09.2024	200,000	800,000
3	G	Rruga Egnatia,Kavaje	Karburant	15.03.2023	15.03.2024	200,000	800,000
4	G	Prokuroria	Karburant	14.09.2023	14.09.2024	200,000	800,000
5	G	Stadiumi Besa	Karburant	14.09.2023	14.09.2024	200,000	800,000
6	G	Luz i Vogel, Kavaje	Karburant	14.09.2023	14.09.2024	200,000	800,000
7	M	Agjensia, Kavaje	Karburant	12.01.2024	12.01.2025	200,000	800,000
8	K 2	Helmas	Karburant	30.03.2023	30.03.2024	200,000	800,000
9	K 3	Lgj.Nr.2,Rruga Josif Buda	Karburant	14.09.2023	14.09.2024	200,000	800,000
10	V	Luz i Vogel Kavaje	Karburant	13.10.2023	13.10.2024	200,000	800,000
<b>T O T A L I</b>						<b>2,000,000</b>	<b>8,000,000</b>

Burimi i të dhënave Bashkia Kavajë përpunuar nga grupi i auditimit

Mos paisja me licencë me afat 5 vjeçar por me autorizim 1 vjeçar për subjektet e mësipërme për vitin 2023 ka reflektuar dhe në mungesë të ardhurave në buxhetin e Bashkisë Kavajë në vlerën **8,000,000 lekë**.

- 2 subjekte për të cilat nuk disponohet informacion (DKMM nuk ka dosje)

Nr.	Subjekti	NIPT	Adresa	Aktiviteti	Marre licencen	Vlefshmeria e licences	Detyrimi
1	XH	K...I	Luz i Vogel	Karburant	-	-	2,600,000
2	A	L...I	Golem	Karburant	-	-	216,667
<b>TOTALE</b>							<b>2,816,667</b>

Burimi i të dhënave Bashkia Kavajë përpunuar nga grupi i auditimit

Nga verifikimi rezulton se ka subjekte që zhvillojnë këtë aktivitet pa u identifikuar dhe regjistruar në regjistrin e të dhënave që administron drejtoria e konsumatorit (nuk janë paisur me licenca apo autorizime), konkretisht:

**Subjekti XH , person fizik** me NIPT K...I me Administrator Xh. Sinameta me adresë: Tiranë Kavajë Vorrozen i cili ushtron aktivitetin “Shitje ambulante karburanti me pakicë”, regjistruar në QKB më datë 01.11.2003.

Për këtë subjekt nuk janë parashikuar të ardhura në planin e të ardhurave për vitin 2023.

Bazuar në Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, neni 4, “Ushtrimi i veprimtarive në këtë fushë kryhet vetëm nga persona juridik pasi të jenë pajisur me licencat dhe autorizimet përkatëse”, konstatohet se ky subjekt ushtron veprimtari në fushën e tregtimit të karburantit në kundërshtim me ligjin.

Duke bërë perlllogaritjet si rezultat i mosregjistrimit të subjektit XH , dhe mos paisjes me autorizim vitet 2011-2023, ka sjellë te ardhura të munguara në vlerën **2,600,000 lekë**.

**Subjekti “A ” Shpk**, me Administrator A.M me adresë sekondare: Tirane; Kavajë; Golem; Kryemedhenj; Rruga dytesore Shkemb i Kavajës Golem, Objekt me Nr. pasurie 308/115, 308/110, 308/113, Zone Kadastrale 2291; i cili ushtron aktivitetin “Shitje ambulante karburanti me pakice”, regjistruar adresa sekondare në QKB më datë 02.12.2022.

Për këtë subjekt nuk janë parashikuar të ardhura në planin e të ardhurave për vitin 2023.

Duke bërë perlllogaritjet si rezultat i mosregjistrimit të subjektit A , dhe mos paisjes me autorizim vitet 2022 dhe 2023, ka sjellë te ardhura të munguara në vlerën **216,667 lekë**.

**- 3 subjekte** nuk janë të paisura me autorizimet përkatëse pas përfundimit të vlefshmërisë si më poshtë:

Tabela e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin pa autorizim:

Nr .	Subjekti	NIPT	Adresa	Aktiviteti	Marre licencen	Vlefshmeria e licences	Detyrimi
1	SH	K...B	Lagja.Nr.6 Kavaje	Karburant	08.11.2022	11.11.2023	1,000,000
2	K 4	J...P	Autostrada Kavajë-KJ	Karburant	09.10.2018	09.10.2023	1,000,000
3	B	J...M	Blerimaj Kavaje	Pike shitje gazi	19.07.2018	19.07.2023	100,000
<b>TOTALE</b>							<b>2,100,000</b>

Burimi i të dhënave Bashkia Kavajë përpunuar nga grupi i auditimit

Mos paisja me licencë për subjektet SH ; K Shpk dhe B për vitin 2023 ka reflektuar dhe në mungesë të ardhurave ne buxhetin e Bashkisë Kavajë në vlerën **2,100,000 lekë**.

Në fund të vitit 2022 rezultojnë 5 subjekte debitor për vlerën 2,800,000 lekë, si rrjedhojë e mos likuidimit të tarifës së licencimit të tregëtimit të karburantit, pasqyruar si më poshtë vijon:

Nr.	Subjekti	Nipt	Debitor
1	M Shpk	K...A	400,000
2	A	M...K	400,000
3	A	L...G	600,000
4	D.A	K...P	400,000
5	K	L...O	1,000,000
<b>TOTALE</b>			<b>2,800,000</b>

Nuk është proceduar me masat administrative për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 2,800,000 lekë.

Në lidhje me këtë situatë Drejtoria e Konsumatorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit nuk ka marrë masat administrative, në këtë rast për aplikimin e gjobave të këto subjekte dhe nuk i është drejtuar Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial për marrjen e masave përkatëse por këto subjekte të cilat ende vazhdojnë aktivitetin.

**Kriteri:** Ligji nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar”; nenet 29,36,69, 75, 89, 90; Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar”; Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”; Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes, të gazit dhe nënprodukteve të tyre"; VKM nr. 170, datë 25.04.2002, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, kapitulli II dhe III, pika 4; VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj i ndryshuar; VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1, gërma “b”, pika 9 dhe 15; Udhëzim i përbashkët nr. 17, datë 20.6.2022, i Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Brendshme “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”; UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar; VKB nr. 107, datë 22.11.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë”

**Për veprimet më sipër mbajnë përgjegjësi** Drejtor i Drejtorisë së Konsumatorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. **S.M** për periudhën 01.01.2023 deri më 05.07.2023, Z. **K.M** për periudhën 06.07.2023 deri më 06.08.2023 dhe z. **F.M** për periudhën 07.09.2023 në vazhdim; Përgjegjës i sektorit të mbrojtjes së konsumatorit znj. **S.H** për periudhën 01.01.2023 deri më 12.06.2023, z. **A.M** për periudhën 12.06.2023 në vazhdim; Sektori i mbrojtjes dhe mjedisit të pyjeve, z. **S.H** për periudhën 24.08.2023 në vazhdim.

- Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet me objekt aktiviteti tregti karburanti rezulton se për vitin 2023 nuk janë paisur me leje aktiviteti 24 orësh 20 subjekte ndërkohë që ushtrojnë aktivitet “24 orësh”.

Nr.	Subjekti	NIPT	detyrim
			Viti 2023
1.	O Shpk	J...I	10,000
2.	P Shpk	K...Q	10,000
3.	V	K...ë	10,000
4.	G	K...T	10,000
5.	K	J...P	10,000
6.	K	J...P	10,000
7.	K	J...P	10,000
8.	K	J...P	10,000
9.	SH	K...B	10,000
10.	G	K...T	10,000
11.	G	K...T	10,000
12.	G	K...T	10,000
13.	G	K...T	10,000
14.	M	L...H	10,000
15.	K Shpk	K...H	10,000
16.	A	L...G	10,000
17.	L	L...P	10,000
18.	B	J...M	10,000
19.	XH	K...I	10,000
20.	A Shpk	L...I	10,000
<b>TOTALI</b>			<b>200,000</b>

Si rezultat i mosaplikimit të tarifës leje aktiviteti 24 orësh për vitin 2023, nga kjo drejtori ka mungesë të ardhurash në vlerën **200,000 lekë**.

Gjithashtu nga kjo drejtori nuk janë marrë masa për aplikimin e gjobës për ushtrimin e aktivitetit pa paisur me lejen përkatëse.

Tabela e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin pa autorizim Ligji 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar; ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar; ligji nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”; VKB nr.107, datë 22.11.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë”, II.12– c) Tarifë për leje për ushtrimin e aktiviteteve që prodhojnë ndotje akustike.

**Për veprimet më sipër mbajnë përgjegjësi:** Drejtor i Drejtorisë së Konsumatorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. **S.M** për periudhën 01.01.2023 deri më 05.07.2023, **Z.K.M** për periudhën 06.07.2023 deri më 06.08.2023 dhe z. **F.M** për periudhën 07.09.2023 në vazhdim; Përgjegjës i sektorit të mbrojtjes së konsumatorit znj.**S.H** për periudhën 01.01.2023 deri më 12.06.2023, z.**A.M** për periudhën 12.06.2023 në vazhdim; Sektori i mbrojtjes dhe mjedisit të pyjeve, z.**S.H** për periudhën 24.08.2023 në vazhdim.

### **Taksa dhe tarifa Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban të Territorit**

#### **Subjektet që janë pajisur me leje ndërtimi /fillim punimesh në territorin e Bashkisë Kavajë.**

Bazuar në përcaktimet në paketën fiskale të vitit 2023, informacionin e marrë nga DPUZHT për leje ndërtimi mbi 250 m<sup>2</sup>, nga sektori i IMTV për njoftim të fillimit të punimeve si dhe faturimi i detyrimit dhe pagesat nga DTTVAB, duhet që subjektet përpara pajisjes me leje ndërtimi të pajisen me NIPT Sekondar.

Subjektet ndërtuese, që kanë ushtruar veprimtari ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Kavajë, nuk janë paisur me çertifikatë regjistrimi për adresë dytësore për çdo kantier ndërtimi, për këto subjekte nuk është përlllogaritur dhe arkëtuar detyrim për taksat dhe tarifave vendore, më konkretisht gjatë vitit 2023:

- 21 **Subjekte të cilat janë pajisur me leje ndërtimi mbi 250 m<sup>2</sup>.**

- 99 **Subjekteve të cilat kanë njoftuar për fillim punimesh.**

Si rezultat i testimit të këtij procesi për subjektet e paraqitura në Anekset nr. 6 dhe nr. 7. (“2.2.6 Të Ardhurat” bashkëngjitur raportit), për vitin 2023 **u konstatuan diferenca, në vlerën 7,205,204 lekë lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Kavajë, konkretisht si më poshtë trajtuar:**

#### **Subjektet që janë pajisur me leje ndërtimi mbi 250 m<sup>2</sup> gjatë vitit 2023.**

Për vitin 2023, 21 subjekte janë pajisur me leje ndërtimi mbi 250 m<sup>2</sup> dhe kanë kryer punime ndërtimi (Përfshirë edhe subjekte të cilat kanë nisur punimet në vitin 2022, por kanë përfunduar në vitin 2023).

Nga auditimi i regjistrimit elektronik të DTTVAB për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi dhe sipas dokumenteve të paraqitura, u konstatua se këto subjekte nuk janë paisur me çertifikatë regjistrimi për adresë dytësore për çdo kantier ndërtimi dhe për to nuk është përlllogaritur e arkëtuar detyrim për taksat dhe tarifave vendore, (taksën e tabelës, tarifën e pastrimit dhe shërbimit...) për të gjitha lejet e marra.

Si rezultat i testimit të këtij procesi për 21 subjektet, **u konstatuan diferenca në vlerën 643,938 lekë, cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Kavajë. Pasqyruar analitike në Aneksin nr.6, “2.2.6, Të Ardhurat”** “Lista e subjekteve të pajisura me leje ndërtimi mbi 250 m<sup>2</sup> të cilat nuk kanë shlyer detyrimet për taksa /tarifa vendore për vitin 2023”.

### **Subjekteve që kanë njoftuar për fillim punimesh gjatë vitit 2023.**

Në vitin 2023, 99 subjekte kanë njoftuar për fillim punimesh dhe kanë kryer punime ndërtimi.

Nga auditimi i regjistrimit elektronik të DTTVAB-së për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në informacionin e marrë nga IMTV, dhe sipas dokumenteve të paraqitura, u konstatua se: Për vitin 2023 këto subjekte nuk janë paisur me certifikatë regjistrimi për adresë dytësore për çdo kantier ndërtimi dhe për to nuk është përlllogaritur e arkëtuar detyrim për taksat dhe tarifave vendore (nuk janë taksuar për taksën e tabelës, tarifën e pastrimit dhe shërbimit). *Pasqyruar analitike në Aneksin nr.7* “Lista e subjekteve të pajisura me leje ndërtimi **subjekteve që kanë njoftuar për fillim punimesh**”).

Si rezultat i testimit të këtij procesi për 99 subjektet e paraqitura në Aneksin nr. 7 u konstatuan diferenca, në vlerën 6,561,216 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Kavajë si pasojë e moS ëtimit të taksave dhe tarifave vendore sipas përcaktimeve në paketën fiskale për vitin 2023.

Tabela e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin pa autorizim Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, në shkronjën “b” të nënpikës 1.3 të pikës 1 në nenin 9, shkronjën “a” të pikës 5 të nenit 35, shkronjën “f” të nenit 54; Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” pikën 10 të nenit 3 dhe pikën 2 të nenit 18. Ligji nr. 9920, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 40. nenin 43; Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, neni 19, 22, ....43; VKB nr.107, datë 22.11.2022 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2023” në Bashkinë Kavajë.

**Për veprimet mbajnë përgjegjësi:** Drejtor i Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit **z. R. I** për periudhën 01.01.2023 deri me 11.08.2023; **z. A.Ç** për periudhën 14.08.2023 në vazhdimi; **znj. D.Q** (Drejtor Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit).

Nga auditimi i regjistrimit elektronik të DTTVAB- së, bazuar në dokumentet e paraqitura lidhur me subjektet e **pajisura me “Certifikatë Përdorimi”** dhe kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi u konstatua se:

Për vitin 2023 janë pajisur me certifikatë përdorimi gjithësej 22 subjekte. Për këto subjekte nuk është përlllogaritur dhe arkëtuar detyrim për taksat dhe tarifave vendore (**Taksën e pasurisë të paluajtshme Ndërtesë dhe Truall**), **pas pajisjes me Certifikatë Përdorimi**.

Si rezultat i testimit të këtij procesi për 22 subjektet e paraqitura në *në Aneksin nr.8* (“Lista e certifikatave të përdorimit, bashkia kavajë (periudha 2023) bashkëlidhur raportit) u konstatuan diferenca, në vlerën **4,020,853 lekë është e ardhur e munguar për bashkinë Kavajë** e cila është e ardhur e munguar për bashkinë Kavajë (si pasojë e moS ëtimit të taksave dhe tarifave vendore sipas përcaktimeve në paketën fiskale për vitin 2023(**Taksën e pasurisë të paluajtshme Ndërtesë dhe Truall**))

*(Analitike pasqyruar në Aneksin nr.8* “Lista e certifikatave të përdorimit, bashkia kavajë (periudha 2023)”).

Përlllogaritja e detyrimeve për taksë pasurie e paluajtshme (ndërtesë dhe truall), pas pajisjes me Certifikatë Përdorimi për vitin 2023 për 22 subjektet është paraqitur në *në Aneksin nr.8* “Lista e certifikatave të përdorimit, bashkia kavajë (periudha 2023)”).

Veprime në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 40; Udhëzimi nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, KREU III.

**Për veprimet mbajnë përgjegjësi:** Drejtor i Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit **z. R. I** për periudhën 01.01.2023 deri me 11.08.2023; **z. A.Ç** për periudhën 14.08.2023 në vazhdimi; **znj. D.Q** (Drejtor Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit).

### **Taksa e tokës bujqësore.**

Nga auditimi i të dhënave të vendosura në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave për taksën mbi tokën bujqësore për vitin 2023, u konstatua se:

DAV Bashkia Kavajë **ka planifikuar** për ngarkesë fiskale 886 Ha tokë bujqësore më pak të cilat në vlerë **janë 6,198,107 lekë më pak të ardhura** për t'u arkëtuar nga taksa mbi tokën bujqësore.

### **Planifikimi sipas përlogaritjeve të grupit të auditimit pasqyrohet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:**

Me qëllim vlerësimit nëse nga DAV Bashkia Kavajë është bërë planifikimi saktë i taksës së tokës bujqësore, u kryqëzua informacioni i administruar nga DAV Bashkia Kavajë me informacionin e administruar nga agronomët e NJA mbi sipërfaqen e tokës bujqësore, familjet që kanë në pronësi/përdorim tokë bujqësore dhe kategorinë e bonitetit, sipas NJA.

Nga përlogaritjet e kryera, bazuar në kategorinë e bonitetit, sipërfaqen e tokës bujqësore për çdo familje, rezultoi se planifikimi i taksës së tokës bujqësore duhet të bëhet për vlerën 26,198,107 lekë, dhe jo 20,600,000lekë.

Planifikimi sipas përlogaritjeve të grupit të auditimit pasqyrohet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Kategoria e tokës	Sip/HA-Luz I Vogel	Sip/HA-Helmas	Sip/HA-Golem	Sip/HA-Synej	Ha gjithësej	Vlera/Ha	Plani/Lekë
Kategoria I	0	77.9		839.5	917.5	3920	3,596,747
Kategoria II	150.6	48.6		299.2	498.5	3430	1,710,082
Kategoria III	588.4	183	2999	344.3	4114.9	2940	12,098,031
Kategoria IV	1165.5	567.8		262.3	1995.7	2520	5,029,197
Kategoria V	196.6	323.5		276.7	796.9	2100	1,673,544
Kategoria VI	39.3	321		199.2	559.6	1680	940,269
Kategoria VII	18	609.8		285	912.8	1260	1,150,237
<b>Totali sip. ha</b>	<b>2159</b>	<b>2054</b>	<b>2999</b>	<b>1666</b>	<b>8879</b>		<b>26,198,107</b>

Sa më sipër rezulton se:

Gjithësej tokë bujqësore sipas agronomëve në krahasim me informacionin që administrohet nga DTTVAB Bashkia Kavajë rezulton se janë 886 Ha më pak, por diferencat rezultojnë në sipërfaqe sipas kategorisë së bonitetit, fenomen i cili ndikon në rritjen e planifikimit të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore. Konkretisht:

-NJA Luz i Vogël diferencat rezultojnë në kategorinë e IV për sipërfaqen 968.5 Ha, kategorinë e V për sipërfaqen 157.6 Ha, kategorinë e VI për sipërfaqen 21 Ha, si dhe kategorinë e VII për sipërfaqen 18 Ha.

-NJA Helmas diferencat rezultojnë në kategorinë VI të tokës për sipërfaqen 14 Ha dhe në kategorinë e VII të tokës për sipërfaqen 34 Ha;

-NJA Golem diferencat rezultojnë në sipërfaqen e tokës bujqësore për 72 Ha;

-NJA Synej diferencat rezultojnë në kategorinë e I të tokës për 840 Ha, kategorinë e II të tokës për 299 Ha, kategorinë e IV për 17 Ha, kategorinë e VI për 119 Ha dhe kategorinë e VII për 285 Ha.

Situata e mësipërme tregon gjithashtu se regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e subjekteve objekt taksimi.

### **Planifikimi sipas DAV Bashkia Kavajë pasqyrohet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:**

DAV Bashkia Kavajë ka gjithësej 9764.6 Ha tokë bujqësore, sipërfaqe e cila shërben si bazë për planifikimin e arkëtimeve nga kjo taksë. Konkretisht planifikimi i taksës së tokës bujqësore nga DAV Bashkia Kavajë, pasqyrohet në tabelën si më poshtë vijon:



Tabela nr.6 Planifikimi i taksës së tokës bujqësore nga DAV Bashkia Kavajë për vitin 2022

Kategoria e tokës	Sip/HA-Luz i Vogël	Sip/HA-Helmas	Sip/HA-Golem	Sip/HA-Synej	Vlera/Ha	Zbritja 30%	Plani/Lekë
Kategoria I	0	78		0	5,600	3,920.0	897,680
Kategoria II	151	48.6		0	4,900	3,430.0	2,183,538
Kategoria III	588	190	2927	700	4,200	2,940.0	8,983,542
Kategoria IV	1166	700		1400	3,600	2,520.0	5,788,440
Kategoria V	197	340		260	3,000	2,100.0	1,341,900
Kategoria VI	39	307		80	2,400	1,680.0	680,400
Kategoria VII-X	18	575		0	1,800	1,260.0	724,500
<b>Totali sip. ha sipas planifikimit</b>	<b>2159</b>	<b>2238.6</b>	<b>2927</b>	<b>2440</b>			<b>20,600,000</b>

Sa më sipër rezulton se:

-NJA Luz i Vogël ka gjithësej 2159 Ha, nga të cilat 151 Ha kategoria e bonitetit I, 588 Ha kategoria II, 1166 Ha kategoria III, 197 Ha kategoria IV, 39 Ha kategoria V dhe 18 Ha kategoria VI;

-NJA Helmas ka gjithësej 2238.6 Ha, nga të cilat 78 Ha kategoria e bonitetit I, 48.6 Ha kategoria II, 190 Ha kategoria III, 700 Ha kategoria IV, 340 Ha kategoria V, 307 Ha kategoria VI dhe 575 Ha kategoria VII-X;

-NJA Golem ka gjithësej 2927 Ha kategoria e bonitetit III;

-NJA Synej ka gjithësej 2440 Ha, nga të cilat 700 Ha kategoria III, 1400 Ha kategoria IV, 260 Ha kategoria V dhe 80 ha kategoria VI.

Veprime në kundërshtim me Pika 7 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Kreu I, shkronja “b” në Paketën Fiskale të Bashkisë Kavajë për vitin 2023.

**Për veprimet mbajnë përgjegjësi z. SH.K**, specialist për taksat familjare në NJA Golem për periudhën 01.01.2023 deri më 08.08.2023, **Znj. K.Z** për periudhën 14.08.2023 deri më 13.11.2023, **z. R.V** për periudhën 12.12.2023 në vazhdim, **z. TH.D** specialist për taksat në NJA Helmas për periudhën 01.01.2023 deri më 28.09.2023, **z. Z.Ç** për periudhën 19.10.2023 në vazhdim, **z. A.Ç** specialist për taksat familjare në Luz i Vogël, **znj. E.Ç** specialiste për taksat në NJA Synej.

### **Akt marrëveshjet e lidhura për likuidimin e detyrimeve të prapambetura**

Nga auditimi i të dhënave të vendosura në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me, akt marrëveshjet e lidhura për vitin 2023 nga DTTVAB me subjektet debitore për detyrime mbi taksa dhe tarifa vendore u konstatua se:

Për vitin 2023 janë lidhur gjithësej 8 akt marrëveshje nga DTTVAB, me subjektet debitore për likuidimin e detyrimeve të prapambetura me këste në vlerë totale 3,956,805 lekë, nga ku janë kryer pagesa në vlerën prej 2,367,518 lekë ose 59.83 % e vlerës totale të akt marrëveshjeve të lidhura, dhe kanë mbetur pa likuaduar detyrime në vlerën 1,589,287 lekë ose 40.16 %.

- Nga këto akt marrëveshje nuk janë respektuar 3 prej tyre përkatësisht C , I.K dhe A.B me vlerë **1,589,287** lekë.

Në lidhje me to nuk janë kryer njoftime për shkëputje të akt marrëveshjeve si dhe nuk janë marrë masat për vjeljen me forcë të detyrimeve.

Sa më sipër paraqitur analitike në tabelën më poshtë:

Nr	Emri I subjektit	Akt marrëveshje nr. Prot.	Detyrimi total	Pagesa	Detyrimi I mbetur
1	C	1288/1	1371000	820600	550400
2	G - E.B	2381/1	736306	520873	215433
3	Z.I	2120/1	447483	447483	0
4	I.K	3404/1	532630	116861	415769
5	A.B	3321/1	113230	27810	85420

6	S.A	4130	308960	177920	131040
7	A.Ç	4392/1	253483	157423	96060
8	Ç.I	4465/1	193713	98548	95165
<b>TOTALI</b>			<b>3,956,805</b>	<b>2,367,518</b>	<b>1,589,287</b>

Veprime në kundërshtim me Nenet 73, 77, 78, neni 89 pika 2, neni 100 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Udhëzim i përbashkët nr. 17, datë 20.6.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”

**Për veprimet më sipër mbajnë përgjegjësi** : Drejtor i Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit **z. R. I** për periudhën 01.01.2023 deri me 11.08.2023, **z.A.Ç** për periudhën 14.08.2023 në vazhdimësi; Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Ardhurave, Mbledhjes së Borxhit, Rakordimit të Taksave dhe Apelimt **znj.M.Ç** për periudhën 01.01.2023 deri më 06.07.2023, **znj.XH.U** për periudhën 11.07.2023 deri në 15.10.2023 dhe **znj D.M** për periudhën 16.10.2023 në vazhdim.

### **Menaxhimi i vlerave monetare në arkë**

Nga auditimi i të dhënave të vendosura në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me procedurat e ndjekura për menaxhimin e vlerave monetare në arkë për vitin 2023, u konstatua se:

Nga Bashkia Kavajë nuk janë respektuar procedurat për menaxhimin e vlerave monetare në arkë, limitet për arkëtimin e të ardhurave (vlerat e arkëtimeve për këto arka janë ndjeshëm më të larta se limitet e miratuar pra janë më të larta se 1000 lekë për veprim).

Për vitin 2023 nuk janë mbajtur si duhet librat e arkës si dhe nuk janë kryer derdhjet e arkëtimeve të grumbulluara në bankë në fund të cdo dite, konkretisht janë konstatuar 983 mandat arkëtimi të paregjistruara në Librin e Arkës të njësisë administrative Kavajë, konkretisht:

Libri i Arkës të njësisë administrative Kavajë fillon me mandatin nr. 1, datë 04.01.2023 dhe ka regjistrime deri më datë 17.02.2023 me nr. mandati 249. Nuk ka regjistrime për periudhën 17.02.2023 deri më 11.08.2023.

Me datë 11.08.2023 fillon me nr. mandati 1232 dhe mbyllet me nr. mandati 1687 datë 29.12.2023.

Pra 983 mandat arkëtimi janë të paregjistruara në Librin e Arkës. Sipas Sektorit të Menaxhimit të Taksave dhe Tarifave Vendore, vlera totale e mandat arkëtimeve për periudhën Janar -Korrik 2023 është 11,439,454 lekë ndërsa rezultojnë derdhje në bankë 10,954,430 lekë, me një diferencë prej **485,024 lekë, trajtuar më hollësisht si më poshtë vijon:**

Bashkia Kavajë ka në funksion 5 arka, të cilat janë të vendosura pranë çdo njësie administrative dhe ka arkëtuar nëpërmjet veprimeve në to vlerën prej **88,275,813 lekësh.**

Përmbledhëse mbi llojin e veprimeve për arketim sipas arkave në Bashkinë Kavajë:

Arkat sipas njësive	Arka për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 (Likujduar në bankë)	Likujduar Taksa familjare	Likujduar taksë toke bujqësore	Likujduar taksa dhe tarifa të tjera (kopshite, çerdhe, qira etj)	Likujduar taksa dhe tarifa të bizneseve
Njësia administrative Kavaje	13,095,384	1,072,233	-	7,900,631	4,122,520
Njësia administrative Golem	49,727,596	43,990,598	4,952,598	-	784,400
Njësia administrative Synej	9,532,518	5,349,526	4,133,338	-	49,654
Njësia administrative Luz i Vogel	11,040,903	6,394,252	4,337,828	-	308,823
Njësia administrative Helmas	4,879,412	1,486,329	3,367,145		25,938
<b>TOTALI</b>	<b>88,275,813</b>	<b>58,292,938</b>	<b>16,790,909</b>	<b>7,900,631</b>	<b>5,291,335</b>

Nga auditimi i veprimtarisë së arkës të njësisë administrative Kavajë (Librit i Arkës për periudhën Janar-Gusht 2023), u konstatua se janë arkëtuar 11,439,454 lekë për 1217 mandate,

dhe janë anuluar veprime të arkës në vlerën totale 470,400 lekë për 8 mandate arkëtimi me nr. serial si më poshtë konkretisht:

Për z. E.B 4 mandat arkëtimi në vlerë 57,600 lekë secili dhe vlerë totale prej 230,400 lekë.

*Nr. serial 0002883, datë 12.01.2023 me përshkrimin "Pagesë qera trualli"*

*Nr. serial 0002884, datë 12.01.2023 me përshkrimin "Pagesë qera trualli 2023".*

*Nr. serial 0002885, datë 12.01.2023 me përshkrimin "pagesë qera trualli 2022".*

*Nr. serial 0002886, datë 12.01.2023 me përshkrimin "pagesë qera trualli 2022"*

Për këtë subjekt nuk rezulton në DKUM asnjë kontratë dhe kopje mandati për pagesën e kryer në arkë.

Për znj. F.B 4 mandat arkëtimi në vlerë 60,000 lekë secili dhe vlerë totale prej 240,000 lekë.

*Nr. serial 0002889, datë 13.01.2023 me përshkrimin "pagesë dhënie me qera 2023";*

*Nr. serial 0002890, datë 13.01.2023 me përshkrimin "pagesë dhënie me qera 2023;*

*Nr. serial 0002891, datë 13.01.2023 me përshkrimin "pagesë dhënie me qera 2023";*

*Nr. serial 0002892, datë 13.01.2023 me përshkrimin "pagesë dhënie me qera 2023".*

Për këtë subjekt rezulton në DKUM kontratë, por nuk rezulton asnjë kopje mandat arkëtimi për kontratën e lidhur nga DKUM, Më datë 11.04.2023 rezulton se ky subjekt ka mandat për pagesën e kryer në bankë në vlerën 240,000 lekë

Në bllokun e mandat arkëtimeve i cili fillon me nr. serial 0002881 dhe përfundon me nr. serial 0002910 nuk rezultojnë të treja kopjet e mandat arkëtimeve të anuluar, në total 8 mandate, dhe vlerë totale 470,400 lekë, veprime këto të pajustificuara me procesverbalet përkatëse mbi anulimin e tyre.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 52; Ligjinr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 34, 40, 41, 54, 55; Ligji nr.10296, datë 8.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 4 pika 6,25,26; Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin nr. 108, datë 17.11.2016; Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu II pika 34,35 gërma "a", "b", "c", pika 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68 dhe 69; Rregullores së Bashkisë Kavajë nr. 01, datë 02.12.2016 "Për miratimin e Rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës ë Bashkisë Kavajë", neni 44.

**Për veprimet më sipër mbajnë përgjegjësi:** Drejtori i Drejtorisë Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë **z. A.T** për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, **znj. F.GJ** për periudhën 23.06.2023-31.12.2023, **znj. P.M** Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Kontabilitetit, Specialiste Kontabiliteti **znj. A.SH** për periudhën 05.06.2020-11.08.2023, **znj. D.M** për periudhën 15.08.2023- në vazhdim; Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Kontratave dhe Sistemit GIS, **z. A.B** , arkëtarja **znj. A.P** .

- *Mungesë dokumentacioni në dosjet e subjekteve tatimpaguesve, diferenca midis vetëdeklarimit për taksën e pasurisë së paluajtshme dhe gjendjes faktike në terren me dokumentacion.*

Nga auditimi i regjistrit elektronik të DTTVAB-së për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi dhe sipas dokumenteve të paraqitura (akt verifikim në terren), u konstatua se:

Në Bashkinë Kavajë dosjet e subjekteve fizik/juridik kanë mangësi në dokumentacioni e domosdoshëm (çertifikatë pronësie, xhiro vjetore etj.) për të përcaktuar ngarkesat fiskale sipas përcaktimeve në kuadrin ligjor në fuqi dhe paketën fiskale të miratuar për vitin 2023. Verifikimet e kerkuara nga grupi auditimit konstatuan diferenca midis vetëdeklarimit nga subjektet për taksën e pasurisë së paluajtshme dhe gjendjes faktike në terren, konkretisht:

Nga grupi auditimit janë kryer disa testimet për të verifikuar procesin e plotësimit me dokumentacion të dosjeve individuale për subjektet e biznesit të vogël dhe të biznesit të madh që ushtrojnë aktivitet në territorin gjeografik të Bashkisë Kavajë. DTTVAB në asnjë dosje nuk disponon një dokumentacion origjinal apo të njehsuar me të për përcaktimin e detyrimit të

subjektit. Për vitin 2023 nuk është kryer asnjë akt verifikim në terren për të konfirmuar nëse vetdeklarimi i subjektit përputhet me gjendjen faktike të aktivitetit që ushtron subjekti. DTTVAB. Nuk ka një ndarje zonash për cdo inspektor terreni por funksionon mbi bazë urdhrash pune për kryerjen e verifikimeve në terren nga sektori i verifikimeve në terren. Për vitin 2023 nga Sektori i verifikimit të Terrenit janë lëshuar Urdhra Pune, por nuk janë mbajtur akt verifikime pasi ky sektor ka ndryshuar të gjithë punonjësit. Sipas Paketës Fiskale baza e taksës/tarifës përcaktohet si më poshtë:

Grupi i auditimit mori në shqyrtim 10 dosje subjektsh me zgjedhje, për 5 nga këto subjekte ju kërkua sektorit të verifikimit në terren pranë kësaj drejtorie të kryhen akt verifikime lidhur me përputshmërinë e vetdeklarimit të subjekteve dhe gjendjes në fakt për taksë ndërtese dhe trualli...

***Sa më sipër u konstatuan:***

- Mangësi në dokumentacionin mbështetës për përcaktimin e bazës së taksës dhe diferenca midis vetëdeklarimit për taksën e pasurisë së paluajtshme dhe gjendjes faktike në terren konkretisht, dosjet e subjekteve nuk administrojnë fletë inventari apo dokumentacion mbështetës që përcakton bazën e taksës /tarifës sipërfaqen e ndërtesës; truallit, tabelës për qëllim reklamimi etj

- Sipërfaqe të cilat shfrytëzohen nga subjektet për qëllime aktiviteti ekonomik por nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, për këto raste nuk disponohet asnjë akt verifikim apo dokumentacion mbështetës ku të saktësohet nëse janë në pronësi të tyre apo janë prona pjesë e inventarit të Bashkisë Kavajë “Fond Pyjor”. Bashkia Kavajë, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka ndjekë asnjë nga procedurat administrative dhe ligjore për saktësimin e sipërfaqeve të cilat shfrytëzohen nga subjektet për qëllime aktiviteti ekonomik por në fakt janë prona pjesë e inventarit të Bashkisë Kavajë “Fond Pyjor”. Rezultati për këtë verifikim pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Subjekti	NIPT	Dokumentacion në dosje
“B ” Shpk	L...U	Vetëdeklarim+dokumenta pronësie
"E " Shpk	L...A	Vetëdeklarim+dokumenta pronësie
“E ” Shpk	K...P	Vetëdeklarim+leje ndërtimi
"F " Shpk	L...N,	Vetëdeklarim+dokumenta pronësie
“K.R ” pf,	K...D	Vetëdeklarim+dokumenta pronësie
“K ” Shpk	L...G	Vetëdeklarim
“F ” Shpk	M...G	Vetëdeklarim+dokumenta pronësie
“C ” Shpk	L...F	Vetëdeklarim
B ” Shpk	L...A	Vetëdeklarim+dokumenta pronësie
“P ” Shpk	L...G	Vetëdeklarim

Nga 10 subjektet që u përzgjedhën mbi verifikimin e dokumentacionit në dosje dhe planifikimit/arkëtimit për taksa e tarifa vendore u konstatua se në asnjë dosje nuk administrohet dokumentacion origjinal apo të njehsuar me të për përcaktimin e detyrimit të subjektit, për vitin 2023 nuk është kryer asnjë akt verifikim në terren për të konfirmuar nëse vetdeklarimi i subjektit përputhet me gjendjen faktike të aktivitetit që ushtron subjekti.

***Në 5 subjekte për të cilat janë mbajtur akt verifikime (me kërkesë të grupit të auditimit) u konstatuan diferencat në sipërfaqe ndërtese në 2 subjekte për 211 m<sup>2</sup> në vlerën 41,989 lekë dhe në 5 subjekte për sipërfaqe trualli 10,085 m2 me vlerë 201,700 lekë këto sipërfaqe trualli janë pjesë e fondit pyjor të Bashkisë dhe kanë ndryshuar destinacion. Kjo situatë ka sjellë mungesë të ardhurash në vlerë totale 243,689 lekë, dhe pakësim e ndryshim destinacioni për sipërfaqe trualli të cilat kanë qënë pjesë e fondit pyjor të Bashkisë konkretisht si më poshtë:***

Subjekti	NIPT	Diferençë në m <sup>2</sup>	Diferencë në vlerë	Diferencë në m <sup>2</sup>	Diferencë në vlerë
		Sipërfaqe ndërtese	Taksë ndërtese (niveli i taksës 199 l/m <sup>2</sup> )	Sipërfaqe trualli	Taksë trualli (niveli i taksës 20 l/m <sup>2</sup> )
"B " Shpk	L...U	0	0	2250	45,000
"E " Shpk	L...A	0	0	2683	53,660
"E " Shpk	K...P	85	16,915	1667	33,340
"F " Shpk	L...N,	126	25,074	2627	52,540
"K.R " pf,	K...D	0	0	858	17,160
<b>TOTALI</b>		<b>211</b>	<b>41,989</b>	<b>10,085</b>	<b>201,700</b>

Veprime në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar"; nenet 29,36,69, 75...; Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar"; Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat"; VKB nr. 107, datë 22.11.2022 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë"

**Për veprimet më sipër mbajnë përgjegjësi** Drejtor i Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit z. **R. I** për periudhën 01.01.2023 deri me 11.08.2023, z. **A.Ç** për periudhën 14.08.2023 në vazhdimësi; Përgjegjës i sektorit të turizmit z. **G.T** për periudhën 01.01.2023 deri më 27.06.2023, z. **B.R** për periudhën 11.07.2023 në vazhdim; Sektori i Verifikimit në Terren, znj. **S.M** për periudhën 01.01.2023 deri më 15.08.2023 dhe z. **L.GJ** për periudhën 16.08.2023 në vazhdimësi; Drejtor i Drejtorisë së Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve Publike z. **J.K** për periudhën 01.01.2023 deri më 18.07.2023, dhe znj. **A.S** , drejtoreshë për periudhën 18.07.2023 në vazhdim, përgjegjës z. **A.B** për periudhën 01.01.2023 deri më 10.08.2023, dhe z. **K.Ç** , për periudhën 15.08.2023 deri më 31.12.2023.

- Pakësim e ndryshim destinacioni për sipërfaqe trualli të cilat kanë qënë pjesë e fondit pyjor të Bashkisë.

Nga auditimi i regjistrit elektronik të DTTVAB-së për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi dhe sipas dokumenteve të paraqitura (akt verifikim në terren), u konstatua se:

Në Bashkinë Kavajë ka diferenca midis vetëdeklarimit nga subjektet për taksën e pasurisë së paluajtshme dhe gjendjes faktike në terren, konkretisht:

Pakësim e ndryshim destinacioni për sipërfaqe trualli të cilat kanë qënë pjesë e fondit pyjor të Bashkisë si pasojë e shfrytëzimit nga subjektet për qëllime aktiviteti, dhe jo sipas destinacionit. Në mbështetje të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive", Bashkisë Kavajë i kanë kaluar në pronësi inventarët e pronave sipas shtojcës 53. Në çdo rast pronat publike duhen përdorur për të siguruar maksimumin e përfitimeve publike ose mbrojtjen e një karakteristike të veçantë të pronës. Bazuar në ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore (ndryshuar me ligjin nr.9561, datë 12.6.2006; nr.9797, datë 23.7.2007), neni 3 "Prona që u transferohen njësitë të qeverisjes vendore", gërma i) *Prona të tilla si pyje, kullota, parqe dhe kopshte publike, kanë për qëllim të përdoren për interes vendor.*

Nga mosrakordimi midis DTTVAB-së dhe DKUMA Bashkia Kavajë u konstatua një sipërfaqe prej 10085 m<sup>2</sup>, pjesë e inventarit të Bashkisë Kavajë "Fond Pyjor", e cila shfrytëzohet nga subjektet për qëllime aktiviteti, dhe jo sipas destinacionit.

Konkretisht u konstatuan mangësitë e mëposhtme.

- Nuk ka asnjë akt verifikim që të përcaktojë përputhshmërinë e vetëdeklarimit dhe gjendjes faktike në terren e si pasojë sipërfaqja e truallit që përdoret për qëllime aktiviteti është e ndryshme nga gjendja faktike.

- Kjo sipërfaqe është parashikuar si pronë që përdoret për ushtrimin e funksioneve *për interes vendor si pyje, kullota, parqe dhe kopshte publike* ka pësuar ndryshim destinacioni nëpërmjet aplikimeve në ASHK për legalizim apo vlerës së investimeve që mund të kryhet mbi këtë pronë publike.

- Strukturat përgjegjëse kontrolluese/inspektuese në bashki (DKUMA, DTTVAB dhe Policia Bashkiake) dhe në zonat e mbrojtura nuk kanë kontrolluar përmbushjen e detyrimeve ligjore, kontraktuale, në mënyrë që të parandalojnë, zbulojnë dhe marrin masa administrative në rastet e dëmtimit, të pushtimit, shpërdorimit, **tjetërsimit**, shkretimeve dhe degradimit të pyjeve brenda territorit të tyre. Sipërfaqet në fjalë janë të destinuara për ushtrimin e funksioneve për interes vendor si pyje, kullota, parqe dhe kopshte publike dhe jo për veprimtari tregtare të ndryshme nga karakteristika e pronës.

Dhënia me qira duke shmangur procesin e konkurimit e një pjese të kësaj prone tek subjektet private cënon barazinë e subjekteve dhe favorizon një subjekt tregtar dhe çon në konkurrencë jo të ndershme kundrejt bizneseve të ngjashme.

Për 5 subjekte e përmendura më sipër u konstatuan diferenca në sipërfaqet e truallit prej 10085 m<sup>2</sup> të cilat shfrytëzohen nga subjektet për qëllime aktiviteti. Për këto sipërfaqe nga ana e subjekteve nuk disponohet asnjë dokumentacion ku të saktësohet nëse janë në pronësi të tyre apo janë prona, pjesë e inventarit të Bashkisë Kavajë “Fond Pyjor”. Sipas informacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit këto hapësira (sipërfaqja prej 10,085 m<sup>2</sup>) janë pjesë e fondit pyjor të Bashkisë. Bazuar në informacionin e marrë nga akt verifikimet e bëra nga sektori i verifikimit në terren këto hapësira kanë ndryshuar destinacion nga fond pyjor në aktivitet biznesi konkretisht:

- Subjekti “B ” Shpk, NIPT: L...U me përfaqësues ligjor: Z. A.M me aktivitet: Bar, Restorant, Hotel *për sipërfaqe truall ka diferencë 2250 m<sup>2</sup>*;

- Subjekti “E ” Shpk, NIPT: L...A me përfaqësues ligjor: Z. E.D me aktivitet: Restorant, Hotel e stacion plazhi për *sipërfaqe truall ka diferencë 2683 m<sup>2</sup>*;

- Subjekti “E ” Shpk, NIPT: K...P me përfaqësues ligjor: Z. B.S me aktivitet: Hoteleri *për sipërfaqe e ndërtimi ka diferencë 85 m<sup>2</sup> ndërtesë, për sipërfaqe truall ka diferencë 1667 m<sup>2</sup>*;

- Subjekti “F ” Shpk, NIPT: L...N, me përfaqësues: Z. B.K me aktivitet: Hoteleri. *për sipërfaqja e ndërtimit ka diferencë 126 m<sup>2</sup>, për sipërfaqe truall ka diferencë 2627 m<sup>2</sup>*;

- Subjekti “K.R ” pf, NIPT: K...D, me përfaqësues: Z. K.R me aktivitet: Restorant, hotel, stacione plazhi, lundrime turistike, sporte ujore, Subjekti është tarifuar për 2023: ndërtesë sipërfaqe 4241 m<sup>2</sup>, truall 4242 m<sup>2</sup>, pishinë 120 m<sup>2</sup> dhe 40 dhoma si dhe reklamë. *Diferencë midis akt verifikimit dhe planifikimit rezulton se për sipërfaqen e ndërtesës nuk ka, për sipërfaqe truall ka diferencë 858m<sup>2</sup> x 20 lekë/m<sup>2</sup>=17,160 lekë taksë truall.* Sipas Kontrates së qirasë nr.319 repertori nr.144 koleksioni lidhur më datë 25 Qershor 2013, ky subjekt merr me qira nga Bashkia Kavajë një sipërfaqe të Fondit Pyjor prej 5220 m<sup>2</sup>. Në vazhdim nga ky subjekt rezulton se pas marrjes është regjistruar në ASHK leja e legalizimit nr. 87709, datë 09.09.2013, dhe subjekti është pajisur me Certifikatë pronësie nr. 738760 për pronën me sipërfaqe 1366.6 m ndërtesë dhe 531 m<sup>2</sup> truall e cila ndodhet brenda sipërfaqes së dhënë me qira. Për periudhën Qershor 2023 e në vazhdim subjekti nuk disponon kontratë qiraje me qellim veprimtarie pushimi, shlodhëse dhe argetuese, nuk është zhvilluar asnjë procedurë për dhënie në përdorim të fondit pyjor me ankand. Bazuar në kontratën mësipër, pika 8.1 në fund të periudhës së kësaj kontrate ose në përfundim të saj, Qiramarrësi do të rehabilitojë sipërfaqen për çdo dëmtim që mund të jetë shkaktuar gjatë veprimtarisë, dhe do ta dorëzojë sipërfaqen e marrë, siç ishte në gjendjen fillestare, përveç konsumimit fizik normal.

Veprime në kundërshtim me Nenet 801-825 të kodit civil, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat

tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 35, pika 2, gërma a), b), d), e) dhe ë); VKB nr.107, datë 22.11.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë”, pika II.11, nënpika 16. Tarifë për dhënie me qira të sipërfaqeve pyjore, niveli i tarifës është 110,000 lekë/ha/vit; Vendimin Nr. 54, Datë 5.2.2014 “Për Përcaktimin e Kriteve, të Procedurës e të Mënyrës të Dhënies të Qira, Enfiteozë apo Kontrata të Tjera të Pasurisë Shtetërore”, i ndryshuar,

**Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** Drejtor i Drejtorisë së Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve Publike z.**J.K** , për periudhën 01.01.2023 deri më 18.07.2023, dhe znj.**A.S** , drejtoreshë për periudhën 18.07.2023 në vazhdimësi; përgjegjës Sektori i Hartografisë, Kadastrës dhe GIS z.**A.B** për periudhën 01.01.2023 deri më 10.08.2023 , dhe z.**K.Ç** , për periudhën 15.08.2023 në vazhdimësi; përgjegjës Sektori i Hartografisë, Kadastrës dhe GIS z.**A.B** për periudhën 01.01.2023 deri më 10.08.2023 , dhe z.**K.Ç** , për periudhën 15.08.2023 në vazhdimësi.

- DKUMAP nuk organizohet dhe nuk funksionon bazuar në një rregullore të brendshme.

Nga auditimi konstatohet se DKUMAP nuk organizohet dhe nuk funksionon bazuar në një rregullore të brendshme.

DKUMAP nuk organizohet dhe nuk funksionon bazuar në një rregullore të brendshme për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së drejtorisë sipas pozicioneve të miratuara në strukturën organizative; drejtor drejtorie dhe 2 (dy) sektorë e për rrjedhojë DKUMAP dhe sektorët nuk kanë të përcaktuara organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat.

Përcaktimet e Rregullores së Brendshme të miratuar në vitin 2016 me Vendimin nr. 01, datë 02.12.2016, protokolluar me shkresë nr. 3223 prot. datë 02.12.2016, rregullojnë organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së DKUMAP sipas strukturës së miratuar për vitin 2016 nuk ka qenë drejtori por sektor në varësi të drejtorisë së Urbanistikës.

**Këto veprime janë në mospërputhje me:** Ligjin Nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, pika 8/d; VKM 142 datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar.

**Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. **R.K** (Kryetar i Bashkisë) Kryetar për periudhën deri më 14.05.2023, z. **F.Q** për periudhën 25.05.2023-në vazhdim; z. **D.H** (ish Drejtor i Burimeve Njerëzore), z. **K.M** (Drejtor i Burimeve Njerëzore), z. **A.M** (Drejtor Drejtoria Juridike), për periudhën 29.09.2022-18.07.2023 z. **[J.K** (Urdhër largimi nr.266, datë 18.07.2023), për periudhën 18.07.2023 - në vazhdimësi (Sipas Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 267, datë 18.07.2023, “Për punësim”), ngarkohet për drejtimin Drejtorisë së Kadastrës Urbane dhe menaxhimit të asetëve publike znj. **A.S** .

### **Kontratat e qirave**

- Mos rrespektim i legjisllacionit në fuqi për dhënien me qira të asetëve.

Për auditimin e kontratave të qirasë lidhur ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe subjekteve juridik/fizik, saktësinë e tarifave të aplikuara dhe arkëtimin e tyre, të cilat e shtrijnë efektin e tyre deri më datë 31.12.2023, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Ligj nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligj nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;

-Ligj nr.57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020;

-VKM nr.54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriteve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar;

-Kontratat e lidhura me subjektet juridike/fizike për përdorim të fondit pyjor/kullosor/tokës bujqësore, banesave sociale, dyqaneve, hapësira publike.

Nga auditimi i kontratave të lidhura me subjektet juridike/fizike u konstatua se, janë gjithsej 39 subjekte debitor në vlerën **16,326,291** lekë në marrëdhëniet kontraktore me Bashkinë Kavajë, për marrjen me qira të objekteve të ndryshme, pasqyruar sipas natyrës si më poshtë vijon:

Subjekte Qiramarrës Debitor	Principal	Gjithësej
39	16,326,291	16,326,291

Burimi: Drejtoria e Kadastrës Urbane, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

### **Dyqanet e dhëna me qira**

Bashkia Kavajë për vitin 2023 ka dhënë gjithësej 14 dyqane me qira, të cilët variojnë në një sipërfaqe 12 m<sup>2</sup> – 20 m<sup>2</sup>. Bazuar në paketën fiskale të vitit 2023, në përcaktimin e bërë në shkronjën “a” të pikës 1 në Kreun III, në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar është përcaktuar çmimi dysHEME i tarifës së qirasë 150 lekë/m<sup>2</sup>.

Në tabelën më poshtë paraqiten të dhënat për subjekte qeremarrës dhe dyqanet e marra me qira sipas sipërfaqeve respektive:

Nr.	Emer Mbiemer	sip. dyqani (m2)	Pagesa(leke) 2023	Data e pagesës
1	A.H	12.9 m2	23,220	12.05.2023
2	SH.H	12.9 m2		PA PAGUAR
3	M.L	17 m2		PA PAGUAR
4	B.I	12.8 m2	23,040	01.02.2023
5	P.R	13.3 m2		PA PAGUAR
6	S.B	12.9 m2	23,220	31.01.2023
7	D.K	12.6 m2	22,680	13.12.2023
8	V.B	13 m2	23,400	19.05.2023
9	F.Q	16.94	30,492	01.02.2023
10	N.M	16.8	30,240	12.05.2023
11	F.ZH	12.8 m2	23,040	22.06.2023
12	E.H	16.8 m2	30,240	03.11.2023
13	SH.LL	12 m2		PA PAGUAR
14	XH.B	13 m2	23,400	13.02.2023

Burimi: Drejtoria e Kadastrës Urbane, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Nga shqyrtimi i kontratave të qirasë dhe pagesave të kryera për detyrimet kontraktore nga subjektet qiramarrës, në 6 raste u konstatua se:

- Kontratat e qirasë nuk janë sipas formatit tip të përcaktuar paragrafin e dytë të pikës 12 në Kreun II të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, i ndryshuar.

- Pasuritë e mësipërme të dhëna me qira nuk i janë nënshtruar procedurës së konkurrimit në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 1 të VKM nr.54, datë 05.02.2014, i ndryshuar. Theksojmë se këto pasuri nuk bëjnë pjesë në objektet që përjashtohen nga procedura e konkurrimit përcaktuar në pikën 5 të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, i ndryshuar.

- Nuk administrohet dokumentacioni mbi monitorimin e kontratave të qirasë, si procesverbali i dorëzimit ku përcaktohet gjendja fizike e objektit, vlera financiare e tij, foto të objektit të dhënë me qira, sipërfaqja funksionale para objektit (në rast se ka), akt-rakordimet periodike të mbajtura me qiramarrësin, etj.

-Për 4 dyqane nuk administrohet kontrata e qirasë, megjithëse janë në përdorim nga subjektet përkatëse (A.H -12.9 m<sup>2</sup>, D.K- 12.6 m<sup>2</sup>, N.M-16.8 m<sup>2</sup>, E.H 16.8 m<sup>2</sup>), por administrohet vetëm pagesa e qirasë.

-Për 4 dyqane nuk administrohet pagese qiraje për vitin 2023.

Si rrjedhojë e mosrespektimit të detyrimit nga të dy palët për marrëdhënien kontraktore të mësipërme subjektet SH.H për sip.12.9 m2, M.L për sip.17 m<sup>2</sup> P.R për sip. 13.3 m<sup>2</sup>, Shpetim



Llaushi për sip.12 m<sup>2</sup> nuk kanë likujduar vlerën e qirasë për vitin 2023 duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë, gjithësej **99,360** lekë, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Dyqanet		
Nr	Subjekti	Detyrimi në lekë
1	SH.H	23,220
2	M.L	30,600
3	P.R	23,940
4	SH.LL	21,600
	<b>Total</b>	<b>99,360</b>

Burimi: Drejtoria e Kadastrës Urbane, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Nga Drejtoria e Kadastrës Urbane (e cila menaxhon asetet e dhëna me qira) përfaqësuar nga Drejtori i Drejtorisë për periudhën 01.01.2023-18.07.2023 **z. J.K** dhe për periudhën 18.07.2023 A.S , nuk është dokumentuar asnjë procedurë lidhur me këtë situatë.

### **Banesat Sociale**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kontratat e lidhura nga dhënia me qira e banesave sociale u konstatua se: Bashkia Kavajë ka në pronësi dhe ka dhënë për përdorim 48 banesa sociale, nga të cilat kanë lidhur kontratë për vitin 2023 gjithësej 35 kryefamiljare. Për të njëjtën periudhë objekt auditimi rezulton se nga Bashkia Kavajë, DKUM nuk ka lidhur kontrata për 13 banesa.

Situata debitore progresive në vlerë dhe në numër e shprehur në trajtë narrative paraqitet si më poshtë: Gjendja më datë 31.12.2022 është në vlerë 4,048,206 lekë dhe ju përket 15 subjekteve. Për vitin 2023 është krijuar vlera debitore 806,612 lekë që ju përket 20 subjekteve. Pra më datë 31.12.2023 rezultojnë 21 subjekte debitore në vlerën totale **4,845,418** lekë.

Për subjektet e mësipërme është bërë njoftimi për likuidimin e detyrimeve, por jo duke vazhduar me marrjen e masave të tjera në mënyrë shteruese, sipas përcaktimit të bërë në nenin 31 të Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”. *Analitike pasqyruar në Aneksin nr.9 bashkëlidhur Raportit.*

### **Toka bujqësore dhe pyjore e dhënë me qira.**

Nga auditimi i dokumentacionit për qiradhënien e tokave bujqësore/pyjoreu konstatua se: Bashkia Kavajë ka në administrim 10 kontrata qiraje për tokë pyjore, si dhe 22 kontrata për tokë bujqësore/pa frut.

Situata debitore progresive në vlerë dhe në numër e shprehur në trajtë narrative paraqitet si më poshtë: Gjendja më datë 31.12.2022 është në vlerë **8,481,240** lekë dhe ju përket 3 subjekteve. Për vitin 2023 është krijuar vlera debitore 269,456 lekë që ju përket 4 subjekteve. Pra më datë 31.12.2023 rezultojnë 5 subjekte debitorë në vlerën totale **8,707,016** lekë, konkretisht:

**N.K** , kontratë nr. 371 prot., datë 13.08.2013 me afat deri në 13.08.2112, për vlerën 11000 lekë/Ha në vit.

**V.M** , kontratë nr.372 prot., datë 13.08.2013 me afat 99 vite, nuk ka likujduar tarifën vjetore të qirasë, për përdorimin e tokës për vitin 2020 - 2023, për vlerën 60000 lekë për kater vite;

**B sh.p.k**, kontratë nr.372 prot., datë 02.06.2023 me afat 10 vite, nuk ka likujduar tarifën vjetore të qirasë, për përdorimin e tokës për 6 mujorin e vitit 2023, për vlerën 156,096 lekë;

**H.V** , kontratë datë 26.06.2013 me afat 10 vite, nuk ka likujduar qiranë për sipërfaqen e fondit pyjor dhe rezulton debitor në fund të vitit 2023 për vlerën 43,680 lekë.

**A.V** , debitor me vlerën 7 650 000 lekë. Përfunduar kontrata në qershor vitit 2022.

Subjektet e sipër përmendur nuk kanë likujduar detyrimet duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë, gjithësej **8,707,016** lekë e cila përbën të ardhura të munguara për

buxhetin e Bashkisë Kavajë. Në tabelën më poshtë janë pasqyruar të dhenat për subjektet e përmendur më sipër :

<b>Toka bujqësore dhe pyjore</b>	<b>Subjekti</b>	<b>Deri në 31.12.2022</b>	<b>31.12.2023</b>	<b>Progresiv</b>
<b>Nr.</b>			<b>Detyrimi</b>	
1	A.V	7,650,000	0	7,650,000
2	N.K	0	11 000	11,000
3	B sh.p.k	0	156,096	156,096
4	V.M	45,000	15,000	60,000
5	H.V	786,240	43,680	829,920
	<b>Total</b>	<b>8,481,240</b>	<b>269,456</b>	<b>8,707,016</b>

*Burimi: Drejtoria e Kadastrës Urbane, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.*

Nga DKUM nuk janë marrë të gjitha masat në mënyrë shteruese (zgjidhjen e kontratës, kërkesë padinë në gjykatë, bllokimin e llogarive bankare, etj, mbështetur në nenin 5 të kontratës së qirasë, si dhe në pikën 2 në nenin 89 të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar për subjektet e mësipërme), me qëllim arkëtimin e detyrimit apo ridhënien me qera të ketyre hapësirave.

### **Prerje lëndë drusore.**

Nga auditimi i dokumentacionit leje shfrytëzimi për prerje pishash janë dhenë në total 26 leje shfrytëzimi prerje pishash nga këto 15 leje shfrytëzimi janë dhënë nga Drejtoria e Kadastrës ndërsa 11 leje shfrytëzimi janë dhene nga Drejtoria e Mbrojtje së Konsumatorit me ndryshimin e bërë në strukturë në bazë të VKB nr. 01, datë 04.01.2023 ka miratuar numrin e përgjithshëm punonjësve dhe strukturën organizative sipas drejtorive/sectorëve për vitin 2023, konfirmuar ligjshmëria nga Prefektura e Qarkut Tiranë, me shkresën nr. 2388/1 prot.04.01.2023.

*Dokumentacioni që kërkohet për leje prerje pishash është: Kerkesa në të cilën shkruhet arsyeja e prerjes, certifikatë dhe hartë treguese, foto të pishave dhe një mjet identifikimi të kerkuesit.*

Nga auditimi u konstatua se nga 26 leje shfrytëzimi dhenë për të gjitha subjektet të cilat kanë kërkuar leje për prerje pishash për 5 leje subjektet nuk disponojnë dokumentacion (nuk e kanë certifikatën e pronësise dhe hartën treguese) të nevojshëm për tu pajisur me leje shfrytëzimi. Subjektet janë: A.G , N.M , I.I , A.B , E.GJ .

<b>Nr.</b>	<b>Subjekti</b>	<b>Dru Zjarri m<sup>3</sup></b>	<b>L. punimi m<sup>3</sup></b>	<b>Lekë</b>	<b>Nr. Pishave</b>
1	G.H	0,774		1392	2
2	E.Z		0,683	1370	2
3	I.G	0,886		3435	1
4	A.G	1,198	2,198	10332	5
5	E.R		1,522	6070	2
6	N.M	0,442		0	1
7	B.K	0,774	1,005	5809	4
8	S.D	0.565		741	1
9	I.I		1,058	3985	1
10	R.D		0,785	796	1
11	A.B		4.175	0	8
12	P.B		5.419	24,091	9
13	G.L		1.335	5,472	2
14	R.K		0.99	4,368	2
15	E.GJ		1.414	1,554	2
16	D.F		1.59	5,688	1
17	S.K		0.577	2,446	1
18	A.B		1.57	6,224	2
19	SH.M		0.424	1,957	1
20	F.G		0.707	2,862	1
21	K		1.335	5,472	2
22	E.GJ		3.73	15,533	6
23	E.M		1.57	1,592	2

Nr.	Subjekti	Dru Zjarri m <sup>3</sup>	L. punimi m <sup>3</sup>	Lekë	Nr. Pishave
24	A.H		1.272	4,670	1
25	I.K	0.565	0.816	4,368	3
26	Shoqeria "T "		6.813	24,201	4
	<b>TOTALI</b>	1199.13	5816.737	144,428	67

Burimi: Drejtoria e Kadastrës Urbane, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Lejet pa certifikatë pronësie për subjektin E.GJ janë dhënë nga Drejtori i Drejtorisë për periudhën 01.01.2023-18.07.2023, z. J.K , ndërsa për subjektet A.G , N.M , I.I , A.B nga Drejtori i Drejtorisë së Mbrojtjes së konsumatorit F.M dhe përgjegjesi në sektorin e mbrojtjes së mjedisit dhe pyjeve S.H .

### **Hapësira e plazhit e dhënë me qira.**

Në paketën fiskale të Bashkisë Kavajë për vitin 2023, konkretisht në Kreun II.5 “Tarifë e zënies së hapësirës publike për zonën e plazhit”, është përcaktuar niveli i taksës 300 lekë/m<sup>2</sup>/sezon turistik. Pra sipas përcaktimit të mësipërm, një subjekt që lidhë kontratë qiraje për përdorimin e hapësirës së plazhit, do të paguajë qira/taksë të zënies së hapësirës sipas VKM-së nr. 171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, e ndryshuar, konkretisht në pikën 11 të nenit 5 përcaktohet se:

*“Stacioni i plazhit duhet të mbahet i hapur nga subjektet të paktën gjatë afatit nga data **1 maj deri më 15 nëntor** të çdo viti dhe gjatë kësaj periudhe duhet të ofrojë të gjitha shërbimet e të përmbushë të gjitha kushtet minimale të përcaktuara në bazë të tipologjisë së plazhit ku do të ushtrohet aktiviteti”.*

*Është ngitur grupi i punës me Urdhër nr. 411 datë 05.12.2022 "Për ngritjen e grupit të punës mbi zbatimin e VKM nr. 171 datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" i ndryshuar i cili është i përbërë nga: J.K (Kryetar komisioni), A.B (Anëtarë), B.SH (Anëtarë), A.G (Anëtarë), R.SH (Anëtarë).*

Nga auditimi i kontratave të lidhura në vitin 2023 (ku subjektet kanë kryer rregullisht likuidimin e vlerës së qirasë për sezonin turistik), rezulton se Bashkia Kavajë ka arkëtuar vlerën prej **44,730,330 lekë**.

Pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Subjekte që kanë lidhur kontratë në vitin 2023	Sipërfaqe e kontraktuar (m <sup>2</sup> )	Niveli i taksës sipas paketës fiskale/sezoni	Vlera e detyrimit	Vlera e arkëtuar
103	149101	300	44,730,300	44,730,330

Burimi: Drejtoria e Kadastrës Urbane, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Nga auditimi i dokumentacionit për qiradhënien e hapësirës së plazhit për ushtrimin e aktivitetit “Stacion plazhi”, rezultoi se Bashkia Kavajë në vitin 2023 ka në administrim 107 kontrata qiraje për përdorimin e hapësirës së plazhit. Në përfundim konstatohet se në fund të vitit 2023 janë gjithësej 4 subjekte të cilët kanë pasur kontrata 5 vjeçare që nuk kanë kryer likuidimin e tarifës vjetore të qirasë për përdorimin e hapësirës së plazhit, *gjithësej në vlerën 1,964,100 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kavajë.*

Kontrata stacion plazhi	Subjekti	Sipërfaqe e kontraktuar (m <sup>2</sup> )	Niveli i taksës sipas paketës fiskale/sezoni	31.12.2023
Nr.				Detyrimi për tu paguar
1	E Shpk	2535	300	760,500
2	E.H	1237	300	371,100
3	A.SH	1253	300	375,900
4	GJ	1522	300	456,600
	<b>Total</b>			<b>1,964,100</b>

Burimi: Drejtoria e Kadastrës Urbane, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

***Sa më sipër vlera prej 1,964,100 lekë përbën efekt negativ financiar në buxhetin e Bashkisë Kavajë, si rrjedhojë e mosadministrimit të aseteve me efektivitet dhe eficiencë.***

-Për subjektet e mësipërme nuk është aplikuar penalitet për moslikujdimin e tarifës së qirasë, si dhe për arkëtimin e detyrimit nuk janë marrë masat shtrënguese në mënyrë shteruese, njoftimin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, bllokimin e llogarisë bankare, kërkesë padi në gjykatë etj.

Këto veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 8 të VKM nr. 569, datë 17.07.2019 “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të agjencisë kombëtare të bregdetit”, i ndryshuar, nenin 8 në kontratën e qirasë të lidhur ndërmjet palëve, pikën 2 në nenin 89 të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, si dhe nenin 32 në Ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, i ndryshuar.

-Gjithashtu në 4 raste për subjektet “E ” Shpk, me NIPT K...K dhe “E.H ” me NIPT L...I, “A.SH ” me NIPT L5...A dhe “GJ ” me NIPT L...I është konstatuar se janë debitorë për moslikujdimin e tarifës vjetore të qirasë në vlerën **1,964,100 lekë**, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjat “c” dhe “d” të pikës 3 në nenin 5 dhe shkronjën “b” në pikën 2 në nenin 12 në VKM nr. 171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, e ndryshuar.

**Kontrata për “hapësira publike”.**

Për “Hapësirat publike” janë gjithsej 19 kontrata për vitin 2023. Subjektet të cilët kanë lidhur kontratë me bashkinë për vitin 2023, për përdorim të hapësirës publike kanë shlyer pagesën para lidhjes së kontratës.

Nga kontratat e lidhura rezulton se; subjekti në emër të F.B e cila ka lidhur kontratën me nr. 232/1 prot. me datë 18.01.2023, rezulton se pagesa nga ky subjekt është bërë me datë 11.04.2023 pranë bankës Intesasanpaolo. Pra rezulton se pagesa është kryer me vonesë dhe jo përpara lidhjes së kontratës.

Gjithashtu subjekti E.B ka lidhur kontratë me Bashkinë Kavajë për përdorim të përkohshëm të sipërfaqes prej 96 m2 truall për ushtrim aktiviteti tregtar (lavazh). Përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë sipas paketës fiskale 100 lekë/m<sup>2</sup> në muaj respektivisht vlera që paguan subjekti në vit është 115,200 (nje qind e pesëmbëdhjetë mijë e dy qind) lekë.

Ky subjekt është pajisur me kontratë deri më 18.05.2015 me efekt deri më 18.05.2016.

Subjekti E.B							
Lloji i objektit	Aktiviteti	M2	Nr Prot	Dt. Lidhjes kontr	Pagesat	Vlera	Data e pagese
Truall	Lavazh	96	649	21.05.2012	1 muaj	9,600	21.05.2012
					3 muaj	28,800	29.06.2012
					3 muaj	28,800	05.10.2012
					3 muaj	28,800	20.01.2013
					3 muaj	28,800	05.04.2013
			765	25.07.2013	6 mujori I viti 2013	57,600	12.07.2013
					6 mujori II viti 2013	57,600	17.03.2014
			1049	30.06.2014	6 mujori I viti 2014	57,600	30.06.2014
					6 mujori II viti 2014	57,600	16.04.2015
					6 mujori I viti 2015	57,600	16.11.2015
			447/1	18.05.2015	6 mujori II viti 2015	57,600	20.05.2016
					6 mujori I viti 2016	57,600	15.05.2018
					6 mujori II viti 2016	57,600	12.07.2018
					6 mujori I viti 2017	57,600	16.01.2019
					6 mujori II viti 2017	57,600	15.02.2019
					6 mujori I viti 2018	57,600	15.04.2019
					6 mujori II viti 2018	57,600	29.08.2019
					6 mujori I viti 2019	57,600	28.01.2020

					6 mujori II viti 2019	57,600	12.02.2020
					6 mujori I viti 2020	57,600	17.09.2020
					6 mujori II viti 2020	57,600	31.08.2021
					6 mujori I viti 2021	57,600	18.12.2021
					6 mujori II viti 2021	57,600	09.01.2023

Burimi: Drejtoria e Kadastrës Urbane, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Për arsye të vonësës së pagesave nga ky subjekt, nuk janë lidhur kontratat në vazhdim. Subjekti E.B i ka shlyer detyrimet deri për vitin 2021. Për vitin 2022 dhe vitin 2023 subjekti nuk ka shlyer detyrimet ndaj bashkisë ku për këtë periudhë detyrimi është në shumën **230,400** lekë. Subjekti E.B vazhdon ta përdorë objektin e qirasë për qëllime biznesi dhe për këtë arsye është debitor për vitet 2022 -2023.

Dy subjekte të tjerë të cilët kanë lidhur kontrata për hapsirë publike me bashkinë Kavajë nuk kanë shlyer detyrimet për vitin 2023. Konkretisht subjektet D.Ç kontratë nr.3941 prot datë 20.12.2021 kontratë e lidhur me afat 5 vite vlera e kontratës 240, 000 lekë në vit dhe subjekti “B ” Shpk lidhur kontratë me nr.3586 prot datë 17.11.2021 kontrate e lidhur per nje afat 20 vite vlera e kontratës 240, 000 lekë në vit. Vlerat e pa tërhequra për vitin 2023 për hapësirat publike janë 480,000 (katerqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

Nr	Emer Mbiemer	Date	Nr prot	Pagesa/leke	Afati	M2	Pozicioni	Viti 2023	Data e pageses
1	I.K	29.06.2023	2651\1	60,000	5 muaj	120	Kryemedhenj	60,000	27.06.2023
2	A.Ç	04.07.2023	2373\1	2,400	2 muaj	12	Golem	2,400	26.06.2023
3	E.A	13.06.2023	2442\1	4,500	5 muaj	9	mali robit	4,500	13.06.2023
4	L.Q	12.06.2023	2401	60,000	3 muaj	200	Ish Gabinat	60,000	08.06.2023
5	A.B	08.06.2023	2356	4,500	5 muaj	9	Rotondo Golem	4,500	06.06.2023
6	T.V	01.06.2023	1963/1	50,000	5 muaj	100	Prane Pristigjit	50,000	31.05.2023
7	D.M	01.06.2023	2103/1	4,500	5 muaj	9	Rotondo Golem	4,500	31.05.2023
8	P.K	31.05.2023	2049/1	10,000	2 vite	20	Kryemedhenj	10,000	29.05.2023
9	A.C	30.05.2023	2100	3,600	3 muaj	12	Rotondo Golem	3,600	31.05.2023
10	A	13.01.2023	191/1	240,000	1 vit	200	Kryemedhenj	240,000	12.01.2023
11	E.XH	13.01.2023	227	240,000	5 vit	200	Kryemedhenj	240,000	30.12.2022
12	Y.Ç	12.01.2023	82/1	240,000	1 vit	200	Kryemedhenj	240,000	10.01.2023
13	F.B	18.01.2023	232/1	240,000	5 vjet	200	Kryemedhenj	240,000	11.04.2023
14	K.GJ	29.09.2023	4693	240,000	1 vit	200	Kryemedhenj	240,000	29.09.2023
15	Z.H	09.10.2023	4713/3	115,200	1 vit	96	mali robit	115,200	06.10.2023
16	G.H	01.11.2023	4921/1	240,000	1 vit	200	Kryemedhej	240,000	19.10.2023
17	L.H	16.11.2023	3051/1	9,600	1 vit	8	Mali robit	9,600	16.11.2023
18	N.K	04.12.2023	5536/1	240,000	1 vit	200	Kryemedhej	240,000	04.12.2023
19	S.K	12.12.2023	5893/1	240,000	1 vit	200	Qerret	240,000	12.12.2023
20	E	22.02.2022	715	240,000	10 vjet	200	pishat e buta	240,000	19.05.2023
21	M	13.12.2022	4239	240,000	3 vjet	50	Kryemedhenj	60,000	05.12.2022
22	T	13.12.2022	4234	234,000	5 vite	195	Kryemedhenj	234,000	02.12.2022
23	B.M	24.05.2022	1882	240,000	5 vite	200	Kryemedhenj	400,000	10.01.2024
24	B.K	20.05.2022	1821	240,000	5 vite	200	Kryemedhenj	240,000	19.05.2022
25	D.Ç	20.12.2021	3941	240,000	5 vite	200	Kryemedhenj		
26	E.GJ	17.11.2021	3587	240,000	5 vite	200	Proi Agait	260000	25.01.2024
27	B	17.11.2021	3586	240,000	20 vite	200	Golem qender		
			total	4,158,300	-			3,678,300	

Burimi: Drejtoria e Kadastrës Urbane, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Për sa më sipër për subjektin F.B të cilës i është lidhur kontrata e qirasë para pagesës së qirasë me një diference 4 muaj me vonësë mban përgjegjësi Drejtoria e Kadastrës Urbane (e cila menaxhon asetet e dhëna me qira) përfaqësuar nga Drejtori i Drejtorisë për periudhën 01.01.2023-18.07.2023 z. J.K .

Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Kavajë me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Kadastrës Urbane gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e tarifave të qirave, etj), veprime dhe mosveprime të cilat kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kavajë në vlerën **16,326,291 lekë**. Konkretisht veprimet dhe mosveprimet janë konstatuar në marrëdhëniet kontraktuale si vijon: 4 kontrata qiraje për pasuritë e llojit “Dyqan”, 23 familjare për qiradhënie të banesave sociale, 5 kontrata për fond pyjor/tokë bujqësore, 4 kontrata qiraje për hapësirën e plazhit 3 kontrata hapsira publike. Në vijim u konstatua se për dyqanet e dhëna me qira nuk është kryer procedura e konkurrimit, kontratat nuk janë sipas formatit të miratuar, 4 subjekte kanë në përdorim dyqane pa lidhur kontratë qiraje.

Veprime në kundërshtim me Nenin 32 në Ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, i ndryshuar; Pikën 2 në nenin 89 të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Nenin 31 të Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, për banesat sociale; Pikën 1, pikën 12 në Kreun II të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, Pikën 8 të VKM nr. 569, datë 17.07.2019 “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të agjencisë kombëtare të bregdetit”, i ndryshuar; Shkronjat “c” dhe “d” të pikës 3 në nenin 5 dhe shkronjën “b” në pikën 2 në nenin 12 në VKM nr. 171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, e ndryshuar.

Nenin 5 “Çmimi dhe mënyra e pagesës” të kontratave të qirasë për dyqanet.

Nenin 5 të kontratës së qirasë për tokat pyjore/bujqësore;

Nenin 8 në kontratën e qirasë së hapësirës së plazhit të lidhur ndërmjet palëve;

#### **Për veprimet më sipër ngarkohen me përgjegjësi:**

Për periudhën 29.09.2022-18.07.2023 **z. J.K** , për periudhën 18.07.2023 - në vazhdimësi **znj. A.S** , **Përgjegjës z. A.B** për periudhën 14.12.2020- 10.08.2023); **z. K.Ç** 15.08.2023 - në vazhdim.

#### **Korrespondenca me institucionet.**

DTTVAB në kuadrin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacioneve me institucione të ndryshme jashtë bashkisë, ka kërkuar dhe njëkohësisht ka dhënë informacione në funksion të realizimit të detyrave dhe objektivave për të ardhurat vendore. DTTV ka mbajtur korrespondencë me institucione të ndryshme si QKB, ASHK, Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës, Banka të nivelit të dytë dhe institucione të tjera shtetërore.

#### ***- Korrespondenca jo korrekte me institucionet.***

Nga auditimi i korespondencës me institucionet lidhur me kërkesat për informacion rreth subjekteve fizik/juridik u konstatua se:

Për vitin 2023, nga QKB është kërkuar informacion për gjendjen debitorë gjithsej për 57 subjekte (vetëm për qytetin Kavajë). Nga verifikimi me zgjedhje i shkresave në **25 (njëzet e pesë) raste**, rezulton se korrespondenca është jo korrekte. Për asnjë nga rastet e marra në shqyrtim nuk janë ndjekur hapat për zbatimin ne procedurave për arkëtimin e detyrimeve (Njoftim për marrje masë shtrënguese, Urdhër bllokim etj.).

Në 13 (trembëdhjetë) raste për subjekte që është kërkuar informacion për çregjistrim/pezullim në QKB u konstatua se, **janë të regjistruar** në sistemin e DTTVAB, rezultojnë debitorë por nuk i është kthyer përgjigje shkresave brenda afatit ligjor me qëllim mosvazhdimin e procedurave për çregjistrim.

Tabela e subjekteve pa kthim përgjigje:

Nr.	SUBJEKTET	NIPTI	Data e shkresës	Vlera e debise sipas regjistrimit të DTTV	Statusi QKB
1	A.RR	M...V	13.01.2023	0	Pezulluar
2	S.M	L...N	11.01.2023	27,648	Aktiv
3	L.D	L...K	10.01.2023	21,780	Aktiv
4	F.Z	K...S	10.01.2023	0	Cregjistruar 10/03/2023
5	S.L	M...L	15.12.2022	0	Cregjistruar 31/03/2023
6	O	M...C	23.12.2022	41,882	Aktiv
7	O	M...C	23.12.2022	27,316	Aktiv
8	L.Ç	K...S	23.12.2022	52,962	Cregjistruar 08/06/2023
9	A.XH	L...K	16.11.2022	4,226	Pezulluar
10	G.RR	K...Q	16.12.2022	59,589	Pezulluar
11	G.G	L...T	01.12.2022	0	Cregjistruar 28/03/2023
12	G.D	L...S	Ska info	34,516	Ndryshuar adresa 10/05/2023
13	F.F	J...N	01.03.2023	9,990	Pezulluar
14	R.RR	L...M	01.12.2021	16,780	Cregjistruar 30/01/2023
15	L.A	L...N	08.06.2023	0	Çregjistruar
16	R.M	L...J	26.06.2023	0	Aktiv
17	F.SH	K...Q	08.03.2023	0	Hequr adresa dytesore date 26/04/2023
18	A.B	L...C	08.03.2023	13,878	Pezulluar
19	M.A	L...P	07.02.2023	23,454	Pezulluar
20	I.A	M...K	21.02.2023	0	Cregjistruar
21	E.K	M...Q	21.02.2023	0	Pezulluar
22	XH.K	M...V	21.02.2023	0	Aktiv date 26.10.2023
23	F.B	L...U	16.02.2023	67,957	Aktiv
24	K.H	M...H	16.02.2023	0	Hequr Targat me 13.03.2023
25	O.L	M...I	18.03.2023	0	Pezulluar
<b>TOTALI</b>				<b>401,976</b>	

Burimi i të dhënave: DTTAVB, Bashkia Kavajë

Nga 14 (katërmbëdhjetë) rastet e përmendura më sipër rezultojnë se, nga QKB janë çregjistruar 3 subjekte nga ku një prej tyre me detyrime të prapambetura në vlerën 16,780 lekë, ndërsa në regjistrin e DTTV rezultojnë debitor dhe nuk janë mbajtur akt konstatime për të vërtetuar nëse subjekti ushtron ose jo aktivitet në adresën e deklaruar.

DTTVAB dhe sektori i kontrollit në terren pranë DTTVAB nuk i ka kthyer përgjigje QKB, këto raste paraqiten sipas tabelës:

Nr.	SUBJEKTET	NIPTI	Data e shkresës	Vlera e debise sipas sistemit DTTV	Statusi QKB
1	G.D	L...S	Ska info	34,516	Ndryshuar adresa 10/05/2023
2	F	J...N	01.03.2023	9,990	Pezulluar
3	R.RR	L...M	01.12.2021	16,780	Cregjistruar 30/01/2023
4	L.A	L...N	08.06.2023	0	Çregjistruar
5	R.M	L...J	26.06.2023	0	Aktiv
6	F.SH	K...Q	08.03.2023	0	Hequr adresa dytesore date 26/04/2023
7	A.B	L...C	08.03.2023	13,878	Pezulluar
8	M.A	L...P	07.02.2023	23,454	Pezulluar
9	I.A	M...K	21.02.2023	0	Cregjistruar
10	E.K	M...Q	21.02.2023	0	Pezulluar
11	XH.K	M...V	21.02.2023	0	Aktiv date 26.10.2023
12	F.B	L...U	16.02.2023	67,957	Aktiv
13	K.H	M...H	16.02.2023	0	Hequr Targat me 13.03.2023
14	O.L	M...I	18.03.2023	0	Pezulluar
<b>TOTALI</b>				<b>166,575</b>	

Burimi i të dhënave: DTTAVB, Bashkia Kavajë.

Në 6 (gjashtë) raste për subjekte që është kërkuar informacion për çregjistrim në QKB rezultojnë se janë mbyllur në regjistrin (është ndërprerë përlllogaritja për detyrimin vjetor) e DTTVAB, ndërsa në QKB rezultojnë me statusin aktiv. Nga sektori i verifikimit në terren nuk janë

mbajtur akt konstatime për të vërtetuar nëse subjekti ushtron ose jo aktivitet në adresën e deklaruar, të cilat paraqiten sipas tabelës:

Nr.	SUBJEKTET	NIPTI	Data e shkresës	Vlera e debise sipas DTTV	Statusi QKB
1	S.M	L...N	11.01.2023	27,648	Aktiv
2	L.D	L...K	10.01.2023	21,780	Aktiv
3	O	M...C	23.12.2022	41,882	Aktiv
4	O	M...C	23.12.2022	27,316	Aktiv
5	R.M	L...J	26.06.2023	0	Aktiv
6	XH.K	M...V	21.02.2023	0	Aktiv
7	F.B	L...U	16.02.2023	67,957	Aktiv
<b>TOTALI</b>				<b>186,583</b>	

Burimi i të dhënave: DTTAVB, Bashkia Kavajë

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 5, neni 11,...; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë i ndryshuar” neni 1, **neni 2** gërmat a, ç, **neni 5** gërmat a, d, dh, f, g, gj, h, i, **neni 6** pikat 1, 2, 3, neni 12 **gërmat** a, b, dh..., **neni 13** gërma b, neni 15, **neni 23** pika 1, 4, neni 26, neni 27, neni 28 pika 1, **neni 29**, neni 31, neni 40, neni 41, neni 42, **neni 43 pika 1, 2, 3, neni 44, neni 45**, neni 47, **neni 48** pika 1, **neni 57** pikat 4, 5, **nenet 60, 61, 62**, neni 65 pika 5, nenet 68, 69, **neni 70 pika 2, neni 71/1** pika 5; ligji nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, nenet 28–40, **neni 42, neni 43** gërma d, **neni 59**; Manuali i Manaxhimit Financiar dhe kontrollit kapitulli III, Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me Urdhërin e MFE nr. 108 datë 17.11.2016; Udhëzimi nr. 26, datë 16.12.2014; Udhëzimi nr. 655/1 datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore. VKB - në nr.107, datë 22.11.2022 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë”.

**Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** Drejtor i Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit z. **R. I** për periudhën 01.01.2023 deri me 11.08.2023, z. **A.Ç** për periudhën 14.08.2023 në vazhdim; Përgjegjës i sektorit të turizmit z. **G.T** për periudhën 01.01.2023 deri më 27.06.2023, z. **B.R** për periudhën 11.07.2023 në vazhdim; Sektori i Verifikimit në Terren, znj. **S.M** për periudhën 01.01.2023 deri më 15.08.2023 dhe z. **I.GJ** për periudhën 16.08.2023 në vazhdim.

*- Bashkia Kavajë, nuk ka marrë masa për ndjekjen e tapave që parashikon legjislacioni në fuqi për vjeljen e detyrimeve.*

Nga analizimi mbi vjeljen e detyrimeve debitore u konstatua se, nga Bashkia Kavajë, nuk janë marrë masa për ndjekjen e tapave që parashikon legjislacioni në fuqi. Më poshtë janë paraqitur etapat që parashikon kuadri ligjor në fuqi për vjeljen e detyrimeve dhe parashkrimi i detyrimeve si pasojë e shmangies nga ndjekja e etapave që parashikon kuadri ligjor në fuqi për vjeljen e detyrimeve. Mbështetur në nenin 89, pika 2, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, procedura e detajuar e mbledhjes me forcë e detyrimit tatimor përcaktohen në Udhëzimin nr. 17 datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standarteve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore”. (referuar më poshtë si UM nr. 17) Duhet me çdo kusht të ndiqen të gjitha hapat mbledhjes së detyrimeve të taksave e tarifave vendore. Ky udhëzim i rendit procedurat për mbledhjen me masa shtrënguese të detyrimeve tatimore në kreun III si më poshtë vijon: Hapat dhe procedurat që ndiqen nga drejtoritë e taksave dhe tarifave vendore apo strukturat administrative tatimore të ngjashme me to, për mbledhjen e detyrimeve të papaguara të taksave e tarifave vendore:



U.M Nr. 17 pika 1 faqe 2: Njoftimi dhe kërkesa për të paguar.  
 U.M Nr. 17 pika 1/1.1 faqe 2 dhe 3 Bllokimi i shitjes së aktiveve.  
 U.M Nr. 17 pika 1/1.2 faqe 3. Konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit.  
 U.M Nr. 17 pika 1/1.3 faqe 3. Kallëzimi për ndjekje penale.  
 U.M Nr. 17 pika 2 faqe 4. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të taksapaguesit.  
 U.M Nr. 17 pika 2 faqe 4 dhe 5. Urdhëri i ekzekutimit  
 U.M Nr. 17 pika 3 faqe 5. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor.  
 U.M Nr. 17 pika 3.1.2 Njoftimi për vendosjen e barrës hipotekore.  
 U.M Nr. 17 pika 4 faqe 6-7 Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë  
 U.M Nr. 17 pika 5.1 faqe 9. E drejta e mbledhjes së detyrimit tatimor palës së tretë

**Mos ndjekja e etapave të përmendura më sipër dhe shtyrja në kohë e tyre bën që detyrimet e taksapaguesve të parashkruhen e si pasojë bëhet e pamundur vjelja e tyre.** (Parashkrimi, Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”;

Neni 73, E drejta e administratës tatimore për të bërë vlerësim tatimor, si dhe e drejta e tatimpaguesit për të kërkuar tepricën kreditore); neni 100 Parashkrimi i së drejtës për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese.

Nr .	Sipas Njësive Administrative	Debitorë BV+BM	Vlera debi BV+BM	Urdhër bllokime per Biznes per Nentor-Dhjetor 2023 (Nr. subjekte)	Vlera e Urdhërblokimeve	Dif. në numë r	Dif. në vlerë
1	Nj.a Kavajë	721	78,953,433	0	0	721	78,953,433
2	Nj.a Golem	985	161,983,580	83	23,869,875	902	138,113,705
3	Nj.a Synej	56	7,768,192	0	0	56	7,768,192
4	Nj.a Luz i Vogël	93	6,950,047	0	0	93	6,950,047
5	Nj.a Helmas	35	5,185,378	0	0	35	5,185,378
<b>TOTALE</b>		<b>1890</b>	<b>260,840,630</b>	<b>83</b>	<b>23,869,875</b>	<b>1,807</b>	<b>236,970,755</b>

Burimi i të dhënave: DTTAVB, Bashkia Kavajë

Nga auditimi u konstatua se nga 1890 subjekte të cilët rezultojnë debitorë në datë 31.12.2022 me vlerë totale 260,840,630 lekë, vetëm për 83 raste ose 4,39 % në vlerën 23,869,875 lekë janë ndërmarrë masa për arkëtimin me forcë të detyrimeve të prapambetura (është ndjekur vetëm hapi i pestë, duke anashkaluar të gjitha hapat sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr. 17, datë 20.06.2022. **Për vitin 2023 vlera e munguar si pasojë e mosndjekjes së procedurave për arkëtimin me forcë të detyrimeve është 236,970,755 lekë.**

Veprime në kundërshtim me Neni 73, neni 89 pika 2, neni 100, i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”; Udhëzimin nr. 17 datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standarteve proceduriale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore”.

**Për veprimet më sipër mbajnë përgjegjësi:** Drejtor i Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit z. **R. I** për periudhën 01.01.2023 deri me 11.08.2023, z. **A.Ç** për periudhën 14.08.2023 në vazhdimësi; Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Ardhurave, Mbledhjes së Borxhit, Rakordimit të Taksave dhe Apelimit znj. **M.Ç** për periudhën 01.01.2023 deri më 06.07.2023, znj. **XH.U** për periudhën 11.07.2023 deri në 15.10.2023 dhe znj. **D.M** për periudhën 16.10.2023 në vazhdim.

Për sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit janë paraqitur observacione nga Bashkia Kavajë me nr. 176/3 prot., datë 10.05.2024, administruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 34/14 prot., datë 15.04.2024.

**Pretendimet e subjektit:**

*Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore me shkresën nr. 176/3 prot datë 10.05.2024 informon grupin e auditimit për masat që janë marrë për uljen e borxhit tatimor sikurse janë kontrollet në terren për përditësimin e informacionit në dosjet e subjekteve, apo ndjekjen e procedurave të mëtejshme për arkëtimin e detyrimeve për diferencat e lëna në projekt raport.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Përsa më sipër, observacionet shprehin përpjekjet e subjektit për menaxhimin e borxhit dhe grupi i auditimit i merr pjesërisht në konsideratë, por gjetjet dhe rekomandimet qëndrojnë të pa ndryshuara, pasi Bashkia Kavajë duhet të marrë në vijimësi të gjitha masat e nevojshme për uljen e borxhit tatimor.

**Pika 2.3 e programit: Mbi vlerësimin e raportimit financiar për vitin 2023.**

**Shënim:** Çështja; “Mbi vlerësimin e raportimit financiar për vitin 2023” nuk është shqyrtuar nga Grupi i KLSH për arsye se, auditimi në terren u krye në kohën apo gjatë afatit ligjor deri 31 mars 2024 të hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2023 dhe nuk u bë mundur auditimi i saktësisë dhe plotësisë së informacionit kontabël në lidhje me transaksionet financiare dhe mbylljen e llogarive financiare të kësaj njësie shpenzuese.

- **Auditim mbi administrimin e asetëve, procedura e inventarizimit si edhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.**

*- Mungesa e regjistrit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Kavajë.*

Bashkia Kavajë me VKB nr. 01, datë 04.01.2023 ka miratuar numrin e përgjithshëm punonjësve dhe strukturën organizative sipas drejtorive/sectorëve për vitin 2023. Struktura e cila merret me administrimin e pasurive është Sektori i Strehimit dhe Regjistrimit të Pronave, pjese e Drejtorisë së Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve Publike (DKUMAP). Ky sektor menaxhon punën për identifikimin dhe inventarizimin e pronave të paluajtshme të administruar për Bashkinë Kavajë, rritjen e standardeve në sektorët përkatës së strehimit dhe regjistrimit të pronave vendosjen e objektivave për arritjen e këtyre standardeve si dhe parashikon ecurinë e problematikave që trajtohen në këtë sektor.

Si çdo institucion publik, edhe Bashkia Kavajë, ka detyrimin ligjor që përpara konsolidimit të pasqyrës së pozicionit financiar, ndër të tjera, duhet të ketë të saktësuar zërat si: Pronat, tokat dhe pasuritë natyrore. Një pjesë e konsiderueshme e pronave dhe tokave, Bashkia Kavajë i ka fituar nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, shpronësimeve, si dhe një pjesë të tyre nga shkrirja e ish-komunave, aktualisht NjA të Bashkisë Kavajë. Me qëllim pasqyrimit real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Kavajë duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia etj.,.

**a.** Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Kavajë dhe NjA Synej, Helmas, Luz i Vogël, Golem, nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, ku përcaktohet që, “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes

vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre **brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji**".

**b.** Sa më sipër grupi i auditimit kërkoi regjistrin e pronave, tokave dhe pasurive natyrore të cilat janë në pronësi të Bashkisë Kavajë. Gjithashtu referuar rregullores së brendshme të Bashkisë Kavajë, në mënyrë të përgjithshme përcaktohen detyrat për inventarizimin, përditësimin, regjistrimin e pronave të të gjitha llojeve, pra nuk ka një sektor/strukturë të posaçme, për inventarizimin e pronave, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar dhe më pas regjistrimin në kadastër.

Nga auditimi konstatohet se, nuk ekziston një regjistër kontabël ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26-30.

Dokumentacioni dhe të dhënat përkatëse në lidhje me asetet e Bashkisë janë vënë në dispozicion me shkresa zyrtare nëpërmjet VKM përkatëse, si më poshtë:

**c.** Me VKM-të përkatëse janë transferuar në total **3,176 pasuri** si ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat **2,645 pasuri në pronësi** dhe **531 pasuri në përdorim** si më poshtë:

➤ **Bashkia Kavajë**

- Me VKM nr. 1563, datë 26.11.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kavajë, të Qarkut të Tiranë", është miratuar lista inventarit me në total **690 pasuri nga të cilat 655 pasuri në pronësi dhe 34 pasuri në përdorim**. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me numër 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) dhe përbëhet me 112 (njëqind e dymbëdhjetë) fletë.

➤ **Ish-Komuna Helmës sot Njësia Administrative Helmës e Bashkisë Kavajë**

- Me VKM nr. 5, datë 06.01.2013 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Helmas, të Qarkut të Tiranë". Lista me 100 (njëqind) fletë dhe përfundon me numër rendor 702, është miratuar lista inventarit me **702 pasuri total** nga të cilat **419 pasuri në pronësi** dhe **283 pasuri në përdorim**.

➤ **Ish-Komuna Synej sot Njësia Administrative Synej e Bashkisë Kavajë**

- Me VKM nr. 45, datë 19.01.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Synej, të Qarkut të Tiranë". Lista me 82 (tetëdhjetë e dy) fletë dhe përfundon me numër rendor 584 (pesëqind e tetëdhjetë e katër), është miratuar lista inventarit me **584 pasuri total** nga të cilat **401 pasuri në pronësi** dhe **183 pasuri në përdorim**.

➤ **Ish-Komuna Golem sot Njësia Administrative Golem e Bashkisë Kavajë**

- Me VKM-në Nr. 370, datë 30.01.2013 "Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Golem, të Qarkut të Tiranë"., Lista me 110 (njëqind e dhjetë) fletë dhe përfundon me numër rendor 773 (shtatëqind e shtatëdhjetë e tre), është miratuar lista inventarit me **773 pasuri total** nga të cilat **752 pasuri në pronësi** dhe **21 pasuri në përdorim**.

➤ **Ish-Komunës Luz i Vogël sot Njësia Administrative Luz i Vogël**

- Me VKM-në Nr.4, datë 06.01.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Luz i vogël, të Qarkut të Tiranë". Lista me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë dhe përfundon me numër rendor 427 (katërqind e njëzetë e shtatë), është miratuar lista inventarit me **427 pasuri total** nga të cilat **417 pasuri në pronësi** dhe **10 pasuri në përdorim**.

- **Pyjet dhe Kullotat**, në bazë të **VKM nr. 433 datë 8.6.2016** “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, i ndryshuar sipërfaqet pyjore dhe kullosore.

Bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga subjekti, në tabelën e mëposhtme është pasqyruar numri i pronave sipas listës së inventarit si dhe VKM-ve përkatëse të njësive Administrative dhe të Bashkisë Kavajë.

**Tabela përmbledhëse e pronave sipas listës së inventarit**

N r.	Bashkia/ Njësiti	Nr. i Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara Deri Dhjetor 2023	Nr. i Praktikave të Certifikuara 2023	Nr. i Praktikave në proces	Nr. i Pronave të pa Regjistruara
1	Bashkia Kavajë	690	106	0	23	567
2	Nj.Ad. Golem	773	55	0	23	724
3	Nj.Ad. Luz i Vogël	427	2	0	6	412
4	Nj.Ad. Synej	584	13	0	4	497
5	Nj.Ad. Helmas	702	25	0	20	645
	<b>Totali</b>	<b>3176</b>	<b>201</b>	<b>0</b>	<b>76</b>	<b>2845</b>

Burimi: Drejtoria Kadastrës dhe e Menaxhimit të Aseteve Publike

**Shënim: Për pasuritë e llojit “arë”, “pa frute” dhe “pyll”, në VKM rezultojnë të renditura në total si pasuri “mëmë” dhe kur regjistrohen ndahen në pasuri “bija”**

**Konstatim:** Me VKM përkatëse janë transferuar në total **3,176 pasuri** si ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat **2,645 pasuri në pronësi** dhe **531 pasuri në përdorim**. Në total në pronësi të Bashkisë Kavajë janë **2,645 pasuri**, nga të cilat **201 pasuri** janë të pajisura me certifikatë dhe **2,444 pasuri** nuk janë të pajisura me titull pronësie.

Për sa trajtuar më sipër nga Bashkia Kavajë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu III, pika 35 dhe Kreu II, pika 16, neni 37, pika 1, Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

**Gjatë vitin 2023**, nuk është regjistruar asnjë pronë dhe janë në proces regjistrimi **76 prona**.

Të dhënat për pronat sipas fushës së përdorimit dhe informacionit mbi regjistrimin e tyre paraqiten në tabelat e mëposhtme për Bashkinë Kavajë dhe për njësitë Administrative:

*Tabela mbi numrin e pronave të Bashkisë Kavajë*

Nr.	Lloji i pronës	Prona në inventarë	Prona të regjistruara	Prona në proces regjistrimi	Prona të pa regjistruara
1	Administratë	1	1		0
2	Arsim	11			11
3	Shëndetësi	7			7
4	Kulturë sport	6			6
5	Toka produktive	3			3
6	Truall	45		8	18
7	Shesh +Shërbime Publike	81		4	69
8	Rep Ushtarak	64		1	41
9	Rrugë dhe Trotuare	296		4	285
10	Vendstrehime	14			14

Nr.	Lloji i pronës	Prona në inventarë	Prona të regjistruara	Prona në proces regjistrimi	Prona të pa regjistruara
11	Magazina	6		6	6
12	Rezerva Shtetërore	33			33
13	Kanale	8			8
14	Kabinë Elektrike	67	1		66
15	Banesa Sociale	48	48		
	<b>TOTALI</b>	<b>690</b>	<b>106</b>	<b>23</b>	<b>567</b>

Burimi: Drejtoria Kadastrës dhe e Menaxhimit të Aseteve Publike

*Tabela mbi numrin e pronave, Njësia Administrative Golem*

Nr.	Lloji i pronës	Prona në inventarë	Prona të regjistruara	Prona në proces regjistrimi	Prona të pa regjistruara
1	Administratë	2			2
2	Arsim	14			14
3	Shëndetësi	10			10
4	Kulturë sport	3			3
5	Shërbime funerale	10	2		8
6	Infrastrukturë	628	1		627
7	Toka produktive	25	11	12	2
8	Depo uji	2			2
9	Kanalizime	14			14
10	Toka pa frute	9	17	8	
11	Stalla	1			1
12	Pyje	14	24	3	
13	Vaska	21			21
14	Kampi fushor I mbrojtjes	2			2
15	Kabina Elektrike	10			10
16	Përrua	8			8
	<b>TOTALI</b>	<b>773</b>	<b>55</b>	<b>23</b>	<b>724</b>

Burimi: Drejtoria Kadastrës dhe e Menaxhimit të Aseteve Publike

Shënim: Pyjet janë në total 14 parcela të regjistruar brenda këtyre parcelave janë 24 pasuri

Shënim: Tokat pa frute janë në hedhur në totalin e VKM dhe të regjistruara 15 pasuri

*Tabela mbi numrin e pronave, Njësia Administrative Luz i Vogël*

Nr.	Lloji i pronës	Pronat në inventarë	Prona të regjistruara	Prona në proces regjistrimi	Prona të pa regjistruara
1	Administratë	6			6
2	Arsim	8		1	7
3	Shëndetësi	5			5
4	Kulturë sport	1			1
5	Shërbime funerale	6			6
6	Infrastrukturë	354		1	353
7	Toka produktive	9		4	
8	Sistemi ujitës	22			22
9	Kanalizime				
10	Toka pa frute	4	2		
11	Ambulanca	5			5
12	Vend sthime	7			7
	<b>TOTALI</b>	<b>427</b>	<b>2</b>	<b>6</b>	<b>412</b>

Burimi: Drejtoria Kadastrës dhe e Menaxhimit të Aseteve Publike

Shënim: Tokat pa frute janë në hedhur në totalin e VKM me sipërfaqe në hektarë dhe të regjistruara janë 2 pasuri

Tabela mbi numrin e pronave, Njësia Administrative Synej

Nr.	Lloji i pronës	Prona në inventarë	Prona të regjistruara	Prona në proces regjistrimi	Prona të pa regjistruara
1	Administratë	5			5
2	Arsim	7			7
3	Shëndetësi	7			7
4	Kulturë sport	3			3
5	Shërbime funerale	18			18
6	Infrastrukturë	365			365
7	Toka produktive	15	4	3	
8	Sistemi ujitës	29			29
9	Depo Uji	2			2
10	Vaska	5			5
11	Përrua	9			9
12	Toka pa frute	11	3		
13	Ekonomi pyjore	57	2	1	
14	Truall	45	4		41
15	Rrjet elektrik	6			6
<b>TOTALI</b>		<b>584</b>	<b>13</b>	<b>4</b>	<b>497</b>

Burimi: Drejtoria Kadastrës dhe e Menaxhimit të Aseteve Publike

**Shënim:** Tokat pa frute janë hedhur në totalin e VKM me sipërfaqe në hektarë dhe të regjistruara janë 5 pasuri.

Tabela mbi numrin e pronave, Njësia Helmas

Nr.	Lloji I pronës	Prona në inventarë	Prona të regjistruara	Prona në proces regjistrimi	Prona të pa regjistruara
1	Administratë	1			1
2	Arsim	12			12
3	Shëndetësi	4			4
4	Shërbime funerale	15			15
5	Infrastrukturë	337	1		336
6	Toka produktive	43	22	18	
7	Ujësjellës Kanalizime	1			
8	Truall	160	2	1	158
9	Vendstrehime	9			
10	Rezervuare	6		1	5
11	Pyje	56			56
12	Sisteme Ujitje	41			41
13	Përrua	17			17
<b>TOTALI</b>		<b>702</b>	<b>25</b>	<b>20</b>	<b>645</b>

Burimi: Drejtoria Kadastrës dhe e Menaxhimit të Aseteve Publike.

**Shënim:** Tokat pa frute janë në hedhur në totalin e VKM me sipërfaqe në hektarë dhe të regjistruara janë 22 pasuri.

Nga komunikimi me subjektin pretendohet se problematikat e mos regjistrimit janë të natyrave të ndryshme. Pjesa më e madhe e këtyre praktikave ka vonesa në trajtim nga ana e ASHK-së Kavajë, sipërfaqe të konsiderueshme të pronës është e pa azhurnuar, ka diferencë dokument-fakt (sipërfaqja e inventarit e miratuar-me terrenin), ka mbivendosje të pronave.

Një pengesë tjetër në regjistrimin e pasurive shtetërore nga ana e bashkisë pretendohet të jetë **tarifa e regjistrimit**, e cila sjell kosto për buxhetin e bashkisë. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve rezulton se, për vitin 2023, planifikimi i bërë për regjistrimin e pasurive ishte në vlerën **200,000 lekë** dhe janë shpenzuar vetëm **45,000 lekë**, ku

rezulton se bashkia nuk ka shpenzuar as vlerën e parashikuar në buxhet për të kryer regjistrimin e pasurive.

Nga komunikimi me subjektin konstatohet se nuk është ngritur një grup punë që do të ndjekë zbatimin e këtyre VKM si edhe regjistrimin e pronave në ASHK në kundërshtim me VKM nr.1563, datë 26.11.2008 pika 2; VKM nr.45, datë 19.01.2011; VKM nr.4, datë 06.01.2011; VKM nr. 5, datë 06.01.2013; VKM nr. 370, datë 30.01.2013

**Për sa konstatuar më sipër mbajnë përgjegjësi: z. R.K** , në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kavajë (për periudhën 01.01.2023-15.06.2023); **z. F.Q** , në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kavajë (për periudhën 15.06.2023-31.12.2023); **z. A.T** , në cilësinë e NZ (për periudhën 01.01.2023-23.06.2023); **zj. F.GJ** , në cilësinë e NZ (për periudhën 23.06.2023-31.12.2023); **z. J.K** në cilësinë e ish Drejtorit të Kadastrës Urbane, Menaxhimit të Aseteve Publike (për periudhën 01.01.2023-19.07.2023); **zj. A.S** në cilësinë e Drejtorit të Kadastrës Urbane, Menaxhimit të Aseteve Publike (për periudhën 19.07.2023-31.12.2023).

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu III, pika 35 dhe Kreu II, pika 16, neni 37, pika 1, Ligji nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30,

## **Pika 2.4 e programit. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.**

### **2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrimit të prokurimeve.**

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendimit të Këshillit Bashkiak.

	<b>Objekt i prokuruar</b>	<b>Operatori fitues</b>	<b>Kontrata nr. datë</b>	<b>Vlera Fituese pa Tvsh</b>
1	Rindërtimi i kopshtit dhe cerdhes në fshatin Golem (Program i Rindertimit)	BOE I Shpk & Ll Shpk & V Shpk	Nr 1389/4 Dt 01.06.2023	208,606,804
2	Blerje asfalti	RR Sh.a	Nr 234/4 Dt 31.03.2023	29.100.000
3	Rehabilitimi i sinjalistikës së qytetit	“R ” Shpk	Nr 402/5 Dt 05.04.2023	12.254.000
4	Rikonstruksion i kopështit Hap pas Hapi	“G ” Shpk	Nr 43/3 Dt 09.02.2023	56,500,000
5	Rindërtimi i kopsht cerdhe në fshatin Luz i Vogël (Program Rindërtimi)	“N ” Shpk & M Shpk	Nr 14/2 Dt 23.01.2023	106.820.677
6	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare Bago (Programi i Rindertimit)-Rishpallje Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit	BOE G Shpk & E Shpk	Nr 12/2 Date 20.01.2023	189.879.050
7	Rindërtimi i godinës së Ish-Prefekturës	BOE LL Shpk & E Shpk & E Shpk	Nr 13/2 Date 23.01.2023	166.955.696,7
				770,116,227.7

### **2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.**

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Kavajë (regjistri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve) si dhe të dhënave nga Sistemi i Prokurimit Elektronik të APP-së për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten si më poshtë:

**2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.**

Për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, janë realizuar **në total 7** procedura prokurimi me vlerë të lartë, me fond limit në shumën **777,424,405** lekë pa Tvsh dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën **770,116,227.70** lekë pa Tvsh, nga të cilat janë audituar të **7** procedura ose në masë **99 %** të fondit limit.

Procedurat e prokurimit me vlerë të lartë të audituara për periudhën nga data **01.01.2023, deri më 31.12.2023**, paraqiten si më poshtë:

**1. Procedura e prokurimit me objekt: “Rindërtimi i kopsht çerdhe në fshatin Golem”, Bashkia Kavajë.**

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rindërtimi i kopsht çerdhe në fshatin Golem”, Bashkia Kavajë viti 2023.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 87 e nr. 1389 prot., datë 05.04.2023	<b>2. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Nr. 87, datë 05.04.2023	<b>3. Komisioni Vlerësimi Ofertave-</b> Urdhër nr. 109 e nr. 1736 prot., datë 04.05.2023
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E Kufizuar”	1. E.A (Personi përgjegjës), (Jurist) 2. M.D (Arkitekt) 3. H.S (Ekonomist)	1. G.K (Kryetar)-Jurist 2. A.M (Ekonomist) 3. D.H (Ekonomist)
<b>5. Fondi Limit</b> 208,808,602 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> BOE “I ” Shpk & “LL ” Shpk & “V ” Shpk, vlera e ofertës 208,606,804 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 201,798 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 04.05.2023	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i Shtetit (referuar VKM nr. 493 datë 21.07.2022)	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. BOE “I ” Shpk & “LL ” Shpk & “V ” Shpk 2. OE “SH ” Shpk,
<b>11. Ankimime AK:</b> Nuk KA	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.</b>
<b>b. Kontrata nr. 1389/4 prot., prev 01.06.2023</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> 01.06.2023	<b>15. Vlera e kontratës</b>	<b>208,606,804</b>

*- Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit publik, me oponencës teknike të hartuar bazuar në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.*

Referuar shkresës të Institutit të Ndërtimit nr. 479/2 prot., datë 10.05.2023 “Dërgim oponente teknike” (me nr. 888/2 prot., datë 26.05.2023 në bashkinë Kavajë), në vijim të kërkesës për kryerjen e oponencës teknike nga AK me nr. 888 prot., datë 27.02.2023, konstatohet që: Midis dy institucioneve është nënshkruar një marrëveshje me nr. 4791 prot., datë 16.12.2020 ku tarifa e shërbimit për kryerjen e oponencës teknike është 207,529 lekë me Tvsh.

Nga auditimi në faqen zyrtare të Ministrisë dhe Mjedisit u konstatua që: z. GJ.L i mungon certifikata e ekspertit dhe licenca për kryerjen e veprimtarive me ndikim në mjedis lëshuar nga QKB (ose ish QKL).

AK Bashkia Kavajë, ka nisur procedurën e prokurimit pa u realizuar Oponenca Teknike.

(Procedura e prokurimit ka filluar më datë 05.04.2023, kurse oponenca teknike është protokolluar në bashki në datë 26.05.2023).

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis i hartuar nga OE “C ” Shpk, nuk është në përputhje me ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, pasi raporti duhet



të hartohet dhe të firmoset nga persona të certifikuar dhe të licencuar nga Ministria e Mjedisit. OE “C ” Shpk, i mungon certifikata e ekspertit dhe licenca për kryerjen e veprimtarive me ndikim në mjedis lëshuar nga QKB (ose ish QKL).

Raporti VNM i paraqitur nga OE, (i pa plotësuar sipas rekomandimeve të oponentëve) nuk është në përputhje me: ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe VKM nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore”.

Referuar VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponentëve teknike për projektet e veprave të ndërtimit”

3. Të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponentëve teknike. Oponentët teknike është pjesë e dokumentacionit teknik të projektit.

Nga Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavajë, nuk duhej të zhvillohej procedura e prokurimit publik, referuar neneve 6, 9 e 15, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, ligjit nr. 10440, datë 7.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ligji nr. 10431 datë 10.03.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore” dhe Urdhrin e Ministrit nr. 197, datë 09.10.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponentëve teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.

- Në hartimin e kriterëve për zhvillimin e procedurës së prokurimit për ndërtimin e ujësjellësit, janë konstatuar kriterë jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e saj.

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 neni 21 e nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

**1. Në pikën 2.3.2 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të jenë të pajisur me licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të kategorive NP 1 - A; NP 2 - D; NP 7 - A; NP 11 - A; NP 12 - A; NS 1 - A; NS 2 - A; NS 4 - B; NS 8 - A; NS 12 - B; NS 14 - A; NS 18 - A; NS 20 - A”.**

**2. Në pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet:**

1. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune, diplomë, certifikatë të lëshuar nga ISHTI/ekuivalente, librezë pune, CV për 1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier elektrik, 1 (një) inxhinier hidroteknik, 1 (një) inxhinier mjedisi, 1 (një) inxhinier mekanik, 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet/markshajder dhe 1 (një) inxhinier gjeolog/gjeoteknik. Staf i mësipërm, duhet të jetë i listuar në listë pagesat e OE gjatë periudhës Janar – Mars 2023 si dhe të figurojë në licencën e shoqërisë. Kur oferta paraqitet nga një BOE, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar/ certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) ekspert që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën

e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

3. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për **1 (një) ekspert për ndihmën e parë** dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

**3. Në pikën 2.3.3/4 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë të lëshuar nga ISHTI /ekuivalente për 2 (dy) teknikë ndërtimi, 4 (katër) muratorë/suvatues, 4 (katër) karpentirë, 4 (katër) hekurkthyes, 3 (tre) bojaxhi, 3 (tre) elektrikistë, 2 (dy) saldator, 2 (dy) mekanik, 2 (dy) hidraulikë, 2 (dy) specialistë për bashkim tubash dhe instalime të materialeve PE, 2 (dy) pllakashtrues, 3 (tre) hidroizolues, 2 (dy) persona të pajisur me certifikatën për punimet në lartësi.

Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në listë pagesat e OE të paktën gjatë gjatë periudhës Janar – Mars 2023. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe leje drejtimi përkatëse për 5 (pesë) manovratorë/eskavatoristë dhe 10 (dhjetë) shoferë”.

**4. Në pikën 2.3.5 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht 100 (njëqind e dhjetë) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, shoferë, manovratorë, stafi teknik) për periudhën Janar – Mars 2023, i lëshuar nga Administrata Tatimore.

- Listëpagesat për periudhën Janar – Mars 2023, sipas formatit të miratuar nga Administrata Tatimore”.

**5. Në pikën 2.3.6 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht, mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën janë 4 (katër) kamionë me kapacitet mbajtës  $\geq 15$  ton; 3 (tre) kamionë/kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 5 ton; 1 (një) autovinc; 2 (dy) eskavator; 1 (një) fadromë; 1 (një) rul me vibrim; **1 (një) grejder**; 2 (dy) mini eskavator/minifadroma; 2 (dy) autobetoniere; 1 (një) autopompë/presë betoni; 1 (një) autobotë uji; **1 (një) vinq kullë ose autovinq me krah horizontal mbi 30 ml (shoqëruar me skedë teknike)**; 1 (një) rimorkiator për levizjen e mjeteve që nuk lëvizin vetë në rrugë; 2 (dy) pompë suvatimi; 2 (dy) vibrator thellë sie; 2 (dy) elektroorgano; 1 (një) gjenerator; 1 (një) elektropompë; 1 (një) helikopter për nivelim/lucidim; 1 (një) pajisje për ngjitje tubash; 2 (dy) betoniere 500 litër; 1 (një) pajisje topografike GPS/Total Station; 1500 (një mijë e pesëqind) m<sup>2</sup> skelë inventar.

Referuar punimeve të përfshira në preventiv, rezulton se kërkesat për: **1 (një) grejder; 1 (një) vinc kullë ose autovinc me krah horizontal mbi 30 ml (shoqëruar me skede teknike); 1 (një) rimorkiator për levizjen e mjeteve që nuk lëvizin vetë në rrugë;** nuk janë të domosdoshëm për realizimin e kontratës.

Për sa trajtuar më sipër, kriteret: **2.3.3/4, 2.3.5, dhe 2.3.6**, nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish për arsye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës.

**6. Në pikën 2.3.8 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “OE, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e

*cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:*

- 1. ISO 9001 (Standard për sistemin e menaxhimit të cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.*
- 2. ISO 14001 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente e vlefshme.*
- 3. ISO 45001 (Standard për menaxhimin e rreziqeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë)/ekuivalente dhe e vlefshme.*
- 4. ISO 50001 (Standard për menaxhimin e menaxhimit të energjisë)/ekuivalente dhe e vlefshme. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”.*

**7. Në pikën 2.3.9 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore kodi III.2.B për grumbullim dhe transportimin e mbetjeve jo të rrezikshme, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirë argumentuar dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë e ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: *E.A , znj. M.D dhe z. J.H /znoj. H.S në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.*

#### **Zhvillimi i procedurës.**

Në dosje nuk gjenden; “deklaratat e konfliktit të interes” të nënshkruar nga Komisionin i Vlerësimit të Ofertave, veprim që bie ndesh me nenet: 15 - pika 2; 73 - pika 4; 80- 2, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; nenin 19 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; nenin 21 të ligjit nr .9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** Tiullari i AK, personi përgjegjës dhe KVO.

Me nr. 1389/1 prot., datë 23.04.2023 Njoftimi i kontratës, kohëzgjata e realizimit të punimeve 10 (dhjetë) muaj. Me shkresën nr. 1389/2 prot., datë 10.05.2023 “Ftesë për ofertë” Titullari i AK Bashkia i është drejtuar: OE “I ” Shpk, OE “LL ” Shpk e OE “V ” Shpk. Më datë 16.05.2023, është hartuar “Raporti Pjesor për fazën e parë parakualifikimi”, hartuar nga KVO, miratuar nga Titullari i AK.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE/BOE pjesëmarrës, paraqitur në SPE prë këtë procedurë KVO doli ka konstatuar që kanë marrë pjesë:

**1. OE “SH ” Shpk,** është kualifikua pasi i plotësonte të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike.

**2. BOE “I ” Shpk & “LL ” Shpk & “V ” Shpk,** është kualifikuar pasi i plotësonte të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike.

**3. BOE “B ” Shpk & “P ” Shpk,** është skualifikuan pasi nuk përmbushën kriteret e DT.

Me procesverbalin e datës 19.05.2023 “Mbi pranimin e ofertave të operatorëve ekonomikë” KVO ka konstatuar se kanë paraqitur dokumentacionin dy OE/BOE, janë futar të jenë të pranishëm në hapjen e ofertave dhe vlerësimin e procedurës.

Pocesverbalin është nënshkruar nga KVO dhe i BOE “LL ” Shpk & “E ” Shpk & “E ” Shpk dhe OE “SH , të dy pjesëmarrësit janë kualifikuar.

**Kanë qenë pjesëmarrës në fazën tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

**1. BOE “I ” Shpk & “LL ” Shpk & “V ” Shpk** (me Nipt-e respektive L...D & K...K & K...L) me vlerë ekonomike të ofertës **208,606,804** (*dyqind e tetë milion e gjashtëqind e gjashtë mijë e tetëqind e katër*) **lekë**.

**2. OE “SH ” Shpk** (me Nipt J...T), me vlerë ekonomike të ofertës **208,795,210** (*dyqind e tetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e dhjetë*) **lekë**.

**Nuk ka operatorë ekonomik të skualifikuar.**

Sipas procesverbali të datë 09.01.2023, për fazën e II u kualifikuan të dy pjesëmarrësit. Nga vlerësimi i dokumentacionit tekniko ligjor dhe ekonomik ka rezultuar që: BOE “LL ” Shpk & “E ” Shpk & “E ” Shpk është fitues me 97 pikë nga 100 të mundshme. Formulari i njoftimit të fituesit me nr. 1389/3 prot., datë 25.05.2023.

Në dosje e prokurimit mungon Raporti Përmbledhës dhe miratimi i raportit përmbledhës nga Titullari i AK, veprim që nuk është në përputhje me nenin 99, të ligjit nr. 162, datë 23.12.202 “Për prokurimi publik” dhe neni 73, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 1389/4 prot., datë 01.06.20223, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kavajë, të përfaqësuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor z. R.K . dhe BOE “I ” Shpk & “LL ” Shpk & “V ” Shpk, me përfaqësues respektiv administratorët: z. A.T , z. A.LL e z. G.J.B , krijuar me kontratën e bashkëpunimit nr. 3955 rep., nr. 2053 kol., datë 31.05.2023, përfaqësuar me prokurën e posaçme nr. 3956 rep., nr. 2054 kol., datë 31.05.2023 me objekt: “Rindërtimi i kopsht çerdhe në fshatin Golem”, Bashkia Kavajë, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **208,606,804** (*dyqind e tetë milion e gjashtëqind e gjashtë mijë e tetëqind e katër*) **lekë**.

Formulari i njoftimit të publikimit të kontratës së nënshkruar fituesit me nr. 1389/5 prot., datë 01.06.2023, botuar në Buletin e Posaçëm.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues, BOE I ” Shpk & “LL ” Shpk & “V ” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, si dhe me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “I ” Shpk & “LL ” Shpk & “V ” Shpk, rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Referuar kontratës së bashkëpunimit nr. 3955 rep., nr. 2053 kol., datë 31.05.2023, palët kanë marrë përsipër që volume i punimeve të ndahet midis tyre:

1. OE “I ” Shpk me 12.0 %;
2. “LL ” Shpk me 41.0 %
3. “V ” Shpk me 47.0%

OE “I ” Shpk është përfaqësuesi i BOE, përfaqësuar me prokurën e posaçme nr. 3956 rep., nr. 2054 kol., datë 31.05.2023 me objekt: “Rindërtimi i kopsht çerdhe në fshatin Golem”, Bashkia Kavajë.

**OE “I ” Shpk**, referuar transaksioneve ne ëeb-in zyrtar të “Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit”, ka realizuar punime në territorin e bashkive: Tiranë

**OE “I ” Shpk, ka paraqitur për mjete:**

Kontratata e Qerasë me nr. 3163 rep., nr. 1693 kol., datë 03.05.2023, e lidhur me OE “E ” Shpk, për marrjen me qera të mjetit: Autobot Uji – Mercedes Benz; Targa AB7110EH; Leje Qarkullimi TRD02667621; Certifikata me nr. 237, datë 10.09.2022 “Për transport mallrash Brenda vendit për llogari të vet., lëshuar nga Bashkia Dimal

**Në dosje e DT nuk gjenden vërtetime për pagimine taksave dhe tarifve vendore**

**OE “V ” Shpk:** referuar transaksioneve ne ëeb-in zyrtar të “Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit”, ka realizuar punime në territorin e bashkive: **Tiranë; Gramsh; Librazhd, Elbasan**

Ka paraqitur vërtetimin me nr. V-779/1 prot., datë 14.02.2023, nga Bashkia Tiranë, ku vërtetohet që ka shlyer detyrimet për taksat/tarifat vendore.

Ka paraqitur vërtetimin e datës 10.01.2023, nga Bashkia Gramsh ku vërtetohet që ka shlyer detyrimet për taksat/tarifat vendore.

Ka paraqitur vërtetimin nr. 4588 prot., datës 13.10.2022, nga Bashkia Librazhd ku vërtetohet që ka shlyer detyrimet për taksat/tarifat vendore.

#### **Nuk ka paraqitur vërtetim për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Elbasan.**

Kontratata e Qerasë me nr. 1328 rep., nr. 825/1 kol., datë 13.04.2019, e lidhur me OE “V ” Shpk, për marrjen me qera të mjetin për realizimin e objektit të kontratës:

1. Vinç Kullë (I përdorur shoqëruar me gjithë pjesët dhe aksesoret) shoqëruar me Urdhër Zhdoganimi (Fatura nr. 2011 M42154) dhe Deklaratat doganore (R35111, R35090, R35105, R35120, datë 18.07.2011), bashkangjitur një foto e pjesëve të vinçit të çmontuar (gjë që bën të pamundur vlerësimin nëse i plotëson karakteristikat teknike të kërkuara në DT). Mungon skeda teknike.

**OE. “LL ” Shpk** referuar transaksioneve në ëeb-in zyrtar të “Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit”, ka realizuar punime në territorin e bashkive; **Tiranë; Lushnje; Fier; Krujë; Skrapar;**

**Në dosje e DT nuk gjenden vërtetime për pagimin e taksave dhe tarifave vendore, sa më sipër është në kundërshtim me paragrafin e fundit në Kriteret e veçanta të kualifikimit në DT ku citohet:** “OE, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM 285 datë 19.05.2021.

*Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara*

*Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.*

Për sa trajtuar më sipër BOE “I ” Shpk & “LL ” Shpk & “V ” Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor të shpallte fitues BOE “I ” Shpk & “LL ” Shpk & “V ” Shpk, por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Mos disponimi, apo mosparaqitja e dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE “I ” Shpk & “LL ” Shpk & “V ” Shpk, dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “I ” Shpk & “LL ” Shpk & “V ” Shpk, Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kritere jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të BOE “I ” Shpk & “LL ” Shpk & “V ” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të shpallte fitues OE “SH ” Shpk nëse plotëson të gjitha kriteret e DT, nëse jo, të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektiv të fondit për vlerën **208,606,804 lekë.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. R.K Kryetar i Bashkisë Kavajë në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, z. E.A , znj. M.D , z. J.H e znj. H.S në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. G.K , z. A.M , z. D.H në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

## 2. Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje Asfalti”, Bashkia Kavajë.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Asfalti”, viti 2023.		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 14 e nr. 234 prot., datë 13.01.2023	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Nr. 234 prot., datë 13.01.2023	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> nr. 19 e nr. 324 prot., datë 20.01.2023
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “Marrëveshje Kuadër”	1. E.A (Jurist) 2. M.D (Arkitekt) 3. J.H (Ing.)	1. G.K (Kryetar)-Jurist 2. A.M (Ekonomist) 3. D.A (Ekonomist)
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 39,905,800 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> OE “RR ” Sha, vlera e ofertës 29,100,000 lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 10,805,800 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 03.02.2023	<b>9. Burimi Financimit:</b> Të ardhurat Buxheti i Bashkisë \	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. OE “RR ” Shpk 2. OE “B ” Shpk, 3. OE “A ” Shpk 4. BOE “B ” Shpk & “A ” Sha 5. OE “V ” Shpk 6. “SH ” Shpk 7. OE “S ” Shpk
<b>11. Ankimime AK:</b> Nuk KA	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.</b>
<b>b. Kontrata nr. 234/4 prot., datë 31.03.2023</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 31.03.2023</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>34,920,000</b>

-Në hartimin e kriterëve për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje Asfalti”, Bashkia Kavajë janë konstatuar kriterë jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e saj.

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 neni 21e nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

**1. Në pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit.

Konkretisht, për të përmbushur këtë, OE, duhet kenë 1 (një) fabrikë asfalti, e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi III.1.B dhe të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për sistemin e menaxhimit të cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme. Në rastin kur, OE kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet gjithashtu edhe kontrata e vlefshme e qirasë apo e furnizimit.

**2. Në pikën 2.3.4 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “OE, për të vërtetuar se mallrat, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

**2. ISO 14001 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente e vlefshme.** Objekti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përshkruhet në nenin 3 të Direktivës nr. 85/377/CEE: “VNM individualizon, përshkruan dhe vlerëson, në mënyrë specifike, për secilin rast në veçanti efektet direkte dhe indirekte të një projekti mbi faktorët e mëposhtëm: njeriu, fauna, flora; toka, ajri, klima dhe peisazhi; ndërveprimin midis faktorëve të mësipërm dhe të mirave materiale dhe pasurisë kulturore “.

Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirë argumentuar dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë e

ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: E.A , znj. M.D dhe z. J.H në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.**

**- Zhvillimi i procedurës.**

Në dosjen e prokurimit mungojnë formularët e deklaramit të mospasjes së konfliktit të interesit të formular/nënshkruar nga Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Me shkresën nr. 758 prot., datë 21.02.2023, KVO, drejtuar OE B ” Shpk; me shkresën nr. 758/1 prot., datë 21.02.2023; drejtuar OE “RR ” Sha; me shkresën nr. 758/2 prot., datë 21.02.2023, drejtuar OE “A ” Shpk, mbështetur në nenin 82/2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ka kërkuar nga OE “RR ” Sha, informacion shtesë dhe dokumentacion mbështetës sipas përcaktimeve në pikën 2.3 të Kapacitetit Teknik në DT (dërguar në SPE më datë 21.02.2023).

OE “RR ” Sha; me shkresën nr. 20 prot., datë 23.02.2023 (në Bashkinë Kavajë me nr. 821/1 prot., datë 24.02.2023) “Kthim përgjigje” ka dërgura bashkangjitur shkresën elektronikisht dhe në rrugë postare gjithë dokumentacionin mbështetës.

KVO-ja ka hartuar/nënshkruar Raportin Përmbledhës më datë 08.03.2023, ku është përshkruar gjithë procedura e vlerësimit të ofertave dhe dokumentacioni i paraqitur në SPE.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE “RR ” Sha, (me Nipt J...O), me vlerë ekonomike të ofertës 29,100,000 (*njëzet e nëntë milion e njëqind mijë*) lekë pa Tvsh.

2. OE “B ” Shpk, (Nipt K...T) me vlerë ekonomike të ofertës 30,070,000 (*tridhjetë milion e shtatëdhjetë mijë*) lekë pa Tvsh

3. OE “A ” Shpk, (Nipt K...A) me vlerë ekonomike të ofertës 31,816,000 (*tridhjetë e një milion e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë*) lekë pa Tvsh.

4. BOE “B ” Shpk & “A ” Sha, (Nipt K...G me vlerë ekonomike të ofertës 32,980,000 (*tridhjetë e dy milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë*) lekë pa Tvsh.

5. OE “V ” Shpk, (Nipt J...S) me vlerë ekonomike të ofertës 32,980,000 (*tridhjetë e dy milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë*) lekë pa Tvsh.

6. OE “SH ” Shpk, (Nipt K...Ë) me vlerë ekonomike të ofertës 36,860,000 (*tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë*) lekë pa tvsh

7. OE “S ” Shpk, (Nipt K...H) me vlerë ekonomike të ofertës 38,800,000 (*tridhjetë e tetë milion e tetëqind*) lekë pa Tvsh

Nu ka OE/BOE ofertues të skualifikuar.

Kontrata me OE “RR ” Sha, fitues nr. 234/4 prot., datë 31.03.2023. Vlera totale përfundimtare e kontratës: **34,920,000** (*tridhjetë e katër milion e nëntëqindë e njëzetë mijë*) **lekë me Tvsh.** Me nr. 234/3 prot., datë 12.04.2023, Formulari i publikimit të njoftimit të kontratës së nënshkruar.

Lidhur me OE “RR ” Sha, rezulton se OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

**- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues, OE “RR ” Sha, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, si dhe me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.** Nga auditimi i dokumentacionit të OE “RR ” Sha OE “RR ” Sha, të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

**1. OE nuk plotëson pikën 2.3.2 të Kapacitetit Teknik në DT: “Për të provuar kapacitetet teknike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën.**

*Konkretisht, mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën janë 4 (katër) kamionë me kapacitet mbajtës ≥ 15 ton dhe 2 (dy) kamionë me kapacitet mbajtës ≥10 ton”.*

- Mjeti Mercedes Benz 41-46 me: Leje qarkullimi nr. ELD0820419 Targë AA495YM. Ka Certifikatë me nr.0000007537, datë 09.09.2021 Për transport ndërkombëtar mallrash për llogari të vetë, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Elbasan.
  - Mjeti Mercedes Benz 41-46 me: Leje qarkullimi nr. ELD0820419 Targa AA495YM. Ka Certifikatë me nr.0000007537, datë 09.09.2021 Për transport ndërkombëtar mallrash për llogari të vetë, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Elbasan.
  - Mjeti Volvo F12-420 me: Leje qarkullimi nr. ELD0855219 Targa AA943VB. Ka Certifikatë me nr.0000007535, datë 09.09.2021 Për transport ndërkombëtar mallrash për llogari të vetë, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Elbasan.
  - Mjeti Daimler Chrysler 4143 me: Leje qarkullimi nr. ELD0625519 Targa AA758MA. Ka Certifikatë me nr.0000007534, datë 09.09.2021 Për transport ndërkombëtar mallrash për llogari të vetë, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Elbasan.
  - Mjeti Daf-D85X me: Leje qarkullimi nr. ELF0695819 Targa EL2084C. Kontrata e qerasë nr. 552 Rep., nr. 351 Kol., datë 01.02.2023, lidhur me OE “B ” Shpk, me Certifikatë nr. 136/2, datë 09.09.2022 Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet.
- Ka Certifikatë me nr. 02, datë 10.01.2020 Për transport ndërkombëtar mallrash për llogari të vetë, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Elbasan.
- Mjeti Iveco Magirus Starlis 430 me: Leje qarkullimi nr. ELD0948516 Targa AA836HJ. kamionë me kapacitet mbajtës 14.3 ton (26000-11700, nuk është vetshkarkues). Ka Certifikatë me nr. 02, datë 10.01.2020 Për transport ndërkombëtar mallrash për llogari të vetë, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Elbasan.

**OE nuk plotëson** shlyerjen e taksave, tarifave dhe detyrimeve vendore për vitin 2021 pasi nuk ka sjellë vërtetim për pagesën e tarifave vendore në bashkitë: Elbasan, Tiranë e Selenicë ku ka zhvilluar veprimtarinë e tij.

Në Bashkinë Selenicë OE “RR ” Sha është nënkontraktor i OE “T ” Shpk për objektin: “Rikonstruksioni i rrugës ura e Gjormit – Ura e e Leskos Brataj” Bashkia Selenicë.

Për sa trajtuar më sipër OE “RR ” Sha OE “RR ” Sha, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor të shpallte fitues OE “RR ” Sha, por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Mos disponimi, apo mosparaqitja e dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE “RR ” Sha, dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “RR ” Sha. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kritere jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të OE “RR ” Sha, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **31,816,000 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. R.K Kryetar i Bashkisë Kavajë në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, znj. M.D , z. J.H e znj. H.S në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. G.K , z. A.M , z. D.H në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.



### 3. Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i kopështit Hap pas Hap”, Bashkia Kavajë.

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i kopshtëtit Hap pas Hapi”, Bashkia Kavajë viti 2022.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 237 e nr. 2350 prot., datë 21.06.2022	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Nr. 2350 prot., datë 021.06.2022	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> nr. 246 e nr. 2524 prot., datë 05.07.2022
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E Kufizuar”	1. E.A (Jurist) 2. M.D (Arkitekt) 3. H.S (Ekonomiste.)	1. G.K (Kryetar)-Jurist 2. A.M (Ekonomist) 3. G.T (Arkitekt)
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 56,544,778 lekë	<b>6. Oferta fituese: Anuluar</b>	<b>7. Diferenca me fondin limit</b>
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 11.07.2022 ora 10:00	<b>9. Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e Bashkisë.	<b>10. OE Pjesëmarrës</b>
<b>11. Ankimime AK: Nuk KA</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.</b>

#### - Hartimi i dokumenteve të tenderit:

Më datë 21.06.2023 z. E.A (Përgjegjës i Prokurimeve Publike) z. J.H (Ing. Specialist në Sektorin e Prokurimeve Publike) e znj. M.D (Juriste në Sektorin e Prokurimeve Publike), kanë formuluar/nënshkruar formularët e deklarimit të mospasjes së konfliktit të interes. Në urdhërin e prokurimit është znj. H.S dhe jo z. J.H .

Njësia e Prokurimit ka hartuar Procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim. Bashkangjitur DT me REF-34663-06-28 -2022.

Njoftimi i Kontratës me nr. 2350/1 prot., datë 28.06.2022.

Me shkresën nr. 2350/2 prot., datë 12.10.2022 “Formulari i njoftimit të anulimit”, ku citohet që arsyet e anulimit: *Bazuar në ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 98, pika 1 gërma “a” në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme dhe neni në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 65 pika 3,4. Konsultuar me APP për rastet kur në procedurat me faza dhe marrëveshje kuadër me disa OE, është paraqitur vetëm një OE.*

Në dosje e procedurës së prokurimit nuk gjendet asnjë dokumentacion (gjurëm auditimi), që të pasqyrojë zhvillimin e procedurës deri në hartimin e formularit të anulimit.

**Veprimi i mësipërm nuk është në përputhje me nenin 2 të VKM nr 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sa më sipër mban përgjegjësi, Personi Përgjegjës dhe titullari i AK.**

<b>a/1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i kopshtëtit Hap pas Hapi”, Bashkia Kavajë viti 2022.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 237 e nr. 2350 prot., datë 21.06.2022	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Nr. 2350 prot., datë 021.06.2022	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> nr. 246/1 e nr. 2524/1 prot., datë 20.10.2022
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E Kufizuar”	1. E.A (Jurist) 2. M.D (Arkitekt) 3. H.S (Ing.)	1. G.K (Kryetar)-Jurist 2. D.H (Ekonomist) 3. A.M (Jurist)
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 56,544,778 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> OE “G ” Shpk, vlere e ofertës 56,500,000 lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 44,778 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 24.10.2022 ora 10:00	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i Shtetit (referuar VKM nr. 26 datë 20.01.2021)	<b>10. OE Pjesëmarrës</b>
<b>11. Ankimime AK: Nuk KA</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.</b>
<b>b. Kontrata nr. 434/3 prot., prev 09.02.2023</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 09.02.2023</b>	<b>15. Vlora e kontratës (me tvsh)</b>	<b>56,500,000</b>

- Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit publik, me oponencës teknike të hartuar bazuar në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

Raporti Paraprak i Vlerësimit në Mjedis është realizuar nga Ing. F.V , konstatohet që: Referuar shkresës të Institutit të Ndërtimit nr. 1862/2 prot., datë 22.11.2021 “Dërgim oponente teknike”, në vijim të kërkesës për kryerjen e oponentës teknike nga AK me nr. 3325 prot., datë 28.10.2021, konstatohet që: Midis dy institucioneve është nënshkruar një marrëveshje me nr. 1862/1 prot., ku tarifa e shërbimit për kryerjen e oponentës teknike është 104,042 (*njëqind e katër mijë e dyzetë e dy*) lekë me Tvsh.

Është dorëzuar Raporti i VNM hartuar nga Ing. F.V me nr. 5010 Certificate, datë 04.07.2013. Raporti është dorëzuar në nënyrë elektronike, dhe nuk është sigluar nga hartuesi i VNM-së mungon bashkangjitur raportit Licenca për kryerjen e veprimtarive me ndikim në mjedis lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

*Në mbështetje të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, projektet të cilat përfshihen në shtojcën 2 të këtij ligji (ku bën pjesë dhe projekti në fjalë) i nënshtrohen procedurës Paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.*

Referuar informacionit të dhënë në Raport janë dhënë:

***Në përfundim të Grupi i Oponentës ka konkluduar se: Projekti duhet të plotësohet me konkluzionet dhe rekomandimet e dhëna në oponentë teknike, para zbatimit të punimeve. Në fakt është zhvilluar procedura e prokurimit pa u plotësura mangësitë e konstatuara.***

Nga auditimi në faqen zyrtare të Ministrisë dhe Mjedisit u konstatua që: Ing. F.V i mungon certifikata e ekspertit dhe licenca për kryerjen e veprimtarive me ndikim në mjedis lëshuar nga QKB (ose ish QKL).

Në oponentën teknike (Institutit të Ndërtimit)

AK Bashkia Kavajë, ka nisur procedurën e prokurimit pa u realizuar Oponenta Teknike.

(Procedura e prokurimit ka filluar më datë 05.04.2023, kurse oponenta teknike është protokolluar në bashki në datë 26.05.2023).

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis i hartuar nga OE “I” Shpk, nuk është në përputhje me ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, pasi raporti duhet të hartohet dhe të firmoset nga persona të certifikuar dhe të licencuar nga Ministria e Mjedisit. OE “I” Shpk, i mungon certifikata e ekspertit dhe licenca për kryerjen e veprimtarive me ndikim në mjedis lëshuar nga QKB (ose ish QKL).

Raporti VNM i paraqitur nga OE, (i pa plotësuar sipas rekomandimeve të oponentës) nuk është në përputhje me: ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe VKM nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.

Referuar VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponentës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”

***3. Të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponentës teknike. Oponenta teknike është pjesë e dokumentacionit teknik të projektit.***

Nga AK Bashkia Kavajë, nuk duhej të zhvillohej procedura e prokurimit publik, referuar neneve 6, 9 e 15, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, ligjit nr. 10440, datë 7.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ligji nr. 10431, datë 10.03.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në RSH”, VKM nr. 686. datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore” dhe Urdhrin e Ministrit nr. 197, datë 09.10.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponentës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.

**Për shkelje të ligjshmërisë në kryerjen e oponentës teknike të projektit të zbatimit, ngarkohet me përgjegjësi, Projektuesi dhe Kryetari i Bashkisë.**

- Në hartimin e kriterëve për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i kopështit Hap pas Hap”, Bashkia Kavajë janë konstatuar kriterë jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e saj.

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 neni 21 e nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

**1. Në pikën 2.3.2 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të jenë të pajisur me licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të kategorive NP 1 - A; NP 3 - B; NP 4 - A; NP 7 - A; NP 12 - A; NS 1 - A; NS 2 - A; NS 4 - A; NS 12 - A; NS 14 - A; NS 18 - A”.

**2. Në pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet:

1. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune, diplomë, certifikatë të lëshuar nga ISHTI/ekuivalente, librezë pune, CV për 1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier elektronik, 1 (një) inxhinier elektrik, 1 (një) inxhinier hidroteknik, **1 (një) inxhinier mjedisi, 1 (një) inxhinier mekanik, 1 (një) inxhinier topograf/markshajder dhe 1 (një) inxhinier gjeolog/gjeoteknik.**

Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e OE gjatë periudhës Korrik - Shtator 2022 si dhe të figurojë në licensën e shoqërisë. Kur oferta paraqitet nga një BOE, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për **1 (një) ekspert që përmbush** kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM. nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

**3. Në pikën 2.3.3/4 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë të lëshuar nga ISHT dhe Industrial/ekuivalente për 2 (dy) teknikë ndërtimi/specialist ndërtimi, 3 (tre) elektriciistë, 3 (tre) hidraulikë, 5 (pesë) muratorë/suvatues, 2 (dy) karpentierë, 2 (dy) hekurkthyes, 2 (dy) persona të pajisur me certifikatën për punimet në lartësi.

Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në listëpagesat e operatorit ekonomik të paktën gjatë gjatë periudhës Korrik - Shtator 2022. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe leje drejtimi përkatëse për 3 (tre) manovratorë/eskavatoristë dhe 10 (dhjetë) shoferë.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**4. Në pikën 2.3.4 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme, urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe CV për një mjek të përgjithshëm”.

**5. Në pikën 2.3.5 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet OE duhet të paraqesin:

□ Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht 45 (dyzet e pesë) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, shoferë, manovratorë, stafë teknik) për periudhën Korrik - Shtator 2022, i lëshuar nga Administrata Tatimore.

□ Listëpagesat për periudhën Korrik - Shtator 2022, sipas formatit të miratuar nga Administrata Tatimore.

Kur oferta paraqitet nga një BOE, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, OE duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mësipër duhet të paraqitet pranë AK para lidhjes së marrëveshjes kuadër.

**6. Në pikën 2.3.6 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht, mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën janë 3 (tre) kamion vetëshkarkues, me kapacitet mbajtës  $\geq 10$  ton, 3 (tre) kamion/kamionçinë, me kapacitet mbajtës 1 – 7.5 ton, 1 (një) kamion me vinc, me kapacitet mbajtës  $\geq 5$  ton, 1 (një) ekskavator, 1 (një) fadrome, 1 (një) vinc kullë ose autovinc me krahhorizontal mbi 40 ml (shoqëruar me skedë teknike), 1 (një) autobetoniere, 1 (një) autopompë betoni, 1 (një) autobot uji, 1 (një) rimorkiator, 2 (dy) pompë suvatimi, 2 (dy) vibrator betoni, skelë inventar  $\geq 1,000$  m<sup>2</sup> dhe panele armaturë betonimi  $\geq 100$  m<sup>2</sup>.

Për sa trajtuar më sipër, kriteret: 2.3.3/4, 2.3.5, dhe 2.3.6, nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht për asrye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës.

**7. Në pikën 2.3.7 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të garantojnë furnizimin me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit.

Konkretisht për:

1. OE, duhet kenë 1 (një) fabrikë betoni, e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi III.1.B dhe të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për sistemin e menaxhimit të cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme. Në rastin kur, OE kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet gjithashtu edhe kontrata e vlefshme e qirasë apo e furnizimit.

2. OE, duhet kenë 1 (një) fabrikë për prodhimin e inerteve, e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi III.1.B dhe të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për sistemin e menaxhimit të cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme. Në rastin kur, OE kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet gjithashtu edhe kontrata e vlefshme e qirasë apo e furnizimit.

3. OE për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin kontratë/marrëveshje të vlefshme me një laborator, për testimin dhe analizat e betonit, i akredituar nga ana e Drejtorisë së Akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga RSH.

**8. Në pikën 2.3.8 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “OE, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

**2. ISO 14001 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente e vlefshme.**

**Konkluzion:** Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr.

162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. E.A , znj. M.D dhe znj. H.S në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

Me shkresën nr. 2350/4 prot., datë 10.11.2022 “Ftesa për ofertë” i është dërguar:

1. OE “K ” Shpk
2. OE “G ” Shpk
3. BOE “K ” Shpk, & “B . B” Shpk

- **Zhvillimi i Procedurs.**

Formularët e deklaramentit të mospasjes së konfliktit të interesit janë formuluar/nënshkruar në datë 24.10.2022, nga Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Festa për ofertë me nr. 2350/4 prot., datë 10.11.2022, dërguar: **OE “G ” Shpk; OE “K ” Shpk e BOE “B . B” Shpk & “K ” Shpk**

Lista e OE/BOE të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. OE “K ” Shpk
2. OE “G ” Shpk
3. BOE K Shpk “B . B” Shpk.

Referuar Formulari i njoftimit të fituesit me nr. 43 prot., datë 05.01.2023, kanë qenë pjesëmarrës në fazën tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE “K ” Shpk (me Nipt K...Ë), me vlerë ekonomike të ofertës **56,500,000** (*pesëdhjetë e gjashtë million e pesëqind mijë*) lekë.
2. OE “G ” Shpk, (me Nipt K...Ë), me vlerë ekonomike të ofertës 56,500,000 (*pesëdhjetë e gjashtë 93rocedu e pesëqind mijë*) lekë.
3. BOE “K Shpk” & “B . B” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 55,513,353 (*pesëdhjetë e million e pesëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e tre*) lekë.

**Është skualifikuar OE “K ” Shpk**, për arsye se është paraqitur në këtë procedurë me dy oferta ekonomike, manualisht është paraqitur oferta me vlerë 56,500,000 (*pesëdhjetë e gjashtë million e pesëqind mijë*) lekë dhe në SPE oferta ekonomike me vlerë 44,104,758 (*dyzet e katër million e njëqind e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë*) lekë. Bazuar në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 79 pika 4 në të cilin thuhet “OE duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative.” Oferta e paraqitur refuzohet.

Referuar procedurës së lartpërmendur, është informuar **BOE “K Shpk” & “B . B” Shpk**, me përfagësues **BOE “K Shpk”** se oferta e me vlerë 55,513,353 (*pesëdhjetë e pesë million e pesëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e tre*) lekë dhe e vlerësuar me 97 (*nëntëdhjetë e shtatë*) pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me shkresën nr. 43 prot., datë 05.01.2023 “Dërgimi i formularit të njoftimit të fituesit” drejtuar APP, është dërguar “Formularit i njoftimit të fituesit” nënshkruar nga zv. Kryetari G.K (në mungesë dhe me urdhër të Titullarit).

**Në dosjen e Prokurimit mungon dokumentacioni ligjor** (procesverbalet, Raporti Përmbledhës) që pasqyron veprimtarinë e KVO, nga ftesa për ofertë deri në shpalljen e fituesit (BOE K Shpk & “B . B” Shpk).

Në përgjigje të shkresës me nr. 43 prot., datë 05.01.2023, AK, me anë të së cilës AK Bashkia Kavajë ka dërguar për publikim në APP, “Formularin e Njoftimit të Fituesit” në formë shkresore dhe elektronike (CD përkatëse), për procedurën e kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, me 94roced: “Rikonstruksion i kopështit Hap pas Hapi”, me shkresën nr. 157/1 prot., datë 12.01.2023 (me nr. 43/1 prot., datë16.01.2023 në Bashkinë Kavajë), znj. R.K, Drejtor I Përgjithshëm I APP) me anë të së cilës sqaron se: “APP nuk e publikoi informacionin e sjellë, pasi OE “B . B” Shpk, I shpallur fitues nga ana juaj, është I përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike duke filluar nga data 09.12.2022 deri më 09.05.2023”.

Përsa më sipër duhet të risillni informacionet në APP, duke iu referuar dispozitave ligjore, në formë të shkruar dhe elektronike (CD), formë e kërkuar nga dispozitat nënligjore në fuqi mbi Buletinin e Njoftimeve Publike.

Me shkresën nr. 43/2 prot., datë 26.01.2023 “Dërgimi i formularit të njoftimit të fituesit” drejtuar APP, është dërguar “Formularit i njoftimit të fituesit” nënshkruar nga zv. Kryetari G.K (në mungesë dhe me urdhër të Titullarit), bashkangjitu, me nr. 42/2 prot “Formulari i njoftimit të fituesit”, (konceptuar nga z. E.A , nënshkruar nga z. R.K ).

Lista e OE/BOE të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

**1. OE “K ” Shpk**

**2. OE “G ” Shpk**

**3. BOE K Shpk “B . B” Shpk.**

Referuar Formulari i njoftimit të fituesit me nr. 43/2 prot., datë 26.01.2023, kanë qenë pjesëmarrës në fazen tjetër të 94rocedure94 së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. OE “K ” Shpk** (me Nipt K...Ë), me vlerë ekonomike të ofertës **44,104,758** (dyzet e katër million e njëqind e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë.

**2. OE “G ” Shpk**, (me Nipt K...Ë), me vlerë ekonomike të ofertës **56,500,000** (pesëdhjetë e gjashtë milion pesëqind mijë) lekë.

**3. BOE “K Shpk” & “B . B” Shpk**, me vlerë ekonomike të ofertës **55,513,353** (pesëdhjetë e pesë million e pesëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e tre) lekë.

**Janë Skualifikuar:**

**1. OE “K ” Shpk**, Për arsye se është paraqitur në këtë procedurë me dy oferta ekonomike, manualisht është paraqitur oferta me vlerë 56,500,000 (pesëdhjetë e gjashtë million e pesëqind mijë) lekë dhe në SPE oferta ekonomike me vlerë 44,104,758 (dyzet e katër million e njëqind e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë. Bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 79 pika 4 në të cilin thuhet “OE duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative” Oferta e paraqitur refuzohet.

**2. BOE K Shpk “B . B” Shpk** bazuar në shkresën nr. 157/1 prot., datë 12.01.2023 të APP (me nr. 43/1 prot., datë16.01.2023 në Bashkinë Kavajë) ku citohet që: OE “B . B Shpk është i përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike nga data 09.12.2022 deri më 09.05.2023, për sa më sipër oferta e paraqitur refuzohet.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, është nformuar OE “G ” Shpk se oferta e paraqitur, me vlerë 56,500,000 (pesëdhjetë e gjashtë million e pesëqind mijë) lekë dhe e vlerësuar me 95 (nëntëdhjetë e pesë) pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

**Në dosjen e Prokurimit mungon dokumentacioni ligjor që pasqyron veprimtarinë e KVO, nga ftesa për ofertë deri në shpalljen e fituesit (OE “G ” Shpk).**

Formulari i njoftimit të fituesit, botuar në buletin e posaçëm nr. 11, datë 31 janar 2023 të APP.

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 43/3 prot., datë 09.02.2023, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kavajë, të përfaqësuar nga Titullari i AK z. R.K dhe OE “G ” Shpk me përfaqësues administratoren znj. J.B z. me objekt: “Rikonstruksioni i kopshtit Hapa

pas Hapi”, Bashkia Kavajë, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo document të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **56,500,000** (dyqind e tetë milion e gjashtëqind e gjashtë mijë e tetëqind e katër) lekë.

*- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues, OE “G” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, si dhe me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.*

Nga auditimi i dokumentacionit të OE “G ” Shpk, të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

Nuk plotëson pikën 2.2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar në DT:

**OE “G ” Shpk**, gjatë viti 2022, referuar transaksioneve në Eëb-in zyrtar të “Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit”, ka realizuar punime në territorin e bashkive: Tiranë, Kavajë, Mallakastër dhe ka paraqitur:

- Vërtetimin me nr. 2291/1 prot., datë 28.04.2022, nga Bashkia Mallakastër, ku vërtetohet që ka bërë pagesën e taksave dhe tarifave për vitin 2022.

- Vërtetimin elektronik, datë 13.12.2022, nga Bashkia Tiranë, ku vërtetohet që ka likuiduar detyrimet tatimore.

- Vërtetimin me nr. 19741 prot., datë 15.12.2022, nga Bashkia Lezhë, ku vërtetohet që nuk ka detyrime të pa likuiduar.

**OE “G ” nuk plotëson** shlyerjen e taksave, tarifave dhe detyrimeve vendore për vitin 2022 pasi nuk ka sjellë vërtetim për pagesën e tarifave vendore në bashkitë: Kavajë e Fier ku ka zhvilluar veprimtarinë e tij.

**OE “G ” Shpk**, nuk plotëson kërkesën r pikën 2.3.6 të Kapacitetit Teknik, në DT (për mjetet): ***Për Vinç kullë ose autovinç me krah horizontal mbi 40 ml (shoqëruar me skede teknike); sipas faturës tatimore të shitjes nr. 12/B, datë 19.04.2000, nuk është i shoqëruar me skedë teknike*** OE

Kontrata e qiraje nr. 2352 rep., nr. 878 kol., datë 28.10.2020, lidhur me PF B.B , për mjetin: Kamion; Targa AA124KE, ka Certifikatë nr. 42, datë 13.06.2022 “Për transport mallrash Brenda vendit për llogari të vet” lëshuar nag Bashkia Mallakastër.

Kontrata e qiraje nr. 1335 rep., nr. 515 kol., datë 29.04.2022, lidhur me PF M.U, për mjetin: Kamionçinë; Targa AA309AT, nuk janë paraqitur fotot e mjetit.

Kontrata e qiraje nr. 692 rep., nr. 278 kol., datë 15.03.2022, lidhur me PF S.M, për mjetin: Kamion vinç; Targa MK4485A, ka Certifikatë nr. 88, datë 13.10.2022 “Për transport mallrash Brenda vendit për llogari të vet” lëshuar nga Bashkia Mallakastër.

Kontrata e qiraje nr. 2951 rep., nr. 1055 kol., datë 01.09.2020, lidhur me OE “A ” Shpk, për mjetet:

1. Autobetoniere Man; Targa AA258VU, ka Certifikatë nr. 9741, datë 21.10.2022 “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet” lëshuar nag DRTRR Fier.

2. Autobetoniere Mercedes Benz; Targa AA251VU, ka Certifikatë nr. 9743, datë 21.10.2022 “Për transport mallrash Brenda vendit për llogari të vet” lëshuar nag DRTRR Fier.

3. Autopompë betoni Man; Targa AA801CJ, ka Certifikatë nr. 9742, datë 13.06.2022 “Për transport mallrash Brenda vendit për llogari të vet” lëshuar nag DRTRR Fier.

Kontrata e qiraje nr. 2951 rep., nr. 1055 kol., datë 01.09.2020, lidhur me PF SH.A, për mjetin: Autobeto uji; Targa AA306OY, nuk ka Certifikatë për transport mallrash.

Kontrata e qiraje nr. 2351 rep., nr. 877 kol., datë 18.10.2020, lidhur me PF G.M, për mjetin: Kamion; Targa AB420AF, ka Certifikatë nr. 36, datë 16.11.2021 “Për transport mallrash Brenda vendit për llogari të vet” lëshuar nga Bashkia Korçë.

Për sa trajtuar më sipër OE “G ” Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO dhe Titullari i AK të shpallte fitues OE “G ” Shpk, por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Mos disponimi, apo mosparaqitja e dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE “G ” Shpk, dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “G ” Shpk. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direct ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të OE “G ” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **56,500,000 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. R.K Kryetar i Bashkisë Kavajë në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, z. E.A , z. J.H e znj. H.S në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. G.K , z. A.M , z. D.H në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

#### 4. Procedura e prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i sinjalistikës së qytetit”, Bashkia Kavajë.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i sinjalistikës së qytetit”, viti 2023.		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 30 e nr. 402 prot., datë 126.01.2023	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Nr. 234 prot., datë 13.01.2023	<b>3. Komision Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> nr. 42 e nr. 734 prot., datë 20.02.2023
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E Hapur”	1. E.A (Jurist) 2. M.D (Arkitekt) 3. J.H (Ing.)	1. G.K (Kryetar)-Jurist 2. A.M (Ekonomist) 3. D.A (Ekonomist)
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 16,344,112 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> OE “R ”, vlera e ofertës 12,254,000 lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 4,090,112_llekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 03.03.2023	<b>9. Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e Bashkisë.	<b>10. OE</b> 1. OE “R. S. & M” Shpk 2. OE “R ” Shpk 3. OE “S ” Shpk 4. OE “Z ” Shpk
<b>11. Ankimime AK: Nuk KA</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.</b>
<b>b. Kontrata nr. 234/4 prot., datë 31.03.2023</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 31.03.2023</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>14,704,800</b>

#### - Ankesa për DT:

Me nr. 402/2 prot., datë 02.03.2023, Shtojca “Mbi ndryshimin e dokumentave të tenderit”, në bazë nenit 75 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, ku citohet: “*Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bjë ndryshime në dokumentet e tenderit pëmes hartimit të një shtojce.*”, për procedurën e prokurimit publik me objekt: “Rehabilitimi i sinjalistikës se qytetit” me REF-59215-02-15-2023 i parashikuar të zhvillohej më datë 03.03.2023 Ora: 10:00.



- Në hartimin e kriterëve për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i sinjalistikës së qytetit”, Bashkia Kavajë janë konstatuar kriterë jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e saj.

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 neni 21e nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

**1. Në pikën 2.3.2 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OEduhet të jenë të pajisur me licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të kategorive:

**NP - 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.**

**NS - 6 A Sinjalistike Rrugore jo ndriçuese.**

**NS - 18 A Punime topogjeodezike**

**2. Në pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OEduhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet:

1. OEduhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune, diplomë, librezë pune, CV për **1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier mekanik dhe 1 (një) inxhinier topograf/markshajder**. Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Nëntor 2022 - Janar 2023 si dhe të figurojë në licensën e shoqërisë. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2. OEduhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/

licencuar/certifikuar shqiptar ose i huaj për **1 (një) ekspert që** përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve.

3. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhedëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për **1 (një) ekspert për ndihmën e parë** dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 “Per sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

**3. Në pikën 2.3.4 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet OE duhet të paraqesin:

Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht 20 (njëzet) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, shoferë, manovratorë, stafi teknik) për periudhën Nëntor 2022 - Janar 2023, i lëshuar nga Administrata Tatimore.

Listëpagesat për periudhën Nëntor 2022 - Janar 2023, sipas formatit të miratuar nga Administrata Tatimore.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, OE, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021.

**4. Në pikën 2.3.6 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “OE, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

1. ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.

2. ISO 14001 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente e vlefshme.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. E.A , znj. M.D dhe z. J.H në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

- **Zhvillimi i procedurës.**

Në dosjen e prokurimit mungojnë formularët e deklarimit të mospasjes së konfliktit të 98rocedur të formuluar/nënshkruar nga Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Në dosje nuk gjenden; “Raportin Përmbledhës” të nënshkruar nga Komisionin i Vlerësimit të Ofertave, dhe miratimi nga Titullari i AK veprim që bie ndesh me nenin 99, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; nenin 84 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Tiullari I AK, personi përgjegjës dhe KVO.**

Kanë qenë pjesëmarrës në 98rocedure këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE “R. S. & M” Shpk, (Nipt K...I) vlerë ekonomike të ofertës **13,214,000 lekë pa Tvsh.**

2. OE “R ” Shpk, (Nipt) vlerë ekonomike të ofertës **12,254,000 lekë pa Tvsh.**

3. OE “S ” Shpk, (Nipt L...U) vlerë ekonomike të ofertës **12,585,610 lekë pa Tvsh**

4. OE “Z ” Shpk, (Nipt L...O) vlerë ekonomike të ofertës **13,750,200 lekë pa Tvsh**

**Nuk ka OE/BOE ofertues të skualifikuar.**

Formulari i njoftimit përfundimtar të fituesit me nr. 402/4 prot., datë 04.04.2023.

Kontrata me nr. 402/5 prot., datë 05.04.2023, e lidhur ndërmjet AK, Bashkia Kavajë e përfaqësuar nga Titullari z. R.K dhe OE “R ” Shpk, fitues përfaqësuar nga Administratori z. A.K . Vlera totale përfundimtare e kontratës: **14,704,800 (katërmëdhjetë million e shtatëqindë e katër mijë e tetëqind) lekë me Tvsh.**

Me nr. 234/3 prot., 98roc 12.04.2023, Formulari I publikimit të njoftimit të kontratës së nënshkruar.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues, OE “R ” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, si dhe me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE “R ” Shpk, të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

Nga auditimi i dokumentacionit të OE “R ” Shpk, të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

**OE nuk plotëson** nuk plotëson pikën 2.2.3 të Kapacitetit ekonomik dhe financiar në DT, *për shlyerjen e taksave, tarifave dhe detyrimeve vendore për 2022, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë dhe ku ka zhvilluar apo zhvillon veprimtarinë e tij” pasi ka paraqitur:*

1. Vërtetimin me nr. 273 prot., datë 10.05.2022, nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Pogradec, ku vërtetohet që nuk ka detyrime, në bazë të akt marrëveshjes nr. 213 prot., datë 15.04.2022, për pagesë me këste të detyrimeve të vitit 2022 pranë Bashkisë Pogradec.

2. Vërtetimin me nr. 14100 prot., datë 14.04.2022, nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Tiranë.

**OE nuk plotëson** shlyerjen e taksave, tarifave dhe detyrimeve vendore për vitin 2022 pasi nuk ka sjellë vërtetim për pagesën e tarifave vendore në bashkinë: Lezhë ku ka zhvilluar veprimtarinë e tij.

**OE “R ” Shpk,** nuk plotëson pikën 2.3.3/1 të Kapacitetit Teknik në DT. *“OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune, diplomë, librezë pune, CV për 1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier mekanik dhe 1 (një) inxhinier topograf/markshajder. Staf i mësipërm, duhet të jetë i listuar në listëpagesat e OE gjatë periudhës Nëntor 2022 – Janar*

2023 si dhe te figurojë në licensën e shoqërisë. Kur oferta paraqitet nga një BOE, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”. Pasi **z. R.B**, inxhinier mekanik nuk figuron të jetë në Listëpagesat e OE gjatë periudhës Nëntor 2022 – Janar 2023

**OE “R” Shpk**, nuk plotëson pikën 2.3.6 të Kapacitetit Teknik në DT “OE, për të vërtetuar se punët, object prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga RSH. Konkretisht:

Për sa trajtuar më sipër OE “R” Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO dhe Titullari i AK të shpallte fitues OE “R” Shpk, por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT. Mos disponimi, apo mosparaqitja e dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE “R” Shpk, dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “R” Shpk. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen në procedurë, si dhe në shpalljen fitues të OE “R” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **12,254,000 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. R.K Kryetar I Bashkisë Kavajë në cilësinë e titullarit të AK, znj. M.D, z. J.H e z. E.A në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. G.K, z. A.M, z. D.H në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

## 5. Procedura e prokurimit me objekt: “Rindërtimi i kopsht çerdhe në fshatin Luz i Vogël”, Bashkia Kavajë.

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rindërtimi i kopsht çerdhe në fshatin Luz i Vogël”, Bashkia Kavajë viti 2023.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 408 e nr. 4141 prot., 99roc 02.12.2022	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Nr. 4141 prot., 99roc 02.12.2022	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> nr. 109 e nr. 1736 prot., 99roc 04.05.2023
<b>4. Lloji I Procedurës së Prokurimit:</b> “E Kufizuar” (në kuadër të procesit të rindërtimit)	1. E.A (Jurist) 2. M.D (Juristt) 3. H.S (Ekonomiste)	1. G.K (Kryetar)-Jurist 2. A.M (Jurist) 3. D.H (Jurist)
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 107,000,000 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> BOE “N” Shpk & “M” Shpk, vlera e ofertës <b>106,820,677</b> lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 179,323 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 27.12.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti I Shtetit (VKM nr. 493 datë 21.07.2022)	<b>10. OE</b> 1. BOE “I” Shpk & “LL” Shpk & “V” Shpk 2. OE “SH” Shpk,
<b>11. Ankimime AK: Nuk KA</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.</b>
<b>b. Kontrata nr. 14/2 prot., 23.01.2023</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> 23.01.2023	<b>15. Vlera e kontratës</b>	<b>106,820,677</b>

- **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Me shkresën nr. 4141/1 prot., datë 15.12.2022, “Njoftimi I kontratës” afati kohor për dorëzimin e ofertave më 100roc 27.12.2022; Ora 10:00.

Më 100roc 27.12.2022 z. E.A (Përgjegjës i Prokurimeve Publike) z. J.H (Ing. Specialist në Sektorin e Prokurimeve Publike) e znj. M.D (Juriste në Sektorin e Prokurimeve Publike), kanë formuluar/nënshkruar formularët e deklarimit të mospasjes së konfliktit të interes. Në urdhërin e prokurimit është znj. H.S dhe jo z. J.H .

NjP ka hartuar Procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim. Bashkangjitur Dokumentet e Tenderit me REF-34663-06-28 -2022.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike**, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Kavajë, z. R.K .

*- Në hartimin e kriterëve për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Rindërtimi i kopsht çerdhe në fshatin Luz i Vogël”, Bashkia Kavajë janë konstatuar kriterë jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e saj.*

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 neni 21e nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi I dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

**1. Në pikën 2.3.2 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, Oduhet të jenë të pajisur me licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, 100roced I kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të kategorive NP 1 – A; NP 2 – C; NP 7 – A; NP 12 – A; NS 1 – A; NS 2 – A; NS 3 – A; NS 4 – A; NS 8 – A; NS 12 – A; NS 14 – A; NS 18 – A.

**2. Në pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet:

1. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune, diplomë, certifikatë të lëshuar nga ISHTI/ ekuivalente, librezë pune, CV për 1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier elektrik, 1 (një) inxhinier hidroteknik, 1 (një) inxhinier mjedisi, 1 (një) inxhinier mekanik, 1 (një) inxhinier topograf dhe 1 (një) inxhinier gjeolog/gjeoteknik.

Stafi i mësipërm, duhet te jetë i listuar në Listëpagesat e OE gjatë periudhës Gusht – Tetor 2022 si dhe te figurojë në licensën e shoqërisë. Kur oferta paraqitet nga një BOE, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune, diplomë, certifikatë të lëshuar nga ISHTI/ekuivalente, librezë pune, CV për 1 (një) inxhinier mekatronik.

3. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar/certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) ekspert që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në pune” dhe VKM. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

**3. Në pikën 2.3.3/5 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë të lëshuar nga ISHTI/ekuivalente për 2 (dy) teknike ndërtimi, 4 (katër) muratorë/suvatues, 2 (dy) karpentirë, 2 (dy) hekurkthyes, 2 (dy)

bojaxhi, 2 (dy) elektrikistë, 2 (dy) saldator, 1 (një) mekanik, 2 (dy) hidraulikë, 2 (dy) pllakashtrues, 1 (një) hidroizolues.

Stafi i mësipërm, duhet te jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik të paktën gjatë gjatë periudhës Gusht – Tetor 2022. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe leje drejtimi përkatëse për 5 (pesë) manovratorë/eskavatoristë dhe 10 (dhjetë) shoferë.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”.

**4. Në pikën 2.3.4 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme, urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe CV për një mjek të përgjithshëm”.

**5. Në pikën 2.3.5 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet OE duhet të paraqesin:

Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht (përfshirë në këtë numër punëtorë, shoferë, manovratorë, stafi teknik) për periudhën Gusht – Tetor 2022, i lëshuar nga Administrata Tatimore.

Listëpagesat për periudhën Gusht – Tetor 2022, sipas formatit të miratuar nga Administrata Tatimore.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, OE duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mësipër duhet të paraqitet pranë AK para lidhjes së marrëveshjes kuadër”.

**6. Në pikën 2.3.6 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht, mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën janë 2 (dy) kamionë me kapacitet mbajtës  $\geq 15$  ton; 3 (tre) kamionë/kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 5 ton; 1 (një) autovinc; 2 (dy) eskavator; 1 (një) fadromë; 1 (një) rul me vibrim; 1 (një) grejder; 2 (dy) mini eskavator; 2 (dy) autobetoniere; 1 (një) autopompë/presë betoni; 1 (një) autobotë uji; **1 (një) vinç kullë ose autovinç me krah horizontal mbi 40 ml (shoqeruar me skede teknike); 1 (një) rimorkiator për levizjen e mjeteve që nuk lëvizin vetë në rrugë;** 2 (dy) pompë suvatimi; 2 (dy) vibrator thellesie; **2 (dy) elektroorgano;** 1 (një) gjenerator; 1 (një) elektropompë; 2 (dy) betoniere 500 liter; **1 (një) pajisje topografike GPS;** 1000 (një mijë) m<sup>2</sup> skelë inventar.

**7. Në pikën 2.3.7 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht për:

1. OE, duhet kenë 1 (një) fabrikë betoni, e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi III.1.B dhe të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme. Në rastin kur, OE kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet gjithashtu edhe kontrata e vlefshme e qirasë apo e furnizimit.

2. OE, duhet kenë 1 (një) fabrikë për prodhimin e inerteve, e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi III.1.B dhe të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme. Në rastin kur, OE kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet gjithashtu edhe kontrata e vlefshme e qirasë apo e furnizimit.

3. OE për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin kontratë/marrëveshje të vlefshme me një laborator, për testimin dhe analizat e

betonit, i akredituar nga ana e Drejtorisë së Akreditimit / organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë / ekuivalente.

**8. Në pikën 2.3.8 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “OE, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

**2. ISO 14001 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente e vlefshme.**

**9. Në pikën 2.3.9 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “OE duhet të jete te pajisur me leje mjedisore kodi III.2.B për grumbullim dhe transportimin e mbetjeve jo te rrezikshme, lëshuar nga QKL. OE, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirë argumentuar dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë e ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: E.A , znj. M.D dhe znj. H.S në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.**

#### - Zhvillimi i procedurës.

Në dosjen e procedurës së prokurimit gjendet Formulari i deklarimit të mospasjes së konfliktit të interesit janë formular/nënshkruar në datë 27.12.2022, nga z. D.H , Anëtarë e KVO, mungojnë deklaratat e z. G.K e z. A.M

Festa për ofertë me nr. 14 prot., datë 0.11.2022, dërguar: BOE “N ” Shpk & OE “M ” Shpk e BOE “T ” Shpk & “SH ” Shpk.

Me procecoverbalin e datës 09.01.2023 “Mbi pranimin e ofertave të operatorëve ekonomikë”, KVO ka konstatuar se kanë paraqitur dokumentacionin dy OE/BOE, janë futar të jenë të pranishëm në hapjen e ofertave dhe vlerësimin e procedurës.

**Kanë qenë pjesëmarrës në fazen tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

**1. BOE “T ” Shpk & “SH ” Shpk,** (me Nipt-e respektive K...G & K...N) me vlerë ekonomike të ofertës 107,000,000 (njëqind milion) lekë

**2. BOE “N ” Shpk & “M ” Shpk,** (me Nipt-e respektive L...O & L...C) me vlerë ekonomike të ofertës 106,820,677 (njëqind million e tetëqind e njëzetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.

Janë verifikuar dhe u lexuar ofertat e paraqitura, Nga vlerësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor dhe ekonomik, ka rezultuar që BOE “N ” Shpk & OE “M ” Shpk, është fitues me pikë 97 nga 100 të mundëshme.

Me nr. 14/1 prot., datë 13.01.2023, Titullari i AK, ka nënshkruar “Formularin e njoftimit të fituesit botuar në Buletinin e posaçëm nr. 5, datë 17 janar 2023, në faqet 15-16/18.

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 14/2 prot., datë 23.01.2023, është lidhur mes AK, Bashkia Kavajë, të përfaqësuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor z. R.K . dhe BOE “N ” Shpk & “M ” Shpk, me përfaqësues respektiv z. H.H e z. E.B , krijuar me kontratën e bashkëpunimit nr. extra datë 12.12.2022, me prokuën e posaçme nr. 191 rep., nr. 64 kol., datë 23.01.2023 me objekt: “Rindërtimi i kopësht çerdhe në fshatin Luz i Vogël”, Bashkia Kavajë, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **106,820,677 (njëqind million e tetëqind e njëzetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.**

Me shkresën nr. 140/4 prot., datë 01.06.2023 “Kërkesë për arkivimin e procedurës së prokurimit” Titullari i AK Bashkia i është drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues, BOE “N ” Shpk & “M ” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, si dhe me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “N ” Shpk & “M ” Shpk, rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

**OE “N ” Shpk**, referuar transaksioneve ne ëeb-in zyrtar të “Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit”, ka realizuar punime në territorin e bashkive: **Laç, Fier, Krujë; Gjirokastrë, Durrës;** e ka paraqitur: **Vërtetimin** me nr. 1052 prot., datë 13.05 2022, nga Bashkia Tepelenë, ku vërtetohet që ka shlyer detyrimet financiare për vitin 2021 e 2022. Nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e e taksave vendore në bashkitë: Laç, Fier, Krujë; Gjirokastrë, Durrës.

**OE “M ” Shpk**, referuar transaksioneve ne ëeb-in zyrtar të “Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit”, ka realizuar punime në territorin e bashkive: **Durrës; Elbasan; Tiranë; Prrenjas; Korçë; Pogradec e Belsh,** dhe ka paraqitur:

Vërtetimin me nr. 351/1 prot., datë 26.04.2022, nga Bashkia Gramsh, ku vërtetohet që ka shlyer detyrimet financiare për vitin 2022.

Vërtetimin pa nr. prot., datë 14.07.2022, nga Bashkia Cërrik, ku vërtetohet që ka shlyer detyrimet financiare për vitin 2022.

**Nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e e taksave vendore në bashkitë:** Durrës; Elbasan; Tiranë; Prrenjas; Korçë; Pogradec e Belsh.

**OE “N ” Shpk, në lidhje me pajisje makineri ka paraqitur:**

Kontratën e qirasë me nr. **4526 rep., nr. 1325** kol., datë 18.11.2022, e lidhur me OE “A ” Shpk për mjetet:

Nga sa më sipër janë deklaruar në Shtojcën 13 mbi disponimin e mjeteve vetëm mjetet: Autobetoniere me Targa GJ1129B dhe Autopompë betoni Targa AA691JC

Kontratën e qirasë me nr. **4235 rep., nr. 1205** kol., datë 31.10.2022, e lidhur me OE “L ” Shpk për mjetin: Kamion Dailmer Chrysler (të deklaruar mbi 15 ton); Targa AA529PP, Leje qarkullimin DRD023141. Certifikata me nr. 131, datë 26.04.2022 “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet” lëshuar nga Bashkia Lushnje.

Kontrata e qirasë me nr. **5085 rep., nr. 1461** kol., (referuar vetëdeklarimit mbi disponimin e mjeteve – **nuk gjendet në dosjen e prokurimit**), ku janë deklaruar mjetet:

1. Kamionçinë (deri 5 ton) Targa AA657TY, Leje qarkullimin FRD0406818
2. Kamionçinë (deri 5 ton) Targa AA792NI, Leje qarkullimin FRD0185416
3. Fadromë AMGT04, Leje qarkullimin FRD056191
4. Autovinç AA647DA, Leje qarkullimin FRF0328112.

Në dosjen e prokurimit gjenden mjete në pronësi të OE “B ” Shpk, për të cilat nuk ka asnjë kontratë qiraje e nuk kuptohet pse janë pjesë e dokumentacionit të BOE të shpallur fituese në procedurë:

1. Kamioçinë ëolksvagen, Targa AA657TY, Leje qarkullimin FRD0406818.
2. Kamion me vinç, Targa, AA647DA, Leje qarkullimin FRF0328112, ka Certifikatë nr. 141, datë 04.11.2018 “Për transport ndërkombëtar mallrash për llogari të vet” lëshuar nga DRSHTRR Fier.
2. Fadromë- Caterpillar, Targa AGMT04, Leje qarkullimin FRD0561918.

Sa më sipër dokumentacioni për këto mjete është i pavlefshëm për procedurën e prokurimit

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kritere jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të BOE “N ” Shpk & “M ” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektiv të fondit për vlerën **106,820,677 lekë.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. R.K Kryetar i Bashkisë Kavajë në cilësinë e titullarit të AK, znj. M.D , z. E.A e znj. H.S në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. G.K , z. A.M , z. D.H në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

## **6. Procedura e prokurimit me objekt: “Rindërtimi i kopsht çerdhe në fshatin Golem”, Bashkia Kavajë.**

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i shkollë 9-vjeçare Bago”, Bashkia Kavajë viti 2023.</b>		
<b>1. Urdhër prokurimi</b> nr. 409 e nr. 4142 prot., date 02.12.2022	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Nr. 87 prot., date 05.04.2023	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> nr. 416 e nr. 4215 prot., ate 12.12.2022
<b>4. Lloji I Procedurës së Prokurimit:</b> “E Kufizuar”	1. E.A (Jurist) 2. M.D (Jurist) 3. H.S (Ekonomiste)	1. G.K (Kryetar)-Jurist 2. A.M (Jurist) 3. D.H (Jurisdt)
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 191,021,113 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> Anuluar	<b>7. Diferenca me fondin limit</b>
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b>	<b>9. Burimi Financimit: Buxheti I Shtetit</b> (referuar VKM nr. 240 datë 20.04.2022)	<b>10. OE</b> 1
<b>11. Ankimime AK: Nuk KA</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.</b>

### **- Në dosjen e prokurimit gjenden:**

Urdhër Prokurimi nr. 409 e nr. 4142 prot., datë 02.12.2022, ku citohet: Të kryhet prokurimi I fondit me vlerë 191,021,113 (*njëqind e nëntëdhjetë e një milion e njezet e një mijë e njëqind e trembëdhjetë*) lekë, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit me VKM me nr. 240, date 20.04.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare Bago, Bashkia Kavajë dhe caktimin e Bashkisë Kavajë si njësi zbatuese” për: Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Bago”

Bazuar në Ligjin nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 43, në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 48, në VKM me nr.199 datë 04.03.2020 dhe në Aktin Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore” procedura e prokurimit e përzgjedhur është Procedurë e Kufizuar (Procedura e përshpejtuar – Rindërtimi) Ngarkohet, për zbatimin e këtij urdhri, Njësia e Prokurimit e përbërë nga: 1. E.A , 2. M.D e 3. H.S.

Më datë 02.12.2022 z. E.A (Përgjegjës i Prokurimeve Publike) z. H.S (Ekonomiste, Specialist në Sektorin e Prokurimeve Publike) e znj. M.D (Juriste në Sektorin e Prokurimeve Publike), kanë formuluar/nënshkruar formularët e deklarimit të mospasjes së konfliktit të interes.

Urdhëri nr. 416 e nr. 4215 prot., datë 12.12.2022, (për krijimin e KVO), mëshetur në Ligjin 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 75, për emërimin e KVO të prokurimit publik me 104ate104d: “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Bago” që do të zhvillohet më 104ate 19.12.2022 ora 10:00, 1. G.K (Kryetar) 2. A.M (Anëtar) e 3. D.H (Anëtar). Komisioni I mësipërm të marrë masat menjëherë për fillimin e punës dhe të zbatojë detyrat me pavarësi të plotë.

Njësia e Prokurimit ka hartuar Procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim (pa datë e numër protokolli). Dokumententet e Tenderit janë nënshkruar nga anëtarët e NJP. (REF-52572-12-08-22),

- Në hartimin e kriterëve për zhvillimin e procedurës së prokurimit për ndërtimin e ujësjellësit, janë konstatuar kriterë jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e saj.



**Situata:** Në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 neni 21e nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

**1. Në pikën 2.3.2 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të jenë të pajisur me licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të kategorive NP 1 - A; NP 2 - B; NP 3 - C; NP 7 - A; NP 12 - A; NS 1 - A; NS 2 - A; NS 4 - B; NS 8 - A; NS 12 - B; NS 14 - A; NS 18 - A”.

**2. Në pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet:

1. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune, diplomë, certifikatë të lëshuar nga ISHTI /ekuivalente, librezë pune, CV për 1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier elektrik, 1 (një) inxhinier hidroteknik, 1 (një) inxhinier mjedisi, 1 (një) inxhinier mekanik, 1 (një) inxhinier topograf dhe 1 (një) inxhinier gjeolog/gjeoteknik.

Stafi i mësipërm, duhet te jetë i listuar në Listëpagesat e OE gjatë periudhës Gusht – Tetor 2022 si dhe te figurojë në licencën e shoqërisë. Kur oferta paraqitet nga një BOE, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) ekspert që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 “Per sigurinë dhe shëndetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

3. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

**3. Në pikën 2.3.3/4 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë të lëshuar nga ISHT dhe Industrial/ekuivalente për 3 (tre) teknikë ndërtimi, 4 (katër) muratorë/suvatues, 4 (katër) karpentirë, 4 (katër) hekurkthyes, 2 (dy) bojaxhi, 2 (dy) elektrikistë, 2 (dy) saldator, 1 (një) mekanik, 2 (dy) hidraulikë, 2 (dy) pllakashtrues, 2 (dy) hidroizolues, 2 (dy) persona të pajisur me certifikatën për punimet në lartësi.

Stafi i mësipërm, duhet te jetë i listuar në Listëpagesat e OE të paktën gjatë gjatë periudhës Gusht – Tetor 2022. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe leje drejtimi përkatëse për 5 (pesë) manovratorë/eskavatoristë dhe 10 (dhjetë) shoferë.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kërkesat për “Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në listëpagesat...”, nga të cilët: “5 (pesë) manovratorë/ eskavatoristë dhe 10 (dhjetë) shoferë” me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik lëshuar nga ISHTI, nuk është pjesë e kritereve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Aq më tepër që mjetet mund ti vihen në dispozicion (me qera) së bashku me manovratorët/shoferët.

**4. Në pikën 2.3.4 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme, urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe CV për një mjek të përgjithshëm”.

**5. Në pikën 2.3.5 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet OE duhet të paraqesin:

□ Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht 110 (njëqind e dhjetë) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, shoferë, manovratorë, stafi teknik) për periudhën Gusht – Tetor 2022, i lëshuar nga Administrata Tatimore.

□ Listëpagesat për periudhën Gusht – Tetor 2022, sipas formatit të miratuar nga Administrata Tatimore.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, OE duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mesipër duhet të paraqitet pranë AK para lidhjes së marrëveshjes kuadër”.

**6. Në pikën 2.3.6 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht, mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën janë 3 (tre) kamionë me kapacitet mbajtës ≥15 ton; 3 (tre) kamionë/kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 5 ton; 1 (një) autovinc; 2 (dy) eskavator; 1 (një) fadromë; **1 (një) rul me vibrim; 1 (një) grejder;** 2 (dy) mini eskavator; 2 (dy) autobetoniere; 1 (një) autopompë/presë betoni; 1 (një) autobotë uji; **1 (një) vinc kullë ose autovinc me krah horizontal mbi 40 ml (shoqeruar me skede teknike); 1 (një) rimorkiator për levizjen e mjeteve që nuk lëvizin vetë në rrugë;** 2 (dy) pompë suvatimi; 2 (dy) vibrator thellesie; **2 (dy) elektroorgano;** 1 (një) gjenerator; 1 (një) elektropompe; 2 (dy) betoniere 500 liter; 1 (një) pajisje topografike GPS; 1500 (një mijë e pesëqind) m<sup>2</sup> skelë inventar.

**7. Në pikën 2.3.7 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht për:

1. OE, duhet kenë 1 (një) fabrikë betoni, e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi III.1.B dhe të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për sistemin e menaxhimi të cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme. Në rastin kur, OE kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet gjithashtu edhe kontrata e vlefshme e qirasë apo e furnizimit.

2. OE, duhet kenë 1 (një) fabrikë për prodhimin e inerteve, e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi III.1.B dhe të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme. Në rastin kur, OE kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet gjithashtu edhe kontrata e vlefshme e qirasë apo e furnizimit.

3. OE për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin kontratë/marrëveshje të vlefshme me një laborator, për testimin dhe analizat e betonit, i akredituar nga ana e Drejtorisë së Akreditimit / organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë / ekuivalente.

**8. Në pikën 2.3.8 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “OE, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

1. ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.

2. ISO 14001 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente e vlefshme.

3. ISO 45001(Standard për manaxhimin e rreziqeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë) /ekuivalente dhe e vlefshme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**9. Në pikën 2.3.9 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “OE duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore kodit III.2.B për grumbullim dhe transportimin e mbetjeve jo të rrezikshme, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit. OE, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021”.

Kriteri për disponimin me leje mjedisore kodit III.2.B” për grumbullim dhe transportimin e mbetjeve jo të rrezikshme, lëshuar nga QKL, sjellë kufizim të panevojshëm, pasi operatorët ekonomik të cilët mund të disponojnë të gjitha kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme për zbatimin me sukses të punimeve nuk nevojitet kërkesa e sipërcituar.

**Konkluzion:** Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin OE për përmbushjen e këtyre kriterëve.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. E.A , znj. M.D dhe znj. H.S në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

- **Zhvillimi i procedurës.**

Ftesa për ofertë me nr. 12 prot., datë 04.01.2023 i është drejtuar BOE “G ” Shpk & “E ” Shpk dhe OE “SH ” Shpk.

Me shkresën nr. 12 prot., datë 04.01.2023 “Ftesë për ofertë” Titullari i AK Bashkia i është drejtuar BOE “G ” Shpk & “E ” Shpk dhe OE “SH ” Shpk.

Me procesverbalin e datës 09.01.2023 “Mbi pranimin e ofertave të operatorëve ekonomikë” KVO ka konstatuar se kanë paraqitur dokumentacionin dy OE/BOE, janë futur të jenë të pranishëm në hapjen e ofertave dhe vlerësimin e procedurës.

Pocesverbali është nënshkruar nga KVO dhe i BOE G ” Shpk & “E ” Shpk, të dy OE/BOE pjesëmarrësit janë kualifikuar.

**Kanë qenë pjesëmarrës në fazën tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

**1. BOE “G ” Shpk & “E ” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 189,879,050 lekë**

**2. OE “SH ” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 190,689,000 lekë.**

BOE “G ” Shpk & “E ” Shpk (me Nipt-e respective K...A & Nipt K...I, me vlerë ekonomike të ofertës **189,879,050 lekë.**

**Nuk ka OEtë skualifikuar.**

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 12/2 prot., datë 20.01.20223, është lidhur mes AK, Bashkia Kavajë, të përfaqësuar nga Titulari i Autoriteti Kontraktor z. R.K . dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “G ” Shpk & “E ” Shpk, (42 % dhe 58%) me përfaqësues respektiv znj. J.N e z. Ç.S z, krijuar me kontratën e bashkëpunimit nr. 4591 rep., nr. 1526 kol., datë 28.12.2022, përfaqësuar me prokurën e posaçme nr. 4592 rep., nr. 1527 kol., datë 28.12.2022 nga OE “G ” Shpk, me objekt: “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Bago”, Bashkia Kavajë,

në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **189,879,050 lekë**.

- *Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues, BOE “G ” Shpk & “E ” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, si dhe me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.*

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “G ” Shpk & “E ” Shpk, që gjenden në dosjen e prokurimit u konstatuan këto mangësi:

**OE “E ” Shpk**, gjatë viti 2022, referuar transaksioneve ne ëeb-in zyrtar të “Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit”, ka realizuar punime në territorin e bashkive: Tiranë, Dimal, Libohovë e Sarandë dhe ka paraqitur:

- Vërtetimin me nr. 166 prot., datë 27.06.2022, nga Bashkia Libohovë, ku vërtetohet që ka likujduar detyrimet.

- Vërtetimin me nr. 1836 prot., datë 28.06.2022, nga Bashkia Dimal, ku vërtetohet që ka shlyer të gjitha detyrimet për taksat dhe tarifatat lokale deri në vitin 2022.

- Vërtetimin me nr. 7126 prot., datë 21.06.2022, nga Bashkia Vlorë, ku vërtetohet që ka likujduar detyrimet tatimore për vitin 2022.

- Vërtetimin elektronik, datë 20.06.2022, nga Bashkia Tiranë, ku vërtetohet që ka likujduar detyrimet tatimore.

**OE “E ” Shpk për mjetet me qira:**

Kontrata e qiraje nr. 711 rep., nr. 198 kol., datë 12.02.2022, lidhur me PF A.H, për mjetin:

Autovinç PPM, ka Certifikatë nr. 53, datë 27.04.2022 “Për transport mallrash Brenda vendit për llogari të vet” lëshuar nag Bashkia Dimal

Kontrata e qiraje nr. 1748 rep., nr. 656 kol., datë 09.06.2021, lidhur me OE “G ” Shpk, për mjetin: Autopompë betoni: Targa AA604GZ, ka Certifikatë nr. 57, datë 27.04.2022 “Për transport mallrash Brenda vendit për llogari të vet” lëshuar nag Bashkia Dimal

***vinc kullë ose autovinc me krah horizontal mbi 40 ml (shoqëruar me skede teknike);*** OE

**OE “G ” Shpk**, gjatë viti 2022, referuar transaksioneve ne ëeb-in zyrtar të “Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit”, ka realizuar punime në territorin e bashkive: Tiranë, Kavajë, Ballësh e Fier dhe ka paraqitur:

- Vërtetimin me nr. 2291/1 prot., datë 28.04.2022, nga Bashkia Mallakastër, ku vërtetohet që ka bërë pagesën e taksave dhe tarifave për vitin 2022.

- Vërtetimin elektronik, datë 28.04.2022, nga Bashkia Tiranë, ku vërtetohet që ka likujduar detyrimet tatimore.

Për bashkinë Vlorë është paraqitur mandadi i pagesës datë 07.11.2022 nga R.

- Vërtetimin me nr. 19741 prot., datë 15.12.2022, nga Bashkia Lezhë, ku vërtetohet që ka detyrime të palikujduar.

**OE “G ” Shpk, për mjetet me qira:**

*Për vinç kullë ose autovinç me krah horizontal mbi 40 ml (shoqëruar me skede teknike); sipas faturës tatimore të shitjes nr. 12/B, datë 19.04.2000, nuk është i shoqëruar me skedë teknike.*

Kontrata e qiraje nr. 2352 rep., nr. 878 kol., datë 28.10.2020, lidhur me PF B.B , për mjetin: Kamion; Targa AA124KE, ka Certifikatë nr. 42, datë 13.06.2022 “Për transport mallrash Brenda vendit për llogari të vet” lëshuar nag Bashkia Mallakastër.

Kontrata e qiraje nr. 692 rep., nr. 278 kol., datë 15.03.2022, lidhur me PF S.M, për mjetin: Kamion vinç; Targa MK4485A, ka Certifikatë nr. 88, datë 13.10.2022 “Për transport mallrash Brenda vendit për llogari të vet” lëshuar nag Bashkia Mallakastër.

Kontrata e qiraje nr. 2951 rep., nr. 1055 kol., datë 01.09.2020, lidhur me OE “A ” Shpk, për mjetet:

1. Autobetoniere Man; Targa AA258VU, ka Certifikatë nr. 9741, datë 21.10.2022 “Për transport mallrash Brenda vendit për llogari të vet” lëshuar nag DRTRR Fier.

2. Autobetoniere Mercedes Benz; Targa AA251VU, ka Certifikatë nr. 9743, datë 21.10.2022 “Për transport mallrash Brenda vendit për llogari të vet” lëshuar nag DRTRR Fier.

3. Autopompë betoni Man; Targa AA801CJ, ka Certifikatë nr. 9742, datë 13.06.2022 “Për transport mallrash Brenda vendit për llogari të vet” lëshuar nag DRTRR Fier.

Kontrata e qiraje nr. 2951 rep., nr. 1055 kol., datë 01.09.2020, lidhur me PF SH.A , për mjetijn Autobeto uji; Targa AA306OY, nuk ka Certifikatë për transport mallrash.

Për sa trajtuar më sipër BOE “G ” Shpk & “E ” Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO dhe Titullari i AK të shpallte fitues BOE “G ” Shpk & “E ” Shpk, por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Mos disponimi, apo mosparaqitja e dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE “G ” Shpk & “E ” Shpk, dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “G ” Shpk & “E ” Shpk. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të BOE “G ” Shpk & “E ” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **189,879,050 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. R.K Kryetar i Bashkisë Kavajë në cilësinë e titullarit të AK, znj. M.D , z. E.A e znj. H.S në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. G.K , z. A.M , z. D.H në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

## 7. Procedura e prokurimit me objekt: “Rindërtimi i godinës së Ish-Prefekturës”, Bashkia Kavajë.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rindërtimi i godinës së Ish-Prefekturës”, viti 2022-2023.		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 400 e nr. 3962 prot., datë 17.11.2022	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Nr. 3962 prot., datë 17.11.2022 1. E.A (Jurist) 2. M.D (Arkitekt) 3. H.S (Ekonomiste)	<b>3. Komision Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> nr. 414 e nr. 4190 prot., datë 07.12.2022 1. G.K (Kryetar)-Jurist 2. A.M (Ekonomist) 3. D.H (Ekonomist)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “Marrëveshje kuadër”		
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 167,800,000 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> BOE “LL ” Shpk & “E ” Shpk & “E ” Shpk, vlera e ofertës 166,955,696.7 lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 844,303.3 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 12.12.2023	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i Shtetit	<b>10. OE</b> 1. BOE BOE “LL ” Shpk & “E ” Shpk & “E ” Shpk, 2. OE “SH ” Shpk
<b>11. Ankime AK: Nuk KA</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.</b>
<b>b. Kontrata nr. 13/2 prot., datë 23.03.2021</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 23.01.2023</b>	<b>15. Vlera e kontratës</b>	<b>166,955,696.70</b>

- Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit publik, me oponencës teknike të hartuar bazuar në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

AK Bashkia Kavajë, ka nisur procedurën e prokurimit pa u realizuar Oponenca Teknike.

(Procedura e prokurimit ka filluar më datë 17.11.2022, kurse oponenca teknike është realizuar nga Instituti i Ndërtimit më datë 25.04.2023.

Raporti Paraprak i Vlerësimit në Mjedis është realizuar nga Ing. F.V , konstatohet që: Referuar shkresës të Institutit të Ndërtimit nr. 481/2 prot., datë 25.04.2023 “Dërgim oponence teknike”, në vijim të kërkesës për kryerjen e oponencës teknike nga AK me nr. 481 prot., datë 01.03.2023, konstatohet që: Midis dy institucioneve është nënshkruar një marrëveshje me nr. 879/1 prot., datë 11.04.2023, ku tarifa e shërbimit për kryerjen e oponencës teknike është 215,809 (dyqind e pesëmbëdhjetë mijë e tetëqinde nëntë) lekë me Tvsh.

Është dorëzuar Raporti i VNM hartuar nga Ing. F.V me nr. Certificate 5010 datë 04/07/2013. Raporti është dorëzuar në nënyrë elektronike, dhe nuk është sigluar nga hartuesi i VNM-së. mungon bashkangjitur raportit Licenca per kryerjen e veprimtarive me ndikim në mjedis lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

*Në mbështetje të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, projektet të cilat përfshihen në shtojcën 2 të këtij ligji (ku bën pjesë dhe projekti në fjalë) i nënshtrohen procedurës Paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.*

Nga auditimi në faqen zyrtare të Ministrisë dhe Mjedisit u konstatua që: Ing. F.V i mungon certifikata e ekspertit dhe licenca për kryerjen e veprimtarive me ndikim në mjedis lëshuar nga QKB (ose ish QKL).

Në oponencën teknike (Instituti i Ndërtimit)

AK Bashkia Kavajë, ka nisur procedurën e prokurimit pa u realizuar Oponenca Teknike.

(Procedura e prokurimit ka filluar më datë 05.04.2023, kurse oponenca teknike është protokolluar në bashki në datë 26.05.2023).

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis i hartuar nga OE “I ” Shpk, nuk është në përputhje me ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, pasi raporti duhet të hartohet dhe të firmoset nga persona të certifikuar dhe të licencuar nga Ministria e Mjedisit. OE “I ” Shpk, i mungon certifikata e ekspertit dhe licenca për kryerjen e veprimtarive me ndikim në mjedis lëshuar nga QKB (ose ish QKL).

Raporti VNM i paraqitur nga OE, (i pa plotësuar sipas rekomandimeve të oponencës) nuk është në përputhje me: ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe VKM 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.

Referuar VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”

*3. Të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponencës teknike. Oponenca teknike është pjesë e dokumentacionit teknik të projektit.*

Nga AK Bashkia Kavajë, nuk duhej të zhvillohej procedura e prokurimit publik, referuar neneve 6, 9 e 15, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, ligjit nr. 10440, datë 7.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ligji nr. 10431, datë 10.03.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 686. datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore” dhe Urdhrin e Ministrisë nr. 197, datë 09.10.2014 “Për miratimin e

*kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e opionencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.*

*- Në hartimin e kriterëve për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Rindërtimit të godinës së ish-Prefekturës Kavajë”, Bashkia Kavajë janë konstatuar kriterë jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e saj.*

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 neni 21e nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

**Në DT është kërkuar:**

**1. Në pikën 2.3.2 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të jenë të pajisur me licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të kategorive NP 1 - A; NP 2 - C; NP 7 - A; NP 12 - A; NS 1 - A; NS 2 - A; NS 3 - A; NS 4 - B; NS 8 - A; NS 12 - A; NS 14 - B; NS18 - A; NS 20 - A”.

**2. Në pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë

kapacitet: 1. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune, diplomë, certifikatë të lëshuar nga ISHT dhe Industrial/ekuivalente, librezë pune, CV për 1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier elektrik, 1 (një) inxhinier hidroteknik, **1 (një) inxhinier mjedisi**, 1 (një) inxhinier mekanik, 1 (një) inxhinier topograf dhe **1 (një) inxhinier gjeolog/gjeoteknik**.

Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Gusht – Tetor 2022 si dhe të figurojë në licensën e shoqërisë. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune, diplomë, certifikatë të lëshuar nga ISHT dhe Industrial/ekuivalente, librezë pune, CV për **1 (një) inxhinier mekatronik**.

4. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për **1 (një) ekspert** që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

5. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për **1 (një) ekspert** për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

**3. Në pikën 2.3.3/6 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë të lëshuar nga ISHT dhe Industrial/ekuivalente për 3 (tre) teknikë ndërtimi, 4 (katër) muratorë/suvatues, 4 (katër) karpentirë, 4 (katër) hekurkthyes, 2 (dy) bojaxhi, 2 (dy) elektrikistë, 2 (dy) saldator, 1 (një) mekanik, 2 (dy) hidraulikë, 2 (dy) pllakashtrues, 2 (dy) hidroizolues, 2 (dy) persona të pajisur me certifikaten për punimet në lartësi.

Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në listëpagesat e operatorit ekonomik të paktën gjatë periudhës Gusht – Tetor 2022. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme pune dhe leje drejtimi përkatëse për 5 (pesë) manovratorë/eskavatoristë dhe 10 (dhjetë) shoferë.

Kur oferta paraqitet nga një BOE, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”.

**4. Në pikën 2.3.4 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: 2.3.4. OE duhet të paraqesin pranë AK kontratë të vlefshme, urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe CV për një mjek të përgjithshëm”

**5. Në pikën 2.3.5 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet OE duhet të paraqesin:

Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht 90 (nëntëdhjetë) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, shoferë, manovratorë, stafi teknik) për periudhën Gusht – Tetor 2022, i lëshuar nga Administrata Tatimore.

Listëpagesat për periudhën Gusht – Tetor 2022, sipas formatit të miratuar nga Administrata Tatimore.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, OE duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mesipër duhet të paraqitet pranë AK para lidhjes së marrëveshjes kuadër”.

**6. Në pikën 2.3.6 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht, mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën janë 3 (tre) kamionë me kapacitet mbajtës  $\geq 15$  ton; 3 (tre) kamionë/kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 5 ton; 1 (një) autovinc; 2 (dy) eskavator; 1 (një) fadromë; 1 (një) rul me vibrim; 1 (një) grejder; 2 (dy) mini eskavator; 2 (dy) autobetoniere; 1 (një) autopompë/presë betoni; 1 (një) autobotë uji; **1 (një) vinç kullë ose autovinç me krah horizontal mbi 40 ml (shoqëruar me skede teknike); 1 (një) rimorkiator për levizjen e mjeteve që nuk lëvizin vetë në rrugë;** 2 (dy) pompë suvatimi; 2 (dy) vibrator thellesie; **2 (dy) elektroorgano;** 1 (një) gjenerator; 1 (një) elektropompe; 2 (dy) betoniere 500 liter; 1 (një) pajisje topografike GPS; 1500 (një mijë e pesëqind) m<sup>2</sup> skelë inventar dhe 1 (një) sondë në toke të zakonshme 800mm thellesia (10~20m).

Për sa trajtuar më sipër, kriteret: **2.3.3/4, 2.3.5, dhe 2.3.6**, nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht për asrye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës.

**7. Në pikën 2.3.7 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, OE duhet të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht për:

1. OE, duhet kenë 1 (një) fabrikë betoni, e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi III.1.B dhe të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme. Në rastin kur, OE kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet gjithashtu edhe kontrata e vlefshme e qirasë apo e furnizimit.

2. OE, duhet kenë 1 (një) fabrikë për prodhimin e inerteve, e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi III.1.B dhe të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme. Në rastin kur, OE kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet gjithashtu edhe kontrata e vlefshme e qirasë apo e furnizimit.

3. OE për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin kontratë/marrëveshje të vlefshme me një laborator, për testimin dhe analizat e



betonit, i akredituar nga ana e Drejtorisë së Akreditimit / organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë / ekuivalente.

**8. Në pikën 2.3.8 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “OE, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

1. ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.

2. ISO 14001 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente e vlefshme.

3. ISO 45001(Standard për manaxhimin e rreziqeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë)/ekuivalente dhe e vlefshme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**9. Në pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “OE duhet t jen t pajisur me leje mjedisore kodit III.2.B për grumbullim dhe transportimin e mbetjeve jo t rrezikshme, lëshuar nga QKL.

OE, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021”.

#### - **Zhvillimi i procedurës.**

Me shkresën nr. 13 prot., datë 04.01.2023 “Ftesë për ofertë” Titullari i AK Bashkia i është drejtuar: BOE “LL ” Shpk & “E ” Shpk dhe OE “SH ” Shpk, afati kohor për dorëzimin e propozimit është data 09.01.2023: Ora 12:00.

Raporti pjesor (faza e parë e parakualifikimi) i datë 16.05.2023, nga KVO, ka konstatuar që kanë marrë pjesë, në procedurë OE/BOE të cilët kanë paraqitur në SPE.

Me procesverbalin e datës 09.01.2023 “Mbi pranimin e ofertave të operatorëve ekonomikë” KVO ka konstatuar se kanë paraqitur dokumentacionin dy OE/BOE, janë futar të jenë të pranishëm në hapjen e ofertave dhe vlerësimin e procedurës.

**Kanë qenë pjesëmarrës në fazën tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

**1. BOE “L ” Shpk & “E ” Shpk & “E ” Shpk** (me Nipt-e respektive **K...N & J...D & K...P**) me vlerë ekonomike të ofertës **166,955,696.70** (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë shtatë) **lekë.**

**2. OE “SH ” Shpk** (me Nipt K...ë), me vlerë ekonomike të ofertës **167,255,010** (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e dyqind e pesëdhjetë e pesëmijë e dhjetë) **lekë.**

**Nuk ka operatorë ekonomik të skualifikuar.**

Sipas procesverbalit të datë 09.01.2023, për fazën e II u kualifikuan të dy pjesëmarrësit. Nga vlerësimi i dokumentacionit tekniko ligjor dhe ekonomik ka rezultuar që: BOE LL ” Shpk & “E ” Shpk & “E ” Shpk, është fitues me 97 pikë nga 100 të mundshme.

Formulari i njoftimit të fituesit me nr. 13/1 prot., datë 13.01.2023, botuar në Buletin e Posaçëm nr. 5, datë 17 janar 2023, në faqet 13-14/18 të APP.

Formulari i njoftimit të publikimit të kontratës së nënshkruar fituesit me nr. 1389/5 prot., datë 01.06.2023, botuar në Buletin e Posaçëm nr. 5, datë 17 janar 2023, në faqet 13-14/18 të APP.

Marrëveshjen e bashkëpunimit nr. Extra prot., datë 12.12.2022, me objekt: bashkëpunimi i përkohshëm i palëve për zbatimin e objektit: “Rindërtimi i godinës së Ish-Prefekturës”. Pjesëmarrja në zbatimin e kontratës, do të jetë e shprehur në përqindje: OE “LL ” Shpk -23.40%; OE “E ” Shpk – 24.41 % dhe OE “E ” Shpk -52.19 %. Palët kanë rënë dakord që kryesuese e BOE të jetë OE “LL ” Shpk.

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 13/2 prot., datë 23.01.2023, është lidhur nga Titullari i Autoriteti Kontraktor z. R.K dhe BOE LL ” Shpk & “E ” Shpk & “E ” Shpk, me përfaqësues z. N.LL administrator i OE “LL ” Shpk, krijuar me kontratën e bashkëpunimit dhe autorizimit të përfaqësimit paraprak nr. extra prot., datë 12.12.2022.

Me shkresën nr. 13/4 prot., datë 01.06.2023 “Kërkesë për arkivimin e procedurës së prokurimit” Titullari i AK Bashkia i është drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues, BOE “LL ” Shpk & “E ” Shpk & “E ” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, si dhe me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

Nga auditimi i dokumentacionit të e BOE “LL ” Shpk & “E ” Shpk & “E ” Shpk, rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

OE “LL ” Shpk, referuar transaksioneve në ëeb-in zyrtar të “Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit”, ka realizuar punime në territorin e bashkive: Elbasan e Peqin dhe ka paraqitur:

- Vërtetimin me nr. 1338 prot., datë 22.08.2022, nga Bashkia Peqin, ku vërtetohet që ka bërë pagesën e taksave dhe tarifave për vitin 2022.

**Për mjetet:** 1. Kamion Daimler Chrysler -Tërheqs, Targa AA618MY, Taksat vjetore kanë prfunduar më datë 29.12.2022 + Gjysm Rimorkio- Shmitz, Targa PE2508A, Taksat vjetore kanë prfunduar më datë 29.12.2022. 2. Kamionçin Ford, Targa AA046GS; Taksat vjetore kanë prfunduar më datë 11.12.2022.

**Mjeti** Eskavator: Targa AA113IM; Leje qarkullimi ELD0052614, kontrolli teknik i ka prfunduar më datë 13.12.2022, nuk ka paguar taksat vjetore që nga data 29.12.2022.

Kontrata e qiraje nr. 2664 rep., nr. 1102 kol., datë 10.12.2022, lidhur me OE “E ” Shpk, PF B.B , për Aparat GPS. sht paraqitur fatura tatimore e shitblerjes me nr. 33, datë 14.09.2020, nga OE “Y ” Shpk, mungojnë fotot e GPS.

OE “E ” Shpk, referuar transaksioneve në ëeb-in zyrtar të “Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit”, ka realizuar punime në territorin e bashkive: Krujë, Klos e Bulqizë dhe ka paraqitur:

Vërtetimin me nr. 7614 prot., datë 28.04.2022, nga Bashkia Bulqizë, ku vërtetohet që ka bërë pagesën e taksave dhe tarifave për vitin 2022.

**Për mjetet Mjeti** Eskavator: Targa ADMT04, Leje qarkullimi PEF0098916, kontrolli teknik i ka prfunduar më datë 21.05.2021, siguracion i ka prfunduar më datë 23.03.2022, nuk ka paguar taksat vjetore që nga data 16.03.2020.

Kontrata e qiraje nr. 365 rep., nr. 151 kol., datë 28.01.2021, lidhur me PF B.M, për mjetin: Kamion; Iveco Magirus, Targa AA698RY, Taksat vendore kanë prfunduar më datë 29.12.2022.

OE “E ” Shpk referuar transaksioneve në ëeb-in zyrtar të “Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit”, ka realizuar punime në territorin e bashkive: Tiranë, Kavajë, Mallakastër e Fier dhe ka paraqitur:

- Vërtetimin me nr. 1658 prot., datë 12.12.2022, nga Bashkia Kavajë, ku vërtetohet që ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2022.

- Vërtetimin me nr. extra prot., datë 12.12.2022, nga Bashkia Durrës, ku vërtetohet që nuk ka detyrime të pa likuiduar deri në datën e marrjes së vërtetimit.

- Vërtetimin me nr. 17/5 prot., datë 17.05.2022, nga Bashkia Elbasan, ku vërtetohet që nuk ka që ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2022.

- Vërtetimin e datës 13.07.2022, nga Bashkia Librazhd, ku vërtetohet që nuk ka detyrime të pa likuiduar për taksat dhe tarifat vendore.

Për mjetet: 1. Kamion Mercedes Benz, Targa AB983FB; 2. Kamion Mercedes Benz, Targa AB226CS; 3. Kamionçin Mercedes Benz, Targa AA193SA, Taksat vendore kanë prfundur

më datë 14.12.2022; 4. Kamionçin Daimler Chrysler, Targa AA137NE; 4. Kamion Mercedes Benz, Targa EL1401C;

Për sa trajtuar më sipër BOE “LL ” Shpk & “E ” Shpk & “E ” Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO dhe Titullari i AK të shpallte fitues BOE “LL ” Shpk & “E ” Shpk & “E ” Shpk, por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Mos disponimi, apo mosparaqitja e dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE “LL ” Shpk & “E ” Shpk & “E ” Shpk, dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “LL ” Shpk & “E ” Shpk & “E ” “LL ” Shpk & “E ” Shpk & “E ” Shpk, Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriteret jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të BOE “LL ” Shpk & “E ” Shpk & “E ” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **166,955,696.70 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. R.K Kryetar i Bashkisë Kavajë në cilësinë e titullarit të AK, znj. M.D , z. E.A e znj. H.S në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. G.K , z. A.M , z. D.H në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

### **Nënpika 2.4.1 e programit: Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.**

#### **1. Zbatimi i punimeve për objektin: “Rikonstruktion i kopshtit Hap pas Hapi”, Bashkia Kavajë.**

<b>1/b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Rikonstruktion i kopshtit Hap pas Hapi”, Bashkia Kavajë</b>				
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 43/3 prot., datë 09.04.2023.	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> <b>56,500,000 lekë</b> OE fitues “G ” Shpk		<b>16. Likuiduar lekë</b> <b>Sipas aneksit të aktit</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar datë</b> <b>-Vlera 56,500,000 lekë</b>	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 7 muaj, Zbatuar 7 muaj. Fillim i punimeve: 07.04.2023 Përfundim i punimeve: 06.11.2023		<b>19. Zgjatja e kontratës</b>	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “C Shpk	Licenca Nr: MK 2049/8	Kontrata nr 10/1.prot., datë 27.05.2021.	Vlera e Kontratës 543,812.5 lekë	Likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> OE “M” Shpk	Licenca Nr: MK.3752/3	Kontrata nr. 41/1prot., datë 11.12.2023	Vlera e Kontratës 80,605 lekë	Likuiduar lekë
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Datë 12.12.2023	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> datë			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të

situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,050,334 lekë**.

- Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksion i kopshtit Hap pas Hapi”, Bashkia Kavajë, nga zbatuesi i punimeve OE “G ” Shpk, për zërat e punimeve II, IV dhe VI.

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës: “Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm + rrjetë + suva”; “Grup pompimi MKZ, për furnizimin e hidranteve me kasetë në përputhje me normën UNI9490, i përbërë nga: elektropompë shërbimi q=28.8 m<sup>3</sup>/h80, kPa, pompë pilote “Jockey” Q=60l/min, 80kPa”; “Sistemim nivelim dhe pasurim me humus 5kg/m<sup>2</sup>”; “Mbjellje bari” dhe “F.V Fidane pemë dekorative Blin 16-18cm/6m”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3; - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 43/3 prot., datë 09.02.2023; - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 10/1 prot., datë 04.04.2023; - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 43/1 prot., datë 11.12.2023.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. V.M , me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. M.A me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

## **2. Zbatimi i punimeve në objektin “Ndërtim i zjarrëfikes Kavajë (ndërtesë & rrethim)”, Bashkia Kavajë.**

Në dosje gjendet procesverbali i datës 28.06.2022 (pa nr. prot. në bashki) “Mbi negociimin e zërave të rinj të punimeve, nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi i punimeve dhe titullari i AK z. R.K . Janë shtuar 27 zëra punimesh, nga të cilat 9 zëra nuk janë në manualin e miratuar. **Punimet kanë përfunduar më datë 16.11.2022, nuk janë marrë në dorëzim paraprak.**

Para fillimit të punimeve në objekt dhe gjatë realizimit të punimeve konstatohet që nuk ka asnjë bashkëpunim ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës në Bashkinë Kavajë, IMT, sipërmarrësit të punimeve, projektuesit dhe mbikëqyrësit të punimeve. Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 9 të ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (i përditësuar), pikat 3, 3.1, 7, 7.1. 11, 11.1, 11.2, 11.3 e 11.4 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe pika 4 e Udhëzimit nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit.”

Në dosje nuk ka asnjë korrespondencë ndërmjet palëve të nënshkrimit të ndryshimeve dhe projektuesit. Ndryshimi pothuajse total i projektit, mbart riskun që projekti i miratuar dhe i tenderuar për ndërtimin e godinës mund të ketë patur mangësi teknike, por mund të ketë ndikuar edhe në pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit të këtij objekti.

Dosja e plotë teknike duhet të dorëzohej te Autoritetin Kontraktor më datë 16.12.2022, që më pas të fillojë procedura e kolaudimit të objektit sipas udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 kreu II “Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit” pika 2 ku citohet: *Kolaudatori ose grupi i kolaudimit caktohet nga investitori, i cili duhet t’ia komunikojë, me shkrim, këtë person apo grup*

personash, Sekretariatit Teknik të KRRT-së, pranë zyrës dhe seksionit urbanistik përkatës në rreth, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të punimeve.

Në dosje nuk administrohet asnjë dokumentacion për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit. Ky veprim është në kundërshtim me UKM nr .2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu II, pika 10.2, sipas të cilës “...Sipërmarrës i është përgjegjës për drejtimin, mbajtjen në gatishmëri, riparimin, mirëmbajtjen, ruajtjen e punimeve të ndërtim-montimit të objektit e të kantierit, deri në nënshkrimin e procesverbalit të kolaudimit. Objekti merret në dorëzim në datën e nënshkrimit të procesverbalit të kolaudimit”. Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi z. R.K ish Kryetari i Bashkisë dhe z. F.Q Kryetari i Bashkisë Kavajë.

b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Rindërtimi i Stacionit të Zjarrëfikësës”				
14.Lidhja e kontratës Nr. 881/3 prot., datë 12.04.2022	15.Vlera e kontratës 77,663,390 lekë (pa tvsh) BOE fitues “G ” & “SH ” & “M” & “F ” Shpk		16. Likuiduar lekë	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera pa tvsh 9,419,608 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 5 muaj, Fillim i punimeve: 16.06.2022 Përfundim i punimeve: 16.11.2022		19. Zgjatja e kontratës	
20. Mbikëqyrësi i punimeve “G ” Shpk	Licenca Nr: MK. 2812/4	Kontrata nr. 491/1prot., datë 07.01.2022.	Vlera e Kontratës 874,256.65 lekë pa Tvsh	Likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve Emri Mbiemri:	Licenca Nr:	Kontrata nr..	Vlera e Kontratës	Likuiduar (me Tvsh) lekë
22.Akt Kolaudimi Datë	23.Akt i marrjes në dorëzim			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **7,039,858.04 lekë**.

- Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin: “Ndërtim i zjarrëfikës Kavajë (ndërtesë & rrethim)”, Bashkia Kavajë, nga zbatuesi i punimeve BOE “G ” Shpk & “SH ” Shpk & “M” Shpk & “F ” Shpk, për zërat e punimeve IV, VI, XI, XII, XIII dhe B.

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës: “Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingato d=100”, “Kasetë shkarkimi me llamarinë xingato “; “Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm +\_rrjetë + suva”; Enë zgjerimi mbi pompë 80 litra”, “Pompë për sistemimin e mbrojtjes nga zjarri elektrike dhe naftë”, “F.V Pemë dekorative perimetër 20cm”, “Konstruksione metalike të thjeshta (muret rrethuese-Kangjellat)”, “Kapak mermeri mbi mur rrethues dhe kollona” dhe “Pomp nxehtësie reversibile me kit idronik të inkuorporuar 26kë, përfshi aksesorët e nevojshëm të montimit” për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II, nenet 4 e 5, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3; - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 881/3 prot., datë 12.04.2021; - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 491/1 prot., datë 07.01.2022.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. G.B, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. z. A.R , me detyrë projektuese e objektit.

Me shkresën nr. 61/1 prot., datë 30.04.2024, për Projekt Raportin e Auditimit për për zbatimin e punimeve objekt: “Rindërtimi i zjarrfikses Kavajë”, nga Mbikqyrësi i Punimeve OE “G ” Shpk, me administrator z. G.B . Observimi është identik me kundërshtit e paraqitura me shkresën nr. 34/10 prot., datë 06.03.2024, për Akt Konstatimi nr. 17, datë 15.12.2023.

**Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:** Grupi i auditimit e ka trajtuar këtë ankesë në Projektreportin e Auditimit.

**Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe trajtohen në raportin përfundimtar të auditimit.**

### 3. Zbatimit i shërbimit me objekt: “Shërbimi i pastrimit Njësia Administrative Golem”, Bashkia Kavajë.

#### Kontratat (Sipërmarrjes).

Kontrata me nr. 3568/3 prot., datë 02.10.2020 me objekt: “Shërbimi i pastrimit Njësia Administrative Golem”, e lidhur ndërmjet Bashkisë Kavajë përfaqësuar nga Kryetari z. R.K dhe Operatori Ekonomik “A ” Shpk përfaqësuar nga administratori z. A.A . Vlera totale e kontratës (në përputhje me preventivin e punimeve për të gjitha operacionet e shërbimit) është **305,433,338 (treqind e pesë million e katërqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e treqind e tridhjetë tre) lekë me Tvsh** (254,527,782 lekë pa Tvsh).

*Afati i realizimit të shërbimit do të jetë 5 (pesë) vjetë, nga data e lidhjes së kontratës*

<b>13. Zbatimi i Kontratës së shërbimit me objekt: “Shërbimi i pastrimit Njësia Administrative Golem”, Bashkia Kavajë, Viti 2020</b>			
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 921/6 prot., datë 19.06.2020	<b>15.Vlera e kontratës</b> 305,433,338 lekë me Tvsh OE fitues “A ” Shpk	<b>16.Likuiduar:</b> Situacione mujore, hollësisht në fund të Aktit të Konstatimit	
<b>17- Situacionet në Vitin 2023 Nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023</b>	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 5 vite (60 muaj). Fillimi i shërbimit: 19.06.2020 Përfundimi shërbimit më datë 18.06.2025	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> S’ka	
<b>20. Mbikëqyrësi i Shërbimit</b>			

Në Bashkinë Kavajë (deri më shkurt 2024, perudhë kur është afati i auditimit), nuk është hartuar plani vendor i menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të ligjit nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Sa më sipër bie ndesh me:

-Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përcakton përgjegjësitë dhe autoritetin e njësive të qeverisë vendore. Konkretisht neni 23 *Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: pika 10. “Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake”. Sipas këtij përcaktimi, bashkia ka të drejtë dhe përgjegjësi për të ushtruar menaxhimin e shërbimit të mbetjeve....”*

-Ligji nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, konkretisht: Neni 12 *“Planet rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve”.*

Neni 14 *“Programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve”, në mënyrë të veçantë pika 2, ku paracaktohet: “Afati për hartimin e programeve të para për parandalimin e krijimit të mbetjeve është jo më vonë se data 1 janar 2017”.*

Neni 18 *“Ripërdorimi dhe riciklimi i mbetjeve”, në mënyrë të veçantë pika 3, ku paracaktohet: “Njësitë e qeverisjes vendore grumbullojnë në mënyrë të diferencuar mbetjet, sipas nenit 16 të këtij ligji, brenda 31 dhjetorit 2018, të paktën për këto rryma mbetjesh: letër, metal, plastikë dhe qelq”.*

Neni 21 “Përgjegjësia për menaxhimin e integruar të mbetjeve” në mënyrë të veçantë pika 12, ku paracaktohet: “Kryetarët e njësisë të qeverisjes vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrativ, në përputhje me kërkesat e këtij ligji”.

-Vendimi nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve “Ekzistenca e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve është vendimtar para fillimit të llogaritjes së kostove, pasi ai do të sigurojë shumicën e informacionit teknik dhe infrastrukturor të nevojshëm për variablat e sistemit.

#### **Në dosjen e zbatimit të shërbimit mungojnë:**

**Grafikët e realizimit të shërbimit, në kundërshtim me specifikimet teknike:**

Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, pregatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoritetit kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën pikë kontenierësh.
2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.
4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

Është deklaruar se: Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedure disponimit të tyre, **nuk do të jenë të angazhuara në asnjë kontratë apo** punëmarrje tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti. prokurimi, pavarësisht

Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.7 në DT. OE duhet të kenë në dispozicion apo që mund t'i vihet në dispozicion për të përmbushur kontratën ambient me sipërfaqe jo më e vogël se 1000 m<sup>2</sup> e cila do të shërbejë si pikë për parkim për mjetet dhe të tjera.

Operatori Ekonomik “A ” Shpk, ka paraqitur Kontratë Qiraje nr. 1434 rep., nr. 729 kol., datë 13.05.2020, me T.D , për marrjen e truallit të ndodhur në Rr. “Kisha Shënkolli”, me nr. 12/5 pasurie, Vol. 6, faqe 49, me sipërfaqe totale 1429m<sup>2</sup>, ZK. 8551, referuar Certifikatës së pronësisë të lëshuar nga ASHK Kavajë.

#### **Në lidhje me përdorimin e ujit:**

**Në zërat e punimeve që nevojitet për realizimin e shërbimit janë:** Larja e rrugëve me makinë teknologjike natën) dhe larja e dizifektim të kontenierëve. Konstatohet që vetëm për shërbimin “Larja e rrugëve me makinë teknologjike (ditën/natën)” është paguar mesatarisht 82,861 lekë/muaj për realizimin e shërbimeve të sipërcituar, ka harxhuar 1,899 m<sup>3</sup> ujë/vit.

(Larja duhet të bëhet me ujë me ngarkesë bakteriale jo më shumë se 200 E koli për 100ml ujë.) vetë për shërbimin e larjes së rrugëve (pa përfshirë larjen e makinerive dhe kontenierëve) dhe OE “A ” Shpk nuk na paraqiti asnjë kontratë nga “K” Sha.

Standartin e harxhimit është 0,8 litër ujë për 1 m<sup>2</sup> rrugë për larjen e darkës dhe 0.6 litër ujë për m<sup>2</sup> për larjen e ditës. Për 100 ditë x 31,656 m<sup>2</sup>x 0,6litër/m<sup>2</sup>=1,899,360 m<sup>3</sup> ujë/vit.

#### **Në lidhje me kontenierët:**

Gjendja reale e kontenierëve është jashtë çdo standarti të kërkuar në Specifikimet teknike, shumë kontenier ndodhen brenda teritoreve të hoteleve në zonë (nuk është deklaruar me shkrim ndonjë kontratë private). Të gjithë kontenierët janë pa kapak, disa janë të tejmbushur, disa tepër të vjetër. Nga Bashkia Kavajë nuk ka asnjë inventar për sasinë dhe cilësinë e reale të kontenierëve. Në zonë ka kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonen përreth kontenierëve.

Nuk ka Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të ishte e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00. Nuk ka përfaqësues të operatorit të shërbimit prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe të Autoritetit kontratues dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit.

Uniformat e punëtorëve që kryejnë shërbimin e pastrimit janë vetëm jelekët fosforeshent, kur është rigorozisht i detyrueshëm dhe në asnjë rast nuk janë aplikuar gjoba për mosplotësim këtij detyrimi.

**Nga auditimi në terren u konstatua që për realizimin e shërbimit OE“ A ”** Shpk, përdorte mjetin Iveko me Targa AB652KJ, dhe punonjësit: N.T, D.E, A.M, R.I – Përgjegjës pastrimi, S.GJ – Mbushje kazanësh, M.K -Fshesë, B.E – Fshesë, GJ.E Fshesë, H.P Fshesë, P.L, G.SH, -Brigadier Ditën, I.R - Mbushje kazanësh Gjithsej 13 (përfshirë edhe shoferin e mjetit) punonjës nga 25 të kërkuar në DT.

**Në zbatim të pikës 2.3.4 në DT.** Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht **25 (njëzet e pesë)** punonjës.

***Në zbatim të Specifikimeve Teknike “Rregulla për tu zbatuar”, pikat***

*e. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.*

*f. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.*

Fuqia punëtore që realizon shërbimi e pastrimit në Njësinë Administrative Golem, *Bashkia Kavajë është sa 52 % e fuqisë punëtore të përllogaritur në fondin limit të shërbimit. (13/25 =0.52)*

Në përllogaritjen e kostos për menaxhimin e mbetjeve në vit, kostoja personel zë 55.07 % të vlerës së përllogaritur të shërbimit (5,088/9,293)

*Kostua e mirëmbajtjes dhe amortizimit përbën për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit, zë 24.45 % (2,272/9,239).*

**Sa më sipër OE “A ”** Shpk, ka faturuar dhe është paguar për fuqinë punëtore që nuk e ka në dispozicion gjatë vitit 2023 (12 punonjës) për realizimin e kontratës me objekt: “Shërbimi i pastrimit Njësia Administrative Golem”, Bashkia Kavajë vlerën **12,719,126.42 lekë pa Tvsh** Nga auditimi i situacionit të preventivuar, DT, përllogaritjes së fondit limit, si dhe volumet të shërbimit, listëprezencat si dhe realizimit të shërbimit në fakt, rezultuan diferenca në volumin e shërbimit referuar numrit të minimal të punonjësve që nevojiten për realizimin e shërbimit, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Kavajë në vlerën **12,719,126.42 lekë pa Tvsh**  
**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. R.K , ish Kryetar i Bashkisë Kavajë.
2. Z. F.Q , Kryetar i Bashkisë Kavajë.
3. Z. L.H , ish Drejtor i Shërbimeve Publike.
4. Z. B.SH , Përgjegjës i Sektorit të Pastrimit
5. Z. M.K , Drejtor i Shërbimeve Publike.
6. Z. F.GJ , mbikëqyrës i kontratës së shërbimit.
7. Z. M.R , mbikëqyrës i kontratës së shërbimit.
8. Z. S.P , mbikëqyrës i kontratës së shërbimit.

**4. Zbatimi i shërbimit me objekt: “Shërbimi i pastrimit të Qytetit Kavajë dhe Njësi Administrative Synej, Luz i Vogël e Helmas”, Bashkia Kavajë.**

**Kontratat (Sipërmarrjes).**

Kontrata me nr. 3568/3 prot., datë 09.12.2022 me objekt: “Shërbimi i pastrimit të Qytetit Kavajë dhe Njësi Administrative Synej, Luz i Vogël e Helmas”, Bashkia Kavajë e lidhur ndërmjet Bashkisë Kavajë përfaqësuar dhe BOE “A ” Shpk & “A ” Shpk, vlera e kontratës



është **549,298,645** lekë pa Tvsh. **659,158,374** lekë me tvsh. *Afati i realizimit të shërbimit do të jetë 5 (pesë) vjetë, nga data e lidhjes së kontratës.*

<b>b. Zbatimi i Kontratës së shërbimit me objekt: “Shërbimi i pastrimit të Qytetit Kavajë dhe Njësive Administrative Synej, Luz i Vogël e Helmas”, Bashkia Kavajë</b>			
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 3568 Prot., datë 04.04.2022	<b>15.Vlera e kontratës</b> <b>165,674,646</b> lekë me Tvsh BOE “A ” Shpk & “A ” Shpk	<b>16.Likuiduar:</b> Situacione mujore, hollësisht në fund të Aktit të Konstatimit	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> Nga data <b>01.01.2023-</b> deri më <b>31.01.2023</b>	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 5 vite (60 muaj). Fillimi i shërbimit: 04.04.2014 Përfundimi shërbimit më datë 04.04.2027	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> S’ka	
<b>20. Mbikëqyrësi i Shërbimit</b>			

Në Bashkinë Kavajë (deri më shkurt 2024, perudhë kur është afati i auditimit), nuk është hartuar plani vendor i menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të ligjit nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Sa më sipër bie ndesh me:

-Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përcakton përgjegjësitë dhe autoritetin e njësive të qeverisë vendore. Konkretisht neni 23 *Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: pika 10. “Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake”. Sipas këtij përcaktimi, bashkia ka të drejtë dhe përgjegjësi për të ushtruar menaxhimin e shërbimit të mbetjeve....”*

-Ligji nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, konkretisht: Neni 12 *“Planet rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve”.*

Neni 14 *“Programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve”, në mënyrë të veçantë pika 2, ku paracaktohet: “Afati për hartimin e programeve të para për parandalimin e krijimit të mbetjeve është jo më vonë se data 1 janar 2017”.*

Neni 18 *“Ripërdorimi dhe riciklimi i mbetjeve”, në mënyrë të veçantë pika 3, ku paracaktohet: “Njësitë e qeverisjes vendore grumbullojnë në mënyrë të diferencuar mbetjet, sipas nenit 16 të këtij ligji, brenda 31 dhjetorit 2018, të paktën për këto rryma mbetjesh: letër, metal, plastikë dhe qelq”.*

W 21 *“Përgjegjësia për menaxhimin e integruar të mbetjeve” në mënyrë të veçantë pika 12, ku paracaktohet: “Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrativ, në përputhje me kërkesat e këtij ligji”.*

-Vendimi nr. 319, datë 31.5.2018 *“Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve “Ekzistenca e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve është vendimtar para fillimit të llogaritjes së kostove, pasi ai do të sigurojë shumicën e informacionit teknik dhe infrastrukturor të nevojshëm për variablat e sistemit.*

**Për shkeljet e sipërcituara mbajnë përgjegjësi:** Z. R.K , ish Kryetar i Bashkisë Kavajë dhe Z. F.Q , Kryetar i Bashkisë Kavajë.

**Në dosjen e zbatimit të shërbimit mungojnë:**

*Grafikët e realizimit të shërbimit, në kundërshtim me specifikimet teknike:*

*Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, pregatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga autoritetit kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:*

- 1. Oraret e operimit në secilën pikë kontenierësh.*
- 2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.*
- 3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.*
- 4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.*

Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit. Sa më sipër nuk është sanksionuar as kontratën nr. 3568 nrot., datë 04.04.2022 dhe në procedurën e prokurimit mungojnë Raporti teknik dhe Specifikimet Teknike.

**Në lidhje me kërkesën e Pikës 2.3.8. në DT është kërkuar:** “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

1. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, 4 (katër) copë;
2. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me shume se 7 ton, 2 (dy) copë;
3. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me shume se 5 ton, 1 (një) copë;
4. Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, te pajisura me dy fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, me sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe system spërkatje me ujë gjatë punës, e pajisur me tub aspirimi të jashtëm thithës jo më pak se 2 (dy) copë;
5. Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, 1 (një) copë;
6. Makina për larjen e rrugëve, (autobot) i pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 5000 litra ujë, 1 (një) copë;
7. Mjet pastrimi (gazelone) me kapacitet mbajtës 0,5-1.5 ton, me ngarkim fundor ose anësor, 1 (një) copë.
8. Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, jo më shume se 10 ton, 1 (një) copë; rezerve

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore dhe foto perkatëse ku të jetë e dukshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

Në Formularin përmbledhës të deklarimit (Shtojca 9), më datë 03.10.2022 Administratori i OE “A ” Shpk, deklaroi se në rast se BOE do të shpallet fituese ne proecedurën me objekt: “Shërbimi i pastrimit të qytetit Kavajë dhe Njësie Administrative Synej, Luz i Vogël e Helmas”, Bashkia Kavajë.

Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedure disponimit të tyre, nuk do të jenë të angazhuara në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e ketij objekti. prokurimi, pavarësisht formës

Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.7 në DT. OE duhet të kenë në dispozicion apo që mund t’i vihet në dispozicion për të përmbushur kontratën ambient me sipërfaqe jo më e vogël se 1000 m<sup>2</sup> e cila do të shërbejë si pikë për parkim për mjetet dhe të tjera.

Operatori Ekonomik “A ” Shpk, ka paraqitur Kontratë Qiraje nr. 569 rep., nr. 2633 kol., datë 01.10.2022, me T.D , për marrjen e truallit të ndodhur në Rr. “Kisha Shënkolli”, me nr. 12/5 pasurie, Vol. 6, faqe 49, me sipërfaqe totale 1429m<sup>2</sup>, ZK. 8551, referuar Certifikatës së pronësisë të lëshuar nga ASHK Kavajë. “ky truall do shërbejë si pikë për parkimin e mjeteve dhe pikë larje dhe disinfektimi kazanësh deri në përfundim të objektit. Megjithëse është

kontartë tjetër i njëjti trual është paraqitur për objektin: “Shërbimi i pastrimit Njësia Administrative Golem”, Bashkia Kavajë.

Administratori i OE “A ” Shpk, ka deklaruar se Stafi Teknik i deklaruar në këtë procedurë prokurimi sipas formularit përmbledhës të vetdeklarimit, në rast se shpallet fitues nuk do të jetë i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

E.C - Ing. Mjedisi në të njëjtën kohë dhe drejtuese teknik e pranë shoqërisë.;

E.M- Ing Mekanike e punësuar pranë shoqërisë edhe në rolin e drejtueses teknike.

Z.T- Ekspert zjarrfikës i pajisur me certifikate

SH.F- Mjeku i shoqërisë.

Punonjës të kualifikuar deklaruar në këtë procedurë prokurimi, në rast se do të shpallemi fitues nuk do të jetë i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm realizimin e këtij objekti.

Administratori i OE “A ” Shpk, ka deklaruar më datë 15.05.2020 që: në përputhje me kërkesat e parashikuara për tenderin: “Shërbimi i pastrimit të Njësive Administrative Golem”, me fond limit : 255,581,960 (dyqind e pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë Tvsh, emëron si Drejtues Teknik te punimeve në objekt E.C dhe E.T të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve.

Autoriteti Kontraktor Bashkia Kavajë nuk janë kryer verifikimet rezervon të drejtën të kryeje verifikimin e nevojshëm mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga OE/BOE, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, date 19.05.021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

#### **Në lidhje me përdorimin e ujit:**

**Në zërat e punimeve që nevojitet për realizimin e shërbimit janë:** Larja e rrugëve me makinë teknologjike natën) dhe larja e dizifektim të kontenierëve. Konstatohet që vetëm për shërbimin “Larja e rrugëve me makinë teknologjike (ditën/natën)” është paguar mesatarisht 498 mijë lekë/muaj për realizimin e shërbimit të sipërcituar në Kavajë, ka harxhuar 18,816 m<sup>3</sup> ujë dhe përrealizimin e shërbimit në Njësive Administrative Synej, Luz i Vogël e Helmas është ka harxhuar 2,098 m<sup>3</sup> ujë/vit.

*(Larja duhet të bëhet me ujë me ngarkesë bakteriale jo më shumë se 200 E koli për 100ml ujë.) vetë për shërbimin e larjes së rrugëve (pa përfshirë larjen e makinerive dhe kontenierëve) dhe OE BOE “A ” Shpk & “A ” Shpk nuk na paraqiti asnjë kontratë nga “K ” Sha.*

*Standartin e harxhimit është 0,8 litër ujë për 1 m<sup>2</sup> rrugë për larjen e darkës dhe 0.6 litër ujë për m<sup>2</sup> për larjen e ditës. **Për 100 ditë x 31,656 m<sup>2</sup>x 0,6litër/m<sup>2</sup>=1,899,360 m<sup>3</sup> ujë/vit***

**Nga auditimi në terren u konstatua që për realizimin e shërbimit gjithsej 35 punonjës.**

**Në lidhje me kërkesën e Pikës 2.3.6.** në DT është kërkuar: Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: 1. Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht 70 (shtatëdhjetë) punonjës.

BOE duhet të ketë **70** (shtatëdhjetë) punonjës minimalisht për realizimin e kontratës

Referuar në proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës së shërbimit, si dhe numrin e punonjësve të nevojshëm në çdo rast, bazuar në analizën e kryer nevojiten, si më poshtë:

1. Shofere 10 persona, 7 shoferë të domosdoshëm për drejtimin e mjeteve teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor dhe 3 shoferë për drejtimin e 6 mjeteve të tjera teknologjike, të cilat kryejnë procese shërbimi jo ditor.

2. Për afrimin e kontenierëve pranë mjeteve teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor duhen për secilin mjet 2 persona, në total 14 persona.

3. Punëtorë për fshirjen e shesheve janë 32 persona në Kavajë dhe 14 persona në njesitë administrative Synej, Luz i Vogël dhe Helmas.

Nga auditimi i realizimit të shërbimit në objekt; *“Shërbimi i pastrimit të Qytetit Kavajë dhe Njësive Administrative Synej, Luz i Vogël e Helmas”*, Bashkia Kavajë, u konstatua se mungojnë:

- grafikët e punimeve të miratuara nga Autoriteti Kontraktor.
- faturat tatimore për blerjen e materialeve dhe pajisjet të llogaritura për shërbimin.
- listëprezencat për çdo ditë pune nga OE i shërbimit që detyrimisht duhet të ketë çdo ditë/natë në punë për realizimin e kontratës.
- kontrata për furnizimin me ujë me “K ” Sha.
- dokumentacioni që provon numrin minimal të makinerive, pajisjeve, numrin e kërkuar të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e prokurimit për të garantuar kryerjen në kohë dhe me cilësi të shërbimit.

Në përlllogaritjen e fondit limit (*ofertën fituese, përveç dy konstanteve; sipërfaqes së rrugëve e shesheve, numri i makinerive/pajisjeve dhe numrin e kontenierëve*), merret në konsideratë numri minimal i përditshëm i punonjësve dhe pajisje/makineri të domosdoshëm për realizimin e shërbimit. Mungon numri minimal i domosdoshëm i punonjësve të përlllogaritur/kërkuar/deklaruar për realizimin e kontratës

Fuqia punëtore që realizon shërbimi e pastrimit në Qytetin e Kavajës dhe Njësive Administrative Synej, Luz i Vogël e Helmas, është sa 50 % e fuqisë punëtore të përlllogaritur në fondin limit të shërbimit. ( $35/70 = 0.50$ )

Në përlllogaritjen e kostos për menaxhimin e mbetjeve në vit, kostoja personel zë 24.87 % të vlerës së përlllogaritur të shërbimit ( $677+1,222/2,246+5,389$ )

Kostua e mirëmbajtjes dhe amortizimit përbën për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit, zë 22.53 % ( $1,720/7,635$ ).

Nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Kavajë nuk janë kryer verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga OE/BOE, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, date 19.05.021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nuk janë zbatuar specifikimet teknike në zbatimin e shërbimit në përputhje me neni 12 të Kontrata me nr. 3568/3 prot., datë 09.12.2022 me objekt: “Shërbimi i pastrimit të Qytetit Kavajë dhe Njësive Administrative Synej, Luz i Vogël e Helmas”, Bashkia Kavajë

Diferenca në realizimin e kontratës, pasojë e mungesës së numrit minimal të punonjësve të domosdoshëm (*referuar Përlllogaritjes së FL, DT, Specifikimeve Teknike e Ofertës Fituese*) për realizimin e shërbimit me objekt: *“Shërbimi i pastrimit të Qytetit Kavajë dhe Njësive Administrative Synej, Luz i Vogël e Helmas”*, Bashkia Kavajë, nga zbatuesi i shërbimit BOE “A ” Shpk & “A ” Shpk.

**Sa më sipër BOE “A ” Shpk & “A ” Shpk, ka faturuar dhe është paguar për fuqinë punëtore që nuk e ka në dispozicion gjatë vitit 2023 (35 punonjës) për realizimin e kontratës me objekt: objekt: “Shërbimi i pastrimit të qytetit Kavajë dhe Njësive Administrative Synej, Luz i Vogël e Helmas”, Bashkia Kavajë vlerën **22,658,743.42 lekë pa Tvsh****

*Nga auditimi i situacionit të preventivuar, Përlllogaritjes së fondit limit, si dhe volumet të shërbimit (si dhe realizimit të shërbimit në fakt, rezultuan diferenca në volumin e shërbimit referuar numrit minimal të punonjësve që nevojiten për realizimin e shërbimit, me pasojë dëm ekonomik në buxhetit e Bashkisë Kavajë në vlerën **22,658,743.42 lekë pa Tvsh.***

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. **Z. R.K** , ish Kryetar i Bashkisë Kavajë.
2. **Z. F.Q** , Kryetar i Bashkisë Kavajë.
3. **Z. L.H** , ish Drejtor i Shërbimeve Publike.
4. **Z. B.SH** , Përgjegjës i Sektorit të Pastrimit

5. **Z. M.K** , Drejtor i Shërbimeve Publike.
6. **Z. M.K** , mbikëqyrës i kontratës së shërbimit.
7. **Z. T.D** , mbikëqyrës i kontratës së shërbimit.

Me shkresën nr. 176/31 prot., datë 23.04.2024, me nr. 34/14 prot., datë 13.05.2024 në KLSH nga Z. M.K , Drejtor i Shërbimeve Publike, ka paraqitur në lidhje me shërbimet e pastrimit.

**Pretendimet e subjektit:**

*Nga auditimi i kryer për vitin 2023 në faqen 189 të raportit në paragrafin e pestë të kësaj faqeje thuhet se si rezultat i numrit të mangut të puntorëve në kryerjen e shërbimit të pastrimit të Njesisë Administrative Golem për 13 punonjës mangut për rrjedhojë nuk është kryer shërbimi dhe dilet në konkluzion për dëm ekonomik për 12,719,126 lekë.*

*Sa më sipër nga kontaktet që kemi pasur me OE “A ” Shpk, rezulton se numri i punonjësve të paguar për sa më sipër është 27 ku një është përgjegjës, dhe në periudhën e verës meqënëse është zonë turistike numri i punonjësve rritet me 3 puntorë dhe 2 shofera me plus 5 veta.*

*Për kontraktuesin nuk kemi pasur ankesa për moskryerjen e shërbimit të pastrimit në Njesisë Administrative Golem.*

*Pretendimi për sasi mangut të fuqisë puntore nuk qëndronë, ju vëmë në dispozicion pagesat Nga auditimi i kryer për vitin 2023 në faqen 193 të Raportit në paragrafin e katërt të kësaj faqeje thuhet se si rezultat i numrit të mangut të puntorëve në kryerjen e shërbimit të pastrimit të Bashkisë Kavajë dhe të njësive administrative Synej, Luz i Vogël, Helmes për 35 punonjës mangut për rrjedhojë nuk është kryer shërbimi dhe dilet në konkluzion për dëm ekonomik për 22,658,743 lekë.*

*Sa më sipër nga kontaktet që kemi pasur me OE “A ” Shpk, rezulton se numri i punonjësve të paguar për sa më sipër është 56 punonjës dhe 14 punonjës të cilët paguhen nga kontraktuesi. Pra 70 punonjës.*

*Për kontraktuesin nuk kemi pasur ankesa për moskryerjen e shërbimit të pastrimit në Njesisë Administrative Golem.*

*Pretendimi për sasi mangut të fuqisë puntore nuk qëndron. ju vëmë në dispozicion pagesat. Sa më sipër te dy vlerat e dëmit ekonomik nuk qëndrojnë.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Grupi i auditimit e ka trajtuar realizimin e shërbimit të pastrimit hollësisht në aktkonstatime dhe projekt raportin e auditimit. Ju nuk keni paraqitur asnjë dokumentacion tekniko ligjor ku të vërtetoni që keni monitoruar/mbikëqyrur realizimin e shërbimit.

**Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe trajtohen në raportin përfundimtar të auditimit.**

**5. Zbatimit i punimeve në objektin “Rindërtimi i godinës së Bordit të Kullimit”, Bashkia Kavajë.**

Nga Bashkia Kavajë është dhënë Leja ndërtimit nr. 3665 prot., datë 02.09.2022, pas shqyrtimit të aplikimit për “Leje ndërtimi”, për objektin: “Rindërtim i Godinës së Bordit të Kullimit”

**Kontratat**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1236/2 prot., datë 20.05.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavajë, të përfaqësuar nga Titullari Z. R.K dhe Operatorit Ekonomik “SH ” Shpk, me përfaqësues z. SH.K, me licencë profesionale NZ.5586/8, datë 18.06.2018. Vlera e kontratës është 145,250,480 lekë. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore xx muaj nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve dhe hyrja në kantierin e ndërtimit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1536/2 prot., datë 20.05.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “C ” Shpk me përfaqësues z. V.M , me

nr. Licencë për mbikëqyrje/kolaudim punimesh MK 2049/8, datë 23.06.2022, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 1,670,000 lekë.

Projektpreventivi

Projektpreventivi i objektit është hartuar nga A.R në vitin 202.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 13.09.2022 dhe kanë përfunduar më datë 13.11.2023, brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 13.04.2022, sipas të cilit “...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lirë dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...”.

Punimet kanë përfunduar më datë 13.11.2023, dhe nuk janë marrë në dorëzim paraprak.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Rindërtim i godinës së Bordit të Kullimit”				
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 1236/2 prot., datë 20.05.2022	<b>15.Vlera e kontratës</b> 145,250,480 lekë OE fitues “SH” Shpk		<b>16. Likuiduar lekë</b> lekë	
<b>17- Situacioni Përfundimtar datë</b> <b>-Vlera me tvsh lekë</b>	<b>18.Afati I kontratës në dite</b> Parashikuar 14 muaj, Zbatuar ditë. Fillim i punimeve: 13.09.2022 Përfundim i punimeve 13.11.2023		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> nr. ext prot., date 10.04.2023 7 MUAJ	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> “C” Shpk	Licenca Nr: MK 2049/8,	Kontrata nr. 1536/2 prot., date 20.05.2022.	Vlera e Kontratës (me Tvsh) Lekë 1,670,000	Likuiduar leke
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> Emri Mbiemri:	Licenca Nr:	Kontrata nr.	Vlera e Kontratës (me Tvsh)	Likuiduar (me Tvsh)
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Datë	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim datë</b>			

- Njoftimi i përfundimit të punimeve nga sipërmarrësi është realizuar deri më datë 13.11.2023,  
- Bazuar në UKM nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu II, pika 10 citon se: *Mbikëqyrësi, me kërkesë të sipërmarrësit, vërteton në procesverbal datën e përfundimit të punimeve, sipas projektit, të ndryshimeve të urdhëruara e kushteve të kontratës, e cila në këtë periudhë ende nuk disponohej nga AK.*

- Bazuar në UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” pika 15 dhe kontratën e shërbimit mbikëqyrjes pika 18 citohet:

Sipërmarrësi duhet t’i njoftojë me shkrim mbikëqyrësit të punimeve përfundimin e punimeve. Me këtë rast, **brenda 30 ditëve**, ai i parqet mbikëqyrësit:

a. Kontratën dhe aktet që lidhen me të.

b. Regjistrimin e kontabilitetit.

c. Procesverbalet e fillimit, të ndërprerjes ose të zgjatjes dhe të përfundimit të punimeve.

ç. Certifikatat e provave të materialeve të përdorura, të lëshuara nga laboratorët e autorizuar për këtë qëllim.

d. Deklaratë se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe me kushtet teknike. Për të gjitha problemet e verifikuara prej tij, mbikëqyrësi i punimeve duhet të firmosë gjithçka që ka miratuar.

Dosja e plotë teknike duhet të dorëzohet në Autoritetin Kontraktor më datë 13.12.2022, që më pas të fillojë procedura e kolaudimit të objektit sipas udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 kreu II “Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit” pika 2 ku citohet:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit caktohet nga investitori, i cili duhet t’ia komunikojë, me shkrim, këtë person apo grup personash, Sekretariatit Teknik të KRRT-së, pranë zyrës dhe seksionit urbanistik përkatës në rreth, **brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të punimeve.**

Në dosje nuk administrohet asnjë dokumentacion për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit. Ky veprim është në kundërshtim me UKM nr .2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e

punimeve të ndërtimit”, kreu II, pika 10.2, sipas të cilës “...Sipërmarrës i është përgjegjës për drejtimin, mbajtjen në gatishmëri, riparimin, mirëmbajtjen, ruajtjen e punimeve të ndërtim-montimit të objektit e të kantierit, deri në nënshkrimin e procesverbalit të kolaudimit. Objekti merret në dorëzim në datën e nënshkrimit të procesverbalit të kolaudimit”. Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi z. F.Q Kryetari i Bashkisë Kavajë.

Para fillimit të punimeve në objekt dhe gjatë realizimit të punimeve konstatohet që nuk ka asnjë bashkëpunim ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës në Bashkinë Kavajë, IMT, sipërmarrësit të punimeve, projektuesit dhe mbikqyrësit të punimeve. Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 9 të ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (i përditësuar), pikat 3, 3.1, 7, 7.1, 11, 11.1, 11.2, 11.3 e 11.4 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe pika 4 e Udhëzimit nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit.”

Nga auditimi i zbatimit në terren u konstatua që punimet nuk kishin përfunduar: Punimet për sistemimin e ajrimit kondicionimit; Punimet për ndërtimin e kabanonit; Nuk ishte vendosur ashensori etj. Në objekt vazhdonin punimet nga punëtorët e OE “SH ” Shpk.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

**1. Z. V.M**, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

### **Pika 2.5 e programit: Mbi organizimin, funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.**

Bashkia Kavajë ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 2, datë 27.04.2018, i ndryshuar me Vendimin KKT nr. 4, datë 25.04.2023.

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. Dhënia e lejes së zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura
2. Dhënia e lejes së ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik
3. Saktësia e llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë
4. Dhënia e certifikatës së përdorimit
5. Deklaratat paraprake për kryerje punimesh.

#### **➤ Lejet e ndërtimit, zhvillimit dhe certifikatat e përdorimit për vitin 2023**

Në bazë të informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Kavajë, gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 31.12.2023 janë miratuar **61 leje zhvillimi**, **21 leje ndërtimi** për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup>, **45 leje ndërtimi** për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m<sup>2</sup>, **6 leje ndërtimi** për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup>, **18 leje ndërtimi** për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m<sup>2</sup>, **203 deklarata** paraprake përkryerje punimesh dhe **25 certifikata përdorimi**, të paraqitura në Aneksin L1, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKTZH e Bashkisë Kavajë, leje për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup> dhe certifikatat e përdorimit, janë të paraqitura në Aneksin L2, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për tu audituar rastet e lejeve së ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup> dhe certifikatat e përdorimit, të paraqitur në Aneksin L3, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

- Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan **4 praktika** tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosrespektimin e kriterëve të përcaktuara në Planin e

Përgjithshëm Vendor dhe në Planin e Detajuar Vendor, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se nuk respektohen kriteret e përcaktuar në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe ato të përcaktuara në Planin e Detajuar Vendor, të tilla si koeficienti i shfrytëzimit të territorit, intensiteti i ndërtimit, lartësia e ndërtimit, distancat dhe tipologjia e lejuar sipas njësisë strukturore përkatëse. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuara për leje ndërtimi, me objekt:

**1. Objekti me destinacion:** “Strukturë akomoduese 5 dhe 6 katëshe + 2 kat nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 4881, datë 04/12/2023, me zhvillues shoqëria “L ” Shpk, në adresën rruga Mali i Robit, Golem, Kavajë.

- Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin nr. 4808, datë 04.10.2023. Parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore **G1-A23-11**, në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor. Planvendosja e miratuar nuk përkon me konfigurimin e gjurmës së projektit të ndërtimit. Nga verifikimi i projektit të ndërtimit evidentohen që, në planvendosjen e miratuar nuk janë reflektuar të gjitha sipërfaqet e ndërtimit dhe nuk pasqyrohet e plotë gjurma e katit përdhe, me kuotë  $\pm 0.00$ , në mospërputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 15, pika 1, gërma “c”, plani i vendosjes së ndërtimit. Mospasqyrimi i plotë i gjurmës së ndërtimit ndikon në rritjen e koeficientit të shfrytëzimit të territorit të lejuar.

- Duke u bazuar në PPV të njësisë **G1-A23-11**, koeficienti i shfrytëzimit të territorit i lejuar është **50%**. Në bazë të verifikimit në autocad (DËG) të planvendosjes së miratuar rezulton se sipërfaqja e njollës së objektit është 1821,3 m<sup>2</sup> dhe KSHT-ja është 74%, duke tejkalluar koeficientin e lejuar të njësisë.

- Bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të miratuar me Vendimin e KKT-së nr. 2, datë 27.04.2018, i ndryshuar me Vendimin nr. 4, datë 25.04.2023, të njësisë **G1-A23-11**, intensiteti i lejuar i ndërtimit është 3. Për sipërfaqen e parcelës 2459.4 m<sup>2</sup>, në të cilën zhvillohet ndërtimi i ri, me intensitetin e lejuar 3, sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë e lejuar është 7378.2 m<sup>2</sup>. Në bazë të verifikimit në autocad (dëg) të projektit të ndërtimit të miratuar u konstatua që sipërfaqja e ndërtimit nuk përputhej me të dhënat e pasqyruara në tabelën e treguesve të zhvillimit të pasqyruar në planvendosjen e miratuar. Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë nga 1823.8 m<sup>2</sup>, rezulton të jetë 7981.8 m<sup>2</sup>, duke shtuar 603.6 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi mbi sipërfaqen e lejuar. Diferenca në sipërfaqe ndikon në rritjen e intensitetit të ndërtimit, duke e tejkalluar atë **nga 3 i lejuar për njësinë përkatëse, në 3.25**, në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 38 dhe Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar me vendimin e KKT-së nr. 2, datë 27.04.2018, i ndryshuar me Vendimin nr. 4, datë 25.04.2023.

- Nga verifikimi i projektit të ndërtimit dhe relacionit teknik, evidentohet që lartësia e kateve të objekteve tejkallon lartësinë e 6 kateve, në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 37, pika 3, gërma a dhe gërma c, në të cilin përcaktohet që: “Lartësia dysHEME–hapësirë shërbimi është 5.44 metra, duke e tejkalluar me 1.44 metra. Në sipërfaqen më të madhe dysHEME për katet banim është minimumi 3.00 m.” dhe “Kati për përdorim shërbimi, lartësia minimale dysHEME–dysHEME është 4.00 m.” Lartësia e katit përdhe nga 4.00 metra që duhet të ishte për të katit përdhe janë pozicionuar njësi të banimit, në të cilën lartësia e katit nga 3.00 metra e lejuar është 5.44 metra, me një diferencë prej 2.44 metra më e lartë, duke tejkalluar lartësinë e lejuar të kateve.

- Në raport me tipologjinë e ndërtimit, leja e ndërtimit është miratuar për zhvillimin e një strukture akomoduese, por nga shqyrtimi i projektit të ndërtimit dhe relacionit teknik konstatohet që tipologjia e ndërtimit nuk i plotëson të gjitha kriteret e strukturave akomoduese në bazë të Vendimit nr. 730, datë 20.10.2016, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifatat dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, i ndryshuar. Ndërsa



në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, kategoria e përdorimit për njësinë G1-A23-11 përcaktohet si dendësi e mesme dhe e larte banimi dhe në përdorimet e lejuara përcaktohet si zonë për rihvillim.

**Për sa më lart, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:** Z. R.K , Kryetar i Bashkisë Kavajë; Znj.D.Q , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga periudha 01.01.2023; Z. G.XH , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, nga periudha 15.08.2023 e në vijim; Znj. A.H , me detyrë specialist në DPKZHT, për periudhën 01.01.2023 e në vijim.;

**2. Objekti me destinacion:** “Strukturë akomoduese 5 kat me 1 kat podrum”, miratuar me vendimin nr.4249, datë 14.04.2023, me zhvillues shoqëria “D ” Shpk, në adresën rruga Mali i Robit, Golem, Kavajë.

- Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin nr. 3721, datë 21/06/2022. Parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore **G1-S1-08**, për të cilën është miratuar Plani i Detajuar Vendor me Vendimin nr. 04, datë 16.03.2022.

- Bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të miratuar me Vendimin e KKT-së nr.2, datë 27.04.2018, i ndryshuar me Vendimin nr.4, datë 25.04.2023, të njësisë **G1-S1-08**, intensiteti i lejuar i ndërtimit është 2. Për sipërfaqen e parcelës 5450 m<sup>2</sup>, në të cilën zhvillohet ndërtimi i ri, me intensitetin e lejuar 2, sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë e lejuar është 10.900 m<sup>2</sup>. Në bazë të verifikimit në autocad (dëg) të projektit të ndërtimit të miratuar u konstatua që sipërfaqja e ndërtimit nuk përputhej me të dhënat e pasqyruara në tabelën e treguesve të zhvillimit të pasqyruar në planvendosjen e miratuar. Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë nga 10900 m<sup>2</sup>, rezulton të jetë 12984 m<sup>2</sup>, duke shtuar 2084 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi mbi sipërfaqen e lejuar. Diferenca në sipërfaqe ndikon në rritjen e intensitetit të ndërtimit, duke e tejkaluar atë nga 2 i lejuar për njësinë përkatëse, në 2.38, në kundërtim me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 38 dhe Planin e Detajuar Vendor të miratuar me Vendimin nr. 04, datë 16.03.2022.

- Nga verifikimi i projektit të ndërtimit dhe relacionit teknik, evidentohet që objekti nuk është në lartësinë e 5 kateve si përcaktohet në planvendosje dhe në të dhënat e treguesve të zhvillimit, por në lartësinë e **6 kateve** të ndërtimit, në kundërshtim me lartësinë e kateve të përcaktuara në Planin e Detajuar Vendor të miratuar me Vendimin nr. 04, datë 16.03.2022. Gjithashtu në bazë të VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 37, pika 3, gërma a, përcaktohet që: “Lartësia dysheme–dysheme për katet banim është minimumi 3.00 m.” Lartësia e katit përdhe dhe lartësia e katit të parë nuk plotësojnë lartësinë minimale të katit për hapësirat e banimit.

- Nga verifikimi i projektit të ndërtimit dhe relacionit teknik evidentohet që tipologjia e ndërtimit nuk plotëson kriteret e strukturave akomoduese në bazë të Vendimit nr. 730, datë 20.10.2016, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifën, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, i ndryshuar. Në bazë të projektit të ndërtimit propozohen 4 godina banimi, që përfshijnë disa apartamente të tipit 2+1 dhe 1+1. Në asnjërën nga godinat nuk ofrohen shërbime dhe hapësira ndihmëse në funksion të shërbimit akomodues të ofruar. Nga ana tjetër, vetë kontrata me nr. Rep. 489, nr. Kol. 268, datë 25.01.2023, ndërmjet sipërmarrësit shoqëria D dhe pronarit Z. A.K nuk siguron mundësinë e zhvillimit të pronës sipas përdorimit të lejuar (Zonë shërbimesh dhe hoteleri). Konkretisht, nga njëra anë, marrëveshja midis sipërmarrësit dhe pronarit të trullit i garanton këtij të fundit një sipërfaqe takuese të objektit të përfunduar, nga ana tjetër pronari i trullit nuk ka asnjë detyrim ligjor që të respektojë destinacionin apo përdorimin e lejuar të sipërfaqes që do të marrë në pronësi sipas kontratës së sipërcituar.

-Gjithashtu në marrëveshjen e realizuar me pronarin e tokës, në tipologjinë e ndërtimit përshkruhet që **objekti është kompleks banimi, në mospërputhje me përdorimet e lejuara**

në bazë të Planit të Detajuar Vendor për njësinë G1-S1-08, në të cilën zonat e shërbimit S1 përfshijnë zona me shërbime bare restorante dhe qendra tregtare në funksion të turizmit dhe zona ku lejohen shërbime akomodimi, si dhe shërbime komplementare të lidhura me hotelerinë.

**Për sa më lart, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:** Z. R.K , Kryetar i Bashkisë Kavajë; Znj. D.Q , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga periudha 01.01.2023; Z. H.Z , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, për periudhën 01.01.2023-27.07.2023.

**3. Objekti me destinacion:** “Struktura banimi 2 kat + 1 kat nëntokë (podrum)(katër struktura banimi)”, miratuar me vendimin rr. 4892, datë 09.11.2023, me zhvillues R & S.V, në adresën Lagja nr 2 Rruga "Metalikes", Kavajë.

- Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin nr. 4756, datë 19.09.2023. Parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore **K2-A41-01**, për të cilën është miratuar Plani i Përgjithshëm Vendor. Në bazë të kondicioneve urbane të parashikuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, parashikohet që përpara miratimit të lejes së ndërtimit të realizohet Plan i Detajuar Vendor për njësinë **K2-A41-01**. **Leja e ndërtimit është miratuar pa pasur një Plan të Detajuar Vendor.**

- Referuar VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 14 “Kushtet për lëshimin e lejes së ndërtimit”, pika 3, në të cilën përcaktohet që dhënia e lejes së ndërtimit kushtëzohet nga ekzistenca e infrastrukturës kryesore dhe dytësore në njësinë ku kërkohet ndërtimi. Në planvendosjen e miratuar evidentohet që, pozicionimi i parcelës në të cilën do të zhvillohet objekti i propozuar, **nuk ka akses nga infrastruktura.**

**Për sa më lart, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:** Z. F.Q , Kryetar i Bashkisë Kavajë; Znj.D.Q , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga periudha 01.01.2023; Z. G.XH , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, nga periudha 15.08.2023 e në vijim; Znj. A.H , me detyrë specialist në DPKZHT, për periudhën 01.01.2023 e në vijim.

**4. Objekti me destinacion:** “Strukturë Turistike, 6 Kat me 1 kat nën tokë”, miratuar me vendimin Nr. 4934, datë 04/01/2023, me zhvillues shoqëria “C ” Shpk, në adresën Golem, Kavajë.

- Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin nr. 4808, datë 04.10.2023. Parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore **G1-A21-13**, në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor. Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të miratuar me Vendimin e KKT-së nr. 2, datë 27.04.2018, i ndryshuar me Vendimin nr. 4, datë 25.04.2023, të njësisë G1-A21-13, **përdorimi i lejuar është zona me banesa kolektive.** Nga shqyrtimi i projektit të ndërtimit dhe relacioni teknik, objekti është strukturë banimi dhe me shërbime, ndonëse leja është miratuar për strukturë turistike. Objekti duhet të klasifikohet në tipologjinë e banesës kolektive, në ndryshim nga leja e miratuar.

- Nga verifikimi i planvendosjes së miratuar **distanca minimale që duhet të respektohet ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës për objektin në lartësinë e 6 kateve është 7 metra**, në bazë të VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 35, pika 1. Nga verifikimi i planvendosjes së miratuar, distanca në orjentimin lindor është 3.16 metra dhe 6.29 metra, në orjentimin jugor 5.03m; 5.70m; 5.00m dhe në orjentimin perëndimor 5.13m; 5.16m; 27.17m, **duke mos respektuar distancën e lejuar nga kufiri i pronës.**

- Në planvendosjen e miratuar nuk janë pasqyruar të gjitha distancat e objektit nga trupi i rrugës. Në orjentimin verior, distanca nga trupi i rrugës **është më e vogël se 3 metra** në skajin e objektit, në mospërputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së

zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 36, pika 3/b, në të cilën përcaktohet që duhet respektuar distanca minimale nga trupi i rrugës **prej 3 metrash**.

- Nga verifikimi i projektit të ndërtimit evidentohet që lartësia e katit përdhe është në lartësinë e 5.40 metra edhe në sipërfaqen e banimit, jo vetëm në sipërfaqen e shërbimit, në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 37, pika 3, gërma “a” dhe gërma “c”, në të cilin përcaktohet që: “Lartësia dysHEME–dysHEME për katet banim është minimumi 3.00 m.” dhe “Kati për përdorim shërbimi, lartësia minimale dysHEME–dysHEME është 4.00 m.” Lartësia e katit përdhe nga 4.00 metra që duhet të ishte për hapësirë shërbimi është 5.44 metra, duke e tejkaluar me 1.44 metra. Në sipërfaqen më të madhe të katit përdhe janë pozicionuar njësi të banimit, në të cilën lartësia e katit nga 3.00 metra e lejuar është 5.44 metra, me një diferencë prej 2.44 metra më e lartë, duke tejkaluar lartësinë e lejuar të kateve.

Veprimet e sipërcituara, nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: - Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 20, Plani i Përgjithshëm Vendor

- Plani i Përgjithshëm Vendor dhe Rregullorja e Planit të miratuar me Vendimin e KKT-së nr. 2, datë 27.04.2018, i ndryshuar me Vendimin nr. 4, datë 25.04.2023

- Plani i Detajuar Vendor me Vendimin nr. 04, datë 16.03.2022.

- VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 38, Intensiteti i ndërtimit

- VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 39, Koeficienti i shfrytëzimit të territorit për ndërtim.

- VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 37, pika 3, gërma a dhe gërma c, Lartësia e ndërtimeve.

- VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 35, pika 1, Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës.

- VKM nr 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 36, pika 3/b, Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe trupit të rrugës.

-Vendimit nr. 730, datë 20.10.2016, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, i ndryshuar.

**Për sa më lart, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Z. F.Q , Kryetar i Bashkisë Kavajë; Znj. D.Q , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga periudha 01.01.2023; Z. G.XH , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, nga periudha 15.08.2023 e në vijim; Z. B.SH , me detyrë specialist në departamentin e DPKZHT-së, nga periudha 15.08.2023;**

➤ Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 2 praktika tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me pavlefshmërinë e dokumentacionit të pronësisë dhe kufizime të pronësisë në kartelën e pasurisë së paluajtshme, përpara miratimi të lejes të ndërtimit.

Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në dokumentacionin e pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje dokumentacioni i pronësisë nuk është i vlefshëm dhe në rastin tjetër ka kufizim të pronësisë, në mospërputhje me legjislacionin në fuqi për miratimin e lejeve të ndërtimit. Gjetjet e konstatuara u evidentuan në rastet e mëposhtme të miratuar me objekt:

**1. Objekti me destinacion:** “Strukturë akomoduese 5 dhe 6 katëshe + 2 kat nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 4881, datë 04.12.2023, me zhvillues shoqëria “L ” Shpk, në adresën rruga Mali i Robit, Golem, Kavajë. Në bazë të VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 15, pika 1, gërma “b”, përcaktohet që pjesë e dokumentave që duhet të dorëzohen janë ato që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta; Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, **dokumentat e pronësisë të paraqitura janë të klasifikuara si “të pavlefshme”, “jo**

zyrtare/për konsultim”, duke mos disponuar dokumentacion pronësie të vlefshëm për sipërfaqen në të cilën aplikohet për leje ndërtimi. Gjithashtu në bazë të VKM nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, neni 21, pika 6, përcakton që: “...informacioni, që mundësojnë drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën”. Në kërkesën për mendim drejtuar AShK-së Kavajë, institucioni nuk është përgjigjur dhe nuk ka shprehur dakortësinë.

**Për sa më lart, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:**

Z. R.K , Kryetar i Bashkisë Kavajë;

Znj.D.Q , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga periudha 01.01.2023;

Z. G.XH , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, nga periudha 15.08.2023 e në vijim;

Znj. A.H , me detyrë specialist në DPKZHT, për periudhën 01.01.2023 e në vijim.

**2. Objekti me destinacion:** “Struktura banimi 2 kat + 1 kat nëntokë (podrum)(katër struktura banimi)”, miratuar me vendimin nr. 4892, datë 09.11.2023, me zhvillues R & S.V , në adresën Lagja nr 2 Rruga “Metalikes”, Kavajë. Në bazë të VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 15, pika 1, gërma “b”, përcaktohet që pjesë e dokumentave që duhet të dorëzohë janë ato që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta; Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, në kartelën e pasurisë të paluajtshme, në pikën D, në seksionin e **kufizimit të pronësisë, pronësia është kufizuar me urdhër nr. 514, datë 15.06.2022.**

Veprimet e sipërcituara, nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 15, në pikën 1, gërma “b”.

-VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 21, pika 6.

-Ligji nr. 111/2018, datë 7.2.2019 “Për kadastrën”, neni 17, pika 4.

**Për sa më lart, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:**

Z. F.Q , Kryetar i Bashkisë Kavajë;

Znj. D.Q , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga periudha 01.01.2023;

Z. G.XH , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, nga periudha 15.08.2023 e në vijim; Znj.

A.H , me detyrë specialist në DPKZHT, për periudhën 01.01.2023 e në vijim.

➤ Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 3 praktika tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mungesën e marrjes së miratimeve dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, të paraqitura e ngarkuara në sistemin e-leje gjatë aplikimit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi.

Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua që në lejen e ndërtimit të miratuar nuk janë marrë miratimet nga institucionet përkatëse, gjetje e cila u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuara për leje ndërtimi, me objekt:

**1. Objekti me destinacion:** “Strukturë akomoduese 5 dhe 6 katëshe + 2 kat nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 4881, datë 04.12.2023, me zhvillues shoqëria “L ” Shpk, në adresën rruga Mali i Robit, Golem, Kavajë. Në bazë të shkresës me nr. 3772 prot., datë 03.10.2023, lidhur me “Mbi kontrollin e konformitetit për pajisjen me Leje Zhvillimi për objektin:

“Strukturë akomoduese 6 dhe 5 katëshe plus 2 kat parkim nëntokë” me vendndodhje në territorin e Bashkisë Kavajë, me zhvillues shoqëria “L ” Shpk, Agjencia e Zhvillimit të Territorit shprehet se: “Bashkia Kavajë si autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit, mund të vijojë, sipas fushës së kompetencës, shqyrtimin dhe vlerësimin për pajisjen me Leje Zhvillimi, vetëm nëse projekt-propozimi është në përputhje me kriteret dhe standardet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kavajë miratuar me Vendimin nr. 2, datë 27.04.2018, **vetëm pas përmirësimit të projektit arkitektonik**, si dhe legjislacionin sektorial në fuqi.” Në bazë të mendimit të institucionit nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, nevojitet të rishikohet projekti arkitektonik, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në bazë të dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje, projekti arkitektonik nuk plotëson kondicionet urbane sipas Planit të Përgjithshëm Vendor dhe nuk është marrë në konsideratë mendimi i institucionit, në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 21, pika 6.

**Për sa më lart, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:**

Z. R.K , Kryetar i Bashkisë Kavajë;

Znj. D.Q , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga periudha 01.01.2023;

Z. G.XH , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, nga periudha 15.08.2023 e në vijim;

Znj. A.H , me detyrë specialist në DPKZHT, për periudhën 01.01.2023 e në vijim.

**2. Objekti me destinacion:** “Strukturë akomoduese 5 kat me 1 kat podrum”, miratuar me vendimin nr. 4249, datë 14.04.2023, me zhvillues shoqëria “D ” Shpk, në adresën rruga Mali i Robit, Golem, Kavajë. Referuar VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 21 “Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor”, pika 6, autoriteti vendor duhet të marrë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Nga kontrolli i dokumentacionit në lidhje me sa më lartë cituar, rezulton se nuk është kërkuar mendimi i OSHEE, Ujësjiellës Kanalizime dhe PMNZSH, mbi marrjen e konformitetit për vijimin e procedurës së lejes së ndërtimit.

**Për sa më lart, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:**

Z. R.K , Kryetar i Bashkisë Kavajë;

Znj. D.Q , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga periudha 01.01.2023;

Z. H.Z , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, për periudhën 01.01.2023-27.07.2023.

**3. Objekti me destinacion:** “Strukturë Turistike, 6 Kat me 1 kat nën tokë”, miratuar me vendimin Nr. 4934, datë 04/01/2023, me zhvillues shoqëria “C ” Shpk, në adresën Golem, Kavajë. Në bazë të shkresës me nr. 4398 prot., datë 06.12.2023, lidhur me “Mbi kontrollin e konformitetit për pajisjen me Leje e ndërtimit për objektin: “Strukturë turistike 6 kat me 1 kat nëntokë” me vendndodhje në territorin e Bashkisë Kavajë, me zhvillues shoqëria “C ” Shpk, me vendndodhje në territorin e Bashkisë Kavajë, me zhvillues shoqëria “C ” Shpk, Agjencia e Zhvillimit të Territorit shprehet se: “Bashkia Kavajë si autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit, mund të vijojë, sipas fushës së kompetencës, shqyrtimin dhe vlerësimin për pajisjen me leje ndërtimi, vetëm nëse projekt-propozimi është në përputhje me kriteret dhe standardet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kavajë miratuar me Vendimin nr. 2, datë 27.04.2018, **me kushtin e përmirësimit të projektit arkitektonik, si dhe legjislacionin sektorial në fuqi.**” Në bazë të mendimit të institucionit nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, nevojitet të rishikohet projekti arkitektonik, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në bazë të dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje, projekti arkitektonik nuk plotëson kondicionet urbane sipas Planit të Përgjithshëm Vendor dhe nuk është marrë në konsideratë mendimi i institucionit, në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 21,

pika 6. Në kërkesën për miratimin e institucioneve nuk është marrë miratimi nga Drejtoria e Bordit të Kullimit, pasi në kufirin lindor objekti kufizohe nga një kanal kullimi dhe nevojitet miratimi i tyre në bazë të VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 21, pika 6.

Veprimet e sipërcituara, nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

- VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 21, pika 6.

**Për sa më lart, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:**

Z. F.Q , Kryetar i Bashkisë Kavajë;

Znj. D.Q , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga periudha 01.01.2023;

Z. G.XH , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, nga periudha 15.08.2023 e në vijim; Z.

B.SH , me detyrë specialist në departamentin e DPKZHT-së, nga periudha 15.08.2023.

➤ Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua **1 praktikë** tek e cila tipologjia e ndërtimit mund të jetë e ndryshme nga përcaktimi i destinacionit sipas lejes së ndërtimit të miratuar.

Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua që destinacioni i objektit i përcaktuar në lejen e ndërtimit mund të ndryshojë në momentin e përdorimit, me objekt:

**1. Objekti me destinacion:** “Strukturë akomoduese 5 dhe 6 katëshe + 2 kat nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 4881, datë 04/12/2023, me zhvillues OE “L ” Shpk, në adresën rruga Mali i Robit, Golem, Kavajë; Leja e ndërtimit është miratuar për zhvillimin e një strukture akomoduese, por nga shqyrtimi i projektit të ndërtimit dhe relacionit teknik evidentohet që tipologjia e ndërtimit nuk plotëson kriteret e strukturave akomoduese në bazë të Vendimit nr. 730, datë 20.10.2016, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifafat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, i ndryshuar. Ndërsa në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, kategoria e përdorimit për njësinë G1-A23-11 përcaktohet si dendësi e mesme dhe e larte banimi dhe në përdorimet e lejuara përcaktohet si zonë për rizhvillim. Me ndryshimin e përcaktimit të tipologjisë së ndërtimit dhe funksionit të objektit të ri që do të ndërtohet, ndryshon edhe mënyra e përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe shmang detyrimin për kontributit e sektorit privat në krijimin e fondit publik, me sigurimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3 % të sipërfaqes funksionale. Në këtë praktikë llogaritja e TNI është kryer sipas destinacionit dhe tipologjisë të deklaruar nga aplikuesi, ndërkohë që, duke ju referuar projektit të ndërtimit, ky i fundit paraqet detaje sipas të cilave destinacioni përfundimtar i ndërtimit mund të jetë i ndryshëm nga ai i deklaruar. Dhënia e një destinacioni përfundimtar të ndryshëm nga ai i deklaruar ndikon në mënyrën e llogaritjes së TNI-së si dhe eventualitetin apo mundësinë e aplikimit ndaj subjektit përfitues të nenit 19, pika 1 të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”.

Veprimet e sipërcituara, nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

- Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Neni 27, taksa e ndikimit në infrastrukturë;

- Ligjin nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 46, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;

-Vendimi i Këshillit Bashkiak Kavajë, nr. 107, datë 22.11.2022, mbi “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë”;

- Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social”, datë 03.5.2018, Neni 19, pika 1.

**Për sa më lart, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:**

Z. R.K , Kryetar i Bashkisë Kavajë;

Znj. D.Q , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga periudha 01.01.2023;

Z. G.XH , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, nga periudha 15.08.2023 e në vijim;  
Znj. A.H , me detyrë specialist në DPKZHT, për periudhën 01.01.2023 e në vijim.

- Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua **1 praktikë** tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mosrealizimin e marrëveshjes për 3% të sipërfaqes funksionale për kontributin e sektorit privat në favor të krijimit të fondit publik të banesave sociale, pasi nuk është përcaktuar në mënyrën e duhur tipologjia e ndërtimit dhe destinacioni i përcaktuar në lejen e ndërtimit nuk është në përputhje me përdorimet e lejuara të njësisë strukturore përkatëse, sipas PPV të Bashkisë Kavajë.

Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në bazë të përdorimit të lejuar sipas përcaktimeve të Planin të Përgjithshëm Vendor dhe tipologjisë së objektit sipas projektit të ndërtimit, nuk është realizuar marrëveshja për kontributin privat në favor të fondit publik të banesave sociale, në të cilën zhvilluesi është subjekt i përcaktimeve të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratuar për leje ndërtimi, me objekt:

**1.Objekti me destinacion:** “Strukturë Turistike, 6 Kat me 1 kat nën tokë”, miratuar me vendimin nr. 4934, datë 04.01.2023, me zhvillues shoqëria “C ” Shpk, në adresën Golem, Kavajë. Në raport me tipologjinë e ndërtimit, leja e ndërtimit është miratuar për zhvillimin e një strukture turistike, por nga shqyrtimi i projektit të ndërtimit dhe relacionit teknik evidentohet që tipologjia e ndërtimit është banesë kolektive me shërbime, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor. Me ndryshimin e përcaktimit të tipologjisë së ndërtimit dhe funksionit të objektit të ri që do të ndërtohet, ndryshon edhe mënyra e përlllogaritjes e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe shmang detyrimin për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik, me sigurimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3 % të sipërfaqes funksionale. Në bazë të **Ligjit nr.22/2018**, “Për strehimin social”, datë 3.5.2018, Neni 19, pika 1, përcaktohet që: “Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi **për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë**, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t’u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.” Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Bashkia Kavajë, leja e **ndërtimit e miratuar me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 metra katrorë**, nuk ka realizuar marrëveshjen ndërmjet bashkisë Kavajë dhe subjektit zhvillues, për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik, me sigurimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3 % të sipërfaqes funksionale. Sipërfaqja e banimit mbi tokë të objektit që do të zhvillohet është **10326.5 metra katrorë, prej të cilës 3% e sipërfaqes së saj duhet t’i kalojë bashkisë pa shpërblim, një sipërfaqe prej 309.8 m<sup>2</sup>** ose e shprehur në vlerë monetare si referencë është 309.8 x 51,000 lekë/m<sup>2</sup> (çmimi i shitjes për metër katror) = **15,799,545 lekë**. Veprimet e sipërcituara, nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

- Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social”, datë 3.5.2018, Neni 19, pika 1.

**Për sa më lart, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:**

Z. F.Q , Kryetar i Bashkisë Kavajë;

Znj. D.Q , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga periudha 01.01.2023;

Z. G.XH , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, nga periudha 15.08.2023 e në vijim; Z.

B.SH , me detyrë specialist në departamentin e DPKZHT-së, nga periudha 15.08.2023.

- Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua **2 praktika** tek e cila pasqyrohej situata, në lidhje me mosllogaritjen në mënyrën e duhur të taksës së ndikimit në infrastrukturë, në bazë të përdorimit të lejuar sipas Planit të Përgjithshëm Vendor dhe nga verifikimi i sipërfaqeve të ndërtimit sipas projektit të ndërtimit të miratuar.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit, u konstatuan **2 praktika** në të cilat taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është përllogaritur në mënyrën e duhur, pasi në një rast tipologjia e ndërtimit nuk është në përputhje me përdorimet e lejuara sipas njësisë strukturore të PPV-në të Bashkisë Kavajë dhe në rastin tjetër janë evidentuar ndryshime të sipërfaqeve të ndërtimit nga verifikimi i projektit të ndërtimit. Gjetjet e konstatuara u evidentuan në rastet e mëposhtme të miratuar për leje ndërtimi, me objekt:

**1.Objekti me destinacion:** “Strukturë Turistike, 6 Kat me 1 kat nën tokë”, miratuar me vendimin nr. 4934, datë 04/01/2023, me zhvillues shoqëria “C ”.

, në adresën Golem, Kavajë. Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se mënyra e përllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur, referuar Nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si rrjedhojë, Nenit 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, pika 1, marrim informacionin se: “Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri.”, si dhe pika 2: “Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri në 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror”. Sipas VKB Kavajë me nr.107, datë 22.11.2022, mbi “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë”, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja për qëllime banimi apo për njësi tregëtimi dhe shërbimi është 4% mbi çmimin e shitjes për metër katror. Fatura e përllogaritur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Bashkisë Kavajë është **13,396,453 lekë**, ndërsa llogaritja e saktë ka vlerën **26,316,918 lekë**. Mënyra e përllogaritjes nuk është e rregullt, pasi është realizuar duke ju referuar një destinacioni të strukturës në funksion të turizmit, ndërsa objekti është në funksion të banimit. Gjithashtu në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, përdorimi i lejuar i njësisë strukturore **G1-A21-13** është zona të formuara me banesa kolektive. Diferenca ndërmjet dy vlerave të mësipërme prej **12,920,465 lekë** përbën të ardhura të munguara shkaktuar Bashkisë Kavajë.

**Për sa më lart, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:**

**Z. F.Q** , Kryetar i Bashkisë Kavajë;

**Znj. D.Q** , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga periudha 01.01.2023;

**Znj. B.A** , me detyrë specialisti në sektorin e DPKSHT-së, për periudhën 01.01.2023-01.08.2023.

**2.Objekti me destinacion:** “Strukturë akomoduese 5 kat me 1 kat podrum”, miratuar me vendimin nr. 4249, datë 14/04/2023, me zhvillues shoqëria “D ” Shpk, në adresën rruga Mali i Robit, Golem, Kavajë. Nga verifikimi i projektit të ndërtimit u konstatuan diferenca në sipërfaqen e ndërtimit, pasi nuk janë përfshirë të gjitha sipërfaqet ndërtimore të objektit.Referuar Nenit 46 të Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si rrjedhojë, Nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, pika 1, marrim informacionin se: “Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri”. Sipas VKB Kavajë me nr. 107, datë 22.11.2022, mbi “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë”, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit është 3% e vlerës së preventivit. Fatura e përllogaritur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Bashkisë



Kavajë është **14,615,466 lekë**, ndërsa llogaritja e saktë ka vlerën **16,932,177 lekë**. Diferenca ndërmjet dy vlerave të mësipërme prej **2,316,711 lekë** përbën dëm ekonomik shkaktuar **Bashkisë Kavajë**.

Veprimet e sipërcituara, nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Neni 27, taksa e ndikimit në infrastrukturë;

- Ligji nr. 107/2014, datë 31.7.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", neni 46, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;

- VKB Kavajë, nr. 107, datë 22.11.2022, mbi "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë";

**Për sa më lart, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:**

Z. R.K , Kryetar i Bashkisë Kavajë;

Znj. D.Q , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga periudha 01.01.2023; Znj. B.A , me detyrë specialisti në sektorin e DPKSHT-së, për periudhën 01.01.2023-01.08.2023.

- Gjatë auditimit të certifikatave të përdorimit u konstatua **1 praktikë** tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me miratimin e certifikatës së përdorimit pa pasur dokumentacionin e nevojshëm të ngarkuar në sistemin e-Leje dhe realizimi i objektit në terren në mospërputhje me lejen e ndërtimit të miratuar.

Nga auditimi i certifikatave të përdorimit u konstatua se në materialet e ngarkuara në sistemin e-Leje, nuk paraqitet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për miratimin e certifikatës së përdorimit. Në dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë përdorimi është projekti arkitektonik i miratuar dhe projekti "as build" (i zbatuar); Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje paraqitet vetëm projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit, por nuk paraqitet projekti "as build" i zbatuar. Gjithashtu nuk paraqiten foto të realizimit të objektit në terren dhe nga verifikimi i realizimit të punimeve të ndërtimit, objekti nuk është realizuar në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar. Nga verifikimi i punimeve të ndërtimit në terren dhe nga fotogrami ajror, u konstatuan ndryshime në realizimin e punimeve të ndërtimit nga projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit me Vendimin nr. 2631, datë 24/12/2020, me objekt: "Struktura Turistike 6kat (Kati 5 dhe 6 Dupleks) + Kafazi i Shkallëve + 1 kat Nën Tokë dhe Pishinë" pasi është objekti është realizuar **në lartësinë e 9 kateve nga 6 kate i miratuar në lejen e ndërtimit** dhe ka ndryshuar konfigurimi i gjurmës së ndërtimit duke ndryshuar/ shtuar volume në skajet e objektit, duke ndryshuar edhe përmasat e objektit e të gjurmës së ndërtimit. Gjithashtu, certifikata e përdorimit është miratuar për certifikimin e objektit në lartësinë e **8 kateve**, në kundërshtim nga leja e ndërtimit e miratuar për objektin në lartësinë e **6 kateve**. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtme të miratur për certifikatë përdorimi, me objekt: 1. "Strukturë turistike + hotel 6 kate + duplex (8 kate) + ambiente funksionale (teknike) + 1 kat nëntokë", miratuar me vendimin nr.4653, datë 18.07.2023, me zhvillues "B" Shpk, në adresën Golem, Kavajë. Për miratimin e certifikatë së përdorimit është bazuar në lejet e ndërtimit si më poshtë:

1. Lejes së Ndërtimit **nr. 1023/876**, datë 15.03.2019 (09/10/2018).

2. Lejes së Ndërtimit **nr. 2046**, datë 25.08.2020, me objekt: "Shtesë në Lejen në Zhvillim me nr. 1026/876 (Struktura Turistike 5kat + Papafingo + 1 kat Nën Tokë dhe Pishinë)"

3. Lejes së Ndërtimit **nr. 2294**, datë 09.10.2020, me objekt: "Ridimensionim i kushteve të sheshit"

4. Lejes së Ndërtimit **nr. 2631**, datë 24.12.2020, me objekt: "**Struktura turistike 6kat (Kati 5 dhe 6 Dupleks) + kafazi i shkallëve + 1 kat nën tokë dhe pishinë**".

5. Lejes së Ndërtimit nr. 3142, datë 08.09.2021, me objekt: **“Rikonfigurimi i fasadave dhe hapësirave të brëndshme pa ndryshuar lartësinë e miratuar”**.

Certifikata e përdorimit është miratuar në bazë të lejes së ndërtimit të fundit me Nr.2631, datë 24/12/2020, me objekt: **“Struktura turistike 6kat (Kati 5 dhe 6 Dupleks) + kafazi i shkallëve + 1 kat nën tokë dhe pishinë”**, por në ndryshim nga leja e ndërtimit, certifikata është miratuar për objektin: **“Strukturë turistike + hotel 6 kate + duplex (8 kate) + ambjente funksionale (teknike) + 1 kat nëntokë”**, duke miratuar zhvillimin e 2 kateve shtesë pa pasur leje ndërtimit të miratuar, duke sjellë si pasojë **certifikimin e një objekti nga 6 kate në 8 kate**.

- Në bazë të VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin Neni 27/2, në pikën 1, gërma g, përcaktohet që në dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë është projekti arkitektonik i miratuar dhe projekti “as build” (i zbatuar); Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje paraqitet vetëm projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit, **por nuk paraqitet projekti “as build” i zbatuar**.

- Në bazë të VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin Neni 27/2, në pikën 1, gërma “j”, përcaktohet që në dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë janë fotografi të objektit në të gjitha orientimet. **Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje nuk paraqiten fotografi të objektit dhe miratimi i certifikatës së përdorimit është dhënë pa verifikuar realizimin e tij**.

- Nga verifikimi i punimeve të ndërtimit në terren dhe nga fotogrami ajror, u konstatuan ndryshime në realizimin e punimeve të ndërtimit nga projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit me Vendimin nr. 2631, datë 24.12.2020, me objekt: “Struktura Turistike 6 kat (Kati 5 dhe 6 Dupleks) + Kafazi i Shkallëve + 1 kat Nën Tokë dhe Pishinë” pasi është objekti është realizuar në lartësinë e **9 kateve** nga **6 kate** i miratuar në lejen e ndërtimit dhe ka ndryshuar konfigurimi i gjurmës së ndërtimit duke ndryshuar/ shtuar volume në skajet e objektit, duke ndryshuar edhe përmasat e objektit e të gjurmës së ndërtimit.

- Në bazë të ligjit 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 42, në pikën 3, përcaktohet se certifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, sipas fazave dhe kritereve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit, në rregulloren e zhvillimit dhe në legjislacionin mjedisor. Ndërsa në pikën 4 të këtij vendimi përcaktohet se në rast se konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera me kërkesat, sipas pikës 3, autoriteti i planifikimit lëshon aktin e konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili jep sugjerimet dhe afatin kohor dhe, nëse afati kohor nuk respektohet, sanksionet për sigurimin e përputhshmërisë nga zhvilluesi. Në bazë të në Neni 27/1, mbikëqyrja e punimeve, pika 3, në të cilën përcaktohet se: "Autoriteti vendor mund të verifikojë konformitetin e akteve të kontrollit sipas shkronjave “a”, “c”, “ç” dhe “dh”, të pikës 1, sipas gjendjes faktike të objektit, brenda 15 ditëve pune nga depozitimi i tyre. Në mungesë verifikimi nga autoriteti vendor, brenda afatit të mësipërm, subjekti ndërtues mund të kalojë në fazën vijuese. Në rast se konstatohet mospërputhje e faktit me aktkontrollin e mbajtura, ai merr masat e nevojshme kundrejt subjektit ndërtues, si dhe subjekteve të licencuara që janë shprehur në aktkontrolle. **“Autoriteti vendor nuk ka kryer verifikimet në terren përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, duke sjellë si pasojë ndryshimin e projektit të ndërtimit, devijim nga leja e ndërtimit të miratuar, shtimin e sipërfaqes së ndërtimit, rritje të numrit të kateve dhe ndryshimin e kondicioneve urbane. Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor të njësisë G1-A41-07, lartësia maksimale e ndërtimit është 7 kate, nga 9 kate lartësia që është realizuar në terren”**.

- Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Kavajë, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim të ligjit 107/2014, datë 31.07.2014 *“Për planifikimin dhe*

zhvillimin e territorit”, Neni 51, Inspektimi e Neni 52, Kundravajtje administrative dhe ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, Neni 10, Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, ka sjellë si pasojë devijimin nga leja e ndërtimit e miratuar dhe shtimin e numrit të kateve, në kundërshtim me përcaktimet e Planin e Përgjithshëm Vendor.

Veprimet e sipërcituara, nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

- Ligji nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 42, Certifikata e përdorimit

-Ligji nr. 107/2014, për “Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 51, Inspektimi.

-VKM 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27, certifikata e përdorimit; neni 27/1, mbikqyrja e punimeve; neni 27/2, dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi

-Ligji Nr.9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, Neni 10, Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar.

**Për sa më lart, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:**

Z. F.Q , Kryetar i Bashkisë Kavajë;

Znj.D.Q , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga periudha 01.01.2023; Z. H.Z , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, për periudhën 01.01.2023-27.07.2023;

Z. S.V , me detyrë specialisti në sektorin e DPKSHT-së, për periudhën 01.01.2023-27.07.2023;

Z. M.R , me detyrë Kryeinspektor i IMT-së Kavajë;

Z. D.D , me detyrë inspektorë për njësinë e Golemi, për periudhën 15.03.2023 e në vijim; Z.

SH.K , me detyrë inspektorë për njësinë e Golemi, për periudhën 26.02.2020-27.07.2023;

Z. D.GJ , me detyrë inspektorë për njësinë e Golemi, për periudhën 13.10.2021-12.07.2023.

Lidhur me objektin “Strukturë akomoduese 5 dhe 6 katëshe + 2 kat nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 4881, datë 04.12.2023, me zhvillues shoqëria “L ” Shpk, në adresën rruga Mali i Robit, Golem, Kavajë, me shkresën e administruar në KLSH me nr. 34/14 prot., datë 13.05.2024 dhe me shkresën nr. 176/33, datë 10.05.2024, **është observuar në fazën e Projekt Raportit të Auditimit**, nga znj. D.Q , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga z. A.Ç , me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, por i komanduar në mungesë e me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

*Në lidhje me gjetjen e konstatuar për mospërputhjen e planvendosjes me projektin e ndërtimit, përfaqësuesit e Bashkisë Kavajë shprehën se: “Për sa sipër sqarohet se planvendosja e aplikuar nga zhvilluesi i ka të përcaktuar sipërfaqet e ndërtimit të gjurmës së objektit, sipërfaqen totale të ndërtimit mbi tokë dhe nën tokë. Si dhe kemi sqaruar sipas projektit të aplikuar në sistemin e-leje që gjendet në praktikën në pdf (lehtësisht e aksesueshme) dhe të konvertuar në dëg nga specialistët e sektorit të planifikimit e zhvillimit të territorit rezulton se planimetria e katit përdhe është e njëjtë me plan vendosjen e paraqitur si gjurmë të projektit. (bashkangjitur planimetrite me sipërfaqet sipas dëg) ku sqarohet dhe pika 1.3 për koeficientin e shfrytëzimit të territori i lejuar 50% dhe në akt konstatim e në projekt raport citohet të jetë 1821,3 m<sup>2</sup> dhe ksht 74% e cila ka rezultuar si tejkalim të njësisë pasi është marrë në konsideratë plan sistemimi dhe ky nuk tejkalon planin e katit përdhe sipas planvendosjes së miratuar por vetëm sistemimin e territorit pas përfundimit të punimeve ndërtimore. Nga projekti arkitektonik i konvertuar nga pdf rezulton që sipërfaqe totale e ndërtimit mbi tokë është 7434.5 m<sup>2</sup> në shtesë totale prej 56.5m<sup>2</sup> dhe si rrjedhim intesiteti i saktësuar është 3.02, gabim ky për shkak të mos saktësisimit nga projekti në pdf në dëg nga sistemi e-leje dhe për të*

*cilën nuk e konsiderojmë gabim por marzh gabimi 0.7% të sipërfaqes totale të ndërtimit mbi tokë”.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, ashtu sikurse ju kemi sqaruar në fazën e aktkonstatimit, në projektin arkitektonik të ngarkuar në sistemin e-Leje, pasqyrohet plansistemimi i objektit në të cilin evidentohen sipërfaqet e ndërtimit në kuotën ± 0.00 dhe ndërhyrjet në sistemin përreth. Në raport me sipërfaqen totale të ndërtimit, e cila është verifikuar në versionin dëg, janë konstatuar ndryshime të të dhënave të paraqitura. Më poshtë pasqyrohet plansistemimi i shkëputur nga projekti arkitektonik.



Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

**Pretendimet e subjektit:**

*Në lidhje me gjetjen e konstatuar për pavlefshmërinë e dokumentacionit të pronësisë, përfaqësuesit e Bashkisë Kavajë shprehen se: “Për sa është konstatuar nga ju është e saktë si konstatim por po ju japim shpjegimin tonë për këtë problematikë: Së pari kemi hasur probleme të vazhdueshme me ASHK për dhënie mendimi nga sistemi e-leje si organ mendim dhënës për aplikimet në sistemin e -leje për të cilën nuk marrim përgjigje dhe jemi të detyruar ti kërkojmë aplikantit ti dërgojë pranë Drejtorisë së Planifikimit e Zhvillimit të territorit kopjen e certifikatave, hartave e kartelen e pasurisë si dhe kontratat përkatëse që arshivohen sipas lejes përkatëse. Sqarojmë se dokumentacioni i mëposhtëm është arshivuar si çdo dokument tjetër i domosdoshëm që kërkohet nga specialistët sipas praktikave përkatëse për të saktësuar dokumentacionin tekniko-ligjor të aplikantit dhe zhvilluesit duke mos krijuar vonesa të panevojshme dhe zbatuar afatet ligjore të përcaktuara në ligj”.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se miratimi i lejeve të ndërtimit realizohet nëpërmjet sistemit e-Leje dhe në të ngarkohen të gjitha dokumentacionet e nevojshme përpara miratimit të lejes. Në sistemin e-Leje, dokumentat e pronësisë të ngarkuara janë të pavlefshme në **momentin e miratimit të lejes së ndërtimit**. Më poshtë pasqyrohen dokumentacioni i paraqitur në lejen e ndërtimit të miratuar. Në bazë të VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 15, pika 1, gërma “b”, përcaktohet që pjesë e dokumentave që duhet të dorëzohë janë ato që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta. Gjithashtu në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, neni 21, pika 6, nevojitet dakortësia e ASHK-së Kavajë. Në mendimin e institucionit të ngarkuar në sistemin e-Leje, ASHK nuk është përgjigjur dhe nuk ka shprehur dakortësinë



Nga ana juaj nuk paraqiten fakte të reja apo kundërshtime të ndryshme të mbështetura ligjërisht, nga sa janë trajtuar gjatë mbajtjes së aktkonsatimeve. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

**Pretendimet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjen e konstatuar për tejkalimin e lartësisë së ndërtimit, përfaqësuesit e Bashkisë Kavajë shprehen se: *“Referuar VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 37. Kati për përdorim shërbimi, lartësia minimale dysheme–dysheme është 4.00 m, si dhe në zhvillimet e fundit të zonës turistike Golem-Qerret ku pothuajse të gjithë objektet e ndërtuara vitet e fundit 2020 e në vazhdim po aplikojnë për ndryshim funksioni nga banim në shërbim dhe cilësia e ndërtimeve e strukturave akomoduese ka nevojë për hapësirë në lartësi të hapësirës së shfrytëzueshme për shërbim dhe akomodim të kateve përdhe. Në treguesit teknik të përcaktuar në planvendosje, në projektin arkitektonik ku janë paraqitur (prerje dhe plane) nga ana jonë kati përdhe (me nën ndarje) është vlerësuar si 1 (një) kat i vetëm (me destinacion shërbim akomodim, fjetje) me shkallë të brendshme për çdo njësi ku në nivelin 0.00 është ambjenti i gatimit dhe ndenjës dhe në nivelin më sipër është ambjenti i fjetjes dhe duke tejkaluar lartësinë prej 5 m, sipas nenit të sipër cituar të rregullores vendore të Bashkisë Kavajë”.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në bazë të VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 37, pika 3, gërma “a” dhe gërma “c”, në të cilin përcaktohet që: “Lartësia dysheme–dysheme për katet banim është minimumi 3.00 m.” dhe “Kati për përdorim shërbimi, lartësia minimale dysheme–dysheme është 4.00 m.” Lartësia e katit përdhe nga 4.00 metra që duhet të ishte për hapësirë shërbimi është 5.44 metra, duke e tejkaluar me 1.44 metra. Në sipërfaqen më të madhe të katit përdhe janë pozicionuar njësi të banimit, në të cilën lartësia e katit nga 3.00 metra e lejuar është 5.44 metra, me një diferncë prej 2.44 metra më e lartë, duke tejkaluar lartësinë e lejuar të kateve. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

**Pretendimet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjen e konstatuar në raport me tipologjinë e ndërtimit të lejuar në njësinë strukturore GI-A23-11, ndryshimin e përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe kontributit e sektorit privat në krijimin e fondit publik, përfaqësuesit e Bashkisë Kavajë shprehen se: *“Për sa sipër sqarojmë se jemi dakort vetëm parimisht me konstatimin tuaj për shkak të projektit të dorëzuar në sistemin e-leje pasi është trajtuar me apartamente por emërtimi i lejes dhe i projektit është strukturë akomoduese e cila në rastin konkret trajtohet po si strukturë akomoduese sipas legjisllacionit në fuqi për strukturat akomoduese. Në këtë aplikim kemi të bëjmë me të njëjtin zhvillues dhe pronar dhe ndërtues pra nuk kemi të bëjmë me kontratë sipërmarrje me pronarët ku të jetë trajtuar për qëllime shitje dhe përfitim sipas paketës fiskale të Bashkisë Kavajë për vitin 2023 citohet: Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së preventivit dhe : a) për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 deri në 3 përqind e vlerës së preventivit. Specialistet që kanë llogaritur TNI kanë marrë në konsideratë emërtimi i projektit, plan vendosjes dhe të Projektit si dhe trajtimit si strukturë akomoduese (“Strukturë akomoduese”- Në sensin e ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin” është strukturë që vë në dispozicion të turistëve vendas dhe të huaj, individë ose të organizuar në grupe, për një periudhë të pacaktuar, por jo më shumë se 1 vit, shërbimet e akomodimit (fjetje, ushqim pije dhe shërbime të tjera) në përputhje me standartet e përcaktuara sipas klasifikimit dhe kategorizimit të saj. Gjithë zona turistike e Golemit për shkak të kërkesave të shtuara të turistëve apo pushuesve vendas dhe të huaj ka stimuluar investitorët vendas të kryejnë*

*investime në struktura të tilla akomoduese me apartamente pasi brezi i parë pranë detit është plotësuar me strukturë hoteliere (me dhoma), problem shqetësues për specialistët e bashkisë për trajtimin sipas llogaritjeve të konstatuara nga ana e audituesve është dhe problemi i detyrimit të investitorëve të kryejnë pagesën kur nuk kanë qëllim shitje dhe përfitimi dhe janë në funksion të turizmit e cila shkakton problematike për shkak të rikthimit të shumës së arkëtuar nqs trajtimi është kryer jo në korrektësi me funksionin e saj primar. Gjithashtu sqarojmë se në çdo aplikim për certifikatë përdorimi i strukturave të tilla me emërtim "Strukturë akomoduese apo strukturë turistike) trajtohet me korrektësi dhe ligjshmëri sipas funksionalitetit dhe ecurisë së punimeve, kjo e saktësuar dhe e vërtetuar në praktikën që po shqyrtohen apo janë në proces përfundimtar të certifikimit të objektit".*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në raport me observacionin e dërguar nga ana juaj, duke marrë parasysh faktin që njësi strukturore në të cilën zhvillohet objekti dhe në bazë të përdorimeve të lejuara të zonës për zhvillim, pretendimi juaj merret pjesërisht në konsideratë. Gjithsesi, Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, të vijojnë me ndjekjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit deri në momentin e përfundimit të objektit. Në rast se destinacioni përfundimtar i objektit, për të cilin do të lëshohet certifikata e përdorimit, është i ndryshëm nga ai i reflektuar në lejen e ndërtimit, të bëhet rillogaritja e diferencës së taksës së ndikimit në infrastrukturë TNI, sipas VKB Kavajë me nr.107, datë 22.11.2022, duke aplikuar gjithashtu, ndaj subjektit përkatës, nenin 19, pika 1, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social".

Lidhur me objektin: "Strukturë akomoduese 5 kat me 1 kat podrum", miratuar me vendimin nr. 4249, datë 14.04.2023, me zhvillues shoqëria "D " Shpk, në adresën rruga Mali i Robit, Golem, Kavajë, me shkresën e administruar në KLSH me nr. 34/14 prot., datë 13.05.2024 dhe me shkresën nr. 176/33, datë 10.05.2024, është observuar në fazën e Projekt Raportit të Auditimit, nga znj. D.Q , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga z. A.Ç , me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, por i komanduar në mungesë e me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjen e konstatuar për tipologjinë e ndërtimit që është në mospërputhje me përdorimet e lejuara në bazë të Planit të Detajuar Vendor për njësinë G1-S1-08, përfaqësuesit e Bashkisë Kavajë shprehen se: "*Strukture akomoduese*"- Në sensin e ligjit nr. 93/2015 "*Për Turizmin*" është strukturë që vë në dispozicion të turistëve vendas dhe të huaj, individe ose të organizuar në grupe, për një periudhë të pacaktuar, por jo më shumë se 1 vit, shërbimet e akomodimit (fjetje, ushqim pije dhe shërbime të tjera) në përputhje me standartet e përcaktuara sipas klasifikimit dhe kategorizimit të saj. Struktura akomoduese mund të konfigurohet në hapësira të ngjashme me apartamentet ku përfshinë kuzhinë dhe dhoma të ndara brenda që lëshohen me qira nga pronari i objektit, pasi kjo formë turizmi është mjaft e përhapur në këtë zonë duke mos pasur nevojë për hapësira ndihmëse pasi çdo ndarje përfshin banjo dhe kuzhinë duke bërë të mundur akomodimin e individeve apo grupeve deri në një 1 Vit. Gjithashtu në këtë parcelë (njësi strukturore) është miratuar dhe leja për një Hotel me 5 yje i cili është pjesë e këtij zhvillimi duke bërë të mundur ofrimin e faciliteteve dhe shërbimeve komplementare për të gjithë njësinë. Në pikën B të kontratës së sipërmarrjes citohet: "Shtetasi A.K në cilësinë e palës porositëse në këtë akt porosit shoqërinë "D " Shpk të ndërtojë në pronen e sipërshënuar të porositësi një objekt strukturë Turistike etj." Në kontratën e sipërmarrjes neni 1 objekti i kontratës citohet: "Në bazë të kësaj kontrate, Porositësi vendos në dispozicion të sipërmarrësit, për ndërtim, pasurinë e paluajtshme të pershkruar ne piken A me siper ,dhe ky i fundit merr persiper ndertimin e Strukture Turistike mbi kete sipërfaqe "Siç citohet në kontratë palët kanë firmosur me vullnet të lirë dhe në kontartë është shprehur qartë që kemi të bëjmë me një marrveshje për ndërtimin e strukturave turistike. Për sa i përket

detyrimet ligjor që pronari i truallit të respektojë destinacionin për pjesën takuese 25% të sipërfaqes ndërtimore sipas kontartës iu bëjmë me dije se në momentin e regjistrimit të objektit në ASHK (Agjencia Shtetërore e Kadastrës) destinacioni i sipërfaqes takuese do të jete i percaktuar ne Certifikatën e Pronësisë, për rrjedhojë kjo e detyron pronarin e truallit të respektojë destinacionin dhe përdorimin e lejuar”.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**


Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore **G1-S1-08**, për të cilën është miratuar Plani i Detajuar Vendor me Vendimin nr. 04, datë 16.03.2022. Në përdorimet e lejuara në bazë të PDV për njësinë përkatëse, kategoria e përdorimit është zonë shërbimesh, S1 dhe në përdorimet e lejuara bëjnë pjesë funksione të tilla si: (Bare, restorante, qendra tregtare) +hotele. Nga verifikimi i projektit të ndërtimit dhe relacionit teknik evidentohet që tipologjia e ndërtimit nuk plotëson kriteret e strukturave akomoduese në bazë të Vendimit nr. 730, datë 20.10.2016, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, i ndryshuar. Në bazë të projektit të ndërtimit propozohen 4 godina banimi, që përfshijnë disa apartamente të tipit 2+1 dhe 1+1. Në asnjërën nga godinat nuk ofrohen shërbime dhe hapësira ndihmëse në funksion të shërbimit akomodues të ofruar. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

### **Pretendimet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjen e konstatuar përsa i përket lartësisë së ndërtimit, përfaqësuesit e Bashkisë Kavajë shprehen se: “Në rregulloren vendore të Bashkisë Kavajë neni 19 Lartësia e Katit. citohet se: lartësia e katit përdhe në çdo rast nuk mund të kalojë lartësinë 5 m nga kuota e sistemimit. Në këtë lartësi përfshihet dhe diferenca e kuotës 0.00 me kuotën e terrenit të sistemuar. Në treguesit teknik të përcaktuar në planvendosje, në projektin arkitektonik ku janë paraqitur (prerje dhe plane) nga ana jonë kati përdhe (me nën ndarje) është vlerësuar si 1 (një) kat i vetëm (me destinacion shërbim akomodim, fjetje) me shkallë të brendshme për çdo njësi ku në nivelin 0.00 është ambjenti i gatimit dhe ndenjës dhe në nivelin me sipër është ambjenti i fjetjes duke respektuar lartësinë prej 5 m sipas nenit të sipër cituar të rregullores vendore të Bashkisë Kavajë. Pra kemi të bëjmë me lartësinë e 5 kateve dhe jo 6 kateve sipas gjetjes suaj. Nisur nga kjo ju sqarojmë dhe për pikën 2.2 të konstatimit tuaj, se me të njëjtën logjike nuk e kemi konsideruar sipërfaqje që ndikon në intensitet nën-ndarjen e brendshme të këtij kati nga ku ju keni konstatuar shtim të sipërfaqes me 2084m<sup>2</sup> nga intensiteti i lejuar 2m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>. Pra sipërfaqja totale mbi tokë mbetet 10,900 m<sup>2</sup> dhe intesisteti 2 sipas planvendosjes dhe lejes së miratuar”.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se shqyrtimi i projektit arkitektonik dhe prerje teknike, të pasqyruara më poshtë, objekti zhvillohet në lartësinë e 6 kateve të banimit dhe nuk respekton lartësinë minimale të banimit prej 3 metrash, të përcaktuar sipas VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 37, pika 3, gërma “a”.



Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

**Pretendimet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjen e konstatuar për mungesën e marrjes së miratimeve nga institucionet përkatëse, përfaqësuesit e Bashkisë Kavajë shprehen se:” *Mendimi i këtyre institucioneve dhe konformiteti është marrë në Lejen e Zhvillimit nr. 3721, datë 21.06.2022 si dhe në aplikimin e lejes së ndërtimit të refuzuar me nr. 3943 datë 17.01.2023. Gjithashtu i njëjti shesh ndërtimi në pasurinë me nr. 107/16 pasurie Vol 44 fq.14 ZK 1791 me sip.5450 m2 e llojit truall në emër të A.K është dërguar për konformitet në Institucionet përkatëse në lejen me nr. 3943 prot., dhe ka marrë konfirmimin e tyre, por leja është refuzuar me vendim nr. 3943, datë 17.01.2023 për arsye se: “Gjatë procedurës për shqyrtimin e kërkesës, kërkuesi u njoftua me shkresën nr. 3943, datë 20/12/2022 mbi detyrimin që, brenda afatit të caktuar prej 15 ditësh, të dorëzonte dokumentacionin mungues, si vijon: Mandat pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë”. Për këtë arsye e dërguam procedurën për mendim vetëm në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës”.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në bazë të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 21 “Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor”, pika 6, autoriteti vendor duhet të marrë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen **përpara miratimit të lejeve të ndërtimit**. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

**Pretendimet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjen e konstatuar për diferencën në taksën e ndikimit në infrastrukturë, përfaqësuesit e Bashkisë Kavajë shprehen se: ”*Për sa sipër, nga ana jonë është trajtuar sipas gjykimit të mësipërm, por në bazë të trajtimit nga ana e Juaj e siperfaqes ndërtimore të katit përdhe në 2 kate, por sigurisht në momentin e certifikates së përdorimit do të merren në konsideratë dhe konstatimi i kryer nga auditueset”.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në kushtet kur observacioni i paraqitur nga subjekti nuk ka të bëjë me kundërshtime mbi gjetjen e lënë nga grupi i auditimit, por në thelb e konfirmon atë, sqarojmë se koha e përlllogaritjes së taksës, nuk është në varësi të momentit të pajisjes me certifikatë përdorimi. Në këto kushte diferenca e taksës së ndikimit në infrastrukturë duhet ti dërgohet zyrtarisht fatura sipas llogaritjeve të rishikuara, pa prituri përfundimin e punimeve dhe aplikimin për certifikatë përdorimi.

Lidhur me objektin “Struktura banimi 2 kat + 1 kat nëntokë (podrum)(katër struktura banimi)”, miratuar me vendimin nr. 4892, datë 09/11/2023, me zhvillues R & S.V , në adresën Lagja nr. 2 Rruga “Metalikes”, Kavajë, me shkresën e administruar në KLSH me nr. 34/14 prot., datë 13.05.2024 dhe me shkresën nr. 176/33, datë 10.05.2024, është observuar në fazën e Projekt Raportit të Auditimit, nga znj. D.Q , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga z. A.Ç , me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, por i komanduar në mungesë e me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjen e konstatuar për miratimin e lejes së ndërtimit pa pasur më parë të miratuar një Plan të Detajuar Vendor, përfaqësuesit e Bashkisë Kavajë shprehen se: “*Për sa sipër sqarojmë se konstatimi juaj qëndron parimisht, por nga ana e specialistëve që kanë shqyrtuar aplikimin dhe pasi zhvilluesi dhe pronari sipas statusit juridike familjes është familje shumë e madhe dhe realisht është trajtuar si banesa individuale deri në 250 m<sup>2</sup> sipas citimit në vendimin e KKT. nr. 4 datë 28.07.2020 “Për përcaktimin e llojit të punimeve për të cilat*



*hartimi i PDV nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm ti paraprijë lejes për zhvillim, ndërtim apo deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve, ndryshuar dhe Rishikimit të PPV të bashkisë Kavajë”.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar me vendimin e KKT-së nr. 2, datë 27.04.2018, i ndryshuar me Vendimin Nr.4, datë 25.04.2023, parashikohet që përpara miratimit të lejes së ndërtimit të realizohet Plan i Detajuar Vendor për njësinë K2-A41-01. Leja e ndërtimit është miratuar për leje ndërtimi me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup>. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

Lidhur me objektin “Strukturë Turistike, 6 Kat me 1 kat nën tokë”, miratuar me vendimin nr. 4934, datë 04.01.2023, me zhvillues shoqëria “C ” Shpk, në adresën Golem,Kavajë, me shkresën e administruar në KLSH me nr. 34/14 prot., datë 13.05.2024 dhe me shkresën nr. 176/33, datë 10.05.2024, është observuar në fazën e Projekt Raportit të Auditimit, nga znj. D.Q , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga z. A.Ç , me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, por i komanduar në mungesë e me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjen e konstatuar për sa i përket mendimit të shprehur nga AZHT-ja, për objektin: përfaqësuesit e Bashkisë Kavajë shprehen se: *”Për sa sipër sqarojmë se në bazë të projektit të paraqitur nga zhvilluesi i cili është dhe pronar dhe sipas gjykimit të specialisteve që kanë shqyrtuar aplikimin dhe mos kqyrjes së shënimit të bërë nga AZHT-ja për përmirësimin e projektit do kërkojmë nga zhvilluesi të rishikojë projektin arkitektonik sipas shënimit të lënë nga AZHT.”*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në kushtet kur observacioni i paraqitur nga subjekti nuk ka të bëjë me kundërshtime mbi gjetjen e lënë nga grupi i auditimit, por në thelb e konfirmon atë, duke pranuar në të njëjtën kohë edhe rekomandimin e lënë, grupi i auditimit rikonfirmon gjetjen duke theksuar se kërkesa për rishikimin e projektit dërguar aplikuesit pas miratimit të lejes së ndërtimit nuk ka asnjë efekt për zbatimin e tij, për sa kohë vepra mund të jetë realizuar, si dhe faktit që kjo kërkesë nuk është detyruese për aplikuesin, i cili tashmë disponon një leje ndërtimi.

**Pretendimet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjen e konstatuar për sa i përket respektimit të distancave, përfaqësuesit e Bashkisë Kavajë shprehen se: *“Duke qënë se në rastin konkret, kemi të bëjmë me një konsolidim urban, dhe kufinj të nuk do të ekzistojnë me pasi nuk kemi dhënë leje për mur rrethues. Muri rrethues, në rastet e rrethimeve për zhvillime në zona urbane, kërkojë leje ndërtimi, dhe të përjashtura janë vetëm rastet, sipas Nentit 7, të cilën e kemi referuar më lart. Për këtë arsye, i jemi referuar nenit 34, pikës 2 dhe pikës 3, konkretisht distancave nga objekti në objekt, në njësitë strukturore të urbanizuara në proces konsolidimi, ku rasti në fjalë bën pjesë, që ka një distancë për 5.6 metra, ose 0.6m më shumë se sa e lejon ligji. Në momentin e eliminimit të barrierave arkitektonike, siç është dhe rrethimi i pronës, kjo ndikon drejt për së drejti në maksimizimin e hapësirave publike të dedikuara për krijimin e zonave rekreative dhe të gjobëruara në funksion të dy objekteve që përballen me njëri tjetrin”.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me observacionin e dërguar nga ana Juaj, sqarojmë se baza ligjore që ju i referoheni, nuk i referohet gjetjes së grupit të auditimit. Në bazë të VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 35, pika 1 dhe nenin 36, pika 3/b, distancat nuk janë respektuar. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

**Pretendimet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjen e konstatuar përsa i përket lartësisë së ndërtimit, përfaqësuesit e Bashkisë Kavajë shprehen se: *“Për llogaritjen e lartësisë së ndërtimit në metra, për sa kohë që nuk përcaktohet ndryshe nga rregulloret e ndërtimit në fuqi, përdoret sipas rastit si dhe në zhvillimet e fundit të zones turistike Golem-Qerret ku pothuajse të gjithë objektete e ndërtuara vitet e fundit 2020 e në vazhdim po aplikojnë për ndryshim funksioni nga banim në shërbim dhe cilësia e ndërtimeve e strukturave akomoduese ka nevojë për hapësirë në lartësi të hapësirës së shfrytëzueshme për shërbim dhe akomodim të kateve përdhe. Në treguesit teknik të përcaktuar në planvendosje, në projektin arkitektonik ku janë paraqitur (prerje dhe plane) nga ana jonë kati përdhe (me nen ndarje) është vlerësuar si 1 (një) kat i vetëm (me destinacion shërbim akomodim, fjetje) me shkallë të brendshme për çdo njësi ku në nivelin 0.00 është ambjenti i gatimit dhe ndenjës dhe në nivelin më sipër është ambjenti i fjetjes dhe duke tejkalluar lartësinë në prej 5 m sipas nenit të sipër cituar të rregullores vendore të Bashkisë Kavajë”*.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me observacionin e dërguar nga ana Juaj, sqarojmë se përpara miratimit të lejes së ndërtimit, pavarësisht ndryshimit të destinacionit në një fazë të dytë, në shqyrtimin e projektit të ndërtimit verifikohen edhe lartësitë e kateve, që të jenë në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, *“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”*, i ndryshuar, në nenin 37, pika 3, gërma “a” dhe gërma “c” dhe në bazë të funksionit të katit. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

#### **Pretendimet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjen e konstatuar përsa i përket diferencës së taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe në raport me kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik, me sigurimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3 % të sipërfaqes funksionale, përfaqësuesit e Bashkisë Kavajë shprehen se: *“Për sa sipër sqarojmë se jemi dakort vetëm parimisht me konstatimin tuaj për shkak të projektit të dorëzuar në sistemin e-leje pasi është trajtuar me apartamente por emërtimi i lejes dhe i projektit është strukturë akomoduese e cila në rastin konkret trajtohet po si strukturë akomoduese sipas legjislacionit në fuqi për strukturat akomoduese. Në këtë aplikim kemi të bëjmë me të njëjtin zhvillues dhe pronar dhe ndërtues pra nuk kemi të bëjmë me kontratë sipërmarrje me pronarët ku të jetë trajtuar për qëllime shitje dhe përfitimi sipas paketës fiskale të Bashkisë Kavajë për vitin 2023 citohet: Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së preventivit dhe: a) për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individ apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 deri në 3 përqind e vlerës së preventivit. Specialistët që kanë llogaritur TNI kanë marrë në konsideratë emërtimi i projektit, plan vendosjes dhe të Projektit si dhe trajtimit si strukturë akomoduese (“Strukturë akomoduese”- Në sensin e Ligjit nr.93/2015 “Për turizmin” është strukturë që vë në dispozicion të turistëve vendas dhe të huaj, individe ose të organizuar në grupe, për një periudhë të pacaktuar, por jo më shumë se 1 vit, shërbimet e akomodimit (fjetje, ushqim pije dhe shërbime të tjera) në përputhje me standartet e përcaktuara sipas klasifikimit dhe kategorizimit të saj. Gjithë zona turistike e Golemit për shkak të kërkesave të shtuara të turistëve apo pushuesve vendas dhe të huaj ka stimuluar investitorët vendas të kryejnë investime në struktura të tilla akomoduese me apartamente pasi brezi i parë pranë detit është plotësuar me strukturë hoteliere (me dhoma), problem shqetësues për specialistet e bashkisë për trajtimin sipas llogaritjeve të konstatuara nga ana e audituesve është dhe problemi i detyrimit të investitorëve të kryejnë pagesën kur nuk kanë qëllim shitje dhe përfitimi dhe janë në funksion të turizmit e cila shkakton problematike për shkak të rikthimit të shumës së arkëtuar nqs trajtimi është kryer jo në korrektësi me funksionin e saj primar. Gjithashtu sqarojmë se në çdo aplikim për certifikatë përdorimi i strukturave të tilla*

me emërtim "Strukturë akomoduese apo strukturë turistike) trajtohet me korrektësi dhe ligjshmëri sipas funksionalitetit dhe ecurisë së punimeve, kjo e saktësuar dhe e vërtetuar në praktikë që po shqyrtohen apo janë në proces përfundimtar të certifikimit të objektit. Nga ana e bashkisë Kavajë është dërguar njoftimi për konstatimin e audituesve në projekt raportin e dërguar për sipas shkresës me nr. 2272 /1 prot., 19.04.2024".

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore **G1-A21-13** dhe në përcaktimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, si edhe Rregullores së Planit, të miratuar me Vendimin e KKT-së nr. 2, datë 27.04.2018, i ndryshuar me Vendimin nr. 4, datë 25.04.2023, përdorimi i lejuar është "zona të formuara me banesa kolektive". Ndonëse përshkrimi të lejes së ndërtimit si një objekt me destinacion në funksion të turizmit, në bazë të PPV të miratuar për njësinë strukturore, objekti duhet të jetë në funksion të banimit. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Lidhur me objektin: "Strukturë turistike + hotel 6 kate + duplex (8 kate) + ambiente funksionale (teknike) + 1 kat nëntokë", miratuar me vendimin nr. 4653, datë 18.07.2023, me zhvillues "B" Shpk, në adresën Golem, Kavajë, me shkresën e administruar në KLSH me nr. 34/14 prot., datë 13.05.2024 dhe me shkresën nr. 176/33, datë 10.05.2024, është observuar në fazën e Projekt Raportit të Auditimit, nga znj. D.Q, me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Kavajë, nga z. A.Ç, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, por i komanduar në mungesë e me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjen e konstatuar përsa i përket verifikimit të realizimit të objektit përpara për pajisjen me certifikatë përdorimi, përfaqësuesit e Bashkisë Kavajë shprehen se: "Sqarojmë se grupi i terrenit verifikon sipas kërkesave të Subjektit zhvillues apo ndërtues pranë Drejtorisë së Planifikimit e Zhvillimit të Territorit për fazat e kontrollit para aplikimit në sistemin e -leje të certifikatës së përdorimit".

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, nuk paraqiten argumente dhe fakte që kundërshtojnë problematikën e ngritura nga grupi i auditimit. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

**Pretendimet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjen e konstatuar përsa i përket mungesës së dokumentacionit për pajisjen me certifikatë përdorimi, përfaqësuesit e Bashkisë Kavajë shprehen se: "Ne aktin e kolauditimit në faqen e pare është paraqitur fotografia e objektit. Përsa i përket verifikimit të objektit janë paraqitur me firmë dhe vule nga drejtuesi Teknik, mbikqyresi i punimeve, inxhinieri topograf, kolaudatori, sipermarresi i punimeve (të gjithë individë, subjekte të lincensuara) konformiteti i perputhshemrise se punimeve me lejet e ndërtimit të miratuara nga Bashkia Kavajë".

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, nuk paraqiten argumente dhe fakte të reja të mbështetura ligjrisht, që kundërshtojnë problematikën e ngritura nga grupi i auditimit. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

**Pretendimet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjen e konstatuar përsa i realizimit të punimeve të ndërtimit dhe zbatimit të projektit të ndërtimit sipas lejes së miratuar, përfaqësuesit e Bashkisë Kavajë shprehen se: "Përsa i përket gjetjes suaj ku shpreheni se ka ndryshuar konfigurimi i gjurmës së ndërtimit duke shtuar volume në skajet e objektit duke ndryshuar dhe përmasat e objektit iu bëjmë me dije se në skicën që iu keni marrë nga Plani i Vendosjes është paraqitur gjurma e objektit (kati përdhe) ndërsa fotografimi ajror pasqyron pamjen e objektit e sipas katit tip (njollës nga lart)

*dhe konfigurimi i katit tip korrespondon me fotografimin ajror siç paraqitet në figurën me poshtë e marrë nga kati tip i projektit arkitektonik . Pra nuk kemi të bëjmë me ndryshim të konfigurimit të formës së objektit”.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, nuk paraqiten argumente dhe fakte që kundërshtojnë problematikat e ngritura nga grupi i auditimit. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

**Pika 2.6 e programit: Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtës së Territorit.**

Sipas dokumenteve të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në lidhje me organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, është ngritur dhe funksionon IMTV në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”.

Në strukturën e miratuar me Vendimin nr. 01, datë 04.01.2023, IVMT ka në përbërje **10 (dhjetë)** pozicione pune, nga të cilët **1 (një)** Kryeinspektor **8 (tetë)** inspektor dhe **1 (një)** specialist inxhinier/arkitekt.

Për periudhën objekt auditimi, IMTV është drejtuar nga Kryeinspektor **z. Y.N** , i cili rezulton me arsim të lartë në degën drejtësi (për periudhën 01.01.2023-23.06.2023), dhe Kryeinspektor **z. M.R** , i cili rezulton me arsim të lartë në degën drejtësi (për periudhën 23.06.2023-31.12.2023).

Në vitin **2023**, rezulton se janë larguar **9** (nëntë) punonjës dhe janë rekrutuar **9 (nëntë)** punonjës të tjerë në strukturën e IMTV-së.

*- Burimet në dispozicion të strukturës së IMTV-së nuk kanë arsimin e lartë të nevojshëm profesional. Kjo mbart riskun e pamjaftueshmërisë së burimeve për arritjen e objektivave në sasi por mund të cenojë dhe cilësinë e punës së Inspektoriatit.*

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se arsimimi i 5 (pesë) inspektorëve **z. B.O** , **z. D.D** , **z. F.Ç** , **z. F.A** , **z. A.K**, të IMTV-së nuk është në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin Nr.183/2014 “Për inspektimin e ndërtimit” neni 11 “Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit”, ku përcaktohet se: “Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjes vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.

Mungesa e stafit të kualifikuar, sidomos atij inxhinierik përbën mungesë cilësore për mbarëvajtjen e punës së inspektoratit, pasi nuk kanë kualifikimet e nevojshme për të kryer akte kontrolli apo për të përcaktuar dhe përshkruar teknikisht situatat e konstatuara gjatë inspektimit.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, neni 11.

**Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi:**

**Z. R.K** , në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kavajë (për periudhën 01.01.2023-15.06.2023); **z. F.Q** , në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kavajë (për periudhën 15.06.2023-31.12.2023); **z. K.M** , në cilësinë e Drejtorit të Burimeve Njerëzore, (periudha 07.08.2023-31.12.2023); **z. D.A** , në cilësinë e ish Drejtorit të Burimeve Njerëzore, (periudha 01.01.2023-28.07.2023).

## **I. Auditim mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.**

Për periudhën objekt auditimi Janar - Dhjetor 2023 nga Inspektorët e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Kavajë, janë proceduar gjithsej **45 subjekte** për ndërtime informale të ndërtuar pa leje ndërtimi dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, IMTV- Kavajë ka proceduar vetëm për **25 subjekte** me Vendim për "Prishje të objektit të kundërligjshëm" për ndërtime informale të ndërtuar pa leje ndërtimi dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit në kundërshtim me nenin 5 dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Në të gjitha rastet, nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e "Urdhrit të ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm", që do të thotë se objektet për të cilat ka një vendim prishjeje **vijojnë të pa ekzekutuara nga IMT-ja e Bashkisë Kavajë, duke u bërë shkaktarë i rritjes së numrit të ndërtimeve in formale që kalojnë në procesin e legalizimit**, ku subjektet kanë përfituar parcela ndërtimore në pronësi publike, në zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, në kundërshtim me nenin 5, pika "d" të ligjit nr. 9780/ 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", i ndryshuar, i cili përcakton se gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

*d) vendos prishjen e ndërtimit të kundër-ligjshëm;*

-Ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, neni 52 pika 6, i cili përcakton se: "*Vendimi për prishjen e ndërtimeve përmban edhe detyrimin e prishjes së menjëhershme të ndërtimit dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e kundërvajtësit*";

-Vendimin nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore" në pikën 1"(b)"/"iv" përcakton se: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë njësisë vendore, përfshin në kontrollin e tij punimin/zhvillimin/ndërtimin e një objekti të ri, prishjen e objektit, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, infrastrukturën tokësore e nëntokësore, si dhe prishjen e objekteve që paraqesin rrezik shembjeje, me pasoja për jetën e shëndetin e njerëzve dhe mbi pasurinë e të tretëve, *në përputhje me ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.*

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u shqyrtuan me zgjedhje procedurat e ndjekura nga IMTV për ndërtimet in formale të ndërtuara pa leje ndërtimi dhe për objektet në shkelje të lejes së ndërtimit*

## **I. Dosja e subjektit (PF) R.D**

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 11.04.2023, Inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, pranë Bashkisë Kavajë, D.GJ dhe SH.K , kanë ushtruar kontroll në subjektin (PF) R.D me adresë: Bulevardi i Pishave, Golem, Kavajë, u konstatuan punime pa leje. Inspektorët e IMTV-së, me procesverbalin nr. 54, datë 11.04.2023, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës për punime pa leje përkatëse "Në shkelje të deklaratës paraprake të punimeve, subjekti ka kryer mbyllje me gips kartonxhes dhe shtrim pllakash në objektin e tij". Duke vlerësuar sa më sipër si kundërvajtje administrative, inspektorët kanë vendosur njoftimin e kryeinspektorit, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave. Me vendimin nr. 51, datë 18.04.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën prej **50,000 lekë**. Bazuar në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", neni 30, gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi i drejtpërdrejtë në gjykatë, brenda 10 ditëve duke filluar nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi gjyqësor kundër këtij vendimi nuk pezullon ekzekutimin e tij.

Nëpërmjet faturës nr. 1, datë 24.04.2023, rezulton se z. R.D ka arkëtuar për llogari të Bashkisë Kavajë shumën prej **50,000 lekë**.

**Konkluzion:** Kryeinspektori nuk ka nxjerrë “Vendim për Prishje” në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

## **II. Dosja e subjektit (PF) A.D**

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 26.07.2023, Inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, pranë Bashkisë Kavajë, I.H, R.T dhe T.M, kanë ushtruar kontroll në subjektin (PF) A.D me adresë: Karpen, Kavajë, u konstatuan punime pa leje. Inspektorët e IMTV-së, me procesverbalin nr. 69, datë 26.07.2023, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës për punime pa leje përkatëse, “Vendosje kioske e çmontueshme në plazh pa dokumentacion përkatës”. Duke vlerësuar sa më sipër si kundërvajtje administrative, inspektorët kanë vendosur njoftimin e kryeinspektorit, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave. Me vendimin nr. 66, datë 10.08.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën prej **500,000 lekë**. Me vendimin nr. 44, datë 10.08.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm për subjektin A.D .

Nga trajtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se procedurat janë në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, regjistruar për gjykim me nr. 4866, datë 09.01.2024 regjistrimi, çështje administrative që i përket paditësit z. A.D dhe palë paditëse Inpektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, me objekt “Shfuqizim Vendimi”.

## **III. Dosja e subjektit (PF) E.K**

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 03.08.2023, Inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, pranë Bashkisë Kavajë, I.H , R.T, J.M dhe T.M, kanë ushtruar kontroll në subjektin (PF) E.K me adresë: Laguna Blu, Qerret, Kavajë, u konstatuan punime pa leje. Inspektorët e IMTV-së, me procesverbalin nr. 73, datë 03.08.2023, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës për punime “Shtesë anësore” pa leje përkatëse. Duke vlerësuar sa më sipër si kundërvajtje administrative, inspektorët kanë vendosur njoftimin e kryeinspektorit, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.

Me vendimin nr. 70, datë 10.08.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën prej **500,000 lekë**. Me vendimin nr. 47, datë 10.08.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm për subjektin E.K. Nga trajtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se procedurat janë në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, regjistruar për gjykim me nr. 4821-06398 themeltar, datë 18.0.8.2023 regjistrimi, çështje administrative që i përket paditësit z. E.K dhe palë paditëse Inpektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, me objekt “Shfuqizim Vendimesh”.

## **IV. Dosja e subjektit (PF) B.Ç.**

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 09.06.2023, Inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, pranë Bashkisë Kavajë, D.GJ dhe T.M, kanë ushtruar kontroll në subjektin (PF) B.Ç me adresë: Golem Plazh, Kavajë, u konstatuan punime pa leje dhe procesverballi nuk shoqërohet me foto. Inspektorët e IMTV-së, me procesverbalin nr. 61, datë 09.06.2023, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës për “Vendosje kioske e çmontueshme në plazh pa dokumentacion përkatës”. Duke vlerësuar sa më sipër si kundërvajtje administrative, inspektorët kanë vendosur njoftimin e kryeinspektorit, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave. Me vendimin nr. 58, datë 12.06.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën prej **50,000 lekë**. Gjoha nuk është paguar nga kundërvajtësi në mospërputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, ku përcaktohet se “gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit ”.

-Në dosje mungon kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit në Gjykatë.

**Konkluzion:** Kryeinspektori nuk ka nxjerrë “Vendim për prishje” në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

- Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat e ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:

a) kryetari i bashkisë;

b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;

-Vendimi “Për dënimin me gjobë” prej 50,000 lekë i vendosur nga inspektorët e terrenit është minimal, në kundërshtim me nenin 52 shkronja “e” të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar;

- IMTV-ja e Bashkisë Kavajë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit B.Ç, për shkeljen e konstatuar në kundërshtim me nenin 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar.

#### V. Dosja e subjektit (PF) M.XH

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 20.07.2023, Inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, pranë Bashkisë Kavajë, F.O , I.H dhe R.T, kanë ushtruar kontroll në subjektin (PF) M.XH me adresë: Golem Plazh, Kavajë, u konstatuan punime pa leje.

Inspektorët e IVMT, me procesverbalin nr. 68, datë 20.07.2023, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës për “Vendosje tende me konstruksion metalik” pa leje përkatëse. Duke vlerësuar sa më sipër si kundërvajtje administrative, inspektorët kanë vendosur njoftimin e kryeinspektorit, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave. Me vendimin nr. 68, datë 31.07.2023 nga Kryeinspektori është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën prej **500,000 lekë**. Gjoha nuk është paguar nga kundërvajtësi në mospërputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, ku përcaktohet se “gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit”.

Me vendimin nr.42, datë 31.07.2023 nga Kryeinspektori është marrë vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm për subjektin M.XH .

-Në dosje mungon kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit në Gjykatë.

-Në dosje mungon “Kërkesë për mbështetje” nga Kryeinspektori i IMT-së, drejtuar Institucioneve ligj zbatuese.

**Konkluzion:** Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

- Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative" i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:

a) kryetari i bashkisë;

b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;

-IMTV-ja e Bashkisë Kavajë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit M.XH , për shkeljen e konstatuar në kundërshtim me nenin 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar.

#### VI. Dosja e subjektit (PF) Z.H

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 20.07.2023, Inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, pranë Bashkisë Kavajë, D.GJ , SH.K , dhe T.M , kanë ushtruar kontroll

në subjektin (PF) Z.H me adresë: Golem, Kavajë, u konstatuan punime pa leje. Inspektorët e IMTV-së, me procesverbalin nr. 52, datë 18.05.2023, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës "Mbyllje me mure gipsi" pa leje përkatëse. Duke vlerësuar sa më sipër si kundërvajtje administrative, inspektorët kanë vendosur njoftimin e kryeinspektorit, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.

Me vendimin nr. 54, datë 18.05.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën prej **50,000 lekë**. Gjoha nuk është paguar nga kundërvajtësi në mospërputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", neni 30, ku përcaktohet se "gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit". Me vendimin nr.35, datë 23.05.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm për subjektin Z.H .

- Në dosje mungon kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit në Gjykatë.

- Në dosje mungon "Kërkesë për mbështetje" nga Kryeinspektori i IMT-së, drejtuar Institucioneve ligj zbatuese.

**Konkluzion:** Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

- Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të Ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:

a) kryetari i bashkisë;

b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;

**Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi:**

**Z. R.K** , në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kavajë (për periudhën 01.01.2023-15.06.2023); z.

**F.Q** , në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kavajë (për periudhën 15.06.2023-31.12.2023); z.

**Y.N** , në cilësinë e Kryeinspektorit të IMTV-së (për periudhën 01.01.2023-23.06.2023); z.

**M.R** , në cilësinë e Kryeinspektorit të IMTV-së (për periudhën 23.06.2023-31.12.2023).

- Nga Kryeinspektori i IMT-së në 25 raste me Vendim për "Prishje e objektit të kundërligjshëm", nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e "Urdhrit të Ekzekutimit" për prishje objekti të kundërligjshëm.

Nga auditimi i dokumentacionin konstatohet se, janë proceduar gjithsej **45 subjekte** për ndërtime in formale të ndërtuar pa leje ndërtimi dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit të pa shoqëruara të gjitha me Vendim për "Prishje të objektit të kundërligjshëm". Në **25** raste, nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e "Urdhrit të ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm", që do të thotë se objektet e konstatuara të Kundërligjshëm për të cilat ka një vendim prishjeje **vijojnë të pa ekzekutuara nga IMT-ja e Bashkisë Kavajë, duke u bërë shkaktarë i rritjes së numrit të ndërtimeve in formale që kalojnë në procesin e legalizimit**, ku subjektet kanë përfituar parcela ndërtimore në pronësi publike, në zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, në kundërshtim me nenin 5, pika (d) të ligjit nr. 9780/ 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar; nenin 52 pika 6" e Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar; pikën 1 "b"/"iv" i Vendimit nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore".

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar, nenin 5 pika "d"; Ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, neni 52 (6); Vendimit nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore" pikën 1 "b"/"iv"



## II. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV, për subjektet të cilat kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

Nga auditimi i kryer, u konstatua se IMTV Kavajë i ushtron funksionet e veta **jo në përputhje të plotë me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”** i ndryshuar, me qëllim mbrojtjen e territorit nga ndërhyrjet e paligjshme si dhe kontrollin ndërtimeve të pajisura me leje.

*Në formë tabele paraqiten vendimet e marra nga IMTV Kavajë për vitin 2023, pasqyruar si më poshtë:*

Nr.	Lloji i aktit	2023
1	PV/Akte kontrolli	-
2	PV/Akte konstatimi	45
3	Vendime gjobe	43
4	Vendime pezullimi	19
5	Vendime prishje	25
6	PV ekzekutimi të prishjeve	0
7	Kallëzime penale	0
8	Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv	0
9	Informacion periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT	0
10	Plane vjetore të punës të miratuara nga k/inspektori	0
11	Plane mujore të punës të miratuara nga k/inspektori	0

IMTV Kavajë nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 – mujor për IKMT për masat e marra, veprim ky në mospërputhje me nenin 5, gërma “f” të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar i cili përcakton se:

Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

*f) përgatit dhe i jep të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, të këtij neni.*

Kryeinspektori, nuk ka miratuar planet vjetore dhe mujore të punës, në mospërputhje me pikën 1 gërma b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, që përcakton se:

b) Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë njësisë vendore:

*ii) kryen kontrole në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga kryeinspektori, si dhe në bazë të njoftimeve të marra nga institucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizike e juridike*

Për periudhën janar-dhjetor 2023 nga Inspektorët e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Kavajë, janë proceduar gjithsej **45** subjekte për ndërtime in formale të ndërtuar pa leje ndërtimi dhe për objektet me shkëlqe të lejes së ndërtimit, janë proceduar **41** subjekte me “Vendim Gjobe” me një shumë totale për tu arkëtuar **13,100,000 lekë**, nga këto janë ekzekutuar (arkëtuar) vetëm **12** vendime në një vlerë prej **1,400,000 lekë**, ndërsa **29** vendime të tjera janë të pa paguara nga subjektet, në një vlerë prej **11,700,000 lekë duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën prej 11,700,000 lekë.**

Për 4 vendime me gjobë të proceduara përgjatë 2023, përkatësisht:

1. Vendimi me gjobë nr. 42 datë 14.02.2023 në vlerën prej 823,872,600 lekë;
2. Vendimi me gjobë nr. 43 datë 14.02.2023 në vlerën prej 7,763,000 lekë;
3. Vendimi me gjobë nr. 44 datë 14.02.2023 në vlerën prej 3,150,000 lekë;
4. Vendimi me gjobë nr. 45 datë 14.02.2023 në vlerën prej 6,251,000 lekë.

IMTV Kavajë, ka zbatuar shkresën nr. 728/1 prot., datë 31.01.2023, me lëndë “Për kompetencë” e ardhur nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Shuma totale për tu arkëtuar për 4 vendimet me gjobë është **850,036,600 lekë**, nga këto është ekzekutuar (arkëtuar) vetëm 1 vendim në një vlerë prej **6,251,000 lekë** ndërsa për 3 vendime të tjera vjelja e gjobave në vlerën prej **843,785,600 lekë i ka kaluar për kompetencë IKMT-së**.

Me shkresën nr. 728/12 prot., datë 24.02.2023, me lëndë “**Njoftim vlerësimi**”, IKMT i bën me dije IMTV-së Kavajë që: “Duke qenë se këto 4 (katër) objekte ndodhen në zonë bregdetare me rëndësi kombëtare, bazuar në pikën 14/a të VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njesisë Vendore”, ekzekutimi i këtyre vendimeve do të kryhet vetëm nga IKMT”.

Referuar pikës 8 të **Vendimit nr. 894, datë 4.11.2015** “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njesisë Vendore”, IKMT-ja, në mbështetje të nenit 9, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar, ushtron përgjegjësitë e veta në nivel njësie vendore drejtpërdrejt dhe pa asnjë kufizim për ndërtimet/punimet që lidhen me çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor.

**Konstatohet se:** Edhe pse IKMT mund ti ushtronte përgjegjësitë e veta drejtpërdrejt dhe pa asnjë kufizim, me shkresën nr. 728/1 prot., datë 31.01.2023, i ka deleguar kompetencën “Për vendime me gjobë” IVMT-së Kavajë e cila ka marrë masat përkatëse për kundërvajtësit.

**-Vendimi me gjobë nr. 42 datë 14.02.2023 në vlerën prej 823,872,600 lekë, është anuluar me vendimin nr. 11, datë 24.07.2023 “Për anulimin e vendimit nr. 42, datë 16.03.2023 për dënim me gjobë ndaj subjektit “E ” Shpk të z. F.Q , Kryetar i Bashkisë Kavajë.**

Nga trajtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se Vendimi me gjobë nr. 42 datë 14.02.2023 është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Apelit Tiranë, me nr. regjistri themeltar 5317 (3155-7369-8-2023), çështje administrative që i përket paditësit Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Tiranë dhe palë paditëse Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, me objekt: “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Aktit Administrativ” Vendim nr.11. datë 24.07.2023 i Kryetarit të Bashkisë Kavajë “Për anulimin e vendimit nr.42, datë 16.03.2023 për dënim me gjobë ndaj subjektit “E ” Shpk.

### Subjekte kundërvajtës të konstatuar IVMT, Bashkia Kavajë

Emërtimi	Gjoba viti 2023		Arkëtuar		Vendim Gjykatë		Diferenca	
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë
Gjoba IVMT	41	13,100,000	12	1,400,000	-	-	29	11,700,000
Gjoba deleguar nga IKMT	4	850,036,600	1	6,251,000	-	-	3	843,785,600
<b>Gjoba gjithsej</b>	<b>45</b>	<b>863,136,600</b>	<b>13</b>	<b>7,651,000</b>			<b>32</b>	<b>855,485,600</b>

Burimi: IVMT Kavajë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se, përgjatë periudhës objekt auditimi nuk është bërë asnjë kërkesë për të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit të gjobave, veprim ky në mospërputhje me kërkesat e parashikuara në dispozitat ligjore të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 30 (4) i cili përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:

**a) kryetari i bashkisë;**

**b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative.**

#### - Mbi gjobat e mbartura 2019-2022

Nga auditimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga IMTV u konstatua se janë gjithsej **69** debitorë, për gjoba të mbartura prej vitit 2019-2022. Vlera totale e gjobave të pa arkëtuara (të vendosura ne vitet 2019-2022 nga IVMT) është **22,650,000 Lekë**.

Subjekte kundërvajtës të konstatuar për vitet 2019-2022  
IVMT, Bashkia Kavajë.

Emërtimi	Gjopa vitet 2019-2022	
	Numër	Vlerë
<b>Gjopa IVMT</b>	<b>69</b>	<b>22,650,000</b>

Burimi: IVMT Kavajë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sa më sipër, konstatohet se IMTV, ka bërë kërkesë për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit, me qëllim arkëtimin e detyrimeve për **69** debitorë. Gjykata ka pranuar kërkesën për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit për **27** subjekte, në vlerën prej **8,600,000 Lekë**, pasqyruar si më poshtë:

Nr.	Viti	Nr. i gjobave	Vlera e gjobave
1	2022	12	3,450,000
2	2021	6	2,550,000
3	2020	4	1,100,000
4	2019	5	1,500,000
<b>Totali</b>		<b>27</b>	<b>8,600,000</b>

Burimi: IVMT Kavajë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

IMTV nuk ka ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Kavajë **në vlerën prej 8,600,000 Lekë**, në mospërputhje me nenin 22 të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “*Për kundërvajtjet administrative*” që citon: Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, i vendosur nga organet administrative të përmendura në nenin 20 të këtij ligji, si dhe vendimet e parashikuara në nenin 21 të këtij ligji, *përbëjnë titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbartimor ose/dhe organet e përcaktuara në kreun V të këtij ligji.* IMTV nuk ka përcjellë pranë zyrës përmbartimore urdhrat e ekzekutimit me qëllim arkëtimin e detyrimeve të prapambetura.

Nga auditimi i kryer u konstatua se, gjykata ka refuzuar kërkesën për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit për **42** subjekte, në vlerën prej **14,050,000 Lekë**, pasqyruar si më poshtë:

Nr.	Viti	Nr. i gjobave	Vlera e gjobave
1	2022	24	8,750,000
2	2021	10	2,750,000
3	2020	3	1,300,000
4	2019	5	1,250,000
<b>Totali</b>		<b>42</b>	<b>14,050,000</b>

Burimi: IVMT Kavajë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Gjykata i ka gjetur të pabazuara në prova dhe në ligj kërkesat e IMTV Kavajë pasi nuk është provuar që aktet “*Për dënim me gjobë*” ti jenë njoftuar kundërvajtësve, duke sjellë pamundësinë e hyrjes në fuqi të këtyre akteve. Në këto kushte, referuar nenit 104/1 të Kodit të Procedurës Administrative, këto akte administrativ nuk kanë hyrë në fuqi.

*Procedura e njoftimit nëpërmjet të tretit, e ndjekur nga IVMT Kavajë, nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 160 të Kodit të Procedurës Administrative.*

Nga ana e organit publik nuk janë kryer përpjekjet e nevojshme për njoftimin e subjekteve kundërvajtës.

-Në të gjitha rastet nga IMTV-ja, arkëtimi i shumave të detyrimeve, nuk është shoqëruar me kamatë vonesë bazuar në masën e gjobës, në kundërshtim me nenin 30 të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “*Për kundërvajtjet administrative*” i ndryshuar.

-Kryeinspektori i IMTV-së, **nuk ka përcjellë asnjë Kallëzim Penal ndaj subjekteve që kanë kryer punime ndërtimore pa leje** nga organet përkatëse, në kundërshtim me nenin 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar.

- Bashkia Kavajë nuk ka bërë arkëtimin e të gjitha masave administrative të vendosura nga IMTV.

-Për periudhën janar-dhjetor 2023 nga Inspektorët e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Kavajë, janë proceduar gjithsej **45** subjekte për ndërtime in formale të ndërtuar pa leje ndërtimi dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, janë proceduar **41** subjekte me “Vendim Gjobe” me një shumë totale për tu arkëtuar **13,100,000 lekë**, nga këto janë ekzekutuar (arkëtuar) vetëm **12** vendime në një vlerë prej **1,400,000 lekë**, ndërsa **29** vendime të tjera janë të pa paguara nga subjektet, në një vlerë prej **11,700,000 lekë**, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën prej **11,700,000 lekë**.

Nga auditimi i të dhënave të vëna në dispozicion (mbi gjobat e mbartura 2019-2022) u konstatua se janë gjithsej **69** debitorë, për gjoba të mbartura prej vitit 2019-2022.

Sa më sipër, konstatohet se IMTV, ka bërë kërkesë për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit, me qëllim arkëtimin e detyrimeve për **69** debitorë. Gjykata ka pranuar kërkesën për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit për **27** subjekte, në vlerën prej **8,600,000 Lekë**.

IMTV nuk ka ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Kavajë në vlerën prej **8,600,000 Lekë**, në mospërputhje me nenin 22 të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative". IMTV nuk ka përcjellë pranë zyrës përmbartimore urdhrat e ekzekutimit me qëllim arkëtimin e detyrimeve të prapambetura.

Në të gjitha rastet nga IMTV-ja, arkëtimin e shumave të detyrimeve, nuk është shoqëruar me kamatë vonesë bazuar në masën e gjobës, në kundërshtim me nenin 30 të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” i ndryshuar;

Në 1 rast nga IMTV-ja është vendosur “Për dënimin me gjobë” për ndërtime pa leje në shumë minimale, në kundërshtim me nenin 52 shkronja “e” të ligjit nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar;

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar; Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, Ligji nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative".

### **III. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe, bashkëpunimi me Drejtorinë dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit.**

- IMTV Bashkia Kavajë ka ushtruar funksionet e veta jo në përputhshmëri të plotë me detyrimet që përcakton ligji për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme dhe ai për planifikimin e territorit.

**Situata:** Për periudhën objekt auditimi, bashkia rezulton të ketë **797** aplikime në sistem për leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione dhe certifikata përdorimi ndër të cilat rezultojnë të miratuara **495** leje, pasqyruar si më poshtë:

#### **Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023 nga sistemi e-Leje**

Përshkrimi i lejes	Nr i aplikimeve	Nr i miratimeve
Certifikatë përdorimi	45	27

Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	279	203
Leje infrastrukture	-	-
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	88	58
Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	11	8
Leje për ndryshim funksioni	11	5
Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	40	22
Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	13	7
Leje përshtypjen e afatit të lejes së ndërtimit	23	10
Leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni	29	13
Leje zhvillimi	145	73
Njoftim për fillim punimesh	19	17
Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	1	1
Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	37	18
Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	40	23
Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	12	7
Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	4	3

Kryeinspektori nuk ka miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim ky në mospërputhje me nenin 5 gërma “a” të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar i cili përcakton se:

Gjatë ushtrimit të përgjegjësi të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

a) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

-nenin 51 “Inspektimi” të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar i cili përcakton se:

*Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.*

-pikën 2 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” e cila përcakton se: *Kryeinspektori/inspektori i njësisë vendore, gjatë kontrollit të ushtruar për zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi, i vlerëson shkelje të punimeve në ndërtim rastet e mospërputhjes së objektit në ndërtim me kërkesat e lejes së zhvillimit/të ndërtimit e të projektit teknik të zbatimit apo me deklarin paraprak të miratuar e të konfirmuar nga organi i autorizuar.*

Nga auditimi konstatohet mungesa e një bashkëpunimi eficient, midis IMTV-së dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit në Bashkinë Kavajë në kundërshtim me pikën (3) të nenit 51 në Ligjin Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, i cili përcakton se: *Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.*

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar; Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

**Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi:**

Z. R.K , në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kavajë (për periudhën 01.01.2023-15.06.2023); z. F.Q , në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kavajë (për periudhën 15.06.2023-31.12.2023); z. Y.N , në cilësinë e Kryeinspektorit të IMTV-së (për periudhën 01.01.2023-23.06.2023); z. M.R , në cilësinë e Kryeinspektorit të IMTV-së (për periudhën 23.06.2023-31.12.2023); zj. D.Q , në cilësinë e Drejtorit të DPZHT-së.

Nga përfaqësuesit e Bashkisë Kavajë, z. M.R me shkresën nr. 34/14 prot., datë 13.05.2024, janë paraqitur observacione përkatësisht si në vijim:

#### **Pretendimi i subjektit:**

**Z. M.R paraqet pretendimet si vijon:** *Pasi u njohëm me akt konstatimin tuaj në paragrafin IV mbi dosjet e subjekteve (PF) B.Ç , (PF) M.XH , (PF) Z.H nga ana juaj janë konstatuar mungesat e kërkesave për nxjerrjen e Urdhrave të Ekzekutimit në Gjykatë. Për sa më sipër, po ju bashkëlidh kërkesat për nxjerrjen e Urdhrave të Ekzekutimit në Gjykatë.*

*Ju bëjmë me dije se nga ana jonë është bërë kërkesë për lëshimin e urdhrat të ekzekutimit si dhe kërkesë për mbështetje IKMT-së për ekzekutimin e vendimeve të marrë nga ana e IMT në territorin Bashkia Kavajë.*

*Në lidhje me situatën nga auditimin e dokumentacionit për vijimin e vendimeve të pa ekzekutuara ju sqarojmë se: IMT Bashkia Kavajë nuk disponon mjete si dhe kemi kërkuar mbështetje nga Drejtoria e Shërbimeve për mjete dhe makineri të domosdoshme për ekzekutimin e tyre, gjithashtu kemi kërkuar mbështetje dhe për mjete dhe makineri të domosdoshme nga IKMT-ja. Në lidhje me informacionin periodik të dërguar IKMT-së ju bëjmë me dije se kemi patur korrespondencë shkresore për rastet e konstatuara nga ana jonë.*

*Për sa më sipër po ju bashkëngjisim kopje të dokumentacioneve të përmendur në këtë shkresë.*

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, grupi i auditimit sqaron se:

Nga auditimi i kryer u konstatua se, **përgjatë periudhës objekt auditimi** nuk është bërë asnjë kërkesë për të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit të gjobave, veprim ky në mospërputhje me kërkesat e parashikuara në dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative" neni 30 (4).

Grupi i auditimit e vlerëson qëndrimin tuaj për përmirësimin e situatës në vijim, por vlen të theksohet që kërkesat për të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit të gjobave janë bërë jashtë periudhës objekt auditimi dhe pas konstatimit nga ana e KLSH-së.

-Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura në lidhje me informacionin periodik të dërguar IKMT-së, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

Mbi Ekzekutimin e "Vendimeve për Prishje"

Vlen të theksojmë se në ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, neni 52 (6) përcakton se: "**Vendimi për prishjen e ndërtimeve përmban edhe detyrimin e prishjes së menjëhershme të ndërtimit dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e kundërvajtësit**".

Neni 5, pika (d) i ligjit nr. 9780/ 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar, përcakton se gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

#### **d) vendos prishjen e ndërtimit të kundër-ligjshëm**

Vendimi nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore" në pikën 1 (b)/(iv) përcakton se: **Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë njësisë vendore, përfshin në kontrollin e tij** punimin /zhvillimin/ndërtimin e një objekti të ri, **prishjen e objektit**, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, infrastrukturën tokësore e nëntokësore, si dhe prishjen e objekteve që paraqesin rrezik shembjeje, me pasoja për jetën e shëndetin e njerëzve

dhe mbi pasurinë e të tretëve, në përputhje me ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Në kuadër të respektimit të këtyre dispozitave ligjore, IMTV Kavajë duhet të organizoj punën e tyre në mënyrë që të respektohen vendimet e marra nga ushtrimi i kontrollit të territorit.

Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve

## **Pika 2.7 e programit: Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.**

### **1. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.**

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Kavajë **nuk ka respektuar këtë afat** duke mos informuar KLSH-në mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

### **2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.**

Në zbatim të nenit 30 paragrafi 2, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Kavajë **nuk ka respektuar këtë afat** duke mos raportuar KLSH-në mbi ecurinë e zbatimit e rekomandimeve të lëna.

### **3. Raportimi në Këshillin Bashkiak Kavajë.**

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore **nuk ka raportuar në këshillin e njësisë** (këshillin bashkiak), në mospërputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50 “Auditimi i jashtëm” ku përcaktohet se: Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij”.

### **4. Statusi i rekomandimeve të lëna në Auditimin e mëparshëm**

Sipas shkresës përcjellëse të raportit përfundimtar të auditimit të administruar në KLSH me nr. 207/13 prot., datë 31.07.2023, dhe në Bashkinë Kavajë me shkresën nr. 955/24 prot., datë 04.08.2023, nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Janë rekomanduar **16** masa organizative;
- b. Janë rekomanduar **4** masa për shpërbllim dëmi me vlerë **8,606,856 lekë**;
- c. Është rekomanduar **1** masë për eliminimin e efekteve negative të përdorimit të fondeve publike;
- d. Janë rekomanduar **7** masa për uljen e borxhit tatimor;
- e. Janë rekomanduar **9** masa disiplinore.

#### **- Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të KLSH-së.**

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Kavajë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së rezultoi se:

Raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar në Bashkinë Kavajë me shkresën nr. 207/13 prot., datë 31.07.2023, pra në datën 31.01.2024 janë bërë 6 muaj nga data e dërgimit.

- Bashkia Kavajë nuk ka respektuar këtë afatin ligjor prej 20 ditësh duke mos informuar KLSH-në mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, në kundërshtim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Bashkia Kavajë nuk ka respektuar këtë afatin ligjor prej 6 muajsh duke mos raportuar KLSH-në mbi ecurinë e zbatimit e rekomandimeve të lëna në kundërshtim të nenit 30 paragrafi 2, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk ka raportuar në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në kundërshtim të nenit 50, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Grupi i auditimit zhvilloi auditimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së ku rezultoi se, nga Bashkia Kavajë **nuk janë marrë masa lidhur me zbatimin e rekomandimeve**. Kryetari i Bashkisë Kavajë nuk ka përcjellë në asnjë prej drejtorive pjesën takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit të administruar në KLSH me shkresën nr. 207/13 prot., datë 31.07.2023, dhe në Bashkinë Kavajë me shkresën nr. 955/24 prot., datë 04.08.2023. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se:

1. Me shkresën nr. 572/1 prot., datë 01.02.2024, sipas dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Ligjore, rezultoi se nuk është zbatuar pjesa takuese e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit të KLSH-së;

2. Me shkresën nr. 572/5 prot., datë 02.02.2024, sipas dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, rezultoi se nuk janë zbatuar rekomandimet e lëna në raportin përfundimtar të auditimit të KLSH-së për arsye se nuk i është vënë në dispozicion pjesa takuese e raportit.

3. Me shkresën nr. 572/6 prot., datë 02.02.2024, sipas dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjedisit, rezultoi se nuk janë zbatuar rekomandimet e lëna në raportin përfundimtar të auditimit të KLSH-së për arsye se nuk i është vënë në dispozicion pjesa takuese e raportit.

4. Me shkresën nr. 572/7 prot., datë 05.02.2024, sipas dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Policia Bashkiake, rezultoi se nuk kanë marrë njoftim mbi rekomandimet e lëna në raportin përfundimtar të auditimit të KLSH-së.

5. Me shkresën nr. 572/9 prot., datë 06.02.2024, sipas dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit, rezultoi se nuk janë zbatuar rekomandimet e lëna në raportin përfundimtar të auditimit të KLSH-së për arsye se nuk i është vënë në dispozicion pjesa takuese e raportit.

6. Me shkresën nr. 572/10 prot., datë 07.02.2024, sipas dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Prokurimeve Publike, rezultoi se nuk janë zbatuar rekomandimet e lëna në raportin përfundimtar të auditimit të KLSH-së për arsye se nuk i është vënë në dispozicion pjesa takuese e raportit.

7. Me shkresën nr. 572/11 prot., datë 07.02.2024, sipas dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, rezultoi se nuk janë zbatuar rekomandimet e lëna në raportin përfundimtar të auditimit të KLSH-së për arsye se nuk i është vënë në dispozicion pjesa takuese e raportit.

8. Me shkresën nr. 572/12 prot., datë 08.02.2024, sipas dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike, rezultoi se nuk janë zbatuar rekomandimet e lëna në raportin përfundimtar të auditimit të KLSH-së për arsye se nuk i është vënë në dispozicion pjesa takuese e raportit.

9. Me shkresën nr. 572/12 prot., datë 08.02.2024, sipas dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve Publike, rezultoi se nuk janë zbatuar rekomandimet e lëna në raportin përfundimtar të auditimit të KLSH-së për arsye se nuk i është vënë në dispozicion pjesa takuese e raportit.



10. Me shkresën nr. 572/13 prot., datë 22.02.2024, sipas dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, rezultoi se nuk janë zbatuar rekomandimet e lëna në raportin përfundimtar të auditimit të KLSH-së për arsye se nuk i është vënë në dispozicion pjesa takuese e raportit.

Rezulton se nga 37 rekomandime të lëna në total, janë pranuar plotësisht të gjitha.

▪ **Masa Organizative.**

- Nga 16 masa organizative; 1 rekomandim është pjesërisht i zbatuar, 15 rekomandime janë të pa zbatuara.

▪ **Masa Shpërblim Dëmi.**

- Nga 4 masa për shpërblim dëmi me vlerë 8,606,856 lekë; 4 rekomandime janë të pa zbatuara.

▪ **Masa për eliminimin e efekteve negative .**

- Nga 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike edhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike; **1 rekomandim është i pa zbatuar.**

▪ **Masa për uljen e borxhit tatimor.**

- Nga 7 masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore; **7 rekomandime janë të pa zbatuara.**

▪ **Masa Disiplinore.**

- Nga 9 masa disiplinore; 9 rekomandime janë të pa zbatuara.

Në përfundim rezulton se:

**Janë pjesërisht të zbatuara 1 rekomandim:** 1 rekomandim nga masa organizative;

**Janë të pa zbatuara: 36 rekomandime.**

Në total janë rekomanduar gjithsej **37 masa**, të cilat janë pranuar nga subjekti. Nga të pranuarat, 36 masa rezultuan të pazbatuara ose 97.3 %, dhe 1 masë rezultoi pjesërisht e zbatuar ose 2.7 %.

*Përmbledhëse e zbatimit të rekomandimeve*

N r.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Statusi i zbatimit		
				Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	16 masa	-	1 masë	-	15 masa
2	Shpërblim dëmi	4 masa	-		-	4 masa
3	Për eliminimin e efekteve negative të përdorimit të fondeve publike	1 masë	-		-	1 masa
4	Për uljen e borxhit tatimor	7 masa	-	-	-	7 masa
5	Masa disiplinore	9 masë	-	-	-	9 masa

Veprime në kundërshtim me Neni 15, gërma “j” dhe neni 30 pika 2 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Kavajë, Drejtoria Ekonomike, gjatë planifikimit të buxhetit, të marrë masa për planifikimin e trajnimeve të punonjësve, në mënyrë të tillë për mbarëvajtjen e punës në bashki, sa i përket pozicioneve të punës përkatëse për secilin punonjës.

**1.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Kavajë, drejtorët e drejtorive, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

**1.3. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë, Drejtori i Drejtorisë Juridike të ngrejë grupin e punës për kryerjen e planit të veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

**2.1. Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kavajë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditimin tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH-ja, për të pasqyruar aktivitetin e drejtorive të ngarkuara për zbatimin, me qëllim për mbarëvajtjen e punës në bashki.

**3.1. Rekomandim:** Strukturat drejtuese të Bashkisë Kavajë, për çdo vit buxhetor të marrë masa të ngrejë Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe me Grupet e Menaxhimit të Programeve (EMP) dhe ne bashkëpunim me to, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që planifikimi i shpenzimeve buxhetore PBA dhe të vitit koherent të jenë sa më të argumentuara, duke u bazuar në kërkesat e sektorëve dhe dëgjesat me publikun me palët e interesit.

- Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

- Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara, për të cilat të bëhet përcaktimi i plotë i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

- Drejtoria e Burimeve Ekonomike të përgatisë raportet periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit (4 mujore), jo vetëm vjetore, duke i paraqitur në KB dhe krahas tyre të paraqesë dhe një material për uljen e detyrimeve në mënyrë të kontrolluar.

**4.1. Rekomandim:** Strukturat drejtuese të Bashkisë Kavajë dhe Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara, për të cilat të bëhet përcaktimi i plotë i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet. Gjithashtu të përgatitet një plan për daljen nga situata e vështirë financiare dhe paraqitja në Këshillin Bashkiak një material për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura në vlerën reale dhe sipas programeve, dhe të hartojë një grafik likuidimi, duke zbatuar radhën e pagesave, ku të shqyrtohen të gjitha mundësitë dhe rriten burimet e financimit, duke përdorur fondin rezervë dhe të kontingjencës, rishikimin e buxhetit, rritjen e nivelit të të ardhurave si dhe negociminin me kreditorët për të ristrukturuar pagesat për detyrimet e konstatuara dhe të pa likuiduara.

**5.1. Rekomandim:** Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerën 1,907,396 lekë në aktivin e Bilancit të fund vitit 2023 me artikujt kontabël në debi të llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit, në kredi të llog.4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në pasiv të bilancit, për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

**6.1. Rekomandim:** Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të të drejtave për arkëtim të debitorëve. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë, duke përfshirë në gjendjen e llog.468 “debitorë të ndryshëm” debitorët për detyrimet e lindura nga rekomandimet e shpërblim dëmit të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme.

**7.1. Rekomandim:** Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë vlerën prej 122,396,352 lekë AA jo materiale duhet të realizojë inventarin kontabël sipas investimeve përkatëse dhe të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime “dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.

**8.1. Rekomandim:** Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të marrë masa që të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet të AAGJM, duke saktësuar gjendjet e llogarive të klasës 21 në aktiv të bilancit dhe duke ribërë klasifikimin e saktë të aktiveve në llogaritë përkatëse, sipas nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik, të bëjë rakordimin e inventarëve të tyre si dhe përcaktimin e plotë të vlerës së plotë të çdo aktivi, që nga vlera fillestare me gjithë shtesat dhe

pakësimet, shoqëruar me korrektime kontabël për amortizimet, si dhe duke i finalizuar me evidentimin e tyre aktiv për aktiv në librin historik të hartuar sipas formatit të përcaktuar ligjor.

**9.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Kavajë të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kriteret të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet.

**10.1. Rekomandim:** Titullari i AK Bashkia Kavajë, të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

**11.1. Rekomandim:** Titullari i njësisë vendore apo personi i autorizuar prej tij të miratojë për çdo rast urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqëruës. Komisioni të përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision duhen të bëjnë pjesë jo më pak se tre anëtarë, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

**12.1. Rekomandim:** Nga DPKZHT Kavajë të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me planin e përgjithshëm vendor, ku të jenë respektuar kushtet e përcaktuara në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm për distancat nga objektet, nga rrugët kryesore, nga kufitarët.

**13.1. Rekomandim:** Kryeinspektori i IMTV të marrë masa që në bashkëpunim me DPZHKT, Policinë Bashkiake, Policinë e Shtetit, administratorët e njësive vendore, apo dhe cdo organ në nivel qendror e vendor, të dërgojnë e kërkojnë informacione periodike mbi gjendjen në territor. Të ushtrojnë inspektime të planifikuara mbi zona të caktuara por sidomos ato me rëndësi kombëtare si bregdet, pyje apo zona të mbrojtura.

**14.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Kavajë të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre, si më poshtë:

**14.2. Rekomandimi:** Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kadastrës Urbane Bashkia Kavajë të marrë masat e nevojshme, që procedura e dhënies me qira të dyqaneve të bëhet nëpërmjet konkurrimit publik. Gjithashtu të bëjë ndryshimin e formatit të kontratave në përputhje me përcaktimet ligjore, si dhe lidhjen e tyre nga e para me 14 subjektet qiramarrës.

**15.1. Rekomandim:** Titullari i AK Bashkia Kavajë, të marrë masa që në të ardhmen, për marrjen në dorëzim të investimeve publike, të ngrëjë grupe pune me specialistë të fushës së ndërtimit, në mënyrë që kontrolli i cilësisë së punimeve të bëhet sa më korrekt dhe objektet publike të investuara të vihen në shërbim të komunitetit në kohë dhe me cilësinë e duhur.

**16.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Kavajë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kontratës.

**Menjëherë**

## **B. Masa për shpërblim dëmi**

**1.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,579,457 lekë pa TVSh** nga BOE "B B" & "E" SHPK & "P" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 612/4 prot., datë 12.04.2021, me objekt "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Razi Leka"", Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**2.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,933,868 lekë pa TVSh** nga BOE "B B" & "E" SHPK & "P" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 479/5 prot., datë 24.03.2021, me objekt "Rikonstruksion i shkollës së mesme "Aleksandër Moisiu"", Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**3.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,179,291 lekë pa TVSh** nga BOE “D ” & “Z ” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 507/3 prot., datë 04.06.2021, me objekt “Rikualifikimi i qendrës Kulturore “Aleksandër Moisiu”, Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**4.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,914,240 lekë pa TVSh** nga OE “B ” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4075/2 prot., datë 11.11.2020, me objekt “Vazhdim i punimeve për rikonstruksionin e Shëtitorës nr. 2 dhe pajisja e disa rrugëve me polica të shtrirë”, Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

### **C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.**

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Kavajë të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përlllogaritjen e gabuar të fondit limit, e cila ka sjellë përdorim pa ekonomikitet të fondeve në vlerën 7,248,258 lekë pa TVSH.

*Menjëherë*

### **D. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara)**

**1.1. Rekomandim:** Nga strukturat drejtuese dhe Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit të merren masa që planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale, i studiuar dhe i argumentuar, duke shfrytëzuar të gjitha burimet e të ardhurave si dhe të mundësive të arkëtitimit të tyre.

- Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit, për arkëtimin nga tatimpaguesit të vlerës debitorë prej 705,827,865 lekë të marrë të gjitha masat, që përveç nxjerrjes së njoftimit të vlerësimit tatimor, paralajmërimin e masave shtrënguese si dhe njoftimet e bllokimit bankar në bankat e nivelit të dytë për një pjesë të debitorëve të ndjekë të gjitha rrugët ligjore si:

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare për pjesën tjetër të debitorëve të krijuar.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e-Të bashkërendojë punën me QKB dhe DRIT, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

**2.1. Rekomandim:** Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë të marrë masa për plotësimin, saktësimin dhe përditësimin e të dhënave të nevojshme të regjistrit të taksapaguesve vendorë të kategorisë “Familjar” për Bashkinë Kavajë dhe NJA si bazë për llogaritjen e detyrimeve vendore që ju linden familjeve referuar paketës fiskale të miratuar për një planifikim sa më real. Gjithashtu të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat familjare.

**3.1. Rekomandim:** Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë në bashkëpunim dhe me specialistët të Drejtorisë së Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve Publike në NJA, të marrë masa për saktësimin e të dhënave për tokën bujqësore e dhënë në përdorim/pronë si dhe përditësimin e regjistrit të taksapaguesve fermerë për taksën bujqësore për Bashkinë Kavajë dhe NJA, si bazë për llogaritjen e detyrimeve vendore që ju linden familjeve referuar paketës fiskale të

miratuar për një planifikim sa më real dhe të argumentuar. Gjithashtu të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat e tokës ndaj familjeve fermere debitorë.

**4.1. Rekomandim:** Drejtoria e Planifikimit të Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Kavajë të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë të taksës së ndikimit në infrastrukturë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtime të reja që legalizohen. Gjithashtu, strukturat e Bashkisë Kavajë të bashkëpunojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), që krahas legalizimeve në zonat e stimuluar të marrë informacion periodik për të gjitha legalizimet, që kryhen në territorin e Bashkisë Kavajë si dhe të sigurojë një marrëveshje për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**5.1. Rekomandim:** Drejtoria e Mbrojtjes të Konsumatorit dhe Mjedisit të shqyrtojë dokumentacionin e 8 subjekteve debitorë dhe të marrë masa, që këta subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën e mbetur të tarifës së autorizimit prej 1,000,000 lekë ndaj Bashkisë Kavajë për 5 vjet, duke filluar nga data e mbarimit në vitin 2022, si dhe të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur arkëtimet e plota brenda afateve.

**6.1. Rekomandim:** Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkia Kavajë, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës, që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 8 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në vlerën 13,009,282 lekë dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të kontratave dhe nëse në rastet ku është e pamundur arkëtimi i debitorëve të ndiqen të gjitha hapat ligjore, duke parë dhe si mundësi anulimin e kontratave. Ndërsa në rastet e kontraktimit të parcelave pyjore me afat mbi 10 vjet të shikohet mundësia e rishikimit dhe amendimit të tyre me palët për korrektimin e këtyre kontratave sipas dispozitave ligjore në fuqi.

**7.1. Rekomandim:** Drejtoria e Kadastrës Urbane e Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme duke bërë ndryshimin në paketën fiskale të kohëzgjatjes së qiradhënies së hapësirës së plazhit (minimalisht 4-5 muaj me çmimin 100 lekë/m<sup>2</sup>/muaj) me qëllim rritjen e të ardhurave që arkëtohen nga tarifa e qiradhënies për objektin e mësipërm, si dhe eliminimin e efekteve negative financiare në buxhetin .

**Menjëherë**

## **E. Masat disiplinore.**

### **E.I. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin Civil:**

**a- Masa “Vërejte”, shkronja (a) e nenit 58 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”**

1. zj. D.Q , me detyrë drejtore e DPZHDK
2. z. S.V me detyrë specialist në DPZHDK
3. z. H.Z me detyrë specialist në DPZHDK
4. zj. M.H me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ardhura nga Taksat dhe Tarifave Vendore
5. z. SH.K , specialist për taksat familjare në NJA Golem,
6. z. TH.D specialist për taksat në NJA Helmas,
7. z. A.Ç specialist për taksat familjare në Luz i Vogël
8. zj. E.Ç specialist për taksat në NJA Synej.

**b- “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 shkronja (c), për 4 (katër) punonjës si më poshtë:**

9. z. R. I me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit (DTTVAB).

**Menjëherë**

**Për sa konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. F.Q , në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kavajë (për periudhën 15.06.2023-31.12.2023).**

## IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

**Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

### **A. MASA ORGANIZATIVE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se Bashkia Kavajë nuk ka rishikuar rregulloren e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore e për rrjedhojë nuk ka çdo drejtori, sektor apo njësi, përgjegjësi dhe detyra të mire përcaktuara. Bashkia nuk ka një miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe nuk ka hartuar plane vjetore të punës për të gjitha drejtoritë. Nuk rezulton të ketë Urdhër për miratimin e Planit të Veprimit për Kontrollin e Brendshëm dhe për rrjedhojë as raporte periodike të monitorimit të këtij Plani. Institucioni nuk ka asnjë procedurë për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave si rrjedhojë e kësaj. Mungojnë programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale e cila ka mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, librezat e punës, rekrutimin, trajnimet, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Bashkia Kavajë nuk zhvillon takimet e GMS, të dokumentuara me procesverbale dhe nuk ka krijuar Komitetin e Auditimit të Brendshëm.

Bashkia Kavajë nuk ka hartuar strategjinë dhe regjistrin e risqeve, si rrjedhojë e kësaj nuk ka plan-veprime për menaxhimin e riskut. Konstatohet mungesa e monitorimit dhe raportimeve në mënyrë periodike për risqet me impakt të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre. Bashkia nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Bashkia nuk ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni për rrjedhojë këto ndryshime strukturore apo menaxheriale nuk janë ndjekur nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës. Institucioni nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës si edhe nuk janë hartuar hartat dhe manualet e proceseve të punës. Faqja zyrtare e institucionit nuk përditësohet rregullisht dhe punonjësit nuk kanë e-mail zyrtar.

Konstatohet se bashkia nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi. Në bazë të auditimit të kryer, rezulton se titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH nuk ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe nuk ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Për sa më sipër evidentohet se nga ana e Bashkisë Kavajë nuk janë marrë masa për ngritjen e një sistemi funksional dhe efektiv për kontrollin e brendshëm.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrin qendror të personelit”; Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manualin e MFK-së, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Kavajë, Koordinator i Riskut dhe Koordinator i MFK -së të marrë masa për:

- Përditësimin e rregullores së brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore të institucionit.
- Hartimin e planeve operacionale të konsoliduar të punës, me tregues performance, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.
- Hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, regjistrin e konsoliduar të riskut si dhe planin e veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre.
- Hartimin e manualeve të shkruara të proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit, në mënyrë që të identifikojnë përgjegjësitë dhe të përcaktojnë linja të qarta raportimi për njësinë publike. Monitorim të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Kavajë përgjatë vitit 2023, u konstatua se:

Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit. Nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Kavajë, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë. Auditimi mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara. Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve dhe nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të MAB. Nuk është kryer auditim tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH-ja; NjAB nuk ka dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 25.28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Kavajë, Drejtoria e Auditit të Brendshëm të merren masa për:

- Krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, si një organ i pavarur.
- Përditësimin e Kartës së Auditimit dhe Programit për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë së veprimtarisë audituese.
- Shqyrtimin e risqeve më të rëndësishëm për planifikimin dhe zbatimin e projekteve, programeve në të cilat janë fokusuar objektivat strategjike, të njesisë publike.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion të grupit të auditimit “Për hartimin e PBA-së për periudhën 2023-2025”, dhe “Buxheteve Vjetore”, u konstatua se:

Buxheti vjetor për vitin 2023 është realizuar në vlerën **2,055,911** mijë lekë nga **2,713,330** mijë lekë të planifikuara ose në masën 76%. Në mosrealizim kanë ndikuar akordim fondesh me rezervë nga pushteti qendror dhe zërit 230-231 “Shpenzime për investime” në masën 82 %, nga mos realizimi i projekteve në vlerë të plotë, marrjes së angazhimeve dhe lidhjeve të kontratave si dhe financimeve me vonesë, zëri “shpenzime operative” në masën 64 %.

Për vitin 2023, të ardhurat janë realizuar në masën 122% (nga 627,789 mije lekë të planifikuara janë realizuar 766,627 mijë lekë, ndërsa vlera e debitorëve të akumuluar ndër vite për taksa e tarifa vendore, paraqitet në nivele relativisht të larta, në shumën **705,828** (deri më 31.12.2022) mijë lekë. Referuar këtyre treguesve të të ardhurave të realizuara konstatohet se, financimi i

buxhetit vjetor 2023 është bërë në masën 76% nga Buxheti i Shtetit dhe 24% nga të ardhurat e veta.

Buxheti vjetor i Bashkisë Kavajë nuk është hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore për nevojat reale nga njësitë administrative, sektorët e bashkisë, njësitë vartëse. Strukturat e Bashkisë Kavajë nuk kanë ndjekur të gjithë hapat ligjore (Për përgatitjen e PBA -së 2023-2025) konkretisht:

-Kryetari i Bashkisë nuk ka miratuar udhëzimin e brendshëm për përgatitjen e PBA- së, (Ky udhëzim përgatitet prej titullarit, shpërndahet te secili drejtues i EMP (DEMP), dhe përmban, listën e programeve buxhetore, përcaktimin e ekipeve përkatëse të menaxhimit të programeve, tavanet përgatitore për çdo program për tre vitet e ardhshme, afate të detajuara për EMP lidhur me përgatitjen e kërkesave për shpenzime sipas programeve të PBA-së 2023-2025, veprime këto në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 5 dhe 6 të Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e PBA vendor 2023-2025”.

Buxhetet nuk janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, ndërmarrjet e varësisë, etj. (në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse), Pra prej tyre nuk janë marrë kërkesat për nevojat reale, dhe mbi bazën e tyre të hartohet buxheti.

Bashkia Kavajë nuk ka ngritur Ekipet e Menaxhimit të Programeve. Drejtoria e Burimeve Ekonomike nuk administron një urdhër për ngritjen e Ekipeve të menaxhimit të programeve për përgatitjen e PBA dhe Buxhetit vjetor 2023. në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”. Buxhetet nuk janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, ndërmarrjet e varësisë, etj, gjë që vërteton se prej tyre nuk janë marrë kërkesat për nevojat reale, ku mbi bazën e tyre të hartohet buxheti. Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 5/ç,33/1,34,35,36,37,39,40,41; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; neni 12; si dhe udhëzimin e MFE nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e PBA 2023-2025; udhëzimi i MFE nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e PBA 2023-2025; me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 65; me Udhëzimin e MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 161.. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqe 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Kavajë dhe Drejtoria e Burimeve Ekonomike, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të miratojë udhëzimin e brendshëm të përgatitjes së buxhetit i cili të shpërndahet te secili drejtues i EMP (DEMP), dhe të përmbajë, listën e programeve buxhetore, përcaktimin e ekipeve përkatëse të menaxhimit të programeve, tavanet përgatitore për çdo program për tre vitet e ardhshme, afate të detajuara për EMP lidhur me përgatitjen e kërkesave për shpenzime sipas programeve të PBA-së.

Të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Kavajë. Gjithashtu për çdo vit të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Kavajë.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi detyrimet ndaj kreditorëve të Bashkisë Kavajë, u konstatua se nuk janë marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi nga njëra anë kryhen pagesa gjatë vitit për detyrimet e trashëguara ndër vite dhe gjatë vitit buxhetor krijohen detyrime të reja të prapambetura. Detyrimet nuk janë likuiduar sipas radhës (sipas datës së krijimit).



Referuar raportimit të detyrimeve në MFE në fillim të vitit buxhetor 2023 detyrimet e prapambetura kanë vlerën 794,288,097 lekë. **Gjatë vitit 2023** janë krijuar detyrime në vlerën **207,517,297** lekë janë raportuar në MFE 63,826,141 me një diferencë prej 143,691,156 Lekë më pak.

**Në fund të vitit 2023 ka mbetur pa u likuiduar në mënyrë progresive vlera prej 1,452,552,695** lekë ndërsa nga Bashkia Kavajë është raportuar për vlerën **794,288,097** lekë.

Detyrimet e prapambetura të palikujduara të raportuara në MFE në fund të vitit 2023 paraqiten në vlerën 794,288,097 lekë, të cilat nuk rakordojnë me gjendjen e llogarive të klasës 4 të detyrimeve në pasiv të bilancit për vlerën 658,264,598 lekë.

Nga Bashkia Kavajë nuk janë marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi nga njëra anë kryhen pagesa gjatë vitit për detyrimet e trashëguara ndër vite dhe gjatë vitit buxhetor krijohen detyrime të reja të prapambetura.

Vlera e detyrimit të mbetur nuk është e barabartë me vlerën e gjeneruar në sistemin e thesarit sipas llogarive ekonomike, për periudhën e kërkuar.

**Në fund të vitit 2023 ka mbetur pa u likuiduar në mënyrë progresive vlera prej 1,452,552,695 dhe jo vlera 794,288,097 lekë e raportuar në MFE. Pra konstatohet një diferencë në raportim për vlerën 658,264,598** lekë më pak.

Peshën më të madhe të detyrimeve të prapambetura e përbëjnë detyrimet e palikujduara për mallra e shërbime në vlerën 1,331,028,662 lekë, ku vlera më e lartë është për furnizimin me energji elektrike të krijuara në vite nga bashkia dhe ish-komunat për vlerën **1,095,957,411** lekë, që pasohet nga detyrimet e mbetura pa likuiduar për vendime gjyqësore në vlerën 43,572,499 lekë, detyrimet për fatura të palikujduara për investime në vlerën 34,173,066 lekë dhe detyrimin e pa shlyer në vlerën 35,628,212 lekë për “Huanë afatgjatë” të marrë për programin e strehimit.

Pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është **70.6 %** kundrejt shpenzimeve faktike.

*Bashkia Kavajë mund të konsiderohet në vështirësi financiare, pasi raporti i e detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është mbi nivelin prej 25 %.* Për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në Buxhetin e Bashkisë janë bërë shtesë fondesh në vlerën **1,563,711,000** lekë, ku **98,108,000** nga të ardhurat e Bashkisë dhe 1,465,603,000 lekë shtesë fondi nga Pushteti Qendror, fonde këto që kanë një peshë specifike të ulët në vlerën e detyrimeve prej **1,452,552,695** lekë.

Nga Bashkia Kavajë nuk është bërë një punë e mjaftueshme për daljen nga situata e vështirësisë financiare. Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3; Udhëzimi i MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pikat 153-162; ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 52; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91; me ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 56; udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”; Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, pika 3.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë dhe GMS të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrin të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjeve të detyrimeve të reja dhe monitorimit të zbatimit të kontratave të investimeve/shërbimeve si dhe për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme, duke zbatuar aktet ligjore

/nënligjore në likuidimin e tyre në afat, për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim zvogëlimin e detyrimeve të prapambetura.

Të përgatitet një plan për daljen nga situata e vështirë financiare dhe të raportohet në Këshillin Bashkiak në mënyrë periodike gjendja e faturave të pa likuiduara të prapambetura si dhe të hartohet një grafik likuidimi, sipas datës së krijimit të detyrimit.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i strukturës së paketës fiskale për vitin 2023 dhe evidencës së realizimit të të ardhurave u konstatua se:

-Nuk identifikohen taksa dhe tarifa vendore për të gjitha subjektet që zhvillojnë aktivitete dhe gjenerojnë të ardhura në territorin që administrohet prej saj. Struktura e raportimit (Evidenca për Planifikimin dhe Realizimin e të ardhurave, Evidenca për Listën e Debitorëve) nuk jep informacion të plotë mbi të gjitha taksat dhe tarifatat vendore sipas strukturës së paketës Fiskale të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Në regjistra rezultojnë mungesa sipas kategorizimeve për nënkategoritë e taksave /tarifave dhe përjashtimet nga detyrimi për të krahasuar me paketën fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak Kavajë.

-Nuk identifikohen taksa dhe tarifa vendore të përcaktuara për pajisjet automatike të cilat krijojnë aktivitete dhe gjenerojnë të ardhura si: ATM, pajisje elektronike, makineta, lojra për fëmijë, ekranet dixhital të reklamimit, karikues për mjete të lëvizëse (që janë të vendosura në hapësira publike apo biznes privat, pranë institucioneve të ndryshme etj), tenda (konstruksione metalike edhe pse janë të identifikueshme nuk janë të përfshira në takstat dhe tarifatat vendore. Në DTTVAB nuk përcillet informacion lidhur me “Planifikimin” mbi realizimin e pritshëm për taks/tarifa vendore dhe “Listat e Debitorëve” për taks/tarifa vendore nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit; Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Burimeve Ekonomike.

Struktura e raportimit nuk jep informacion të plotë mbi të gjitha taksat/tarifatat vendore dhe gjjobat e aplikuarat për kundërvajtjet administrative, si rrjedhojë nuk ka evidencat e plota për “Planifikimin” mbi realizimin e pritshëm dhe “Realizimin Faktik” për taks/tarifa vendore apo vlerësimin e gjendjes së debitorëve të krijuar për taksat dhe tarifatat vendore dhe gjjobat e aplikuarat për kundër vajtjet administrative, si rrjedhojë mungon gjurma e auditimit mbi vlerësimin e gjendjes së debitorëve të krijuar për to. Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, Neni 2 pika 13: “Subjekt” është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, që ka cilësinë e tregtarit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, shoqëritë tregtare dhe degët e shoqërive të huaja, Neni 2 pika 16. “Veprimtari” është veprimtaria e pavarur ekonomike, profesionale apo tregtare, e ushtruar në mënyrë të vazhdueshme nga subjektet; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, nenet 20-25 në Kreun IV; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 12; Udhëzimi nr. 655/1, datë 06.02.2007 pika 3.1, pika 3.2, pika 3.3, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Bashkia Kavajë të marrë masa që strukturat e ngarkuara për administrim të taksave dhe tarifave vendore sipas paketës fiskale, të japin informacion të plotë në DTTVAB lidhur me planifikimin, realizimin dhe ndjekjen e subjekteve debitorë për të gjitha taksat/tarifatat vendore dhe gjjobat e aplikuarat për kundërvajtjet administrative. Gjithashtu, të rishikohet paketa fiskale duke parashikuar taksat dhe tarifatat për të gjitha kategoritë e biznesit që ushtrorjnë aktivitete në territorin e bashkisë.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi administrimin e regjistrimit të tatimpaguesve fizik/juridik dhe abonentë familjarë, u konstatua se:

Regjistri Elektronik sa i përket funksionimit, organizimit, dhe të dhënave të cilat përpunon nuk funksionon bazuar në përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi.

Bashkia Kavajë grumbullon dhe përpunon të dhëna në Regjistrin Elektronik për abonentët familjarë, personat fizikë e juridikë të cilët kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifën vendore me qëllim administrimin e veprimtarisë së DTTVAB. Të dhënat që kjo drejtori administron ndër të tjera përmbajnë informacion për gjeneralitetet e tatimpaguesit, datat e regjistrimit/çregjistrimit, planifikimit për detyrimet lidhur me taksa dhe tarifa vendore, njoftim detyrimin dhe regjistrimin e arkëtimeve dhe gjendjen debitorë për abonentët familjarë dhe personat fizikë e juridikë të cilët kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifën vendore në territorin që kjo bashki administron.

Të dhënat e regjistrimit nuk janë administruar sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Nuk evidentohet me dokument momentin e protokollimit të mbylljes së regjistrimit elektronik vjetor ekzistues dhe krijimit të regjistrimit elektronik të ri vjetor, të dhëna të cilat do shërbejnë për përgatitjen e evidencave të cilat përdoren për raportim (evidenca mbi planifikimin e pritshëm dhe realizimin faktik mbi të ardhurat për taksa/tarifa vendore, evidenca mbi ndjekjen e subjekteve debitorë, listat për njoftim bllokimi për subjektet debitorë në bankat e nivelit të dytë apo QKB) realizimi në drejtimin e Bashkisë Kavajë dhe përgatitjen e pasqyrave financiare. Mungon rakordimi analitik dhe i dokumentuar midis sektorëve dhe kontabilitetit.

Të dhënat në kontabilitet regjistrohen sipas të dhënave të përcjellë nga DTTVAB e cila krijohet nga procesi i përpunimit në formatin Excel i informacionit të grumbulluar në regjistrin elektronik vjetor (në të cilin nuk ka të dhëna mbi informacionin historik mbi subjektin) si dhe nga informacioni që paraqesin drejt saj drejtoritë të cilat administrojnë taksa dhe tarifa vendore bazuar në paketën fiskale. Procesi i përpunimit bëhet manualisht duke ulur efikasitetin, nivelin e cilësisë dhe sigurinë e informacionit të përpunuar.

Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore” nenin 3, Ligji nr. 2/2017, datë 26.01.2017, “Për sigurinë kibernetike” neni 4; Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” Kreun II “Rregullat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave; Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të ndryshuar” nenet 2, 3,.5, 6....20...27,28.; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar nenet 25, 27, 28, 31; VKM nr. 945, datë 02.11.2012, “Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore” i ndryshuar, etj (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1 Rekomandimi:** Bashkia Kavajë të marrë masa për ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit bazuar në të gjithë elementët e tij, (mjedisin i sigurisë së informacionit, vlerësimi i riskut, politikat e sigurisë, organizimi i sigurisë së TIK, menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, menaxhimi i aseteve, siguria e burimeve njerëzore, siguria fizike dhe mjedisore, kontrolli i aksesit, menaxhimi i incidenteve të sigurisë së tik, menaxhimi i vazhdueshmërisë së aktivitetit të njësisë, përputhshmëria.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**7. Gjetje nga auditimi:** Nuk ka element kontrolli mbi vërtetësinë e të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve. Popullimi i regjistrimit elektronik me kërkesa për regjistrim të subjekteve të reja, ndryshimet në të dhënat rreth adresës primare, shtimin apo mbylljen e adresave dytësore dhe të dhënave mbi të cilat përllogariten tarifën dhe taksat vendore për subjektet ekzistuese **nuk realizohet duke rakorduar informacionin e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB me sektorin e verifikimeve në terren dhe DRT.** Për vitin 2023 nuk ka asnjë komunikim me QKB dhe DRT lidhur me rakordimin mujor apo vjetor për numrin e subjekteve të reja, subjekteve të cilat kanë ndryshuar të dhënat rreth adresë primare ose sekondare, subjekteve të çregjistruara.

Kërkesat për regjistrim të subjekteve të reja, kërkesat për ndryshime të dhënash, kërkesat për ndryshimin e statusit të aktivitetit (çregjistrim, pasiv apo pezullim të subjekteve ekzistuese) nga subjektet tatim pagues **nuk shoqërohen në asnjë rast me Akt konstatimet nga sektori i verifikimit në terren**, edhe konstatimet e administruara në dosjet ekzistuese nuk janë të rifreskuara periodikisht (çdo vit) dhe nuk shprehin qartë objektin për të cilin është kërkuar mbajtja e këtij akt konstatim. Kjo ndikon në cilësinë e të dhënave që popullojnë bazën e regjistrit elektronik të DTTVAB- së, planifikim dhe në përgatitjen e evidencave të qarta sa i përket identifikimit të subjektit dhe përcaktimit të njoftim detyrimit për tu paguar lidhur me taksat dhe tarifave vendore”.

DTTVAB për çdo aplikim nga subjektet ekzistuese lidhur **ndryshimin e statusit të aktivitetit (çregjistrim, pasiv apo pezullim)** nuk kërkon nga sektori verifikimit në terren informacion lidhur me kërkesën e paraqitur nga QKB. (nëse subjekti i cili ka paraqitur kërkesën për ndryshim statusi ushtron aktivitet ose jo.)

Në regjistër janë konstatuar raste ku subjekti edhe pse ka gjendje debitorë, rezulton me statusin çregjistruar, pasiv apo pezulluar.

Termi i përdorur më shpesh në akt konstatime është “Nuk u gjet në aktivitet” ose “Nuk u Gjet”, pa përcaktuar numrin e procesverbaleve të mbajtura për të vërtetuar shpeshësinë e kontrolleve apo faktin nëse ky subjekt nuk ushtron aktivitet.

Nga evidencat e trajtuara në DTTVAB nuk u konstatua asnjë dokument i cili tregon rakordimin me degët rajonale të tatimeve lidhur me klasifikimin e biznesit dhe llojin e aktivitetit që kryen. Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 5, neni 11,...; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 1, neni 2 germat a, ç, neni 5 germat a, d, dh, f, g, gj, h, i, neni 6 pikat 1, 2, 3, neni 12 germat a, b, dh..., neni 13 germa b, neni 15, neni 23 pika 1, 4, neni 26, neni 27, neni 28 pika 1, neni 29, neni 31, neni 40, neni 41, neni 42, neni 43 pika 1, 2, 3, neni 44, neni 45, neni 47, neni 48 pika 1, neni 57 pikat 4, 5, neni 60, 61, 62, neni 65 pika 5, neni 68, 69, neni 70 pika 2, neni 71/1 pika 5 etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1 Rekomandimi:** DTTVAB të kryej inventarizimin e të gjithë subjekteve të cilët janë objekt i taksave vendore dhe të plotësohet një regjistër me të dhënat përkatëse, të plotësohen dosjet e subjekteve me dokumente që informojnë në mënyrë kronologjike veprimtarinë e tatimpaguesit, të tilla si kartela të viteve të kaluara, pagesat nga bankat, llogaritjet e xhiros, akt verifikimet e inspektorëve, të dhëna për aplikimin e gjobave, lloje të ndryshme dokumentesh të pronësisë etj.,.

-Të ushtrohet kontroll në subjekte për llogaritjen e detyrimeve tatimore, mbajtjen e regjistrave dhe kryerjen e pagesave të tatimeve në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në legjislacionin tatimor.

-Të evidentojë subjektet që ushtrojnë aktivitet pa leje dhe të merren masat përkatëse ligjore për regjistrimin e tyre dhe llogaritjen e arkëtimit e detyrimeve përkatëse vendore.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## 8. Gjetje nga auditimi:

a. Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Kavajë dhe Njësite Administrative Synej, Helmas, Luz i Vogël, Golem, nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, ku përcaktohet që, “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të

inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre **brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji**”.

**b.** Referuar rregullores së brendshme të Bashkisë Kavajë, në mënyrë të përgjithshme përcaktohen detyrat për inventarizimin, përditësimin, regjistrimin e pronave të të gjitha llojeve, por nuk ka një sektor/strukturë të posaçme, për inventarizimin e pronave, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar dhe më pas regjistrimin në kadastër.

Nga auditimi konstatohet se, nuk ekziston një regjistër kontabël ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

**c.** Me VKM-të përkatëse janë transferuar në total **3,176 pasuri** si ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat **2,645 pasuri në pronësi** dhe **531 pasuri në përdorim**.

Në total në pronësi të Bashkisë Kavajë janë **2,645 pasuri**, nga të cilat **201 pasuri** janë të pajisura me certifikatë dhe **2,444 pasuri** nuk janë të pajisura me titull pronësie.

Për sa trajtuar më sipër nga Bashkia Kavajë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu III, pika 35 dhe Kreu II, pika 16, neni 37, pika 1, Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 74-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të marrë masa që me grup pune, specialist të fushës, të hartojë regjistrin e plotë të aktiveve, jo vetëm për ato që janë të regjistruara në kontabilitet, por edhe për aktivet të cilat momentalisht nuk janë të regjistruara në librat e kontabilitetit. Të bëhet inventarizimi fizik i të gjitha pasurive në teren dhe për situatën e konstatuar të hartohet një raport i hollësishëm titullarit të institucionit.

**8.2 Rekomandimi:** Sektori i Strehimit dhe Regjistrimit të Pronave të marrë masa për përgatitjen e dosjeve me dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor dhe regjistrimin e tyre në ASHK.

Drejtoria e Burimeve Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Strehimit dhe Regjistrimit të Pronave, të llogarisë në buxhetin e PBA dhe buxhetin vjetor fondet e nevojshme për regjistrimin e pasurive në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Kavajë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan **4 praktika** tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosrespektimin e kriterëve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe ato të përcaktuara në Planin e Detajuar Vendor, të tilla si koeficienti i shfrytëzimit të territorit, intensiteti i ndërtimit, lartësia e ndërtimit, distancat dhe tipologjia e lejuar sipas njësisë strukturore përkatëse, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi, përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt: **1** “Strukturë akomoduese 5 dhe 6 katëshe + 2 kat nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 4881, datë 04/12/2023, me zhvillues shoqëria “L ” ShPK, në adresën rruga Mali i Robit, Golem, Kavajë; **2.** “Strukturë akomoduese 5 kat me 1 kat podrum”, miratuar me vendimin nr. 4249, datë 14.04.2023, me zhvillues shoqëria “D ”

Shpk, në adresën rruga Mali i Robit, Golem, Kavajë; **3.** “Struktura banimi 2 kat + 1 kat nëntokë (podrum) (katër struktura banimi)”, miratuar me vendimin nr. 4892, datë 09.11.2023, me zhvillues R & S.V , në adresën Lagja nr 2 Rruga “Metalikes”, Kavajë; **4.** “Strukturë Turistike, 6 Kat me 1 kat nën tokë”, miratuar me vendimin nr. 4934, datë 04.01.2023, me zhvillues shoqëria “C ” ShPK, në adresën Golem, Kavajë. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 20, Planin i Përgjithshëm Vendor, me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullorja e Planit të miratuar me Vendimin e KKT nr. 2, datë 27.04.2018, i ndryshuar me Vendimin nr. 4, datë 25.04.2023; me Planin i Detajuar Vendor me Vendimin nr. 04, datë 16.03.2022; me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Vendimin nr. 730, datë 20.10.2016, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifet, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 129-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Kavajë, të marrë masa që përpara miratimit të lejeve të ndërtimit të verifikohet se aplikimi i kryer është në përputhje me të gjitha kriteret dhe kondicionet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe në Planin e Detajuar Vendor, të tilla si: koeficienti i shfrytëzimit të territorit, intensiteti i ndërtimit, lartësia e ndërtimit, distancat dhe tipologjia e lejuar sipas njësisë strukturore përkatëse, sipas përcaktimit të tyre, në aktet përkatëse, në kohë dhe hapësirë.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan **2 praktika** tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë në lidhje me pavlefshmërinë e dokumentacionit të pronësisë dhe kufizime të pronësisë në kartelën e pasurisë së paluajtshme, përpara miratimi të lejes të ndërtimit, përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt: **1.** “Strukturë akomoduese 5 dhe 6 katëshe+2 kat nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 4881, datë 04.12.2023, me zhvillues shoqëria “L ” ShPK, në adresën rruga Mali i Robit, Golem, Kavajë; **2.** “Struktura banimi 2 kat + 1 kat nëntokë (podrum) (katër struktura banimi)”, miratuar me vendimin Nr. 4892, datë 09/11/2023, me zhvillues R & S.V , në adresën Lagja nr. 2 Rruga "Metalikes", Kavajë. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 15, në pikën 1, germa b/ neni 21, pika 6; me Ligjin 111/2018, për “Kadastrën”, datë 7.2.2019, neni 17, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 129-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Kavajë të marrë masa për të mos miratuar leje ndërtimi pa verifikuar paraprakisht dokumentacionin e pronësisë, i cili duhet të pasqyrojë gjendjen ligjore të kërkuar, si dhe miratimet/ konfirmimet nga institucionet përkatëse për saktësinë dhe vërtetësinë e tyre.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan **3 praktika** tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mungesën e marrjes së miratimeve dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, të paraqitura e ngarkuara në sistemin e-leje gjatë aplikimit, në zbatim të legjisllacionit të posaçëm në fuqi, përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt:

**1.**“Strukturë akomoduese 5 dhe 6 katëshe + 2 kat nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 4881, datë 04.12.2023, me zhvillues shoqëria “L ” ShPK, në adresën rruga Mali i Robit, Golem, Kavajë; **2.** “Strukturë akomoduese 5 kat me 1 kat podrum”, miratuar me vendimin nr. 4249, datë 14.04.2023, me zhvillues shoqëria “D ” ShPK, në adresën rruga Mali i Robit, Golem, Kavajë; **3.** “Strukturë Turistike, 6 Kat me 1 kat nën tokë”, miratuar me vendimin Nr.

4934, datë 04.01.2023, me zhvillues shoqëria “C ” ShPK, në adresën Golem, Kavajë. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 21, pika 6. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 129-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Kavajë të marrë masa për miratimet e nevojshme nga institucionet përkatëse gjatë fazës së aplikimit për leje zhvillimi dhe për leje ndërtimi, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

### Menjëherë dhe në vijimësi

**12. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua **1 praktikë** tek e cila tipologjia e ndërtimit mund të jetë e ndryshme nga destinacioni i përcaktuar në lejen e ndërtimit të miratuar. Në këtë praktikë, llogaritja e TNI është kryer sipas destinacionit dhe tipologjisë të deklaruar nga aplikuesi, ndërkohë që, duke ju referuar projektit të ndërtimit, ky i fundit paraqet detaje sipas të cilave destinacioni përfundimtar i ndërtimit mund të jetë i ndryshëm nga ai i deklaruar. Dhënia e një destinacioni përfundimtar të ndryshëm nga ai i deklaruar ndikon në mënyrën e llogaritjes së TNI-së si dhe eventualitetin apo mundësinë e aplikimit ndaj subjektit përfitues të nenit 19, pika 1 të ligjit Nr. 22/2018, “Për strehimin social”. Gjetja e konstatuar u evidentua për lejen e ndërtimit me objekt: **1.** “Strukturë akomoduese 5 dhe 6 katëshe + 2 kat nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 4881, datë 04.12.2023, me zhvillues OE “L ” ShPK, në adresën rruga Mali i Robit, Golem, Kavajë;

Anomalitë e trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Neni 27, taksa e ndikimit në infrastrukturë; me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 46, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; Vendimin e Këshillit Bashkiak Kavajë, nr. 107, datë 22.11.2022, mbi “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë”; Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social”, datë 3.5.2018, Neni 19, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 129-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Kavajë, të marrin masa për ndjekjen e zbatimit të punimeve në referencë me lejen e ndërtimit. Në rast se destinacioni përfundimtar i objektit të ndërtimit, për të cilin do të lëshohet certifikata e përdorimit, është i ndryshëm nga ai i reflektuar në lejen e ndërtimit, të bëhet rillogaritja e diferencës së taksës së ndikimit në infrastrukturë TNI sipas VKB Kavajë me nr.107, datë 22.11.2022, duke aplikuar gjithashtu, ndaj subjektit përkatës, nenin 19, pika 1, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”.

### Në vijimësi

**13. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan **1 praktikë** tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mosrealizimin e marrëveshjes për 3% të sipërfaqes funksionale për kontributin e sektorit privat në favor të krijimit të fondit publik të banesave sociale, pasi nuk është përcaktuar në mënyrën e duhur tipologjia e ndërtimit, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: **1.** “Strukturë Turistike, 6 Kat me 1 kat nën tokë”, miratuar me vendimin nr.4934, datë 04.01.2023, me zhvillues shoqëria “C ” ShPK, në adresën Golem, Kavajë. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social”, datë 3.5.2018, Neni 19, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 129-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Kavajë, në lidhje me lejen e ndërtimit të miratuar me vendimin Nr. 4934, datë 04.01.2023, të cilësorë shoqërinë aplikuese “C ” ShPK si subjekt të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, datë 3.5.2018, neni 19, pika 1, duke siguruar kalimin pa shpërbllim, në favor të fondit publik të banesave sociale, të 3% të sipërfaqes funksionale të objektit, nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate për kalim

pronësie dhe regjistrimin e kësaj të fundit në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.  
**Menjëherë dhe në vijimësi**

**14. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të certifikatave të përdorimit u konstatua **1 praktikë** tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me miratimin e certifikatës së përdorimit pa pasur dokumentacionin e nevojshëm të ngarkuar në sistemin e-Leje dhe realizimi i objektit në terren në mospërputhje me lejen e ndërtimit të miratuar, përkatësisht në certifikatën e përdorimit me objekt: 1."Strukturë turistike + hotel 6 kate + duplex (8 kate) + ambjente funksionale (teknike) + 1 kat nëntokë", miratuar me vendimin nr. 4653, datë 18/07/2023, me zhvillues "B "ShPK, në adresën Golem, Kavajë. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me Ligjin 107/2014, datë 31.7.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Neni 42, Certifikata e përdorimit, me Ligjin nr. 107/2014, për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, neni 51, Inspektimi; me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, neni 27, certifikata e përdorimit; neni 27/1, mbikëqyrja e punimeve; neni 27/2, dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi; me Ligjin Nr.9780, datë 16.07.2007, "Për inspektimin e ndërtimit", Neni 10, Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 129-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Kavajë të marrë masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për miratimin e certifikatës së përdorimit dhe për të verifikuar aktet e kontroleve të mbajtura, si edhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionin të aktivitetit e IMTV konstatohet se, janë proceduar gjithsej **45 subjekte** për ndërtime informale të ndërtuar pa leje ndërtimi dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit të pa shoqëruara të gjitha me Vendim për "Prishje të objektit të kundërligjshëm". Në **25** raste, nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e "Urdhrit të ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm", që do të thotë se objektet e konstatuara të kundërligjshëm për të cilat ka një vendim prishjeje vijojnë të pa ekzekutuara nga IMT-ja e Bashkisë Kavajë, duke u bërë shkaktarë i rritjes së numrit të ndërtimeve in formale që kalojnë në procesin e legalizimit, ku subjektet kanë përfituar parcela ndërtimore në pronësi publike, në zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit.

Veprime këto në kundërshtim me nenin 5, pika "d" të ligjit nr. 9780/ 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar; nenin 52 "6" i ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar; pikën 1 "b"/"iv" i Vendimit nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 150-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1 Rekomandimi:** Kryeinspektori IMT-së Bashkia Kavajë, të nxjerrë Urdhër Ekzekutimi për prishjen e objekteve të kundërligjshëm për **25** subjekte që janë me Vendim për "Prishje Objekti të Kundërligjshëm".

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer konstatohet se, IMTV Kavajë nuk e ka përmbushur plotësisht qëllimin e saj, garantimin dhe mbrojtjen për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas kuadrit rregullator të fushës, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat ligjore përkatëse.



-Kryeinspektori nuk ka miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim ky në mospërputhje me nenin 5 germa “a” të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar;

-IMTV Kavajë nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 – mujor për IKMT për masat e marra, veprim ky në mospërputhje me nenin 5, germa “f” të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar;

-Kryeinspektori, nuk ka miratuar planet vjetore dhe mujore të punës, në mospërputhje me pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”;

-Kryeinspektori i IMTV-së, nuk ka përcjellë asnjë Kallëzim Penal ndaj subjekteve që kanë kryer punime ndërtimore pa leje nga organet përkatëse, në kundërshtim me nenin 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar; Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM-në nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 150-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1 Rekomandimi:** Inspektorati i Mbrojtjes Territorit Bashkia Kavajë, të marrë masa për:

- Mbajtjen e akt kontrolleve për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe planifikimit, kontrollit dhe zhvillimit të territorit.

- Të mos lejuar asnjë ndërtim të zhvillohet në kushtet e mungesës së lejes së zhvillimit dhe të ndërtimit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

- Shkëmbimin e informacionit me DPKZHT dhe rritjen e bashkëpunimit midis tyre. Kryerjen kontrolle periodike mbi objektet në zhvillim, të pajisur me leje ndërtimi, për të verifikuar nëse zbatimi i punimeve kryhet sipas projektit të miratuar.

- Hartimin e informacion periodik tre mujor ndaj Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) mbi aktivitetin e saj, procedurat e mbajtura gjatë kësaj kohe dhe vendimet e marra.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Kavajë për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së u konstatua se:

Raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar në Bashkinë Kavajë me shkresën nr. 207/13 prot., datë 31.07.202. Bashkia Kavajë nuk ka respektuar këtë afatin ligjor prej 20 ditësh dhe prej 6 muajsh në informimin e KLSH-në mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe ecurinë e zbatimit e rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 15, shkronja “j” dhe nenit 30 paragrafi 2, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk ka raportuar në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në kundërshtim të nenit 50, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga Bashkia Kavajë **nuk janë marrë masa lidhur me zbatimin e rekomandimeve**, kështu nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej: **16** masa organizative; **4** masa për shpërblim dëmi me vlerë **8,606,856 lekë**; **1** masë për eliminimin e efekteve negative të përdorimit të fondeve publike; **7** masa për uljen e borxhit tatimor; **9** masa disiplinore.

Kryetari i Bashkisë Kavajë nuk ka përcjellë në asnjë prej drejtorive pjesën takuese të raportit përfundimtar të auditimit të administruar në KLSH me shkresën nr. 207/13 prot., datë 31.07.2023, dhe në Bashkinë Kavajë me shkresën nr. 955/24 prot., datë 04.08.2023.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 162/168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1 Rekomandimi:** Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces, si vijon:

**B. Masa organizative**

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Kavajë, Drejtoria Ekonomike, gjatë planifikimit të buxhetit, të marrë masa për planifikimin e trajnimeve të punonjësve, në mënyrë të tillë për mbarëvajtjen e punës në bashki, sa i përket pozicioneve të punës përkatëse për secilin punonjës.

**1.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Kavajë, drejtorët e drejtorive, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

**1.3. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë, Drejtori i Drejtorisë Juridike të ngrëjë grupin e punës për kryerjen e planit të veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

**2.1. Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kavajë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditimin tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH-ja, për të pasqyruar aktivitetin e drejtorive të ngarkuara për zbatimin, me qëllim për mbarëvajtjen e punës në bashki.

**3.1. Rekomandim:** Strukturat drejtuese të Bashkisë Kavajë, për çdo vit buxhetor të marrë masa të ngrëjë Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe me Grupet e Menaxhimit të Programeve (EMP) dhe në bashkëpunim me to, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që planifikimi i shpenzimeve buxhetore PBA dhe të vitit koherent të jenë sa më të argumentuara, duke u bazuar në kërkesat e sektorëve dhe dëgjesa me publikun me palët e interesit.

- Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

- Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara, për të cilat të bëhet përcaktimi i plotë i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

- Drejtoria e Burimeve Ekonomike të përgatisë raportet periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit (4 mujore), jo vetëm vjetore, duke i paraqitur në KB dhe krahas tyre të paraqesë dhe një material për uljen e detyrimeve në mënyrë të kontrolluar.

**4.1. Rekomandim:** Strukturat drejtuese të Bashkisë Kavajë dhe Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara, për të cilat të bëhet përcaktimi i plotë i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet. Gjithashtu të përgatitet një plan për daljen nga situata e vështirë financiare dhe paraqitja në Këshillin Bashkiak një material për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura në vlerën reale dhe sipas programeve, dhe të hartojë një grafik likuidimi, duke zbatuar radhën e pagesave, ku të shqyrtohen të gjitha mundësitë dhe rriten burimet e financimit, duke përdorur fondin rezervë dhe të kontingjencës, rishikimin e buxhetit, rritjen e nivelit të të ardhurave si dhe negociminin me kreditorët për të ristrukturuar pagesat për detyrimet e konstatuara dhe të pa likuiduara.

**5.1. Rekomandim:** Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerën 1,907,396 lekë në aktivin e Bilancit të fund vitit 2023 me artikujt kontabël në debi të llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit, në kredi të llog.4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në pasiv të bilancit, për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet

kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

**6.1. Rekomandim:** Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të të drejtave për arkëtim të debitorëve. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë, duke përfshirë në gjendjen e llog.468 “debitorë të ndryshëm” debitorët për detyrimet e lindura nga rekomandimet e shpërblim dëmit të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme.

**7.1. Rekomandim:** Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë vlerën prej 122,396,352 lekë AA jo materiale duhet të realizojë inventarin kontabël sipas investimeve përkatëse dhe të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime “dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.

**8.1. Rekomandim:** Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të marrë masa që të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet të AAGJM, duke saktësuar gjendjet e llogarive të klasës 21 në aktiv të bilancit dhe duke ribërë klasifikimin e saktë të aktiveve në llogaritë përkatëse, sipas nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik, të bëjë rakordimin e inventarëve të tyre si dhe përcaktimin e plotë të vlerës së plotë të çdo aktivi, që nga vlera fillestare me gjithë shtesat dhe pakësimet, shoqëruar me korrektimet kontabël për amortizimet, si dhe duke i finalizuar me evidentimin e tyre aktiv për aktiv në librin historik të hartuar sipas formatit të përcaktuar ligjor.

**9.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Kavajë të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kriterë të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet.

**10.1. Rekomandim:** Titullari i AK Bashkia Kavajë, të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

**11.1. Rekomandim:** Titullari i njësisë vendore apo personi i autorizuar prej tij të miratojë për çdo rast urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. Komisioni të përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision duhen të bëjnë pjesë jo më pak se tre anëtarë, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

**12.1. Rekomandim:** Nga DPKZHT Kavajë të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me planin e përgjithshëm vendor, ku të jenë respektuar kushtet e përcaktuara në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm për distancat nga objektet, nga rrugët kryesore, nga kufitarët,

**13.1. Rekomandim:** Kryeinspektori i IMTV të marrë masa që në bashkëpunim me DPZHKT, Policinë Bashkiake, Policinë e Shtetit, administratorët e njësive vendore, apo dhe çdo organ në nivel qendror e vendor, të dërgojnë e kërkojnë informacione periodike mbi gjendjen në territor. Të ushtrojnë inspektime të planifikuara mbi zona të caktuara por sidomos ato me rëndësi kombëtare si bregdet, pyje apo zona të mbrojtura.

**14.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Kavajë të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre, si më poshtë:

**14.2. Rekomandimi:** Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kadastrës Urbane Bashkia Kavajë të marrë masat e nevojshme, që procedura e dhënies me qira të dyqaneve të bëhet nëpërmjet konkurrimit publik. Gjithashtu të bëjë ndryshimin e formatit të kontratave në përputhje me përcaktimet ligjore, si dhe lidhjen e tyre nga e para me 14 subjektet qiramarrës.

**15.1. Rekomandim:** Titullari i AK Bashkia Kavajë, të marrë masa që në të ardhmen, për marrjen në dorëzim të investimeve publike, të ngrëjë grupe pune me specialistë të fushës së ndërtimit, në mënyrë që kontrolli i cilësisë së punimeve të bëhet sa më korrekt dhe objektet publike të investuara të vihen në shërbim të komunitetit në kohë dhe me cilësinë e duhur.

**16.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Kavajë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kontratës.

**Menjëherë**

**B. Masa për shpërblim dëmi.**

**1.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,579,457 lekë pa TVSh** nga BOE “B B” & “E ” SHPK & “P ” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 612/4 prot., datë 12.04.2021, me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “Razi Leka””, Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**2.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,933,868 lekë pa TVSh** nga BOE “B B” & “E ” SHPK & “P ” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 479/5 prot., datë 24.03.2021, me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Aleksandër Moisiu””, Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**3.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,179,291 lekë pa TVSh** nga BOE “D ” & “Z ” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 507/3 prot., datë 04.06.2021, me objekt “Rikualifikimi i qendrës Kulturore “Aleksandër Moisiu””, Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**4.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,914,240 lekë pa TVSh** nga OE “B ” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4075/2 prot., datë 11.11.2020, me objekt “Vazhdim i punimeve për rikonstruksionin e Shëtitores nr. 2 dhe pajisja e disa rrugëve me polica të shtrirë”, Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike.**

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Kavajë të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përlllogaritjen e gabuar të fondit limit, e cila ka sjellë përdorim pa ekonomikitet të fondeve në vlerën 7,248,258 lekë pa TVSH.

**Menjëherë**

**D. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, përfshirë dhe detyrimet nga giradhënia (të ardhura të munguara)**

**1.1. Rekomandim:** Nga strukturat drejtuese dhe Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit të merren masa që planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale, i studiuar dhe i argumentuar, duke shfrytëzuar të gjitha burimet e të ardhurave si dhe të mundësive të arkëtimit të tyre.

- Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit, për arkëtimin nga tatimpaguesit të vlerës debitorë prej 705,827,865 lekë të marrë të gjitha masat, që përveç nxjerrjes së njoftimit të vlerësimit tatimor, paralajmërimit të masave shtrënguese si dhe njoftimet e bllokimit bankar në bankat e nivelit të dytë për një pjesë të debitorëve të ndjekë të gjitha rrugët ligjore si:

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare për pjesën tjetër të debitorëve të krijuar.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e-Të bashkërendojë punën me QKB dhe DRRT, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

**2.1. Rekomandim:** Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë të marrë masa për plotësimin, saktësimin dhe përditësimin e të dhënave të nevojshme të regjistrit të taksapaguesve vendorë të kategorisë “Familjar” për Bashkinë Kavajë dhe NJA si bazë për llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar për një planifikim sa më real. Gjithashtu të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat familjare.

**3.1. Rekomandim:** Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë në bashkëpunim dhe me specialistët të Drejtorisë së Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve Publike në NJA, të marrë masa për saktësimin e të dhënave për tokën bujqësore e dhënë në përdorim/pronë si dhe përditësimin e regjistrit të taksapaguesve fermerë për taksën bujqësore për Bashkinë Kavajë dhe NJA, si bazë për llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar për një planifikim sa më real dhe të argumentuar. Gjithashtu të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat e tokës ndaj familjeve fermere debitorë.

**4.1. Rekomandim:** Drejtoria e Planifikimit të Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Kavajë të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë të taksës së ndikimit në infrastrukturë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, strukturat e Bashkisë Kavajë të bashkëpunojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), që krahas legalizimeve në zonat e stimuluar të marrë informacion periodik për të gjitha legalizimet, që kryhen në territorin e Bashkisë Kavajë si dhe të sigurojë një marrëveshje për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**5.1. Rekomandim:** Drejtoria e Mbrojtjes të Konsumatorit dhe Mjedisit të shqyrtojë dokumentacionin e 8 subjekteve debitorë dhe të marrë masa, që këta subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën e mbetur të tarifës së autorizimit prej 1,000,000 lekë ndaj Bashkisë Kavajë për 5 vjet, duke filluar nga data e mbarimit në vitin 2022, si dhe të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur arkëtimet e plota brenda afateve.

**6.1. Rekomandim:** Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkia Kavajë, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës, që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 8 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në vlerën 13,009,282 lekë dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të kontratave dhe nëse në rastet ku është e pamundur arkëtimi i debitorëve të ndiqen të gjitha hapat ligjore, duke parë dhe si mundësi anulimin e kontratave. Ndërsa në rastet e kontraktimit të parcelave pyjore me afat mbi 10 vjet të shikohet mundësia e rishikimit dhe amendimit të tyre me palët për korrektimin e këtyre kontratave sipas dispozitave ligjore në fuqi.

**7.1. Rekomandim:** Drejtoria e Kadastrës Urbane e Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme duke bërë ndryshimin në paketën fiskale të kohëzgjatjes së qiradhënies së hapësirës së plazhit (minimalisht 4-5 muaj me çmimin 100 lekë/m<sup>2</sup>/muaj) me qëllim rritjen e të ardhurave që arkëtohen nga tarifa e qiradhënies për objektin e mësipërm, si dhe eliminimin e efekteve negative financiar në buxhetin .

**Menjëherë**

#### **E. Masat disiplinore.**

**E.I. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin Civil:**

**a- Masa “Vërejte”, shkronja (a) e nenit 58 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”**

1. zj. D.Q , me detyrë drejtore e DPZHKT
  2. z. S.V me detyrë specialist në DPZHKT
  3. z. H.Z me detyrë specialist në DPZHKT
  4. zj. M.H me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ardhura nga Taksat dhe Tarifave Vendore
  5. z. SH.K , specialist për taksat familjare në NJA Golem,
  6. z. TH.D specialist për taksat në NJA Helmas,
  7. z. A.Ç specialist për taksat familjare në Luz i Vogël
  8. zj. E.Ç specialist për taksat në NJA Synej.
- b-“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 shkronja (c), për 4 (katër) punonjës si më poshtë:
9. z. R. I me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit (DTTVAB).

*Menjëherë*

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” u konstatua se:

Nga DTTVAB Bashkia Kavajë për vitin vitit 2023 planifikimi për të ardhura nga taksat dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” është me rezervë për 19,771 familje në vlerën 72,856,135 lekë më pak, të cilat janë të ardhura të munguara si pasojë e mos planifikimit korrekt të taksës familjare, konkretisht trajtuar më poshtë:

DTTVAB Bashkia Kavajë për vitin 2023 ka planifikuar për ngarkesë fiskale kategoria “Familjar” gjithsej 3600 familje. Krahasuar me numrin e familjeve sipas informacionit nga gjendja civile konstatohet se nga Bashkia Kavajë janë planifikuar 19,771 familje më pak x 3685 lekë/familje = **72,856,135 lekë më pak**.

- Krahasuar me të dhënat e evidencës për planifikim dhe realizim për vitin 2022 u konstatua se janë planifikuar **5799 familje më pak** x 3685 lekë/familje = **21,369,315 lekë më pak** se planifikimi për vitin 2022.

Në këto përlllogaritje janë përjashtuar familjet të cilat përjashtohen nga ngarkesa me taksa tarifa vendore sipas paketës fiskale të miratuar për vitin 2023.

Sipas të dhënave nga DTTVAB, planifikimi vjetor i taksave dhe tarifave lokale për vitin 2023 për kategorinë “Familjar”, është **13,266,000 lekë**, kjo për 3600 familje. Realizimi faktik për vitin 2023 janë në vlerën **76,167,604 lekë** nga të cilat **1,083,757 lekë** nëpërmjet bankave dhe **75,083,847 lekë** nëpërmjet arkave në njësi.

DTTVAB Bashkia Kavajë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM nr. 132, datë 7.3.2018, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Për këta taksapagues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, duhet të ndiqeshin procedurat ligjore për njoftimin dhe arkëtimin e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore në përputhje me paketën fiskale.

Theksojmë se në këtë përlllogaritje nuk janë marrë parasysht fshatrat turistike si dhe pasuritë e paluajtshme të dyta në NjA Golem.

Situata e mësipërme, është krijuar për arsye se në vitin 2020 është ndërprerë marrëveshja e bashkëpunimit me UK ShA Kavajë ku ky i fundit ka pasur rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Praktikisht sa i takon taksimit të kategorisë “Familjar”, për Qytetin e Kavajës, DAV Bashkia Kavajë takson vetëm ato familje të cilat kanë një aktivitet ekonomik, pasi vetëm tek kjo kategori e ka të mundur identifikimin dhe ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore. Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Pika 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-25 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Kreu II, pika II.1 në

Paketën Fiskale të Bashkisë Kavajë për vitin 2023. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**18.1 Rekomandimi:** Bashkia Kavajë, të hartojë një program pune për evidentimin e të gjithë taksapaguesve familjar, për të krijuar regjistrin e plotë të tyre. Të bëhet optimizimi i të dhënave të taksapaguesve familjarë, të krijohet një strukturë për monitorimin e veprimtarisë në regjistrin elektronik, statistikave operacionale, zbatimin e rregullave të integritetit për ruajtjen e të dhënave, për të parandaluar regjistrimin e dyfishtë të taksapaguesve, modifikimin e të dhënave pa dokumentacion mbështetës, moslejimin për ndryshime të pa autorizuara të të dhënave.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumenteve të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në lidhje me organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor u konstatua stafi në strukturën e IMTV-së nuk kanë arsimin e lartë të nevojshëm profesional. Kjo mbart riskun e pamjaftueshmërisë së burimeve për arritjen e objektivave në sasi por mund të cenohet dhe cilësinë e punës së Inspektoratit. Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjes vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit. Veprime këto në kundërshtim me Ligji nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 11. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 150-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**19.1 Rekomandimi:** Nga Titullari i Bashkisë Kavajë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa për sistemimin e organizimit të IMTV -së konformë kuadrit rregullator ligjor në fuqi, në mënyrë që të plotësojnë strukturën e me punonjës sipas kriterëve ligjore.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik dhe zbatimit të kontratave për punë publike, u konstatua se në **7 raste**, nga AK Bashkia Kavajë, **nuk është kryer oponenta teknike**, respektivisht për objektet:

1. Procedura me objekt: “Rindërtimi i kopshtit dhe çerdhes në fshatin Golemi”. Bashkia Kavajë, Viti 2023, me fond limit 208,808 mijë lekë.
2. Procedura me objekt: “Rikonstruksion i kopshtit Hap pas Hap”. Bashkia Kavajë, Viti 2023, me fond limit 56,544 mijë lekë.
3. Procedura me objekt: “Rindërtimi i kopsht çerdhe në fshatin Luz i Vogël”. Bashkia Kavajë, Viti 2023, me fond limit 107,000 mijë lekë.
4. Procedura me objekt: “Rindërtimi i kopsht çerdhe në fshatin Golem”. Bashkia Kavajë, Viti 2023, me fond limit 191,021 mijë lekë.
7. Procedura me objekt: “Rindërtimi i godinës së Ish-Prefekturës”. Bashkia Kavajë, Viti 2023, me fond limit 167,800 mijë lekë.

Mos kryerja e oponentës teknike nga AK Bashkia Kavajë, vjen në kundërshtim me pikën 1 të VKM Nr.1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponentës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, sipas të cilës: “Për të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, që realizohen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga subjekte fizike dhe juridike, vendas ose të huaj, për të cilat vlera e preventivuar e punimeve të ndërtimit është jo më pak se 100,000,000 lekë, të bëhet oponentë teknike”, si dhe me pikën 3 të VKM Nr.1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponentës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, sipas të cilës: “Të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponentës teknike...” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4. faqe 80-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**20.1.Rekomandimi:** Bashkia Kavajë të marrë masa që të pajisë me **Oponentë Teknike** çdo

projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

## **Menjëherë dhe në vijimësi**

**21. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimit 01.01.2023 – 31.12.2023 nga Bashkia Kavajë janë realizuar në total 7 procedura prokurimi me vlerë të lartë, me fond limit në shumën 777,424,405 lekë pa TVSh dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën 770,116,227.70 lekë pa TVSh, nga të cilat janë audituar të 7 procedurat ose në masë 99 % të fondit limit.

Nga auditimi i 7 procedurave me vlerë të fondit limit 777,424 mijë lekë, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, të 7 procedurat me vlerë kontrate 770,116 mijë lekë ose 99 % e vlerës së Fondit Limit, shkelje të cilat konsistojnë në aplikim e kriterëve në mënyrë të paargumentuar dhe jo në përputhje me tipologjinë e procedurës së zhvilluar, veprime të cilat kanë çuar në uljen e numrit të OE në procedurë.

Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenet 1, 2, neni 3, “*Parimet të përgjithshme*”, neni 98 “*Anulimi i një procedure prokurimi*” dhe pika 1 neni 21, nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, nenet 39 “*Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike*”, neni 78 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*”, neni 82 “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*” pika 2, neni 67 “*Klasifikimi i ofertave*” pika 2, neni 83 “*Njoftimi i fituesit*

” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 161-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** AK në hartimin e DT, të shmangë aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

## **Menjëherë**

### **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.**

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30/4/2015, “*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “*Për vetëqeverisjen vendore*”, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Kavajë), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **43,468,061 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “*Rikonstruksion i kopshtit Hap pas Hapi*”, Bashkia Kavajë, me vlerë të kontratës 56,500,000. lekë, realizuar nga OE “G” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **1,050,334 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 43/3 prot., datë 09.02.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavajë dhe OE “G” ShPK, si dhe Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, neni 7. Udhëzimi i KM nr. 2, datë



13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 117-129të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Kavajë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **1,050,334 lekë** nga OE “G” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 43/3 prot., datë 09.02.2023, me objekt: “Rikonstruksion i kopshtit Hap pas Hapi”, Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Brenda datës 30.09.2024**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Ndërtim i zjarrfikës Kavajë (ndërtesë & rrethim)”, Bashkia Kavajë”, me vlerë të kontratës 77,663,390 lekë, realizuar nga BOE “G” ShPK & “SH” ShPK & “M” ShPK “F” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **7,039,858.04 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 881/3 prot., datë 12.04.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavajë dhe BOE “G” ShPK & “SH” ShPK & “M” ShPK “F” ShPK, si dhe Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7. Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 117-129të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Kavajë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **7,039,858 lekë** nga BOE “G” & “SH” & “M” & “F” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 881/3 prot., datë 12.04.2022, me objekt: “Ndërtim i zjarrfikës Kavajë (ndërtesë & rrethim)”, Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Brenda datës 30.09.2024**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: “Shërbimi i pastrimit Njësia Administrative Golem”, me vlerë të kontratës **305,433,338 lekë pa TVSh**, (Afati i realizimit të shërbimit 5 (pesë) vite, nga data e lidhjes së kontratës) realizuar nga shoqëria “A” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **12,719,126.42 lekë pa TVSh**, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së shërbimit nr. 3568/3 prot., datë 02.10.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavajë dhe OE “A” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 117-129të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Kavajë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **12,719,126 lekë pa TVSH** nga OE “A” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën së shërbimit me nr. 3568/3 prot., datë 02.10.2020, me objekt: “Shërbimi i pastrimit Njësia Administrative Golem”, Bashkia Kavajë, që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Brenda datës 30.09.2024**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: “Shërbimi i pastrimit të Qytetit Kavajë dhe Njësive Administrative Synej, Luz i Vogël e Helmas”, Bashkia Kavajë me vlerë të kontratës **549,298,645 lekë pa TVSh**, (Afati i realizimit të shërbimit 5 (pesë) vjetë, nga data e lidhjes së kontratës) realizuar nga BOE “A” ShPK & “A” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **22,658,743 lekë pa TVSH**, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së shërbimit nr. 3568/3 prot., datë 09.12.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavajë dhe OE “A” ShPK. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 117-129të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Kavajë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **22,658,743 lekë pa TVSh** nga BOE “A” ShPK & “A” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën së

shërbimit me nr. 3568/3 prot., datë 09.12.2022, me objekt: “Shërbimi i pastrimit të Qytetit Kavajë dhe Njësive Administrative Synej, Luz i Vogël e Helmas”, Bashkia Kavajë, që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Brenda datës 30.09.2024**

### **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit, u konstatuan **2 praktika** në të cilat taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është përlllogaritur në mënyrën e duhur, pasi në një rast tipologjia e ndërtimit nuk është në përputhje me përdorimet e lejuara sipas njësisë strukturore të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kavajë, duke marrë për bazë çmimin e shitjes për metër katror dhe koeficientët përkatës sipas ambjenteve (hapësirë parkimi, hapësirë shërbimi ose hapësirë banimi) dhe në rastin tjetër janë evidentuar ndryshime të sipërfaqeve të ndërtimit nga verifikimi i projektit të ndërtimit rezultuan diferenca për objektet:

**1.** “Strukturë Turistike, 6 Kat me 1 kat nën tokë”, miratuar me vendimin nr. 4934, datë 04.01.2023, me zhvillues shoqëria “C ” ShPK, në adresën Golem, Kavajë. Fatura e përlllogaritur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Bashkisë Kavajë është **13,396,453 lekë**, ndërsa llogaritja e saktë ka vlerën **26,316,918 lekë**, me një diferencë në vlerë prej **12,920,465 lekë**.

**2.** “Strukturë akomoduese 5 kat me 1 kat podrum”, miratuar me vendimin nr. 4249, datë 14.04.2023, me zhvillues shoqëria “D ” ShPK, në adresën rruga Mali i Robit, Golem, Kavajë. Fatura e përlllogaritur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Bashkisë Kavajë është **14,615,466 lekë**, ndërsa llogaritja e saktë ka vlerën **16,932,177 lekë**, me një diferencë në vlerë prej **2,316,711 lekë**.

Anomalitë e trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Neni 27, taksa e ndikimit në infrastrukturë; me Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 46, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; VKB Kavajë, nr.107, datë 22.11.2022, mbi “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë”;  
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 129-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Kavajë të marrë masa për arkëtimin e vlerës **15,237,176 lekë**, vlerë cila përbën të ardhura të munguara në dëm të buxhetit të njësisë. Përkatësisht:

- Nga shoqëria “C ” ShPK të arkëtohet vlera **12,920,465 lekë**;

- Nga shoqëria “D ” ShPK të arkëtohet vlera **2,316,711 lekë**.

**Brenda datës 30.09.2024**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit për kredinë e marrë nga Banka Qendrore Evropiane (CEB) me ndërmjetësimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në rolin e institucionit garant të këtij detyrimi u konstatua Kontabilizim jo i saktë i saj. Në pasqyrat financiare të vitit 2023 nuk ka informacion sa i përket kredisë së marrë nga Banka Qendrore Evropiane (CEB) me ndërmjetësimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në rolin e institucionit garant të këtij detyrimi. Në kontabilitetin e bashkisë kjo kredi është pasqyruar si huamarrje por nuk ka të dhëna kontabël ku të tregohet historiku i transferimit të gjendjeve të llogarive të kësaj veprimtarie. Për këtë huamarrje Bashkia Kavajë nuk rezulton të ketë kryer pagesa për vitet 2022-2023 për këstet vjetore në vlerë **7,670,516 lekë**. Bazuar në legjislacionin për kontabilitetin paraqitja e huasë në bilanc duhet në kredi të Pasivet Afat Gjata/klasa 4 llogari të pagueshme, hua afat gjatë dhe në debi tek të tjera aktive afatshkurtra,

llog 481, shpenzime për tu shpërndarë në disa ushtrime. Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; nenet 10-11, të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 3 pikat 4, 6., nenet 57-60, nenet 62, 63, 64, 67; Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me UMF nr. 5, datë 21.02.2022, Aneksi 1, “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, si dhe në Udhëzimin e MFE nr. 34, datë 14.12.2022, “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike, të marrë masa për kryerjen e pagesave të planifikuara dhe të papaguara për kredinë e marrë nga Banka Qendrore Evropiane (CEB), në shumën **7,670,516** lekë të bëjë kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të llogarive në mënyrë që pasqyrat financiare të sigurojnë informacion të saktë për pozicionin financiar të kredisë. Drejtoria Burimeve Ekonomike në çdo rast të kryejë kontabilizime të sakta dhe të plota të veprimtarisë ekonomike të njësisë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Grupi i auditimit mori në shqyrtim **20** dosjet e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse, karburantit dhe GLN. Referuar të dhënave dhe verifikimit të detyrimeve dhe pagesave rezultojnë se të gjitha subjektet (**20 subjekte**) nuk tarifohen për taksë ndërtese dhe taksë tabelle për qëllime reklamimi, ku vlera e munguar në të ardhurat e Bashkisë për vitin 2023 është **6,088,673 lekë**.

Këto diferenca vijnë si pasojë e mos llogaritjes së saktë të detyrimeve për taksat vendore në vlerën 5,653,785 lekë, konkretisht për taksën e pasurisë “Tendë” dhe për taksën e reklamës vlera të cilat u përlllogaritën nga DTTVAB, pas mbajtjes së akt verifikimeve nga sektori i verifikimit në terren. Përveç këtyre detyrimeve, për vitin 2023, rezultojnë të pa likuiduara detyrimet për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **434,888 lekë** për 4 subjekte.

Gjithashtu për këto subjekte ka një diferencë prej 3976 **m<sup>2</sup>** sipërfaqe ndërtesë(tendë) dhe 347 **m<sup>2</sup>** sipërfaqe reklamë pa regjistruar në regjistrin elektronik të DTTVAB.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar”; neni 5, 8,...., neni 23 pika 4, nenet 29,36,69, 75, 89, 90...; Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar” neni 20, neni 22/5.; Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”; VKB nr. 107, datë 22.11.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Bashkia Kavajë të identifikojë çdo individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e bashkisë, si dhe të planifikojë detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme “ndërtesë” sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3.2 Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin nga **20** subjektet në shumën **6,088,673 lekë**, taksë ndërtese (tendë) dhe tabelle për qëllime reklamimi.

**Brenda datës 30.9.2024**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit dhe bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Konsumatorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit konstatohet se për vitin

2023, mbi subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit të karburanteve, u konstatua se:

- Mos pajisje me licencë e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kjo për 15 subjekte në vlerën totale prej **15,716,667 lekë**, nga ku 10 subjekte nuk janë pajisur me licencë 5 vjeçare por me autorizim 1 vjeçar në vlerën 8,000,000 lekë; 2 subjekte të paregjistruar në regjistrin e DKMM në vlerën 2,816,667 lekë dhe 3 subjekte që ushtrojnë aktivitetin pa licencë pas përfundimit të vlefshmërisë në vlerën 2,100,000 lekë dhe 5 subjekte debitor fund të vitit 2022 për vlerën 2,800,000 lekë.

- Nuk janë pajisur me leje aktiviteti 24 orëshe 20 subjekte (sipas listës së detajuar që është trajtuar në RPA) ndërkohë që ushtrojnë aktivitet “non stop”, duke evidentuar mungesë të ardhurash në vlerën **200,000 lekë**. Nga Drejtoria e Konsumatorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit nuk janë marrë masa për aplikimin e gjobës për ushtrimin e aktivitetit pa pajisur me lejen përkatëse.

Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligji nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar”; nenet 29,36,69, 75, 89, 90...; Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar”; Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”; VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar; VKB nr. 107, datë 22.11.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Konsumatorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim aplikimin dhe liçensimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t’i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa liçensën për aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundor.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**4.2 Rekomandimi:** Drejtoria e Konsumatorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurave të nevojshme për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara për **20** subjekte me vlerë **13,116,667** lekë, si vijon:

- Për **10** subjekte që nuk janë pajisur me licencë 5 vjeçare por me autorizim 1 vjeçar në vlerën **8,000,000 lekë**;

- Për **3** subjekte që ushtrojnë aktivitetin pa licencë pas përfundimit të vlefshmërisë në vlerën **2,100,000 lekë**;

- Për **5** subjekte debitor fund të vitit 2022 për vlerën **2,800,000 lekë**, sipas tabelave faqe 36-74 të RPA;

- Për **2** subjekte me vlerë **2,816,667 lekë**, që zhvillojnë aktivitet pa u identifikuar dhe regjistruar në regjistrin, konkretisht: Subjekti XH , person fizik me NIPT K...I dhe Subjekti A ShPK me NIPT L...I.

- Për **20** subjekte me vlerë **200,000 lekë** që ushtrojnë aktivitet “24 orësh” me qëllim aplikimin dhe pajisja me leje aktiviteti 24 orësh, sipas tabelës faqe 36-74 të RPA.

**Brenda datës 30.9.2024**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i regjistrit elektronik të DTTVAB- së dhe bazuar në dokumentet e paraqitura lidhur me subjektet që kanë ushtruar veprimtari ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Kavajë, konstatua se:

Subjektet ndërtuese, që kanë ushtruar veprimtari ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Kavajë, nuk janë pajisur me certifikatë regjistrimi për adresë dytësore për çdo kantier ndërtimi, për këto subjekte nuk është përlllogaritur dhe arkëtuar detyrim për taksat dhe tarifave vendore, më konkretisht gjatë vitit 2023:

- Janë pajisur me leje ndërtimi mbi 250 m<sup>2</sup> gjithsej 21 subjekte.
- Kanë njoftuar për fillim punimesh 99 subjekte.

Si rezultat i testimi të këtij procesi për subjektet e paraqitura në Aneksat nr. 6 dhe nr. 7. ("2.2.6 Të Ardhurat" bashkëngjitur RPA), për vitin 2023 u konstatuan diferenca, në vlerën **7,205,204 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar.

Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, në shkronjën "b" të nënpikës 1.3 të pikës 1 në nenin 9, shkronjën "a" të pikës 5 të nenit 35, shkronjën "f" të nenit 54; Ligji nr. 68/2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore". pikën 10 të nenit 3 dhe pikën 2 të nenit 18. Ligji nr. 9920, "Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenin 40. nenin 43; Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", neni 19, 22, ...43; VKB nr.107, datë 22.11.2022 "Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2023" në Bashkinë Kavajë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **7,205,204 lekë** për subjektet ndërtuese të pajisura me leje ndërtimi, që kanë ushtruar veprimtari ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Kavajë dhe nuk janë pajisur me certifikatë regjistrimi për adresë dytësore për çdo kantier ndërtimi për vitin 2023 sipas përcaktimeve në paketë fiskale të paraqitura në Aneksat nr. 6 dhe nr. 7. ("2.2.6 Të Ardhurat" bashkëngjitur RPA.).

**Brenda datës 30.9.2024**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i regjistrimit elektronik të DTTVAB- së, bazuar në dokumentet e paraqitura lidhur me subjektet e pajisura me "Certifikatë Përdorimi" dhe kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi u konstatua se:

Për vitin 2023 janë pajisur me certifikatë përdorimi gjithsej 22 subjekte. Për këto subjekte nuk është përlllogaritur dhe arkëtuar detyrim për taksat dhe tarifave vendore (Taksën e pasurisë të paluajtshme Ndërtesë dhe Truall), pas pajisjes me Certifikatë Përdorimi.

Si rezultat i testimi të këtij procesi për 22 subjektet e paraqitura në Aneksin nr.8 bashkëlidhur RPA, u konstatuan diferenca, në vlerën **4,020,853 lekë** e ardhur e munguar për bashkinë Kavajë.

Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 40; Udhëzimi nr.24, datë 2.9.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, KREU III. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **4,020,853 lekë** detyrim për taksë pasurie e paluajtshme (ndërtesë dhe truall), pas pajisjes me Certifikatë Përdorimi për vitin 2023 për 22 subjektet paraqitur në Aneksin nr.8 bashkëlidhur RPA.

**Brenda datës 30.9.2024**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave të vendosura në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave për taksën mbi tokën bujqësore për vitin 2023, u konstatua se:

DTTVAB Bashkia Kavajë ka planifikuar për ngarkesë fiskale 886 Ha tokë bujqësore për vlerën **6,198,107 lekë**, të ardhura për t'u arkëtuar nga taksa mbi tokën bujqësore.

Nga përlllogaritjet e kryera, bazuar në kategorinë e bonitetit, sipërfaqen e tokës bujqësore për çdo familje, rezultoi se planifikimi i taksës së tokës bujqësore duhet të bëhet për vlerën 26,198,107 lekë, dhe jo 20,600,000 lekë.

Gjithsej tokë bujqësore sipas agronomëve në krahasim me informacionin që administrohet nga DTTVAB Bashkia Kavajë rezulton se janë 886 Ha më pak, diferencat rezultojnë në sipërfaqe sipas kategorisë së bonitetit, fenomen i cili ndikon në rritjen e planifikimit të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore. Konkretisht:

-NJA Luz i Vogël diferencat rezultojnë në kategorinë e IV për sipërfaqen 968.5 Ha, kategorinë e V për sipërfaqen 157.6 Ha, kategorinë e VI për sipërfaqen 21 Ha, si dhe kategorinë e VII për sipërfaqen 18 Ha.

-NJA Helmas diferencat rezultojnë në kategorinë VI të tokës për sipërfaqen 14 Ha dhe në kategorinë e VII të tokës për sipërfaqen 34 Ha;

-NJA Golem diferencat rezultojnë në sipërfaqen e tokës bujqësore për 72 Ha;

-NJA Synej diferencat rezultojnë në kategorinë e I të tokës për 840 Ha, kategorinë e II të tokës për 299 Ha, kategorinë e IV për 17 Ha, kategorinë e VI për 119 Ha dhe kategorinë e VII për 285 Ha.

Veprime të cilat nuk janë në përputhje me pikën 7 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Kreu I, shkronja “b” në Paketën Fiskale të Bashkisë Kavajë për vitin 2023. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për hartimin e regjistrit të taksapaguesve privat dhe familjar për taksën e tokës bujqësore, duke evidentuar qytetarët të cilët kanë marrë tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saj, në hektar për secilin Mbi bazën e këtij regjistri të llogariten dhe të arkëtohen detyrimet për taksën e tokës bujqësore në shumën prej **6,198,107 lekë**.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacioni mbi administrimin e dosjeve të subjekteve fizik/juridik rezulton se:

- U konstatuan diferenca midis vetëdeklarimit për taksën e pasurisë së paluajtshme dhe gjendjes faktike në terren me dokumentacion. Grupi i auditimit mori në shqyrtim 10 dosje subjektsh me zgjedhje, për 5 nga këto subjekte ju kërkua sektorit të verifikimit në terren pranë kësaj drejtorie të kryhen akt verifikime lidhur me përputhshmërinë e vetëdeklarimit të subjekteve dhe gjendjes në fakt për taksë ndërtese dhe trualli. Në 5 subjekte për të cilat janë mbajtur akt verifikime (me kërkesë të grupit të auditimit) u konstatuan diferencat në sipërfaqe ndërtese në 2 subjekte për 211 m<sup>2</sup> në vlerën 41,989 lekë dhe në 5 subjekte për sipërfaqe trualli 10,085 m<sup>2</sup> me vlerë 201,700 lekë. Këto sipërfaqe trualli janë pjesë e fondit pyjor të Bashkisë dhe kanë ndryshuar destinacion.

Kjo situatë ka sjellë mungesë të ardhurash në vlerë totale 243,689 lekë, dhe pakësim e ndryshim destinacioni për sipërfaqe trualli të cilat kanë qenë pjesë e fondit pyjor të Bashkisë. Strukturat përgjegjëse kontrolluese/inspektuese në bashki nuk kanë kontrolluar përmbushjen e detyrimeve ligjore, kontraktuale, në mënyrë që të parandalojnë dhe marrin masa administrative në rastet e dëmtimit, të pushtimit, shpërdorimit, **tjetërsimit**, shkretimit dhe degradimit të pyjeve brenda territorit të tyre. Sipërfaqet në fjalë janë të destinuara për ushtrimin e funksioneve për interes vendor si pyje, kullota, parqe dhe kopshte publike dhe jo për veprimtari tregtare të ndryshme nga karakteristika e pronës.

1.Subjekti “B” ShPK, NIPT: L...U me përfaqësues ligjor: Z. A.M me aktivitet: Bar, Restorant, Hotel është tarifuar për 2023 për sipërfaqe trualli ka diferencë, 2250 m<sup>2</sup>x 20 lekë/m<sup>2</sup> në vlerë **45,000 lekë taksë trualli**.

2.Subjekti "E" ShPK, NIPT: L...A me përfaqësues ligjor: Z. E.D me aktivitet: Restorant, Hotel

e stacion plazhi. Subjekti është tarifuar për 2023, ka diferencë, për sipërfaqe trualli ka diferencë 2683 m<sup>2</sup> x 20 lekë/m<sup>2</sup> në vlerë **53,660 lekë taksë trualli**.

**3.** Subjekti "E " ShPK, NIPT: K...P me përfaqësues ligjor: Z. B.S me aktivitet: Hoteleri. Subjekti është tarifuar për 2023, ka diferencë 85 m<sup>2</sup>x199 lekë /m<sup>2</sup> në vlerë 16,915 lekë taksë ndërtese, për sipërfaqe trualli ka diferencë 1667 m<sup>2</sup> x20 lekë/m<sup>2</sup> në vlerë 33,340 lekë taksë trualli. **Në total 50,255 lekë.**

**4.** Subjekti "F " ShPK, NIPT: L...N, me përfaqësues: Z. B.K me aktivitet: Hoteleri. Subjekti është tarifuar për 2023, ka diferencë 126 m<sup>2</sup>x199 lekë /m<sup>2</sup> në vlerë 25,074 lekë, për sipërfaqe trualli ka diferencë 2627 m<sup>2</sup> x20 lekë/m<sup>2</sup> në vlerë 52,540 lekë. **Në total 77,614 lekë.**

**5.** Subjekti "K.R " pf, NIPT: K...D, me përfaqësues: Z. K.R me aktivitet: Restorant, hotel, stacione plazhi, lundrime turistike, sporte ujore. Subjekti është tarifuar për 2023 ka diferencë, për sipërfaqe trualli ka diferencë 858<sup>m2</sup> x 20 lekë/m<sup>2</sup>=17,160 lekë taksë trualli.

Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; nenet 29,36,69, 75...; Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar"; Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat"; VKB nr. 107, datë 22.11.2022 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të identifikojë çdo individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e bashkisë, si dhe të planifikojë detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme sipas rastit (pronar/ ose bashkëpronar).

Të marrë masa që të plotësojë dosjet e subjekteve me të gjithë dokumentacionin mbështetës, për saktësimin e sipërfaqeve të cilat shfrytëzohen nga subjektet për qëllime aktiviteti ekonomik si dhe të ndiqen të gjitha procedurat përkatëse administrative dhe ligjore për vendosjen e statusit juridik të tyre, sipas përcaktimit në listën e inventarit të pronave.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**8.2 Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **243,689 lekë** e cila u përket **5** subjekteve që kanë rezultuar me diferencë midis akt verifikimit dhe planifikimit.

**Brenda datës 30.9.2024**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Kavajë me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Kadastrës Urbane gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore në aplikimin e kamatëvonesave dhe mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e tarifave të qirave, etj., duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën **16,326,291 lekë**, konstatuar kjo në **4** kontrata qiraje për pasuritë e llojit "Dyqan", **23** familjare për qiradhënie të banesave sociale, **5** kontrata për fond pyjor/tokë bujqësore, **4** kontrata qiraje për hapësirën e plazhit **3** kontrata hapësira publike.

Gjithashtu është konstatuar se për dyqanet e dhëna me qira nuk është kryer procedura e konkurrimit, kontratat nuk janë sipas formatit të miratuar.

Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Nenin 32 në Ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile", i ndryshuar, Pikën 2 në nenin 89 të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar, Nenin 31 të Ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", për banesat sociale, Pikën 1, pikën 12 në Kreun II të VKM nr.54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enftiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **16,326,291** lekë, nga dhënia me qira e kontratave për dyqaneve për 4 subjektet në shumën **99,360** lekë, nga dhënia me qira e banesave sociale për 21 familjet për shumën prej **4,845,417** lekë, nga dhënia me qira e tokës bujqësore për 5 subjektet në shumën **8,707,016** lekë, nga dhënia me qira e hapësirave stacione plazhi për 4 subjektet në shumën **1,964,100** lekë dhe nga dhënia me qira e hapësirave publike për 3 subjekte në shumën totale prej 710,400, konkretisht për subjektin E.B në shumën 230,400 lekë, D.C në shumën 240,000 lekë dhe B ShPK, në shumën 240,000 lekë.

**Brenda datës 30.9.2024**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nga 1890 subjekte të cilët rezultojnë debitorë në datë 31.12.2022 me vlerë totale 260,840,630 lekë, vetëm për 83 raste ose 4,39 % në vlerën 23,869,875 lekë janë ndërmarrë masa për arkëtimin me forcë të detyrimeve të prapambetura (është ndjekur vetëm hapi i pestë, duke anashkaluar të gjitha hapat sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr. 17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”. **Për vitin 2023** vlera e munguar si pasojë e mos ndjekjes së procedurave për arkëtimin me forcë të detyrimeve është **236,970,755** lekë. Vlera e debitorëve të rritur për vitin 2023 është prej **23,869,875** lekë.

Gjithashtu evidentohen dhe raste që megjithëse subjektet janë debitorë janë lejuar mbyllje aktiviteti, kjo si rezultat i mos bashkëpunimit ne QKB, kjo evidentuar në **25 raste**.

Veprim i cili nuk është në përputhje me nenin 73, neni 89 pika 2, neni 100, i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”; Udhëzimin nr. 17 datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve që lindin për taksa dhe tarifa vendore me qëllim shmangien e mundësisë për çregjistrimin e tyre pa shlyer detyrimet tatimore, për 1,807 subjekte në shumën totale **236,970,755** lekë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**10.2. Rekomandimi:** Bashkia Kavajë të marrë masa të koordinojë punën me institucionet e ndërlidhura me qëllim marrjen dhe dhënien e informacioneve ne kohë reale për mos lejuar mbylljen e subjekteve pa bërë likuidimin e detyrimeve fiskale.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer u konstatua se, Bashkia Kavajë nuk ka bërë arkëtimin e të gjitha masave administrative të vendosura nga IMTV.

Për periudhën janar-dhjetor 2023 nga Inspektorët e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Kavajë, janë proceduar gjithsej **45** subjekte për ndërtime in formale të ndërtuar pa leje ndërtimi dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, janë proceduar **41** subjekte me “Vendim Gjore” me një shumë totale për tu arkëtuar **13,100,000** lekë, nga këto janë ekzekutuar (arkëtuar) vetëm **12** vendime në një vlerë prej **1,400,000** lekë, ndërsa **29** vendime të tjera janë të pa paguara nga subjektet, në një vlerë prej **11,700,000** lekë **duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara.**

Nga auditimi i të dhënave të vëna në dispozicion (mbi gjobat e mbartura 2019-2022) u konstatua se janë gjithsej **69** debitorë, për gjoba të mbartura prej vitit 2019-2022.

Konstatohet se IMTV, ka bërë kërkesë për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit, me qëllim arkëtimin e detyrimeve për **69** debitorë. Gjykata ka pranuar kërkesën për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit për **27** subjekte, në vlerën prej **8,600,000** Lekë.



Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar; Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM-në nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, Ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 150-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1 Rekomandimi:** Drejtoria Juridike dhe IMTV-ja të marrin masa për kryerjen e të gjitha procedurave që ligji parashikon, për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave të vendosura nga IMTV për vlerën **20,300,000 lekë**. Gjithashtu, të merren masat për përlllogaritjen e kamat-vonesës dhe vjeljen e saj në çdo rast që gjobat nuk paguhen brenda afateve të përcaktuara, për vendosjen në dijeni dhe rritjen e bashkëpunimit me Shërbimin Përmbarrimor, si dhe Drejtorinë e Burimeve Ekonomike Bashkia Kavajë.

**Brenda datës 30.12.2024**

#### **D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimit 01.01.2023 – 31.12.2023 nga Bashkia Kavajë janë realizuar në total 7 procedura prokurimi me vlerë të lartë, me fond limit në shumën 777,424,405 lekë pa TVSh dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën 770,116,227.70 lekë pa TVSh, nga të cilat janë audituar të 7 procedurat ose në masë 99 % të fondit limit.

Nga auditimi i 7 procedurave me vlerë të fondit limit 777,424 mijë lekë, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, të 7 procedurat me vlerë kontrate 770,116 mijë lekë ose 99 % e vlerës së Fondit Limit, shkelje të cilat konsistojnë shpallje fitues të OE me kritere të paplotësuara sipas DT, duke çuar në mungesë konkurrence me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **770,116,227 lekë** pa TVSh.

Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenet 1, 2, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe pika 1 neni 21, nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike”, neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 161-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Kavajë dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.

**Menjëherë**

#### **E. MASA DISIPLINORE.**

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, **i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Kavajë** t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në

Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Gjithashtu i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kavajë që bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, si dhe në kontratën e punës, të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Brenda datës 30.9.2024

## F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Kavajë pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të **ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.**

## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### ANEKSET

**Aneksi L1** Tabela përmbledhëse në të cilën paraqiten të dhënat në lidhje me aplikimet dhe miratimet e zhvilluara gjatë vitit 2023, në Bashkinë Kavajë.

Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023 nga sistemi e-Leje

Nr.	Përshkrimi i lejes	Numri i aplikimeve	Numri i miratimeve
1	Certifikatë përdorimi	45	25
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	279	203
3	Leje infrastrukture	-	-
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	88	45
5	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	11	8
6	Leje për ndryshim funksioni	11	5
7	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	40	20
8	Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	13	5
9	Leje përshtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	23	8
10	Leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni	29	12
11	Leje zhvillimi	145	61
12	Njoftim për fillim punimesh	19	14
13	Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	1	1

Nr.	Përshkrimi i lejes	Numri i aplikimeve	Numri i miratimeve
14	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	37	18
15	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	40	21
16	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	12	6
17	Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	4	4

**Aneksi L3** Tabela në të cilën paraqiten lejet e ndërtimit që janë përzgjedhur për tu audituar në bazë të analizës së riskut.

Nr.	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Zhvilluesi	Vendimi i lejes së ndërtimit	Preventivi sipas subjektit
1	Strukture akomoduese 5 dhe 6 kateshe + 2 kat nëntokë parkim	"L "	Vendimi Nr.4881, datë 04/12/2023	345,668,673.26 lekë
2	Strukture akomoduese 5 kat me 1 kat podrum	D	Vendimi Nr. 4249, datë 14/04/2023	487,182,224 lekë
3	Struktura banimi 2 kat + 1 kat nëntokë (podrum)(katër struktura banimi)	R &S.V	Vendimi 4892, datë 09/11/2023	32,197,354.46 lekë
4	Strukturë Turistike, 6 Kat me 1 kat nën tokë	C	Vendimi Nr. 4934, datë 04/01/2023	460,924,555 lekë
5	" Strukturë turistike + hotel 6 kate + duplex (8 kate) + ambjente funksionale (teknike) + 1 kat nëntokë "	"B "Shpk	Vendimin Nr.4653 , datë 18/07/2023	Certifikatë përdorimi

## Anekse Buxheti

Aneksi nr.1

Ndryshimet buxhetore për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate vitit		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr/ datë	Vlera	Nr/ datë	Vlera	Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull (me emër)			
					SHTESA art.	shuma	PAKSIME art.	shuma
2023	VKB nr.160 Dt.27.12.2022	1,148,819						
			Shkrese 1102 Dt.15.03.2023	2,000	606	2,000	602	2,000
			Shkrese nr.5367 Dt.31.10.2023	200	606	200	602	200
			Shkrese nr.1529 Dt.18.04.2023	400	601	400	600	400
			Shkrese nr.1560/2 Dt.04.05.2023	73	231	73	602	73
			Shkresa 3564, Dt.16.08.2023	100	602	100	606	100

	VKB nr.16 Dt.20.02.2023	630,530					
	VKM 328 Dt.31.05.2023	18,037					
	VKM 681dt.06.12.2023	713,796					
	VKM 687dt.06.12.2023	168,314					
	Shkrese nr.2090111 Dt.04.12.2023	908					
	Shkrese nr.182 Dt.10.01.2024	32,926					

## Aneksi nr.2

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/ lekë

nr	Emërtimi I llogarive ekonomike	Plani	Fakti	Diferenca	Realizimi ne %
1	Paga 600	445,307	417,434	-27,873	94
2	Sigurime shoqërore 601	78,226	69,874	-8,352	89
3	Shp.Oper.602+F.Rezervë	741,568	476,070	-265,498	64
4	Kredia+Interesi 166-651 (CEB)	0	0	0	0
5	K. Q Emergj Civile 604	908	908	0	100
6	Nd/Ekonom invalid 606+te tjera	0	0	0	0
	a. Nd/Ekonom invalid 606+të tjera	161,769	37,018	-124,751	23
	b. Bonus qeraje+bursa+ndihmë financiare+bonuse nga rindërtimi	0	0	0	0
7	Investime 230-231	1,285,552	1,054,607	-230,945	82
	<b>Totali</b>	<b>2,713,330</b>	<b>2,055,911</b>	<b>657,419</b>	<b>76</b>

## ANEKSE BUXHETI 2

### Aneksi 3.6

Me burim financimi të ardhurat e veta (*ardhurat e veta + transferta e pakushtëzuar+transferta specifike*) janë planifikuar 18 projekte investimesh (përfshihen 16 projekte investimesh me vlerë kontrate 148,685,374 lekë nga këto janë realizuar për vitin 2023 projekte investimesh me vlerë kontrate **21,844,800** lekë dhe ka mbetur pa u likuiduar në datë 31.12.2023 vlera prej 21,041,045 lekë. Për këto 2 investime janë lidhur kontratat në vitin 2023 dhe për 16 investime janë lidhur kontrata para vitit 2023, por që ka vazhduar realizimi dhe financimi dhe në vitin 2023.

#### Investime të trashëguara

Nr.	Paguar deri me 31.12.2022	Paguar 2023	Objekti I Kontrates	Vlera e Kontrates	Vlera e Mbetur 196ontratës më 31.12.2023
1	10,971,000.00	5,145,000.00	Blerje Pemesh	16,116,000.00	-
2	1,439,330.00	2,000,000.00	Rehabilitimi sistemim varrezave	3,439,330.00	-
3	56,568,576.00	15,077,824.00	Rehabilitimi 196ontratës LED	73,646,400.00	2,000,000.00
4	2,890,641.00	9,791,664.00	Shpronësime Unaza Lindore	15,134,369.00	2,452,064.00
5	0	96,000.00	Blerje Karrige Zyre	96,000.00	-
6	4,000,000.00	2,661,260.00	Rikonstruksioni 196ontrat te qytetit Beqiri Shpk	6,661,260.00	-
7	0	0	Mbikqyrje Parku Rekretaiv	111,086.00	111,086.00
8	0	1,952,050.00	Rikonstruksion 196ontrat Nektari I Jetes	1,952,050.00	0
9		2,270,400.00	Rkonstruksion i 196ontra se Çetes	3,198,000.00	927,600.00

10	3,026,160.00	1,308,372.00	Rikonstruksion i 197ontra se Fshatit Qerret	13,483,111.00	9,148,579.00
11	0	339,600.00	Mbikq.Kinoteatri Aleksander Miosiu	339,600.00	-
12	0	30,000.00	Kolaudim Shetitorja Nr.2	30,000.00	-
13	0	90,908.00	Kolaudim+Mbikq Shkolla Golem	113,568.00	22,660.00
14	0	1,368,000.00	Mbikq+Kolaudim 197ontra Kla&Xhu dhe Teqja	1,368,000.00	-
15		73,000.00	Blerje Pajisje Shtepiake	73,000.00	
16	6,617,544.00	0	Rikonstruksioni I 197ontra Drita	12,996,600.00	6,379,056.00
	<b>85,513,251.00</b>	<b>42,204,078.00</b>	<b>TOTALI</b>	<b>148,685,374.00</b>	<b>21,041,045.00</b>

**Investimet  
2023**

Nr.	Paguar deri me 31.12.2022	Paguar 2023	Objekti i Kontrates	Vlera e Kontrates	Vlera e Mbetur 197ontratës më 31.12.2023
1	0	14,704,800.00	Sinjalistika	14,704,800.00	-
2	0	7,140,000.00	Blerje Mjete Transporti	7,140,000.00	-
	<b>TOTALI</b>	<b>21,844,800.00</b>		<b>21,844,800.00</b>	0

**Aneksi 3.7**

Për **AKUM** janë planifikuar dhe realizuar fonde per 9 projekte investimesh të ndara në rikonstruksione, mbikqyrje dhe kolaudime për të cilat cila është deleguar vlera prej 262,459,093 lekë. Për këto investime janë lidhur kontratat nga viti 2019 deri në vitin 2022 dhe pagesat janë të ndara sipas viteve në vitin 2020 në vlerë 313,420,404 lekë; në vitin 2021 në vlerën 291,834,364 lekë; në vitin 2022 në vlerën 95,373,168 lekë dhe në vitin 2023 në vlerën 262,459,093 leke. Nga totali i vlerave të kontratave ka mbetur 231,691,721 lekë që pritet të paguhen pasi të transferohen fondet nga ministria e linjës.

Në 000/lekë

N r.	Objekti i kontratës	Fond Planifikim	Kontrata me subjektin			Subjekt i kontraktuar	Paguar sipas periudhave				Mbetja 31.12.2023
			Nr. /datë lidh kontratës	Afati	Vlerë kontrate me TVSH		Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	
1	Rik i rrjetit shpërndarës për furnizimin me ujë të qytetit Kjë dhe ndërtimi i depo uji të re, Faza II	195,279	1534/2 prot date 07.05.2020	12 muaj	789,941,722	G. COMPANY	258,282	190,000	40,000	195,279	106,379
2	M:Rik i rrjetit shpërndarës për furnizimin me ujë të qytetit Kjë dhe ndërtimi i depo uji të re, Faza II	500	1534/1 date 07.05.2021	12 muaj	5,257,800	A. Mk &I. D. Alb		700	400	500	3,657
3	Kolaudim: Rik i rrjetit shpërndarës për furnizimin me ujë të qytetit Kjë	-	3892/1 prot date 26.12.2022	10 ditë	807,241	F. Sh.			807		-

N r.	Objekti i kontratës	Fond Planifikim	Kontrata me subjektin			Subjekt i kontraktuar	Paguar sipas periudhave				Mbetja 31.12.2023
			Nr. /datë lidh kontratës	Afati	Vlerë kontrate me TVSH		Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	
	dhe ndërtimi i depo uji të re, Faza II										
4	Furnizimi me uje ne zonat bregdetare, Plazhi Gjeneral-Bardhor-Karpen-Synej Bashkia Kavaje, Loti I	41,422	509/3 prot date 12.05.2021	8 mu aj	188,549,796	B B Shpk& D. Company Shpk	-	65,000	38,365	41,422	43,761
5	M" Furnizimi me uje ne zonat bregdetare, Plazhi Gjeneral-Bardhor-Karpen-Synej Bashkia Kavaje, Loti I	400	1128/4 date 27.05.2021	8 mu aj	2,580	C Shpk		639	500	400	1,041
6	Riparimi impiantit te ujerave te zeza KJ & ujesjellesi I fshatit Luz lidhjet dhe matesat familjare Bashkia KJ	20,000	508/3 date 23.04.2021	12 mu aj	145,235	A. K. Shpk	-	35,006	15,000	20,000,000	75,228
7	"M :Riparimi impiantit te ujerave te zeza KJ & ujesjellesi I fshatit Luz lidhjet dhe matesat familjare Bashkia KJ		1129/4 date 27.05.2021	12 mu aj	2,411	Gj. & co Shpk		488	300	-	1,623
8	Rikonstrukcion I linjese puseve	4,447	3509/2 Dt.10.1.0.2019		59,585	B Shpk	55,137			4,447	-
9	Mbikqyrje Rikonstrukcion I linjese puseve	409	3509/1 Dt.10.1.0.2019		409	D. Shpk				409	-
Totali i vitit 2022		262,459			1,194,778		313,420	291,834	95,373	262,459	231,691

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.**

# **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**